



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA KORÇË**  
**DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT**  
**TË TERRITORIT**

Adresa: Rr. "28 Nëntori" Nr. 1, Kodi postar 7001, Tel.: ++355 (0) 82 245 755/243 382, ++355 (0) 822 43353, e-mail: info@bashkiakorçe.gov.al, web: http://www.bashkiakorçe.gov.al/

**DOKUMENTI**  
**I STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT**  
**TË TERRITORIT**

**MIRATOHET**  
**KRYETARI I K.K.T**  
**Z. EDI RAMA**

**MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN**  
**Znj. EGLANTINA GJERMENI**

**KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË**  
**Z. ILIR BAJLOS**

**KRYETARI I BASHKISË**  
**Z. SOTIRAQ FILO**

Miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë Korçë

Nr. \_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

<b>Hartuar nga</b>	<b>Bashkia KORÇË</b>
<b>Mbështetur nga</b>	<b>BOLLES &amp; WILSON GMBH &amp; CO</b> <b>dhe IDRA sh.p.k</b>

## Pasqyra e Lëndës

Pasqyra e Lëndës.....	2
Autorësia dhe grupi i punës .....	4
Shënim .....	5
Fjala e kryetarit .....	6
Parathënie.....	7
I. Gjendja ekzistuese dhe problematikat e territorit .....	8
1. Vështrim i përgjithshëm .....	8
1.1 Historik i përgjithshëm i zhvillimit të Korçës .....	15
1.2 Profilët e njësive administrative .....	18
1.3. Analiza Metabolike e Flukseve .....	57
2. Instrumentet dhe çështjet që influencojnë planifikimin e territorit .....	74
2.2 Strategjitë dhe programet ndërkombëtare.....	74
2.3 Analiza e instrumenteve në nivel kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre	76
3. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore .....	102
3.1 Topografia dhe Relievi .....	102
3.2 Klima .....	109
4. Mjedisi dhe Ekosistemet .....	122
4.1 Habitati dhe biodiversiteti .....	122
4.2 Territori dhe nëntoka .....	131
4.3 TEKTONIKA .....	140
4.4 Burimet Ujore .....	147
4.5 Pasurite Minerale .....	157
5. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura .....	168
5.1 Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës .....	168
5.2 Furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza dhe infrastruktura e vaditjes dhe e kullimit të ujërave për tokat bujqësore .....	179
5.3 Rrugët dhe transporti .....	185
6. Zhvillimi Social dhe Ekonomik .....	189
6.1 Sektoret Ekonomike .....	189
Struktura e Bizneseve .....	191
Bujqësia .....	195
Agro-perpunimi .....	196

Turizmi .....	197
Industria Minerare .....	198
Industria e konfeksioneve .....	199
Sektori i Ndërtimit .....	199
6.2 Situata Social-Ekonomike .....	200
Arsimi .....	200
Shendetesia .....	204
Punesimi .....	204
Mireqenia Social Ekonomike .....	206
Mbrojtja shoqërore dhe varfëria .....	206
Aftësia e kufizuar .....	208
Shërbimet e Kujdesit Shoqëror .....	208
Strehimi .....	210
Demografia .....	211
7. Situata financiare e bashkisë .....	218
7.1 Shpënzimet dhe Investimet .....	218
8. Analiza SWOT .....	225
II. Vizioni i Bashkisë Korçë .....	230
Parimet e Planit Strategjik (per tu diskutuar) .....	231
III. Dimensionet Strategjike .....	232
IV. Plani Strategjik, Objektiva dhe Programe .....	237
V. Projektet test .....	259
VI. Vlerësimet e qytetarëve .....	279
9. Anketat dhe rezultatet e nxjerra prej tyre .....	279
9.1. Objektivat dhe metodologjia .....	279
9.2. Rezultatet .....	279
10. Degjesa publike me qytetarët .....	286
VI ANEKS .....	288
1. Platforma GIS .....	288
2. Materiale nga konsultimet .....	297
3. Lista e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar .....	309
4. Vendime të KKT-së dhe KRrTRSh-së 1993-2015 për gjithë territorin e Bashkisë Korçë .....	316
Shënime dhe referenca .....	318

## Autorësia dhe grupi i punës

Ky dokument u përgatit në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Korçë, në zbatim të Ligjit nr.107, datë 31.07.2014, për “Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM nr.671, dt.29.07.2015, për “Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, shtojca 1, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Nr. Prot. 184/7, datë 13.01.2016 “Hartimi i Planeve të Përgjithshme Vendore për Bashkitë: Pogradec, Korçë”, si dhe në zbatim të Termave të Referencës “Shërbim i Konsulencës për Hartimin e Planeve të Përgjithshme Vendore për 26 Bashki në Republikën e Shqipërisë (në Lote)”.

Në përputhje me termat e mësipërme të referencës ky dokument është hartuar nga grupi i punës, i përbërë nga grupi teknik i specialistëve të Bashkisë Korçë, grupi i ekspertëve të studiove të konsulencës, konsorciumi Bolles+Wilson gmbH&CO dhe IDRA shpk, si dhe me ndërmjetësimin dhe mbështetjen teknike të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Grupi i punës:

Bashkia Korçë

Bolles+Willson dhe IDRA

Eriselda Çobo, Shkëlqim Zeqo, Myslim Pasha, Sazan Guri, Elira Caushi, Auron Pasha, Kedis Burrja, Ledina Mahmutaj, Stela Daiu



## Shënim

Ky dokument përmban dokumentet kryesore të strategjisë territoriale të për zhvillimin e 15 viteve të ardhshme të Bashkisë Korçë, reformuar sipas Ligjit nr. 115, datë 31.7.2014, për “Ndarjen Administrativo-Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Përmbajtja e këtij dokumenti është hartuar në përputhje me atë të parashikuar në termat e referencave sipas V.K.M. nr.670, datë 29.07.2015 "Për ngarkimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për hartimin e planeve të përgjithshme vendore deri për 26 bashki”, për Lot 8 (Korçë, Pogradec) duke iu referuar V.K.M. nr. 671, datë 29.07.2015, për “Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, shtojca 1.

Dokumenti i Strategjisë Territoriale është strukturuar sipas Rregullores së Planifikimit dhe konsiston në dokumentin e *Analizës Metabolike të territorit*, që i paraprin *Strategjisë Territoriale, Vizionit Strategjik e Objektivave të Zhvillimit të Bashkisë*, si dhe *Planin e Veprimeve Strategjike me Projektet Test* për zhvillimin e territorit.

Për përmbushjen e nevojave aktuale të studimit dhe cilësisë së vlerësimit të gjendjes ekzistuese, përmes asistencës së studiove konsulente, janë kryer edhe analiza të tjera në ndihmë të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkinë, si *Anketa “Vlerësimi dhe Prioritetet e Qytetarëve”* dhe *Profile të Territorit të ri për Vlerësimin e Njësive Administrative*.

## Fjala e kryetarit

## Parathënie

Strategjia Territoriale është një nga dy dokumentet kryesore përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë. Dokumenti i strategjisë synon të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit të territorit brenda afatit të tij të vlefshmërisë, i cili zgjat 15 vite që nga dita e miratimit të tij.

Ky dokument i ofron lexuesit/përdoruesit që nga njëra anë të krijojë një panoramë të shkurtër të përgjithshme analitike të gjendjes ekzistuese të bashkisë, ndërsa nga ana tjetër të kuptojë drejtimet e ardhshme të zhvillimit në territor përmes vizionit të zhvillimit.

Gjendja ekzistuese është bazuar në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Gjendjes Ekzistuese të Bashkisë, dokument i hartuar gjatë fazës së parë të këtij projekti, i cili ka patur synimin grumbullimin dhe shqyrtimin e të gjithë informacionit ekzistues nga institucionet shtetërore sipas ligjeve në fuqi për të siguruar të dhënat e nevojshme për hartimin e Strategjisë Territoriale në fazën e dytë dhe Planit Territorial në fazën e tretë të këtij projekti. Gjetjet më kryesore prej tij shpalosen në kapitullin e parë të këtij dokumenti në mënyrë të përmbledhur. Për të kuptuar më mirë vlerësimin e gjendjes ekzistuese në territorin e ri të bashkisë, i cili në rastin konkret është rreth 38 herë më i madh, janë prodhuar disa profile për secilën prej njësive të reja administrative që ia janë shtuar territorit të bashkisë së re. Këto profile janë prodhuar nga bashkëpunimi i drejtpërdrejt i stafit të Bashkisë Korçë me ekspertët e studiove konsulente. Metodologjia e gjenerimit të gjetjeve është bazuar te vizita të drejtpërdrejta në zyrat e njësive administrative, konsultime me personelin dhe të dhënat e administratës në kohën e takimeve, vizita e studim i drejtpërdrejt i territorit të njësisë dhe takime të rastësishme me qytetarët.

Drejtimet kryesore të zhvillimit të synuar për 15 vitet e ardhshme të Bashkisë Korçë shtjellohen në kapitujt e tjerë të këtij dokumenti, duke filluar nga ai i Vizionit. Vizioni paraqet në mënyrë të përmbledhur rezultatin e zynuar nga të gjitha veprimet e nevojshme për t'u ndërmarrë gjatë kësaj periudhe. Thënë ndryshe, Vizioni zërthehet në dimensione të përgjithshme zhvillimi, mbi bazën e të cilave janë hartuar objektivat strategjike për secilin dimension. Çdo objektiv strategjik duhet të trajtohet me programe specifike dhe të konkretizohet me projekte të veçanta sipas një plani veprimi të ndarë në faza dhe të shtrirë në kohë.

Zhvillimi i ardhshëm i bashkisë, nga termat e planifikimit strategjik të këtij dokumenti do të përkthehet në terma vazhdimisht të ndryshueshme territoriale të cilat specifikohen në Planin Territorial dhe menaxhohen drejtpërdrejt nga strukturat e Bashkisë Korçë.

## I. Gjendja ekzistuese dhe problematikat e territorit

### 1. Vështrim i përgjithshëm

Bashkia Korçë shtrihet në Rajonin Juglindor të Shqipërisë. Ajo ka një shtrirje veri – jug 32km dhe lindje – perëndim 40km, me një sipërfaqe territoriale prej 730 km<sup>2</sup>. Kjo pozitë gjeografike ka luajtur një rol përcaktues në zhvillimin social, ekonomik dhe kulturor të saj. Nëpërmjet rrjetit rrugor, Korça lidhet me metropolin, Tiranën, në veri dhe qendrën e jugut, Gjirokastrën. Pozita gjeostrategjike në të cilën ndodhet Bashkia Korçë, në një zonë ndërkufitare me Greqinë dhe FYROM, ka bërë që në territorin e saj të kalojnë akse të rëndësishme të transportit, të cilët lidhin Shqipërinë me Ballkanin Juglindor e më gjerë.

Qyteti i Korçës konsiderohet një qendër urbane e rëndësishme kombëtare dhe një prej kryeqendrave të Shqipërisë. Pellgu i Korçës ka një lartësi mesatare prej 850m mbi nivelin e detit. Nga të gjitha anët e rrethojnë male të larta: në anën lindore ngrihet vargmali i Moravës, me lartësi 1800m, në verilindje Mali i Thatë, me lartësi 2262 m, nga perëndimi mbyllet me malet e Gorës, Voskopojës dhe Vithkuqit, në jug lartësohen malet e Qarrit, ndërsa nga veriu përfundon me kodrat shtufore të Grabovicës. Malet që e rrethojnë e zbutin rënien e tyre drejt fushës nëpërmjet një vargu kodrash, si kodrat e Shën Thanasit dhe Shëndëllisë mbi qytetin e Korçës, kodrat e Dvoranit dhe të Kamenicës etj. Nëpërmjet tyre dhe grykave që përshkojnë e ndajnë malet e vargmalet, pellgu i Korçës lidhet me pellgjet e tjera në afërsi. Gryka e Cangonjit, ndërmjet Malit të Thatë dhe vargmalit të Moravës, e lidh me pellgun e Devollit, pragu i Qarrit me atë të Kolonjës, ndërsa nëpërmjet sistemit kodrinor të Grabovicës kalon rruga për në pellgun e Pogradecit.

Fusha e Korçës ka një sipërfaqe përgjithësisht të rrafshët, me pjerrësi të lehtë në drejtim të veriut. Ajo përshkohet nga një rrjet përrenjsh që zbresin nga faqet e maleve, veçanërisht ato të Moravës. Përrenjtë derdhin ujërat e tyre në dy lumenjtë më të rëndësishëm të fushës, në lumin Devoll që e përshkon fushën nga lindja në perëndim dhe në atë të Dunavecit, që rrjedh nga jugu në veri dhe derdhet në Devoll. Fusha e Korçës është shumë pjellore. Kulturat më të përhapura janë gruri, elbi, misri, patatja, panxhari, fasulja etj. Prodhime të bollshme dhe të një cilësie të mirë japin perimet, sidomos qepët, lakrat, preshtë, domatet e specat, ndërsa në prodhimin e frutave dallohet për mollët, kumbullat, dardhat, por kultivohen gjithashtu dhe qershitë, ftonjtë, manat, arrat etj.

Një sipërfaqe të konsiderueshme zinin dhe vreshtat, të cilat vishnin shpatet e kodrave, si ato mbi qytetin e Korçës, mbi fshatrat Voskop e Vinçan etj. Nisur nga karakteristikat e relievit dhe lartësia mbi nivelin e detit, që i jep zonës karakter malor, vendbanimet janë vendosur në pjesën më të

madhe në zonat me kushte natyrore të përshtatshme për të jetuar. Në varësi të vendosjes së tyre dallohen tre tipe vendbanimesh: Vendbanime fushore të vendosura në fushëgropa, gropa dhe luginat e lumenjve (qyteti i Korçës, fshati Bulgarec, etj); Vendbanime kodrinore, fshatrat Mborje, Drenovë, Boboshticë etj; Vendbanime malore, Voskopojë, Dardhë, Vithkuq etj., të cilat shtrihen mbi 1000 m mbi nivelin e detit<sup>1</sup>.




Figura 1 Bashkia e Korçës në kontekstin rajonal

Me miratimin e Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative- territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Korçë përbëhet nga tetë njësi administrative. Në territorin e saj tashmë përfshihet jo vetëm territori i qytetit të Korçës, por dhe territori i 63 fshatrave. Në mënyrë analitike, përbërja e Bashkisë Korçë jepet në figurën e mëposhtme:

Tabela 1 Njësitë Administrative të Bashkisë Korçë dhe fshatrat përkatës<sup>2</sup>

Njësia Administrative	Drenovë	Mollaj	Qëndër Bulgarec	Vithkuq	Voskop	Voskopojë	Lekas
Fshatrat	Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë	Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë	Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht	Vithkuq, Leshnje, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabockë, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë	Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë, Goskovë lart, Goskovë poshtë, Damjanec	Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadh, Lavdar	Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozan, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar Brozdovec, Mazrek, Poponivë



Figura 2 Territori i Bashkisë Korçë sipas ndarjes së re administrative

Qyteti i Korçës është qendra e Qarkut të Korçës dhe Rajonit të Korçës. Rajoni i Korçës është fqinj me Rajonin e Elbasanit në Veriperëndim, Rajonin e Beratit në Perëndim, Rajonin e Gjirokastrës në Jugperëndim, ndërsa ai ka kufinj shtetërore me Maqedoninë në verilindje dhe Greqinë në juglindje. Rajoni i Korçës përfshin katër nënprefektura; Korçën, Pogradecin, Devollin dhe Kolonjën.






**Figura 3 Qarku i Korçës në kontekstin kombëtar të ndarjes në qarqe<sup>3</sup>**

Qyteti i Korçës është një qendër kryesore urbane e pjesës juglindore të Shqipërisë përse i përket madhësisë, popullsisë, administrimit, aktiviteteve ekonomike dhe kulturore. Qyteti është vendi ku ofrohet një numër i madh shërbimesh, aktiviteteve dhe lehtësirash që janë të lidhura jo vetëm me qytetin por edhe në pjesë të tjera të rajonit. Këtu përfshihen: shërbimet publike dhe administrative (Universitet, Spitali Rajonal, Gjykata e Apelit, Zyrat e Qarkut, Zyrat e Shërbimeve Publike, etj), aktivitetet ekonomike (aktivitete industriale dhe të shitjes me shumicë, pazari, bankat, aktivitete biznesi të mesme dhe të vogla); institucione kulturore (si: muzeume, biblioteka); disa aktivitete dhe ekspozita rajonale (karnevalet, festivali i birrës, etj). Roli thelbësor i Korçës në zhvillimin rajonal bazohet në tri kolona kryesore: (1) si një qendër e zhvillimit ekonomik rajonal, (2) si një qendër e zhvillimit të turizmit, dhe (3) si një qendër administrative dhe arsimimi.

Në nivelin ndër-vendor, Korça është pjesë e një rrjeti më të gjerë të qyteteve Shqiptare me madhësi mesatare dhe të vogël si Pogradeci, Erseka, etj., ndërsa historikisht ajo ka qenë pjesë e një rrjeti ndër-rajonar të qendrave urbane në Maqedoni dhe Greqi, përfshirë këtu Ohrin, Manastirin,

Kosturin, Follorinën, Shkupin dhe Selanikun. Prej vitit 1990, lidhjet ndër-rajonale janë rritur dukshëm dhe përbëjnë akse të rëndësishme potenciale për zhvillimin e ardhshëm të saj<sup>4</sup>.



**Figura 4 Hartë e monumenteve kulturore e natyrore në territorin e Bashkisë Korçë**

Në vazhdim, Korça mbetet një qendër rajonale për artet dhe kulturën në Shqipërinë juglindore, duke ndjekur traditën e saj të gjatë. Qyteti i Korçës në vetvete është një vend tërheqës turistik, duke ofruar një imazh të veçantë dhe identitet urban, si edhe shumë asete kulturore, siç janë pazari i qytetit, një ansambël i ndërtuar në shekullin e 19<sup>të</sup>, dhe disa muzeume. Në afërsi të Korçës gjendet një larmi unike e aseteve kulturore. Ndërmjet vendbanimeve që e rrethojnë ia vlen të përmendet Voskopoja, e cila ishte një qendër e madhe kulturore dhe tregtie e shekujve të 17<sup>të</sup> dhe 18<sup>të</sup>, dhe Dardha e cila është një vendbanim tradicional malor që ofron një mjedis kulturor dhe natyror të cilësisë së lartë dhe objekte për ushtrimin e sporteve dimërore. Rajoni i Korçës përmban shumë qendra arkeologjike, siç janë Tumat e Kamenicës, pranë Mollajt, e cila daton në Periudhën e Bronxit. Disa vendbanime siç janë Vithkuqi, Mborja and Boboshtica ofrojnë mjedis tradicional me shtëpi guri, oborre dhe rrugë të shtruara me gurë, si edhe monumente për tu vizituar nga periudha Bizantine dhe ajo Osmane. Së fundmi, rajoni i Korçës është i njohur për shumë produkte lokale si rakia dhe “Birra Korça”.



Thuajse 75% e tokës së rajonit në total mbulohet me kodra dhe male. Megjithatë, cilësia kryesore e mjedist natyror korçar është fusha e madhe e Korçës, që ndodhet në 850m mbi nivelin e detit. Kjo pllajë përbën sipërfaqen e dytë më të madhe bujqësore të Shqipërisë, ndërsa pjesa më e madhe e saj është një ish-kënetë, e bonifikuar mbas Çlirimit. Një përqindje e madhe e tokës bujqësore përreth Korçës aktualisht është jo plotësisht e shfrytëzueshme, për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe emigracionit të madh. Përreth Korçës ka shumë pyje. Një prej kërcënimeve kryesore mjedisore është aktualisht degradimi i pyjeve si rrjedhim i prerjes masive të tyre për ngrohje shtëpiake.

Tabela 2 Shpërndarja e përdorimit të tokës në rajonin e Korçës<sup>5</sup>

Nën - prefektura	Sasia e tokës (ha)	Tokë e kultivuar (ha)		Tokë pyjore (ha)		Kullota & livadhe (ha)		Të tjera (ha)	
<b>Korça</b>	172,478	44,207	26%	54,900	32%	23,604	13%	49,767	29%
<b>Pogradeci</b>	71,541	17,506	24%	27,330	38%	5,364	7%	21,341	31%
<b>Devolli</b>	41,542	13,148	32%	15,165	37%	3,022	7%	10,207	24%
<b>Kolonja</b>	80,463	11,247	14%	34,680	43%	21,742	27%	12,794	16%
<b>Totali (si Rajon)</b>	<b>366,024</b>	<b>86,108</b>	<b>24%</b>	<b>132,075</b>	<b>36%</b>	<b>53,732</b>	<b>14%</b>	<b>94,109</b>	<b>26%</b>





Figura 5 Qyteti i Korçës në basenin e Korçës<sup>6</sup>

Korça është pjesë e një rrjeti të gjerë vendbanimesh, zhvillimi i të cilëve është i lidhur ngushtë me zhvillimin e qytetit dhe anasjelltas. Tendencat e urbanizimit kanë ndjekur kryesisht zhvillimin informal prej fillimit të viteve '90 dhe janë të dukshme në qendrat kryesore urbane të Korçës dhe të Pogradecit. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të zhvillimit linear përgjatë akseve rrugore rajonale dhe kombëtare si çdo ndërtim informal ose jo në Shqipëri, si shkak i mungësës së zhvillimit të infrastrukturave kryesore në zona të reja urbanizimi. Prej fillimit të viteve '90, përgjatë aksit Korçë – Maliq (rruga në drejtim të Tiranës) dhe aksit Korçë – Bilisht (aksi në drejtim të Greqisë) janë vendosur shumë shërbime. Zhvillimi i Qytetit të Korçës në mënyrë specifike prek dhe ndikohet nga zhvillimi i zonave të banuara përreth, ish-Komunat që tashmë janë pjesë e Bashkisë së re. Kështu zonat e Drenovës dhe të Bulgarecit që ndodhen ngjitur me qytetin e Korçës dhe në veçanti fshatrat e Mborjes, Barçit, Ravonikut dhe Turanit, varen drejtpërdrejt nga Korça, si rezultat i përdorimit të tokës ujëqësore, marrëdhënieve të pronësisë dhe pozicionit gjeografik.



## 1.1 Historik i përgjithshëm i zhvillimit të Korçës

*Zonim sipas moshës së objekteve në qytetin e Korçës*



Në periudhën e Antikitetit territoret e trevave të Korçës përfshiheshin në mbretërinë e parë ilire të udhëhequr nga Bardhyli. Në periudhën e Mesjetës treva e Korçës ka qenë nën zotërimin e familjes së Muzakajve, ndërsa nga viti 1391 deri më Shpalljen e Pavarësisë 1912, gjithë krahinat e Korçës u vunë nën qeverisjen e perandorisë turke. Në këtë periudhë këto krahina u përfshinë në sanxhakun e Manastirit dhe të Ohrit.

Në vitin 1827 Korça u bë nënprefekturë dhe më 1870 prefekturë, në të cilën përfshiheshin nënprefektura e Kosturit, Bilishtit, Kolonjës dhe krahina e Oparit. Në vitet 1916-1920, Korça përmendet si kryeqytet i republikës me qeverisje shqiptare, nën kujdesin e ushtrisë franceze. Pas vitit 1920 Korça dhe trevat e saj, përfshihen brenda territorit të Shqipërisë, nën organizimin administrativ të prefekturës. Nga viti 1958 deri në vitin 1990 ndarja administrative në të gjithë

Shqipërinë, përfaqësohej nga rrethe, qytete, fshatra të bashkuar dhe fshatra. Është e mundshme që zanafilla e qytetit mesjetar të Korçës të ketë qenë kalaja, për të cilën bëhet fjalë në regjistrin e vitit 1431-1432.


Vendosja nga turqit e qendrës së krahinës nuk ishte e rastësishme. Këtu ata gjetën një qendër të formuar të rëndësishme ekonomike, në një pozitë të favorshme me kala e Pazar dhe me ekonomi të fuqishme pranë, siç ishin fshatrat e Mborjes e Peshkopisë. Këtu ishte gjithashtu dhe një qendër e rëndësishme shoqërore, si qendër peshkopate e krahinës. Fundi i shek. XV shënon një moment të rëndësishëm për historinë e Korçës. Në vitin 1484, sulltan Bajaziti II i dhuron Mirahor Iliaz Beut për merita shërbimi, fshatrat Leshnjë dhe Vithkuq, ndërsa në vitin 1486 edhe fshatin Boboshticë. Këtyre iu shtuan fshatrat Trebickë, Treskë, Vodicë, Stratobërdhë dhe Panarit. Në vitin 1495, fshatrat Treskë e Panarit u shkëmbyen me fshatin Peshkopi.

Në Peshkopi, u krijua një qendër e re tregtare e shoqërore, e pajisur me treg, faltore, imaret e shkollë, pra një qendër me frekuentim të shpeshtë. Territori i Peshkopisë ishte tepër i gjerë dhe nga dokumente historike mësojmë se ai kufizohej nga Mborja, Barçi e Bulgareci, pra shtrihej në një territor, i cili përkonte me atë që përfshin qytetin e sotëm. Me stabilizimin e pushtetit qendror dhe me zhvillimin e përgjithshëm të qyteteve shqiptare, edhe Korça do të ketë pasur një rritje të qëndrueshme dhe do të ketë përfshirë në përmbajtjen e sa edhe fshatin Peshkopi, i cili në dokumentacionin e mëvonshëm nuk përmendet më.

Nga një dokument i viteve 1647-1648, mësojmë se tregtarët elbasanas për të shkuar në Venedik në kohën e luftës veneto-turke (1644-1669), kur siç duket porti i Durrësit ishte i mbyllur, ndiqnin rrugën shumë të gjatë Elbasan-Korçë-Sajadhë-Korfuz\_Venedik. Gjatë rrugës, në tregun e Korçës ata blinin prodhime blegtorale, prodhime zejtarie dhe shisnin prodhime manufakture të sjella nga Venediku. Burim i rëndësishëm informacioni për jetë shoqërore, kulturore dhe ekonomike të qytetit gjatë shek. XVIII-XIX është sidomos Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit. Në fillim të shek. XIX, konsulli francez Pukëvil jep për Korçën këto të dhëna: ka pesë kisha, një xhami dhe 1300 familje, ndërsa anglezi Lik e çmon Korçën me 450 shtëpi. Në rastin e dytë, pak më sipër njoftimit për numrin e shtëpive, autori bën fjalë për një epidemi murtaje që kishte rënë në qytet 8 muaj përpara arritjes së tij. Kjo do të thotë se është shkaktuar ndonjë braktisje e qytetit. Megjithatë, nuk është për t'u habitur për ritmet e ulta të shtimit të popullsisë në atë kohë. Përveç sëmundjeve, qyteti vuante ende nga dhuna e feudalëve, bejlerëve dhe derebejve, të cilët caktonin haraçe të rënda dhe plaçkitnin herë pas here. Nga sulmet e tyre u shkatërruan qytete të fuqishme si Voskopoja.

Mesi i shek. XIX e gjeti Korçën në lulëzim e sipër, që tërhiqte gjithnjë e më tepër banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Në vitin 1859 Korça numëronte 10000 banorë, më 1879 qyteti kishte 1500

shtëpi e 13000 banorë. Në fillim të shek. XX popullsia e këtij qyteti kishte arritur në 15000 banorë, kurse më 1923 arriti në 25598 banorë dhe të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë. Por ky numër kaq i madh ka përfshirë dhe shtesën e popullsisë së fshatrave të djegur gjatë luftrave ballkanike e botërore që gjeti strehë në Korçë, sepse më 1927 qyteti numëronte 19491 banorë, numër të cilin, me ndryshime të pakta e ruajti deri në prag të Çlirimit. Popullsia erdhi duke u rritur pas çlirimit të vendit dhe në vitin 1968 qyteti kishte 46 300 banorë. Aktualisht me një popullsi prej 86.739 banorë, qyteti i Korçës është qendra e qarkut dhe një ndër qytetet më të rëndësishme të vendit, i dalluar tradicionalisht për rolin e saj në zhvillimin ekonomik, arsimor dhe kulturor kombëtar.



## 1.2 Profilet e njësive administrative

Me implementimin e reformës Administrativo-Territoriale, ndryshimet në sipërfaqe të kufinjve të rinj administrativ të njësive të qeverisjes vendore kanë sjellë shumë ndryshime, të cilat përbëjnë në vetvete vështirësi dhe sfida të reja. Një ndër më të rëndësishmet që është vëzhguar ka të bëjë me nivelin e informacionit për shtrirjen e re territoriale.

Në rastin konkret, Korça ka përfituar një sipërfaqe 38 herë më të madhe administrimi territorial krahasuar me atë që kishte përpara reformës. Por ndërkohë që përvoja e gjatë e bashkisë në territorin e vjetër, e cila përkon me zonën e qytetit, është reflektuar me njohuri të thelluara dhe shumë-përmasore të akumuluar ndër vite, në territorin e ri që zë krahasimisht sipërfaqen më të madhe në terma territorial nuk ndodh e njëjta gjë. Kjo ndodh për shumë arsye. Ndër më kryesoret janë:

- diferencat e tipit të njësisë së qeverisjes vendore para reformës,
- diferencat në popullatë
- transferimi i funksioneve dhe kompetencave

Ndryshimi i parë ka të bëjë me faktin se, ato njësi që përpara reformës ishin të kategorizuara si “Komuna”, paraprakisht kanë patur një strukturë tjetër organizimi nga “Bashkitë”, që i përshtatej më shumë zhvillimit rural, me të cilin Bashkia e vjetër nuk e ka patur të njëjtën përvojë. Gjithashtu, komunat kanë mbledhur sipërfaqe më të mëdha territori, me përmbajtje shumë më të lartë sistemi bujqësor ose natyror dhe shumë më të ulët sistemi urban. Kjo na shpie edhe te çështja e dytë që ka të bëjë me popullatën, ku mund të dallohen lehtë përqendrimet e mëdha në ish-bashkitë dhe dendësi shumë herë më të ulëta në ish-komuna, përveç ndryshimeve saociale, ekonomike e kulturore mes tyre. Rakordimi i këtyre diferencave në nivel shoqëror, ekonomik, institucional, ligjor dhe administrativ, konsiston në vështirësitë më qendrore të pikës së tretë.

Për të kapërcyer këto vështirësi në analizën dhe vlerësimin e gjendjes ekzistuese për territorin e bashkisë të sapoformuar, me nismën e konsulentëve dhe me mbështetjen e bashkisë është formuluar metodologjia për krijimin e një panorame të qartë dhe të balancuar për të gjithë territorin, ndarë sipas Njësive Administrative në formën e profileve. Mbledhja e të dhënave për profilet është konceptuar në mënyrë të atillë që të mblidhet nga a) vizitat e drejtpërdrejta në terren, b) takimi dhe konsultimi me personelin që punon në qendrat e njësive, c) grumbullimi i të dhënave që ekziston në arkivat dhe përvojën e akumuluar nga personeli i njësive administrative, si dhe ç) mbledhja e perceptimeve për problemet më të rëndësishme në këndvështrimin e administratorëve dhe personelit të njësive.

**Për këto arsye, të dhënat e mbledhura më poshtë, nuk duhet të konsiderohen si të dhëna zyrtare për gjendjen ekzistuese – gjë që është trajtuar te analiza – por si një panoramë orientuese për njohjen e territorit të ri në mënyrë të unifikuar dhe të veçorive të përgjithshme që lidhen me të.**






Fig. 1 Kisha e Ristozi (fshati Mborje)

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE DRENOVË

### 1. Gjenezja – historiku i fshatrave

Në krye të fshatit Mborje ndodhet Kisha e Ristozi. Ajo është një nga objektet më të hershme të kultit në Ballkan. Afresket e saj janë realizuar nga piktorë anonimë, në vitin 1390. Një shënim në gjuhën greke, që ndodhet në anën e djathtë të hyrjes e daton ndërtimin e kësaj kishe në vitin 898.

Dardha është fshat turistik relativisht i ri. Në fillim të shekullit XX, numëronte 400 shtëpi. Profesionit i parë i dardharëve duket se ka qenë ai i druvarit.

Studimi arkitektonik i fshatit dëshmon prezencën e një stili evropian. Pamja që krijojnë banesat, urbanistika e fshatit, ndërtimet e forta me gurë të skalitur, rrugicat me kalldrëm, burimet e shumta, punishtet e artizanëve si dhe dyqanet, i jepnin Dardhës imazhin e një qyteti të vogël në rritje. Dallohet tipi i banesës dardhare, dy-trekatëshe e ndërtuar me gurë dhe çati me rrasa guri (plloça), i cili është ruajtur edhe në ndërtimet e reja.





Fig. 2 Banesa karakteristike të zonës

## 2. Demografia

Njësia administrative Drenovë ka **11000 banorë / 1175 familje** (Burimi: Njësia Administrative Drenovë, 2016)

Drenova përbëhet nga 8 fshatra: Drenovë, Mborje, Boboshticë, Moravë, Qatrom, Ravonik, Turan, Dardhë. Popullsia është ndarë në 8 fshatrat e njësisë si më poshtë:

**Mborje**– 3095 banorë / 907 familje  
**Moravë** – 1438 banorë / 424 familje  
**Drenovë** – 2642 banorë / 696 familje  
**Boboshticë** – 1466 banorë / 363 familje  
**Qatrom** – 867 banorë / 211 familje  
**Ravonik**– 1025 banorë / 247 familje  
**Turan** – 347 banorë / 108 familje  
**Dardhë** – 141 banorë / 73 familje

Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike sipas fshatarve:

**Mborje**– 20 familje  
**Moravë** – 24 familje  
**Drenovë** – 5 familje  
**Boboshticë** – 1 familje  
**Qatrom** – 0 familje  
**Ravonik**– 2 familje  
**Turan**– 1 familje  
**Dardhë** – 0 familje  
**Gjithsej** – 53 familje

Numri i personave që përfitojnë pagesë paaftësie sipas fshatrave:

**Mborje**– 41 paaftësi / 8 verbëri / 4 paraplegjikë / 51 invalidë  
**Moravë** – 15 paaftësi / 3 verbëri / 0 paraplegjikë / 32 invalidë  
**Drenovë** – 20 paaftësi / 6 verbëri / 1 paraplegjikë / 51 invalidë



**Boboshticë** – 2paaftësi / 0 verbëri / 2 paraplegjikë / 4 invalidë  
**Qatrom** – 10paaftësi / 1 verbëri / 4 paraplegjikë / 15 invalidë  
**Ravonik**– 8paaftësi / 2 verbëri / 0 paraplegjikë / 8 invalidë  
**Turan**– 2paaftësi / 0 verbëri / 0 paraplegjikë / 4 invalidë  
**Dardhë** – 1paaftësi / 0 verbëri / 1 paraplegjikë / 1 invalidë  
**Gjithsej** – 99paaftësi / 20 verbëri / 12 paraplegjikë / 146 invalidë

### *Lëvizjet demografike*

Popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes të vazhdueshme migratore drejt qyteteve si Tirana, Durrësi edhe pse se në vitet e fundit është pakësuar. Banorët janë larguar edhe drejt Greqisë (më pas drejt Gjermanisë e Europës qendrore) për të siguruar kushte më të mira jetese, por si pasojë e krizës ekonomike në Greqi, janë frenuar edhe keto largime.

Përveç lëvizjeve larguese, ka patur edhe të ardhur nga zonat e thella si Opar, Panarit, Çëmericë, Lavdar, zona rreth Skraparit, të cilët janë larguar për shkak të mungesës së shkollave e qendrave shëndetësore në zonat e tyre.

### **3. Ekonomia**

Aktiviteti kryesor ekonomik në njësinë administrative Drenovë është bujqësia dhe blegtoria e cila aktualisht përdoret vetëm për të mbuluar nevojat personale të banorëve. Krijimi i një tregu do të ishte një investim i mirë për ta zgjeruar akoma më shumë këtë aktivitet. Në këtë njësi janë 2 baxho në Boboshticë dhe 2 në Drenovë të cilat e shesin produktin e tyre edhe në Tiranë. Po ndërtohet një pikë grumbullimi frigoriferike pasi aktualisht ka vetëm 2 në Qatrom dhe 1 në Boboshticë. Në këtë të fundit ndodhen edhe disa pulari dhe thertore.



**Fig. 3** Pamje nga rruga për në fshatin Drenovë

### **4. Bujqësia, Blegtoria**

Njësia administrative Drenovë zotëron 2556 Ha tokë bujqësore, e cila ndahet në 2363 Ha tokë arë, 150 Ha pemtore, 43 Ha vreshta. Në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë të kësaj zone ka disa faktorë kushtëzues e pengues si: ndarja e tokës në shumë pjesë, amortizimi i vazhdueshëm i infrastrukturës bujqësore (*bllokimi i kanaleve vaditëse të cilët nuk pastrohen për më shumë se 20 vjet*). Është planifikuar një fond për pastrimin e kanaleve vaditëse por ky proces ka sjellë konflikte me pronarët e tokave pasi kanë mbjellë parcelat rreth kanalit dhe gjë që sjell humbje të mëdha.



Fig. 4 Në Drenovë

Dreno  
va njihet për  
kultivimin e  
grurit, elbit,  
jonxhës.  
Gruri zë rreth  
gjysmën e  
sipërfaqes.  
Nuk mungon  
as kultivimi i  
frutikuturës (kryesisht  
mollë). Kohët  
e fundit  
interes të  
vecantë tek  
banorët ka  
patur

kultivimi i  
perimeve por  
mungesa e

ujit të bollshëm e ka penguar këtë proces. Uji që përdoret për vaditje vjen nga rezervuari i Gjancit dhe grykat e malit por gjatë stinës së verës nuk është i mjaftueshëm. Shitja e prodhimit në ditët e sotme, ka një seri vështirësish, si mungesa e pikave të grumbullimit, dhe lënia e fatit të prodhimit në dorën e blerësve të rastësishëm privatë, të cilët përgjithësisht u ofrojnë fermerëve çmime shumë të ulëta e aspak të leverdisshme.

Në këtë njësi filloi kultivimi i **bimëve medicinale** si sherebela. Për shkak të rënies së çmimit në treg, këto bimë nuk mbillen më.

Kafshët që mbarështohen në Drenovë janë kryesisht dele dhe lopë. Në njësi ndodhen vetëm 2 ferma në Boboshticë të përbëra nga 25- 30 krerë kurse çdo familje ka mesatarisht 1-2 krerë dhe në total ka rreth 700- 800 krerë.

## 5. Infrastruktura

### *Uji i pijshëm*

Mbulimi i zonës nuk është 24 orë dhe kjo ndodh për shkak të keqmenaxhimit, sidomos gjatë stinës së verës, nga vaditjet. Teksa në pjesën fushore shpërdorohet uji, pjesa malore nuk arrin të furnizohet. Ujës-jellësat përgjithësisht janë me vetrrjedhje ndërsa në Ravonik banorët kanë puse personale.

### *Ujërat e zeza*

Ujërat e zeza depozitohen kryesisht në gropa septike. Në fshatin Ravonik, Turan dhe Zapë nuk ka rrjet kanalizimi, prej të cilëve fshati Turan ka përparësi për shkak të basenit ujëmbledhës që ndodhet në të por terreni problematik e ka vështirësuar procesin. Fshati Boboshticë ka pjesërisht rrjet kanalizimesh por është tepër i amortizuar. Në fshatin Mborje është bërë një ndërhyrje rreth viteve '75 dhe derdhjet nuk dekantohen si dikur por shkojnë në përrenj afër fshatit.

Dalja e ujerave te zeza te burgut, pergjat kanalitanes rruges, ku shkon kanali i ujerave te zeza, krijon probleme në rrugën që është e frekuentuar nga turistët që shkojnë në Dardhë.

### *Elektrifikimi*

Problemet me elektrifikimin janë të shumta dhe sistemi është i amortizuar. Për shkak të këtij amortizimi, në stinën e dimrit fshatrat mbeten pa energji elektrike si pasojë e defekteve të shumta. Në këtë njësi nuk mungon ndriçimi rrogor në të gjitha fshatrat.

Për ngrohje përdoret dru zjarri, që banorët i presin kryesisht vet (ka edhe firma private). Dëmtimi i pyjeve është problem.

### *Telefonia / Televizionet*

Në Mborje Drenove dhe Boboshtice operojnë disa kompani private telefonike të cilat ofrojnë edhe internet.

### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Mbetjet grumbullohen në një “landfill” të ndërtuar 4 -5 vite më parë në fshatin Mborje, afërsisht 5000- 6000 m<sup>3</sup> (në pritje të landfill të Maliqit) dhe një dite në javë në çdo fshat mbetjet mbledhen me një makinë. Kosha për grumbullimin e mbetjeve në fshatra nuk ka por banorët i nxjerrin ato tek dera që i merr makina.

Inertet e ndërtimit i hedhin ku të mundën, nëpër lumenj përrenj. Burim ndotjeje bëhet edhe një fabrikë këpucësh që ushtron aktivitet për regjie lëkure dhe krijon erë të keqe tek lumi i Gjanicës.

### *Transporti*

Transporti bëhet me taksi apo mjete të rastit, nuk ka linjë tjetër veç linjës të autobusit Drenovë - Korçë, që rri në qender të fshatit.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)	
Drenovë	Drenovë	0	0	0	4.7	0	6
	Boboshticë	6.3	0	8	7.3	0	9
	Dardhë	16.9	0	25	17.9	0	30
	Mborje	2.8	0	3	2.7	0	4
	Moravë	-	0	1		0	5
	Qatrom	4.7	0	8	5.7	0	7
	Ravonik	9.8	0	16	6.6	0	8
	Turan	8.2	0	17	5.1	0	6

Tab. 1 Periferialiteti i njësisë administrative Drenovë






Fig. 5 Rrugë në Drenovë

Fig. 6 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Drenovë

## 6. Shërbime

### *Arsimi*

Në njësinë administrative Dardhas mungojnë çerdhet. Kopshtet ka vetëm në 5 fshatra përkatësisht: Turan, Qatrom, Ravonik, Mborje dhe Drenovë. Shkollat fillore e 9 - vjeçare ndodhen në Turan, Qatrom, Ravonik, Mborje, Boboshticë dhe Drenovë. Shkollat e mesme mungojnë, dhe nxënësit detyrohen të shkojnë në Korçë.

### *Shëndetësia*

Çdo fshat ka qendër shëndetësore, janë 2-3 mjekë që lëvizin, vetëm Mborja ka doktor të përhershëm. Në fshatrat e tjera shkojnë 2 herë në javë.

Ne Ravonik ka nevojë për një qendër të re shëndetësore pasi është tejet e amortizuar.

## 7. Asetet Kulturore

**Dardha** ia ka dalë të bëhet e njohur anembanë vendit, jo vetëm për natyrën dhe klimën e saj, por sidomos për traditat, kulturën e të jetuarit. Fshati Dardhë është zonë turistike e vizituar nga shumë turistë.

**Boboshtica** ka shumë kisha të hershme, mund të vizitoni kishën e “Shën Marisë”, kishën e “Shën Gjon Pagëzorit”, " Shën Dhimitrit". Dy kishat e fundit që janë pjesa e mbetur nga 13 kisha e 3 Manastire Ortodokse që kishte ky fshat. Origjina e banorëve të hershëm është historikisht e vërtetuar.

**Mborja** mbahet për një kishë rreth 1300 vjeçare “Kisha e Ristozi” (më e vjetra në Ballkan), e cila është edhe zonë arkeologjike.

**Drenova** ka kishën “Shën Konstandin” tek faqa e malit dhe rreth 7-8 kisha të tjera. Ajo njihet edhe si vendlindja e shkrimtarit të njohur shqiptar Asdreni, në kujtim të të cilit ndodhet një monument.

## 8. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Që nga prill, 2011 në këtë zonë nuk janë dhënë leje ndërtimi edhe pse kërkesat kanë qenë të pakta. Problem të shumta ka në lidhje me dokumentat e pronësisë, për shkak të kostos së lartë nuk tërhiqen nga banorët,

Me zgjidhjen e disa problemeve më imediate, zona do të merrte një zhvillim të konsiderueshëm. Ndër problemet më imediate veçohen:

- Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të zeza
- Sistemimi i rrjetit të ujit të pijshëm
- Sistemimi i kanaleve vaditëse



Fig. 7 Kisha e "Shën Konstandinit", Drenovë




Fig. 8 Kisha "Anargjendët e shenjtë", Boboshticë



Fig. 9 Monumenti i Asdrenit





Fig. 10 Posta Shqiptare, Bulgarec

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE BULGAREC

### 1. Demografia

Njësia administrative Bulgarec ka **14780 banorë**. (Burimi: Njësia Administrative Bulgarec, 2016)

Bulgareci përbëhet nga 13 fshatra: Bulgarec, Lumalas, Biranj, Melcan, Porodinë, Dishnicë, Shamoll, Belorta, Kuç i Zi, Barç, Çiflig, Malavec, Neviçisht.

Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike: **11 familje**



Fig. 11 Banesa të zonës

*Lëvizjet demografike*

Në njësinë administrative Bulgarec vërehet migracioni i jashtëm dhe i brendshëm.

Migracioni i jashtëm është kryesisht drejt Greqisë, tanimë ka filluar dhe levizja me sensin e kundërt nga Greqia. Lëvizja e banorëve është realizuar gjithashtu nëpërmjet procesit të aplikimit të Llotaris Amerikane nga i cili 10% - 15% e Bulgarecit shpallen fitues.

Migracioni i brendshëm është krijuar nga popullsia e mbledhur nga zonat malore. Një rast i tillë është fshati Shamoll në të cilin nuk ka më banorë vendas, por janë të ardhur nga Opari dhe Lavdari, ndërsa banorët të cilët janë larguar nga fshati kanë tentuar drejt qytetit të Tiranës.

## **2. Ekonomia**

### ***Nr i punonjësve***

Administrata përbëhet gjithsej nga 9 punonjës ndër të cilët:

**Administrator - 1**  
**Spektori i të ardhurave - 1**  
**Shërbimet publike- 2**  
**Agronomi - 1**  
**Punonjësi social - 1**  
**Arkëtari- 1**  
**Arkivë- 1**  
**Gjendje civile- 1**

### ***Bizneset***

Në këtë njësi ndodhen aktualisht 400 biznese të cilat pozicionohen përgjatë rrugës kryesore ndër të cilët 40 janë të mëdha. Këto biznese janë të menaxhuar nga bashkia, përfshirë këtu tarifën e tokës, energjisë dhe të pastrimit.

### 3. Aktivitetet kryesore ekonomike në komunë



Fig. 12 Pamje nga fshati Bulgarec

Aktivitetet kryesore në njësinë administrative të Bulgarecit janë bujqësia dhe blegtoaria. Prioritet në bujqësi janë bimët prashitëse si patatja dhe qepa. Gjithashtu nuk mungon as kultivimi i frutikuturës (kryesisht mollë). Drithërat që prodhohen, konsumohen përgjithësisht nga vetë banorët ndërsa tepricat shiten. Për vaditjen e tokës përdoret uji nga lumi i Dunavecit. Një faktor pengues për zhvillimin e bujqësisë është copëzimi i tokës.

Kafshët që mbarështohen në Bulgarec janë lopë dhe kope me dhen. Për shkak të relievit fushor-kodrinor rezulton pamjaftueshmëri për kullotë.

### 4. Infrastruktura

#### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Bulgareci përdor ish gropat e stallave si venddepozitime momentale, teksa janë në pritje të landfillit në Maliq. Gjithashtu disa depozitime provizore janë realizuar në Malavec.

#### *Transporti - Lidhja mes fshatrave*

**Përgjithësisht sistemi rrugor është i asfaltuar por jashtë standarteve, rrugët kanë një gjërësi prej 3.60m duke mos mundur kështu shkëmbimin midis dy makinave.**

Dishnica është e lidhur me urbanin e qytetit. Gjithashtu funksionon shërbimi i taksive dhe linja e furgonit Bulgarec – Korçë me kapacitet 18 vende.

Fshatrat nuk lidhen përmes tyre, por përmes rrugës nacionale.

#### *Uji i pijshëm / Ujërat e zeza*

12 nga 13 fshatra janë të furnizuar me ujë. Cifliku furnizohet nga ujësjellësi i qytetit, Lumalas nga ujësjellësi i fshatit dhe Malaveci furnizohet përmes puseve. Bulgareci ka 24 ore ujë, me presion.

Për sa i përket ujërave të zeza në Bulgarec është e trajtuar në masën 15 %, në Dishnice 50 % ndërsa pjesa tjetër shkarkohet në terren ose në gropa septike.



Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)	
Bulgarec					6		
	Bulgarec	0	0	0	6	0	11
	Barç	7.8	0	18	3.5	0	10
	Belorta	10.7	0	17	9.9	0	14
	Biranj	4.8	0	11	7.5	0	16
	Çiflig	4.6	0	10	4	0	10
	Dishnicë	8.1	0	12	7.3	0	12
	Kuç i Zi	11.8	0	18	10.9	0	15
	Lumalas	3.6	0	6	6.8	0	11
	Malavec	9.4	0	16	8.5	0	14
	Melcan	6.3	0	13	9.1	0	16
	Neviçisht	10	0	16	9.2	0	13
	Porodinë	8.8	0	20	7.7	0	16
	Shamoll	13.3	0	25	12.4	0	23

Tab. 2 Periferialiteti i njësisë administrative Bulgarec




Fig. 14 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Bulgarec



Fig. 13 Rrugë në fshatin Bulgarec

## Shërbime

Në njësinë administrative Bulgarec vërehet mungesa e çerdheve. Aktualisht funksionojnë 11 kopshte dhe 11 shkolla fillore (Malaveci nuk ka asnjë shkollë). Gjithashtu mungojnë shkollat e mesme dhe nxënësit detyrohen të shkojnë në Maliq ose Korçë pasi është më afër. Janë të nevojshme projekte rikonstruktive për rshkollën në Lumalas (ish zyrtat kooperative) e cila aktualisht ka hapësirë të pamjaftueshme ndërsa në fshatin Barç kërkohet përshtatja e godinës aktuale.

Numri i qendrave shëndetësore është 12.

## 5. Asetet Kulturore

Një ndër asetet kulturore është vendbanimi ilir i Barçit (sit arkeologjik-prehistorik) i pagërmuar.

## 6. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

### *Projektet prioritare*

Me zgjidhjen e disa problemeve më imediate, zona do të merrte një zhvillim të konsiderueshëm. Ndër problemet më imediate veçohen:

- Sistemimi i kanalizimeve të ujrave të zeza
- Sistemimi i rrjetit të ujit të pijshëm
- 9 përrrenj me rrezikshmëri përmbytje

### *Problemet kryesore*

Ndër problemet kryesore rënditen ekonomia e mbyllur dhe mungesa e agrobiznesit, agropërpunimi.

### *Pikat e forta*

- Tradita në prodhimet bujqësore dhe blegtorale
- Promovimi i produktit të drithërave në mënyrë që ti shërbejë qytetit për furnizimin me ushqim
- Festimi i ditës së karnavaleve (që në kohën e Zogut) si ringjallje e traditës së vjetër
- Festimi i festës së grurit



Fig. 15 Pamje nga fshati Lekas

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE LEKAS

### 1. Demografia

Njësia administrative Lekas ka **1180 banorë**. (Burimi: Njësia Administrative Lekas, 2016)

Ajo përbëhet nga 15 fshatra: Lekas, Marjan, Gjonbabas, Gurmujas, Shkozanj, Xerje, Tudas, Gjergjevicë, Lavdar, Brozdovec, Mazrek, Poponivë.

#### *Lëvizjet demografike*

80% e banorëve të fshatit Lekas janë larguar duke sjell kështu një ndryshim të numrit të popullsisë nga 4600 banorë në rreth 1120 banorë. Kryesisht personat e larguar janë drejtuar në qytetin e Tiranës, Durrësit dhe drejt shteteve fqinje Itali dhe 30% drejt Greqisë. Aktualisht rezultojnë më tepër se në realitet individ me pashaportizim pasi kryesisht të moshuarit rikthehen sërisht për shkak të përfitimit të pensionit.




Fig. 16 Lugina Lekas

## 2. Ekonomia

### *Nr i punonjësve:*

Personeli i administratës përbëhet nga 8 persona.

### *Bizneset*

Për shkak të mungesës së infrastrukturës rrugore pothuajse nuk ka asnjë biznes përveç dy bar-bufe, dhe sharra.

## 3. Aktivitetet kryesore ekonomike në komunë

Banorët e fshatit Lekas janë marrë me blegtori e cila zë 80% të aktivitetit ekonomik. Kafshët që mbarështohen në Lekas janë gjedhë dhe tinta. Infrastruktura blegtorale përbëhet nga 4 baxho për të gjithë njësinë: 2 në Mazrek dhe 2 në Marjan ndërsa fshatet Lekas, Tudas, Xerje dhe Shkozanj nuk kanë. Dy ndër prodhimet e këtij fshati janë qumështi dhe mishi. Për shkak të kostos së ulët është vënë re rritja e mbarështimit të lopëve.

## Bujqësia

Në fshatin Lekas vërehet mbjellja e tokave me perime e zarzavate të cilat janë te gjitha livadhore. Më parë ekzistonin kanale vaditëse por tashmë janë të shkatërruar. Vetëm në Denas ka një kanal rreth 2 km në të cilin prodhohet misër e elb për koncentrat. Për sa i përket bimëve medicinale ato janë shumë të pakta, ndër to vërehen: aguliçe, murriz, dellinja e zezë dhe e kuqe, caj mali, tërfil dhe salep.



#### 4. Infrastruktura

##### *Uji i pijshëm*

Furnizimi me ujë realizohet nëpërmjet ujësjellësave, por pa u aplikuar asnjëherë tarifa përkatëse. Me kalimin e ndërmarrjes së ujësjellësit do të aplikohet edhe tarifa. Për shkak të kostos së lartë të lidhjes së fshatrave midis tyre secili fshat ka burimin e vet dhe një stacion. Aktualisht do të mjaftonte riparimi i ekzistuesit.

##### *Ujërat e zeza*

Ujërat e zeza depozitohen në gropa septike.

##### *Elektrifikimi*

Problemet me elektrifikimin janë të shumta dhe sistemi është i amortizuar. Centrale elektrike janë 2 në Qelidhon dhe 1 në Marjan. Po ndërtohen edhe 3 të tjerë në Marjan, Xerje dhe Denas. Gjithashtu ekziston një studim për një central në shkozanj. Të gjithë planifikohen të jenë tek e njëjta rrjedhë.

##### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Aktualisht po studiohet ku do të vendosen pikat e vendgrumbullimit të mbetjeve. Për çdo fshat do caktohet një vend, për momentin mbetjet hidhen në përrenj dhe në pika të ndryshme.

##### *Transporti*

Sipas gjendjes ekzistuese një ndër rrugët e fshatit Mazrek është e dëmtuar dhe po bëhen përpjekje për riparimin e saj. Nuk ka linja të mirëfillta transporti, vetëm 2-3 fuoristrada pa liçensë. Deri në vitet 90' funksiononte një linjë Lekas-Korçë, por tashmë është hequr.

#### 5. Shërbime

##### *Arsimi*

Vërehet mungesa e çerdheve, kopështve dhe shkollave të mesme. Ekzistojnë vetëm 3 shkolla fillore.

##### *Shëndetësia*

Në fshatin Lekas ekziston një qëndër e kujdesit shëndetësor, e cila funksionon për të gjithë njësinë, por infermier ka për secilin fshat. Është i nevojshëm realizimi i 3 qëndrave të tjera dhe punësimi i 4 infermierëve dhe një mjek.

##### *SIGURIA / urgjencat zjarrfikese / komisariate policie / zona ushtarake*

Në Lekas është një inspektoriat i policisë Voskopojë- Lekas ndërsa zona ushtarake nuk ka.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë	kohë		hapësirë	kohë	
		(km)	(orë)	(min)	(km)	(orë)	(min)
Lekas							
	Lekas	0	0	0	38.2	1	30
	Brozdovec	8.4	0	30	46.4	2	0
	Gurmujas	7.9	0	25	36.9	1	20
	Gjergjevicë	7.2	0	25	31	1	10
	Gjonbabas	6.5	0	30	38.8	1	30
	Lavdar	7.8	0	25	42.8	1	50
	Marjan	5.1	0	35	39.3	1	30
	Mazrek	12.8	1	0	50.8	2	30
	Poponivë	-	0	40		2	0
	Shkozan	1.7	0	10	36.5	1	25
	Tudas	3.5	0	20	41.4	1	40
	Xerje	2.8	0	10	40.5	1	40

Tab. 3 Periferialiteti i njësisë administrative Lekas




Fig. 19 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Lekas



Fig. 18 Pamje nga fshati Lekas

Asetet Kulturore

Kisha e Shën Triadhës në Tudas të Korçës është një nga objektet kishtare nga më të vjetrat në Shqipëri. Ajo është ndërtuar në vitin 1470, ndërsa zona nuk ishte e pushtuar ende nga Perandoria Osmane dhe është e stilit bizantin. Sipas historisë kisha është ndërtuar nga Ana Muzaka, gjyshja e Gjon Muzakës.



Fig. 20 Kisha e Shën Triadhës në Tudas

## 6. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

### *Kërkesat, tipi dhe zonat për ndërtim*

Për shkak të rrënimit të shtëpive ka pasur shumë kërkesa për ndërtim në tokat e banesave personale ekzistuese. Kryesisht këto kërkesa kanë qënë për ndërtesa të vogla një katëshe me 2-3 dhoma.

### *Zonat e pushimit / tërheqëse për turistët:*

Frekuentimi i kësaj zone nga turistët është shumë i rrallë. Vizitat më të shpeshta janë nga çekë dhe hollandezë të cilët vijnë gjatë verës dhe qëndrojnë 2-3 ditë. Pengesën kryesore të shtimit të frekuentimit e përbën mungesa e infrastrukturës rrugore, një zgjidhje e mirë për këtë problem do të ishte realizimi i unazës së voskopojës.

### *Regjistrimi i pronave, ndertime informale, konflikte të mundshme:*

Gati 80% e pronave nuk kanë përfunduar ende regjistrimin. Pjesa më e madhe e këtij procesi po realizohet me anë të gjyqeve. Ka pasur konflikte midis banorëve, aktualisht mund të jenë 5-6 raste në proces gjyqësor. Problematika me rendin nuk ka.

## PROBLEMET KRYESORE - INVESTIMET PRIORITARE

Ndër problemet më imediate veçohen:

- 1-Realizimi i rrugës Voskopojë-Lekas
- 2-Realizimi i rrugëve lidhëse të fshatrave sepse ekziston interesi për nvestim por në mungesë të rrugëve nuk mund të ralizohet transporti i materialeve gjë e cila frenon investimin në zonë.
- 3-Energjia elektrike. Nevojitet një punonjës për kryerjen e riparimeve emergjente. Aktualisht kabinat janë në gjëndje kritike.
- 4-Ujësjet






Fig. 21 Pamje nga Kisha e Shën Thanasit, Voskopojë

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE VOSKOPOJË

### 1. Gjenezja – historiku i fshatrave

Koha e themelimit të Voskopojës rezulton në vitin 1330, sipas arkivave të gjetura në Manastirin e Shën Prodhromit. Lulëzimin më të madh Voskopoja e ka patur në vitin 1764, atëherë kur popullsia e saj arriti në 30000 banorë. Në këtë periudhë ajo kishte 25 kisha (me afreske të vecanta), prej të cilave kanë mbetur vetëm shtatë. Në të njëjtën periudhë, në këtë qytetërim është ngritur akademia, biblioteka dhe shtypshkronja.

Voskopoja kishte artizanat të zhvilluar dhe kjo shërbeu si urë lidhëse jo vetëm brënda vendit por edhe jashtë tij. Shkatërrimi i pare i saj ndodhi në vitin 1769, i dyti në vitin 1789 dhe i treti në vitin 1916.

Zhvillimi në Voskopojë i profesioneve dhe zejeve të kohës u bë një nxitës real i konkurrencës në të gjithë Ballkanin duke dhënë shenjat e para të një kulture paraindustriale, që do të sillte padyshim një zhvillim paraprakisht të domosdoshëm për zhvillimin e rajonit.

Mallrat që prodhoheshin në Voskopojë kanë qënë të famshme dhe ndonjëherë për tu dalluar mbanin të gdhendur një stemë me shqiponjë.





Fig. 22 Në Voskopojë

## 2. Demografia

Voskopojë – Lekas në fillim të 2015 ka pasur **3618** banorë dhe në fund të 2015 ka pasur **3662** banorë. Përkatesisht 1082 familje në fillim të vitit 2015 dhe 1105 në fund të vitit. (*Burimi: Njësia Administrative Voskopojë, 2016*)

Voskopoja përbëhet nga 5 fshatra: Voskopojë, Shipskë, Krushovë, Gjonomadh dhe Lavdar.

### *Lëvizjet demografike*

Tendenca e lëvizjeve demografike tregon shtim të numrit të popullsisë, numri i banorëve të ardhur është më i madh se numri i banorëve të larguar.

## 3. Ekonomia

### *Sektorët / Punët kryesore / Nr i punonjësve*

Aktualisht janë 12 persona të punësuar, ky numër pritet të shkojë në 14.

### *Bizneset*

Bizneset në njësinë e Voskopojës janë të pakta. Kryesisht janë të tipit hotele, shtëpi pushimi, guest house, guida, suvenire, dyqane. Përkatesisht janë:

- 22 hotele, bujtina, hostele
- 2 restorante
- 3 dyqane
- 1 furrë buke
- 3 dyqane(fshatrat e tjerë)
- 2 lokale

## 4. Aktivitetet kryesore ekonomike në komunë

Në 4 fshatra të Voskopojës turizmi zë 70% të aktivitetit ekonomik ndërsa pjesa tjetër merret me blegtori dhe bujqësi.

Kulturat bujqësore kryesore janë: patatja, fasulja, molla e kumbulla e egër gjatore tropojane. Kultivimi, mbledhja dhe nxjerrja në shitje bëhet në mënyrë private ose me njohje (vijne i marrin tregtarë nga Tirana apo Fieri), ose vetë kultivuesit i mbledhin dhe i shpien në pazarin në Korçë dhe në vënde të tjera, pasi në fshatra nuk ka pazare. Tokat janë të ndara në ngastra shumë të vogla.



Fig. 23 Pamje Voskopojë

## 5. Infrastruktura

### *Uji i pijshëm*

Shërbimi i ujit të pijshëm për Voskopojën është përgjatë 24 orëve dhe vjen nga Shipska (burim malor, pa pompa).

### *Ujërat e zeza*

Kanalizimet e ujrave të zeza në Voskopojë janë në gjëndje të mirë por derdhen në lumin kryesor, (përvec lagjes Pashuta). Fshatrat e tjerë nuk kanë kanalizime por funksionojnë me anë të gropave septike.

### *Elektrifikimi*

Voskopoja si fshat ka ndriçim normal, me problemet e zakonshme si shkëputjet për shkak të rrjetit të amortizuar kryesisht gjatë rreshjeve të dëbores.

### *Telefonia / Televizionet*

Operojnë disa kompani private telefonike të cilat ofrojnë edhe internet.

### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Ekziston një vendgrumbullim i mbetjeve për të gjithë fshatrat. Voskopoja pastrohet çdo ditë, Lavdari e Gjonmadhi pastrohen një herë në javë ndërsa Shipska pastrohet nga vetë banorët pasi është e pa arritshme.

### *Transporti*

Voskopoja ndodhet afersisht 20 km larg Korçës. Lidhja me të realizohet me transport publik, mjetet e të cilit pozicionohen në qendrën e fshatit dhe punojnë gjatë orarit 07:00- 16:00. Gjithashtu ka edhe mjete të tjera të transportit si: furgona, vetura e taksi.

Rrugët rurale janë të paasfaltuara.

**Infrastruktura bujqësore**

Aktualisht në bujqësi përdoren kanalet e vjetra, të cilat janë mbushur me dhe e nuk janë në nivel të mirë.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)	
Voskopojë							
	Voskopojë	0	0	0	20.6	0	30
	Gjonomadh	6.7	0	10	15.7	0	25
	Krushovë	6.6	0	20	27.2	0	50
	Lavdar I Korçës	15.6	0	30	36.2	0	30
	Shipskë	5.4	0	15	25.4	0	45

Tab. 4 Periferialiteti i njësisë administrative Voskopojë



Fig. 24 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Voskopojë




Fig. 25 Rrugë në Voskopojë

## 6. Shërbime

### *Arsimi*

Në njësinë administrative Voskopojë mungojnë çerdhet dhe shkollat e mesme. Kopshte janë gjithsej 3 dhe shkolla fillore janë gjithashtu 3.

### *Shëndetësia*

Në Voskopojë ka një qendër shëndetësore dhe një konsultore të gruas. Fshatrat e tjerë kanë nga një qendër. Gjithsej janë 2 mjekë nga Voskopoja, 1 mjek dhe 1 mami.

### *SIGURIA - urgjencat zjarrfikese / komisaritate policie / zona ushtarake*

Në njësinë administrative Voskopojë nuk ka komisaritate policie dhe urgjenca zjarrfikëse. Në rastin e nevojës për shërbime të tilla, ato sigurohen nga qyteti i Korçës. Zonë ushtarake ka patur por nuk është më në funksion.



## 7. Asetet Kulturore

### Kisha e Shën Thanasit

Kisha e Shën Thanasit shquhet për afresket e rralla, është një nga 24 kishat e Voskopojës, që u ka mbijetuar shkatërrimeve gjatë shekujve. Kisha, e cila është Monument Kulture i kategorisë së parë, daton në vitin 1724 dhe është ndërtuar prej pesë mjeshtrash të njohur nga Kosturi, ndërsa pikturat murale të saj, në pjesën më të madhe të tyre janë vepër e vëllezërve Shpataraku.



Fig. 26 Manastiri i Shen Prodhromit

### Manastiri i Shën Prodhromit

Shën Prodhromi është një nga manastiret më të njohur dhe më të vjetër të Shqipërisë. Ai daton në shekullin XIV dhe nga të dhënat rezulton se kishte kodik që në vitin 1330. Pranë manastirit ndodhen edhe fjetoret, të cilat janë restauruar gjatë viteve të fundit. Shën Prodhromi është një nga vëndet më të preferuara për pushime malore, me klime të mrekullueshme dhe gjelbërim të dendur në hapësirën përreth. Manastiri për shkak të vlerave historike dhe ikonografike që mbart është shpallur monument kulture.

## 8. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Kërkesat për ndërtim janë kryesisht për shtëpi banimi personale dhe hotele e biznese. Është shfaqur interes për zhvillimin e turizmit malor (kryesisht për pistat e skive) por për shkak të problemeve ligjore me tokat nuk është realizuar. Rastet e konflikteve në këtë zonë janë të rralla.

Ndër problemet më imediate veçohen:

- 1- Shkolla në Voskopojë.
- 2- Riparimi i rrjetit shpërndarës energjistik
- 3- Rregullimet e kalldrëmeve dhe infrastrukturës në përgjithësi
- 4- Në fshatrat e tjera ka nevojë për rregullime të ujrave të zeza
- 5- Rregullimi i infrastrukturës bujqësore.
- 6- Zhvillimi i turizmit duke nxitur punimet artizanale kryesisht punime druri, punimet e qilimave etj



Fig. 27 Pamje në Voskop

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE VOSKOP

### 1. Demografia

Njësia administrative Voskop ka **6256 banorë**. (Burimi: Njësia Administrative Voskop, 2016)

Voskopë përbëhet nga 7 fshatra: Voskop, Dërsnik, Polen, Vinçan, Goskovë e sipërme, Goskovë e poshtme, Damjanec.

#### *Lëvizjet demografike*

Popullsia që rezultojnë në gjëndjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes të vazhdueshme migratore drejt Australisë, Amerikës dhe sezonalisht në Greqi e Itali. Dikur në këtë njësi ka pasur rreth 94 shtëpi por në ditët e sotme kanë mbetur vetëm 10.





Fig. 28 Banesa në Voskop



## 2. Ekonomia

Në këtë njësi stallat ndodhen pranë banesave. Më parë ka pasur baxho në Polenë dhe në Voskop por për shkak të rënies së tregut janë mbyllur. Disa familje merren me përpunimin e bulmetit të cilin e tregtojnë në pazar ose në klient të rregullt.

Aktualisht në këtë njësi ka 5 pika grumbullimi frigoriferik (kryesisht për mollën): 3 në Polenë dhe 2 në Voskop. Ka tendencë për të ngritur edhe pika të tjera. Për shkak të mungesës së tregut shitjet (sidomos të mollës) janë problem. Pjesa më e madhe e prodhimit tregtohet në Korçë ndërsa pjesën tjetër e marrin fugonat.



Fig. 29 Pamje në Voskop

## 3. Bujqësia, Blegtoria

Kjo njësi karakterizohet kryesisht nga territor fushor i cili zë 60%, 17% kodrinor dhe 23% malor. Pjesën kryesore të prodhimit bujqësor e zënë drithërat, më pas vjen jonxha, perimet dhe patatet. Prodhimi shkon kryesisht për konsum familjar, përveç miellit i cili tregtohet, por pjesa e shitjes i lihet rastësisë (vijne fugona nga rrethet ose dërgohen në Korçë).

Nuk mungon as kultivimi i frutikuturës me një sipërfaqe prej 170-180ha pemë frutore (kryesisht mollë, por edhe kumbulla, arra, bajame e qershi), 170 ha vreshta rrushi. Nuk ka ndërmarrje private përpunimi.

Problematik për sektorin e bujqësisë përbëjnë ujitja dhe kullimi, aktualisht shfrytëzohet kanali Gjancit i cili ka qenë i organizuar nga federata. Burime të tjera të përdorura janë lumenjtë, perrenjtë dhe kanalet e ish kooperativës. Sistemi i ujitjes është në formë shiu. Në Polenë ai është deri diku i mirëmbajtur ndërsa në Voskop nuk funksionon më për shkak të vjedhjes së tubave. Goskova shfrytëzon edhe pusët, të cilët janë një pus për 4-5 dynym tokë.

## 4. Infrastruktura

### ***Uji i pijshëm***

Banesat në Voskop (përveç një lagjeje) dhe Vinçan janë të pajisura me sahat ndërsa Goskova e sipërme, Goskova e poshtme, Polena dhe Damjaneci nuk kanë matës. Fshati Polenë furnizohet nga ujësjellësi i tij, i cili funksionon me rrjedhje të lirë ndërsa Voskopi pjesën më të madhe të ujit e merr nga Gjonomadhi.

### ***Ujërat e zeza***

Kanalizimet e ujrave të zeza në zonën e Damjanecit janë problematike, për këtë arsye janë realizuar disa preventiva për t'i parandaluar disi. Vetëm në fshatin Polenë ka rrjet kanalizimesh ndërsa fshatrat e tjerë funksionojnë me anë të gropave septike ose të derdhura në lumë ose përrenj. Ekziston një projekt për Voskopin por për shkak të shpërndarjes së tij kosto e realizimit është shumë e lartë.

### ***Elektrifikimi***

Gjendja e elektrifikimit në këtë njësi është e mirë përveç problemit të ndriçimit rrugor. Ngrohja realizohet kryesisht me dru zjarri. Sipas të dhënave konsumohen 8-10 m<sup>3</sup> dru për të kaluar dimrin një familje. Drunjtë blihen nëpërmjet privatit dhe një pjesë e vogël e banorëve i marrin me kubikë në Korçë. Kjo njësi përbëhet nga 940ha pyje të cilat janë cungishte, trungishte dhe shkurre. Për shkollat dhe njësinë konsumohen 200 m<sup>3</sup> dru.

### ***Vendgrumbullimi i mbetjeve***

Mbetjet mblidhen nëpër fshatra me grafik, dy herë në Voskop dhe një herë në fshatrat e tjerë. Në pritje të landfillit të Maliqit mbetjet hidhen ku të mundën. Fshatrat janë të pajisur me kosha, por mund të duhen edhe të tjerë.

### ***Transporti***

Transporti në këtë njësi funksionon me anë të fugonave, taksive dhe shumë pak me makina të licensuara. Transporti midis fshatrave dhe midis fshat - qytet realizohet me mjete të rastit ose me makina personale. Linjë autobusi Korçë -Voskop nuk ka. Rugët janë të asfaltuara deri në Vinçan ndërsa rruga Vinçan- Damianec është në gjendje të keqe. Rruga Voskop-Vinçan është 5 km dhe bëhet për rreth 15-20 min. Dërsnik - Damjanec 12-14 km.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)	
Voskop	Voskop	0	0	0	9.9	0	15
	Damjanec	8.4	0	13	18.3	0	27
	Dërsnik	7.1	0	11	14.4	0	22
	Goskovë lart	4.9	0	8	9.7	0	15
	Goskovë poshtë	3.9	0	6	8.6	0	13
	Polen	2.8	0	4	10.2	0	15
	Vinçan	6.1	0	10	9.5	0	14

Tab. 5 Periferialiteti i njësisë administrative Voskop




Fig. 31 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Voskop



Fig. 30 Rrugë në Voskop

## 5. Shërbime

### *Arsimi*

Në njësinë administrative Voskop mungojnë çerdhet. Ka 5 kopështe, 5 shkolla fillore dhe vetëm 1 shkollë të mesme.

### *Shëndetësia*

Numri i qendrave të kujdesit shëndetësor në këtë njësi është 7.

### **SIGURIA - urgjencat zjarrfikese/komisariate policie/ zona ushtarake**

Në njësinë administrative Voskop nuk ka komisariate policie dhe urgjenca zjarrfikëse. Në rastin e nevojës për shërbime të tilla, ato sigurohen nga qyteti i Korçës. Zonë ushtarake ka patur midis Polenës dhe Voskopit por nuk është më në funksion.

## 6. Asetet Kulturore

Lagjia Zagradihtë përbën një aset kulturor për këtë njësi. Në kohën e ilirëve ajo ka qenë qytet dhe në kohën e monizmit është shpallur zonë arkeologjike, por tani nuk është më. Thuhet që është gjetur një mozaik në një familje por nuk ka më tepër të dhëna.

## 7. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Në këtë zonë nuk janë dhënë leje ndërtimi edhe pse kërkesat kanë qenë të pakta (kryesisht për riparim çatie).

Fshati Dërsnik rezulton me probleme për regjistrimin e pronave, dhe konflikteve me fshatin Dvoran. Shumë prej tokave të Dvoranit (rreth 28ha) janë marrë padrejtësisht nga Dërsniku. Në Damjanec nuk është bërë azhurnimi ndaj nuk mund të bëhen transaksione të ndryshme.

Ndër problemet më imediate veçohen:

- 1- Pastrimi i sistemit të kullimit
- 2- Gjëndja e shkollave në Polenë dhe Vinçan
- 3- Gjëndja e rrugëve
- 4- Depot e ujit
- 5- Mungesa e një ure për në Damjanec





Fig. 32 Pamje në Mollaj

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE MOLLAJ

### 1. Gjenezja – historiku i fshatrave

Tuma e Kamenicës është një zbulim unikal arkeologjik, dëshmi e qendrës së banuar që në prehistori. Kjo tumë ka rëndësi jo vetëm pasi është e para në rajon, por edhe për pasurinë arkeologjike që disponon. Ajo bën pjesë në grupin e tumave të shkatërruara të kësaj zone gjatë punimeve të vazhdueshme bujqësore të viteve 1950-1960 të shekullit të kaluar. Megjithatë ajo u dëmtua rëndë gjatë viteve 1997-1999 nga punimet e thesarkërkuesve, të cilat nxitën Grupin e Arkeologjisë së Shpëtimit të QNASH, që në bashkëpunim me Institutin Arkeologjik Tiranë, Muzeun Arkeologjik Korçë dhe me disa institute kërkimore-shkencore ndërkombëtare, të financuar nga Instituti Packard për Shkencat Humane, të ndërmarrin punime me karakter ndërdisiplinor, që filluan në vitin 2000 e përfunduan në vjeshtën e vitit 2002. Varret më të hershëm të saj i përkasin periudhës së bronzit të vonë rreth shek. XII p.e.s. Kjo tumë ka pushuar së funksionuari rreth mesit të shek VI p.e.s., pra ka një histori gati 700- vjeçare.

### 2. Demografia

Në gjendje civile figurojnë **7000 banorë**, por ka patur dhe lëvizje. (Burimi: Njësia Administrative Mollaj, 2016)

Mollaj përbëhet nga 5 fshatra: Mollaj, Floq, Pulahë, Ujë Bardhë, Kamenicë.

### *Lëvizjet demografike*

Popullsia që rezulton në gjendjen civile nuk përkon me atë reale për shkak të lëvizjes të vazhdueshme. Ardhje më të madhe ka në Dvoran dhe Kamenicë nga Arza. Banorët e ardhur në këto zona merren kryesisht me bujqësi.



Fig. 33 Banesa të zonës

### 3. Ekonomia

Në këtë njësi ekzistojnë 5 biznese të mëdha dhe 4 të vogla, ndër të cilët nga 3-4 janë të siguruar.

Gjithashtu ka 11 frigoriferë me kapacitet 33 000 ton, të cilët ruajnë frutat për 4-6 muaj. Kapaciteti i tyre rezulton i pamjaftueshëm për shkak se shumë pak sasi arrin të magazinohet dhe pjesën e mbetur e mbajnë banorët në shtëpitë e tyre. Gjatë periudhës së vjeljes dhe krasitjes vijnë 50-70 persona në ditë nga jashtë për të punuar. Kompania Frutal bën përpunim, por ka kapacitet të vogël dhe është sezonale. Fermeret nuk organizohen me njeri tjetrin. 90% me nipt. 80% kane subvencionin ne frutikulture. Fermereve nuk i taksohet asgjë.



Fig. 34 Në Mollaj



#### 4. Bujqësia

75-80% e tokës së punueshme në këtë njësi është frutikulturë nga të cilat 70% kultivojnë mollë dhe pjesa tjetër qershi, patate, qepë, jonxhë.

Aktualisht janë 2 baxho, 1 Frutali (është edhe Ali fruit).

Fondi i tokës bujqësore 4600 ha

#### 5. Infrastruktura

##### *Uji i pijshëm*

Përveç fshatit Pulahë në pjesën tjetër të njësisë paraqiten probleme me ujin e pijshëm. Dovorani dhe Kamenica furnizohen me ujë të pijshëm me orar dhe pa sahat. Në Floq ka pasur dhe investime private, por ende ka shumë probleme. Investim të ri ka vetëm në Pulahë, por vetëm në linjat kryesore.

##### *Ujërat e zeza*

Aktualisht ujërat e zeza derdhen në lum përveç Kamenices e cila ka gropa septike.

##### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Ekziston vetëm një gropë në Vithkuq e cila herë pas here ngjeshet me fadromë. Pastrimi bëhet me grafik përkatësisht në ditët: e hënë, e merkurë, e premte në Dvoran dhe të martë të enjte në fshatrat e tjerë.

##### *Transporti*

Transporti midis fshatrave bëhet me taksi ose furgona të cilët janë kryesisht të palicensuar (3 janë liçensuar dhe rreth 10-13 punojnë pa liçensë). Rrugët janë në të gjithë fshatrat të asfaltuar. Është diskutuar për një plan për transport publik për një unazë që të lidh të gjithë fshatrat, por ende nuk është konkretizuar.

Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	Distanca nga Qendra e Nj.A.			Distanca nga Bashkia		
		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)		hapësirë (km)	kohë (orë) (min)	
Mollaj	Mollaj	0	0	0	9	0	25
	Mollaj (Dvoran)	2	0	10	7	0	20
	Floq	6	0	25	15	0	45
	Kamenicë (Iart)	7	0	15	5	0	0
	Kamenicë	2	0	10	11	0	30
	Pulahë	8	0	30	17	0	50
	Ujë Bardhë	8	0	30	17	0	50

Tab. 6 Periferialiteti i njësisë administrative Mollaj



Fig. 36 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Mollaj



Fig. 35 Rrugë në Mollaj

## 6. Shërbime

### *Arsimi*

Në njësinë administrative Mollaj mungojnë çerdhet. Ka 4 kopështe, 4 shkolla fillore dhe vetëm 1 shkollë të mesme. Problematik paraqitet restaurimi i shkollës së Kamenicës, mungesa e kopështeve, shkollave 9 vjeçare dhe të mesme.

### *Shëndetësia*

Në Floq është i domosdoshëm restaurimi i qendrës së kujdesit shëndetësor, ndërsa në Ujëbardhë aktualisht nuk ka asnjë qendër shëndetësore.



## 7. Asetet Kulturore



Fig. 37 Tuma e Kamenicës

Tuma e Kamenicës është një nga tumat më të mëdha të njohura deri më tani, në të cilën u evidentuan 400 varre, mbetje skeletorë të 430 individëve dhe më shumë se 3500 objekte. Hapësira ku ngrihen strukturat e varreve është 3m nën nivelin e tokës.

Varret më të hershëm të saj i përkasin periudhës së bronzit të vonë rreth shek. XII p.e.s. Në këtë tumë gjenden të konservuara si, Unaza e varrit qëndror të tumës, grupi i parë dhe i dytë i varreve me strukturë monumentale si dhe pjesa tjetër që është lënë e pa gërmuar, ku mendohet se në atë pjesë të tumës ekzistojnë edhe 400 varre të tjerë. Ndryshe nga tumat e tjera të këtij lloji të gërmuara në Shqipëri varri qëndror i tumës së Kamenicës është i kufizuar me dy rrrathë bashkëqëndrorë, me diametër 13m, të ndërtuar me gurë me përmasa mesatare. Në zonën brënda kësaj unaze janë vendosur gjatë periudhës së Bronzit të vonë (1200–1050 p. e. s) edhe 40 varre të tjerë.

Në periudhën e dytë të përdorimit të tumës, gjatë periudhës së Hekurit të hershëm (1050 –750 p.e.s.), ajo u lartësua nëpërmjet 200 varrimeve të tjera të mbuluara me dhe, deri sa ajo mori formë gjysmësferike, me diametër 50 m, e lartësi rreth 3m.

Në periudhën e tretë të përdorimit të tumës, që përkon me gjysmën e dytë të shek. VII të p.e.s, në periferinë e pjesës jugore e verilindore të saj janë ndërtuar disa struktura monumentale rrethore ose gjysmë rrethore, brenda të cilave janë varrosur individë me lidhje gjinore.

Gjatë një periudhe shumë të shkurtër kohe (625–540 p.e.s.), tuma e Kamenicës është zmadhuar, duke u shtrirë kryesisht drejt lindjes, nëpërmjet varrimeve intensive të realizuara vetëm me gurë, derisa ajo mori formën e një elipsi me përmasa 70m x50m.

## 8. PROGNOZA E ZHVILLIMIT

Ndër problemet më imediate veçohen:

1. Rikonstrukcion i frigoriferëve dhe rritja e kapacitetit të tyre.
2. Fabrikë perpunimi për mollët dhe qershitë



### 3. Ujësjetësi



Fig. 38 Manastiri i Shën Pjetrit, Vithkuq

## PROFILI I NJËSISË ADMINISTRATIVE VITHKUQ

### 1. Gjenezë – historiku i fshatrave

Vithkuqi daton si vendbanim që me kalatë e Boshanjit, Leshnjës, Bellovodës, (periudha e parë e hekurit). Në mesjetë përmendet si vendbanim në Principatën e Muzakajve. (shek.XV). Në kohën e lulëzimit të vet numëronte një sërë kishash dhe bazilikash disa prej të cilave ruhen edhe sot.

Vithkuqi ka patur 24 kisha, prej të cilave sot ruhen vetëm 4, në gjendje të mirë dhe të restauruara, që përfaqësojnë vlera të mëdha historike të artit bizantin. Përmendim ndër to kishën e Shën Pjetrit, si dhe kishën e shën Mëhillit. Kisha e parë është ndërtuar në shek. e XII dhe në shek. e XVI fshati kishte 343 familje. Vithkuqi është vendlindja e Naum Panajot Bredhit (1767-1846), ideologut të Rilindjes Kombëtare, hartuesit të “Evetarit” (1814), abetares së parë shqipe, me 33 shkronja. Nga ky fshat kanë dalë figura të njohura si piktori i madh Vangjush Mio, i cili njihet si piktori i “njerëzve”, i frymëzuar nga peizazhet e Korçës.





Fig. 39 Pamje nga Vithkuqi

## 2. Demografia

Njësia administrative Vithkuq ka **2700 banorë** (*Burimi: Njësia Administrative Vithkuq, 2016*) dhe përbëhet nga 13 fshatra: Vithkuq, Leshnjë, Gjanc, Lubonjë, Rehovë, Roshanj, Trebickë, Grabocke, Treskë, Stratobërdh, Panarit, Shtyllë, Cemicë.

Janë **25 familjeve** që trajtohen me ndihmë ekonomike në këtë njësi.

Numri i personave që përfitojnë pagesë paaftësie:

**35 persona** me aftësi të kufizuar

**5 persona** të verbër

**3 persona** paraplegjikë

## 3. Ekonomia

Në njësinë administrative Vithkuq janë 6 punonjës: 2 në administratë dhe 4 shërbime.

Rreth 40% të të ardhurave sigurohen nga miracioni dhe pjesa tjetër e aktivitetit ekonomik është bujtësia dhe blegtoaria. Në këtë njësi janë 2 baxho në Panarit, në Vithkuq dhe një tjetër sezonal në Lubonj (mars, maj, korrik, gusht, shatator). Në Vithkuq ndodhen edhe 2 hotele dhe disa shtëpi të tipi bujtina. Në këtë njësi janë të pozicionuar edhe 7 rezervuarë të vegjël: 2 në Vithkuq 2 në Panarit, 2 në Lubonjë dhe 1 në Grabockë. Është edhe rezervuari i Çemicës i cili nuk funksionon më.



Fig. 40 Rezervuari i Gjançit

## 4. Infrastruktura

*Uji i pijshëm*

Mbulimi i zonës është 24 orë dhe kjo ndodh për shkak të burimeve të shumta që ndodhen në zonë. Rrjeti i ujësjellësit është ndërtuar pas viteve '90 por ka akoma nevojë për shtim të kapacitetit. Ai nuk është i pajisur me matësa. U vendos nje tarifë por për shkak të keqmenaxhimit nuk pati vazhdimësi përveçse në fshatin Leshnjë dhe Gjanç që paguajnë me fatura të rregullta.

**Ujërat e zeza**

Janë bërë rregullime për kanalet e ujërave të zeza por nuk janë në nivelin e duhur dhe lënë shumë për të dëshiruar.

**Transporti**

Në njësinë administrative funksionojnë 2 linja të cilat bëjnë lidhjen me Korçën:  
 Lubonjë- Korçë  
 Vithkuq- Korçë, e cila përbëhet nga 2 fugonë dhe një autobus. Këto mjete nisen në mëngjes e kthehen pasdite. Në fshatin Panarit transport publik nuk ka dhe përdoret ai privat. Problem përbën ura e Floqit e cila është në gjendje të prishur.




Fig. 42 Harta e periferialitetit për njësinë administrative Vithkuq



Fig. 41 Rrugë për në Vithkuq

Distanca nga Qendra e Nj.A.	Distanca nga Bashkia
-----------------------------	----------------------



Nj. Admin.	Qyteti/Fshati	hapësirë		kohë		hapësirë		kohë	
		(km)	(orë)	(min)	(km)	(orë)	(min)		
Vithkuq									
	Vithkuq	0	0	0	26.4	1	0		
	Cemicë	14.4	0	35	40.9	1	40		
	Grabockë	s'ka rrugë			s'ka rrugë				
	Gjanc	8.5	0	20	21.4	1	0		
	Leshnje	4.1	0	10	99				
	Lubonjë	19.9	0	50	27.1	1	15		
	Panarit	21.2	1	0	47.7	2	0		
	Rehovë		0	50		1	15		
	Roshanj		0	40		1	0		
	Stratobërdh	51.1	2	0	51.6	2	0		
	Shtyllë	6.1	0	15	32.5	1	15		
	Trebickë	60.6	2	30	61.1	2	30		
	Treskë	54.3	2	15	54.8	2	10		

Tab. 7 Periferialiteti i njësisë administrative Vithkuq

### *Elektrifikimi*

Problemet me elektrifikimin janë të shumta dhe sistemi është i amortizuar. Për shkak të këtij amortizimi, në stinën e dimrit fshatrat mbeten pa energji elektrike si pasojë e defekteve të shumta.

Për ngrohje përdoren dru zjari.

Në fshatin Vithkuq ndodhen 3 Hec ndër të cilët një është i vjetër (I pari në Shqipëri) dhe dy të tjerë janë të rinj, 3 në fshatin Treskë , 1 në Lubonjë dhe është duke u ndërtuar një tjetër në katund (5 janë funksionalë).

### *Vendgrumbullimi i mbetjeve*

Në njësinë administrative vithkuq ka 3 venddepozitime mbetjesh përkatësisht në Vithkuq, Lubonjë dhe Leshnjë. Në këto fshatra menaxhimi i plehrave bëhet 2 herë në javë ndërsa në fshatrat e tjerë janë banorët ata që i menaxhojnë pasi nuk ka as kosha grumbullimi.

## 5. Shërbime

### *Arsimi*

Në njësinë administrative Dardhas mungojnë çerdhet. Kopshte ka vetëm në 2 fshatra përkatësisht: Vithkuq, dhe Lubonjë. Shkolla fillore e 9 - vjeçare janë 4 dhe ndodhen në Lubonjë, Panarit, Vithkuq dhe Leshnjë. Shkollat e mesme mungojnë. Dikur ekzistonte një e tillë në Vithkuq e cila u mbyll si pasojë e numrit të vogël të nxënësve. Aktualisht janë rreth 40- 50 nxënës dhe kush ka mundësi i vazhdon studimet e mesme në Korçë.

### *Shëndetësia*

Në fshatin Leshnjë, Lubonjë dhe Panarit kanë ambulancë dhe funksionojnë me një doktor. Vithkuqi ka një qendër shëndetësore me një doktor dhe tre infermierë. Në fshatrat e tjerë veprohet në bazë të një axhende të hartuar nga mjeku.

### ***SIGURIA - urgjencat zjarrfikese / komisaritate policie / zona ushtarake***

Në njësinë administrative Vithkuq nuk ka komisaritate policie dhe urgjenca zjarrfikëse. Në rastin e nevojës për shërbime të tilla, ato sigurohen nga qyteti i Korçës. Në fshatin Dvoran dhe Vithkuq drejtorja e policisë në Korçë ka vënë në dispozicion një polic i cili vjen herë pas here. Zona ushtarake ka patur por nuk është më në funksion.

## **6. Asetet Kulturore**




Fig. 43 Kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq

### ***Kisha e Shën Mëhillit, Vithkuq***

Sipas mbishkrimit mbi portën jugore të kishës:  
Kisha ka filluar të ndërtohet në vitin 1682 dhe është pikturuar nga Mihaili dhe Gabrieli, me shpenzimet e të krishterëve që jetonin në Vithkuq dhe me kontributin e prift Stavrit, ikonom dhe epitrop, të episkopimit të gjithëshenjtë, Mitropolitit të Kosturit Zotit Krisanth dhe të priftërinjve të tjerë, në 1 tetor 1728.

Është kisha më e vjetër dhe më e madhe që ruhet në Vithkuq, e ndërtuar në vitin 1728. Përbëhet nga naosi, narteksi dhe hajati.

### ***Liqeni artificial i Gjançit***

Liqeni artificial i Gjançit është një tjetër atraksion i kësaj zone. Ai ka lloje të ndryshme peshku dhe shërben gjithashtu edhe për ujitje.

### ***Lapidari i brigadës së parë të ushtrisë nacionalçlirimtare***

## **7. PROGNOZA E ZHVILLIMIT**

Kërkesa për ndërtim ka patur shumë pak kryesisht për shtëpi dhe rikonstrukcion. Ka problem me regjistrimin e pronave. Në Vithkuq dhe Lubonjë nuk është bërë fare regjistrimi ndërsa me AMTP janë pajisur të gjithë.


Me zgjidhjen e disa problemeve më imediate, zona do të merrte një zhvillim të konsiderueshëm. Ndër problemet më imediate veçohen:

1. Sistemimi i rrugëve.
2. Rikonstrukcion Ura e Floqit – Vithkuq dhe ura e Floqit- Lubonjë.

## 3. Ndriçimi i jashtëm

3. Ndërhyrjet në infrastrukturën bujqësore. (kanalizimet dhe mbrojtja e tokës nga gërryerjet etj.)

## 1.3. Analiza Metabolike e Flukseve



Analiza e aktiviteteve ambientale dhe njerëzore përcaktojnë “metabolizmin urban” të qyteteve duke shqyrtuar në mënyrë të veçantë fluksin e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve, me qëllim gjetjen e mundësive për ndërhyrje në shtetet territoriale me strategji të zhvillimit të qendrueshëm. Analiza metabolike bazohet në shqyrtimin e katër flukseve të sipërpërmendur duke kuantifikuar hyrjet dhe daljet e tyre.

Vlen të theksohet që në analizën e këtyre fluksëve, aty ku të dhënat në

nivel bashkie mungojnë, janë përdorur të dhëna në nivel kombëtar kryesisht duke ju referuar INSTAT, Cencusit 2011, etj. Kështu konkretisht fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit nuk mund të përkufizohen vetëm brenda kufijve administrativ, pasi burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen, dhe gjithashtu fluksi i ujit analizohet nëpërmjet burimeve nëntokësore apo burimeve sipërfaqësore, që nuk i përkasin vetëm territorit të Bashkisë Korçë, por menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

*Gjithashtu vlen të theksohet që për llogaritjen e treguesve të konsumit të ujit, energjisë dhe ushqimit për frymë janë përdorur të dhënat kombëtare, duke shfrytëzuar treguesit e raportit të Cencusit 2011.*

Analiza e metabolizmit të Bashkisë Korçë merr në konsideratë disa faktorë që ndikojnë në flukset e energjisë, ushqimit, ujit dhe mbetjeve, duke shqyrtuar burimet si inpute dhe konsumin si output. Korça ka një sipërfaqe prej 806 km<sup>2</sup> dhe një popullësi prej 129'805 banorësh. Analiza e flukseve ndjek të njëjtën metodologji për të katër flukset në parim, por që për shkak të mungesës së informacionit pësojnë modifikime rast pas rasti. Praktiskisht për të analizuar flukset janë, marrë në shqyrtim hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim identifikimin e problemeve mjedisore, hot spoteve, dhe humbjet përkatëse.

**Fluksi i ujit**

Fluksi i ujit merr në shqyrtim gjithë burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore si inpute dhe konsumin e ujit fokusuar në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve të bashkisë Korçë.

*Burimet ujore* – Relievi i Bashkisë së Korçës është pjesë e dy ujëmbledhjeve të mëdha kombëtare që kanë lidhje me lumin Devoll dhe Osumin në Jug. Kështu lugina e Devollit të Sipërm kalon në krahë të Bashkisë në fushëgropë, por ajo merr ujrë që rrjedhin nga relievi i Moravës dhe fushëgropës së Korçës, nga lugina dhe ujëmbledhja e Çemeritës dhe faqeve të Kreshtit të Ostrovicës. Ndërkaq në jug relievi i Malësisë së Vithkuqit Përcjell format dhe ujarat e luginave jugore në lumin Osum.

Ujëmbledhja e fushëgropës, lidhet me vet ndërtimin kohor të fushës e cila veç groprores tektonike që ka përcjell ujrë duke ndikuar në relief përgjatë shtrirjes së saj drejt veriut, në fillimin e Devollit të Epërm (Kanali i Dunavecit). Në fushëgropë hyjnë ujrë që vijnë nga faqet e Moravës, ato që rrjedhin nga Kamenica, Floqi e faqet veriore të Qafës së Qarrit, ato të Gjançit, Dërsnikut, Gjonmadhit, Vinçan- Damjanecit. Lumi i Devollit, që buron në malet e Gramozit, rreshtohet i dyti



për nga gjatësia me 295 km. Lumi i Dunavecit buron në jug të ultësirës së Korçës, në pjesën malore të saj të përbërë nga shkëmbinj ultrabazike dhe gëlqerorë. Gjatë rrjedhjes së tij nga Jugu në Veri në këtë lumë derdhen degë të vogla të tij si lumi i Kamenicës, i Dersnikut, Voskopit, Drenovës, Dvoranit, etj. Regjimi hidrologjik i lumit Dunavec ashtu si dhe lumi Devoll, është në vartësi të plotë të reshjeve atmosferike nivelet dhe prurjet maksimale të këtij lumi takohen në muajin Mars, duke arritur respektivisht vlerat 393cm – 448cm dhe 6.96m<sup>3</sup>/sek. Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e këtij lumi janë të tipit Hidrokarbonat – Magnezium – Kalciumi me Mineralizim të përgjithshëm M.

Qarku i Korçës është i njohur për burime të konsiderueshme dinamike të ujërave nëntokësore. Akuiferët karstikë dhe ato ndërkokrizzor vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë deri mesatare, dhe janë mjaftë të rëndësishëm në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm. Zona e urbanizuar e Bashkisë Korçë dhe një pjesë e mirë e njësisive administrative përreth (ish-komuna) furnizohen nga Puset e Turanit pjesë e akuifereve kuaternare. Burimet ujore shfrytëzohen gjerësisht dhe në bujqësi për vaditje.

Burimet e përgjithshme dinamike në qarkun e Korçës vlerësohen minimalisht 4.832 m<sup>3</sup>/s (pasi burimet janë marrë me prurjet minimale). Rezerva që mund të përdoren për furnizim me ujë të pijshëm janë edhe rreth 3.712m<sup>3</sup>/s, kryesisht nga akuiferi karstik.

*Konsumi i ujit* – Qyteti i Korçës ka një furnizim me ujë të pijshëm nga më të mirët në Shqipëri si për sa i përket burimeve, kohëzgjatjes (24 orë) ashtu edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë për banorë. Gjatësia e këtij rrjeti arrin në rreth 120km ka mundësuar uljen e humbjeve në rrjet, përmirësimin e stacionit të pompave si dhe sasinë e depozitimit. Ky furnizim me ujë i qyteti të Korçës realizohet nga ujësjellësi qytetit i ndodhur në fshatin Turan ku është ngritur dhe stacioni i pompave. Nga monitorimi dhe analizat, uji i Korçës rezulton pa ndotje bakteriologjike.

Në fshatra, në përgjithësi nuk ka probleme me burimet për furnizimin me ujë, por problem përbëjnë shpeshherë tubacionet e shpërndarjes të amortizuara, mungesa e matësve të ujit, abuzimet me ujin e pijshëm duke u përdorur për vaditje, etj.


**NJ.ADMINISTRATIVE**    **Furnizim me ujë**                      **Banesa me ujë të**                      **Pa furnizim me ujë**  
**rrjedhshem në wc**

NJ.ADMINISTRATIVE	Furnizim me ujë	Banesa me ujë të rrjedhshem në wc	Pa furnizim me ujë
<b>BULGAREC</b>	49.83	56.94	1.22
<b>DRENOVË</b>	75.35	73.33	0.77
<b>KORÇË</b>	93.79	94.34	0.16
<b>LEKAS</b>	8.33	11.46	0
<b>MOLLAJ</b>	64.05	61.03	0.56
<b>VITHKUQ</b>	49.41	49.17	0
<b>VOSKOP</b>	45.09	44.02	0.21
<b>VOSKOPOJË</b>	53.93	52.5	2.86

*Burimi: INSTAT*

Për të kuptuar hartëzimin e kosumit të ujit nga banorët dhe bizneset e Bashkisë së Korçë, siç u citua në fillim të analizës janë përdorur të dhënat e INSTAT Cencus 2011, që paraqet shpërndarjen e popullësisë në territor sipas rrjetit kuadratik prej 1km<sup>2</sup>. Konsumi i ujit llogaritet për konsumatorët familjarë dhe bizneset, por duke qënë se nuk ekziston një hartëzimi i shpërndarjes së bizneseve në territor grafikisht marrim në konsideratë vetëm konsumin e familjeve ku kemi llogaritur mbi bazën

e statistikave zyrtare të konsumit të ujit për familje mesatarisht 100 litra/banor/ditë, konsumin vjetor.



### Fluksi i energjisë

Analiza e fluseve të energjisë bazohet në potencialet energjitike si burime të vet territorit në raport me konsumin e energjisë aktualisht në Bashkinë e Korçës.


#### Potenciale energjitike dhe prodhimi i energjisë në territorin e bashkisë Korçë

Sektori i transportit mban peshën më të madhe përkundrejt totalit të konsumit të energjisë me 40.43 %, sektori i banesave 26.06 %, industria 16.32 %, sektori i shërbimeve 8.51 % dhe bujqësia e të tjerat 8.68 %.

#### Konsumi final i burimeve energjetike sipas sektori

Në vitin 2010 sektori i banesave ka konsumuar 45.7 % të energjisë elektrike.

Pas tij vjen sektori i industrisë me 18.3 %, më pas sektori i shërbimeve me 21.3 %, dhe në fund vjen sektori i bujqësisë me 1.8 %. Vlen të theksojmë, se pas vitit 2008 KESH-i, nëpërmjet një harmonizimi të kënaqshëm të importeve gjithvjetore të energjisë elektrike, si dhe




çdo

me përpunimin racional të rezervës hidroenergjetike në kaskadë, arriti të kryejë furnizimin e plotë të konsumatorëve të vendit tonë me energji elektrike. Prodhimi më i ulët vjetor gjatë kësaj periudhe është ai i vitit 2007 me 2,918 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 7.9 milion kWh. Ndërsa prodhimi më i madh është ai i vitit 2010 me 7,743 milion kWh, ose me një prodhim mesatar ditor prej 21.2 milion kWh. Sikurse vihet re diferenca ndërmjet këtyre dy prodhimeve ekstremale arrin në 2.7 herë. Një tregues i tillë shpreh në mënyrë sinjifikative shkallën e lartë të riskut në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik të vendit tonë, të mbështetur vetëm në HEC-e. Po kështu, për periudhën 2007-2011 vërehet një rritje e ndjeshme e prodhimit vendas të naftës brut, duke arritur në vitin 2011 në 891 000 ton (nga rreth 320 000 ton, që ka qënë në vitin 2000), ndërkohë që përpunimi i naftës brut në rafineritë e vendit ka pësuar rënie, si në vlerë absolute, por për më tepër në vlerë relative, në krahasim me prodhimin e naftës brut në vend, duke bërë, që të rritet gjithmonë e më tepër eksporti i naftës brut.

### Situata Aktuale

**Energjia elektrike në dispozicion** e përfutur nga të gjitha burimet, në vitin 2014 u ul me 0,8 përqind krahasuar me vitin 2013. Sasia e energjisë së prodhuar në vend dhe shkëmbimi i energjisë elektrike rezultoi 7.794 GWh.

**Burimi kryesor** i prodhimit të energjisë elektrike është prodhimi nga hidrocentralet. Sasia e energjisë së prodhuar prej tyre është ulur 32,1 përqind krahasuar me një vit më parë. Prodhimi nga hidrocentralet publike përfaqëson 72,1 përqind të prodhimit neto vendas, ndërsa prodhimi i energjisë nga prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë përbën 27,9 përqind.



**Importi bruto i energjisë elektrike** (energji në marrje) rezultoi me rritje prej 44,5 përqind duke arritur vlerën 3.356 GWh nga 2,323 GWh në 2013.

*Energjia e instaluar e HEC-eve per cdo basen ujqor  
Burimi Strategjia Kombetare per Menaxhimin e  
Integruar te Ujerave*

**Eksporti bruto i energjisë elektrike** (energji në dhënie) ishte 288 GWh në vitin 2014 nga 1.425 GWh që përbënte një vit më parë. Në krahasim me vitin

2013, **humbjet në rrjet** janë ulur 15,8 përqind nga 3.306 GWh në 2.783 GWh. Ato përbëjnë 35,7 përqind të sasisë së energjisë të disponueshme për konsum. Humbjet në shpërndarje përbëjnë 94,2 përqind të humbjeve në rrjet, të cilat rezultuan me rënie 15,3 përqind



**Energjia Diellore** mund të shfrytëzohet kryesisht për prodhimin e ujit të ngrohtë dhe fare pak për prodhim energjie elektrike. Ajo pothuajse nuk shfrytëzohet. Potenciali teorik për shfrytëzimin e energjisë diellore në rajonin e Korçës shkon nga 1200 kWh/m<sup>2</sup>. Nga një vlerësim i ditëve me diell rezultojnë, se Korça ka një mesatare të orëve me diell me rreth 2400 orë/vit.

### **Energjia e Erës**

Nga vlerësimet paraprake konstatohet, se erëra me shpejtësi mbi 5 m/s për lartësinë 10 m, rezultojnë të jenë rreth 2200 orë, kurse për lartësitë nga 50 deri 75 m orë në vit, me shpejtësi mbi 5 m, rezultojnë të jenë rreth 3000 orë. Është konstatuar, se vendet më të përshtatshme për ndërtimin e parqeve me erë, për prodhimin e energjisë elektrike janë zona Masivi malor Pogradec- Moker-Korcë dhe zona e Devollit. Deri në tremujorin e parë të vitit 2012, nga ERE dhe nga METE, janë licensuar disa kompani të ndryshme për të ndërtuar parqe eolike, që shfrytëzojnë energjinë e erës, me një fuqi të instaluar në shkallë vendi prej rreth 1600 MW, një pjesë e së cilës është në shkallë regionale Korçë -Pogradec.

**Energjia e biomasës** përftohet si energji e pastër nga përpunimi i nënprodukteve të drurit ose të agrikulturës, nëpërmjet teknologjive të ndryshme. Biomasa, si lëndë energjetike përdoret në formën e saj tradicionale për ngrohje dhe gatim, nëpërmjet druve të zjarrit apo mbetjeve të tjera të agrikulturës. Sipas vlerësimeve paraprake të përafërta, energjia e biomasës në vendin tonë është rreth 7 Mtoe, kurse energjia e biomasës e siguruar nga mbetjet bujqësore është llogaritur në rreth 130 toe/vit, ku rajoni i Korçës zë vend kryesor në këtë prodhim.

**Energjia gjeotermale.** Sipas studimeve në Shqipëri ekzistojnë disa zona në të cilat ka mundësi shfrytëzimi i energjive gjeotermale. Në qendrën e Ultësirës Perëndimore, dendësia e fluksit të nxehëtisë është 41.3 mW/m<sup>2</sup>, në Masivin Malor të Korçës, llogaritet që dendësia e fluksit të nxehëtisë të luhatet nga 40 mW/m<sup>2</sup> deri në 61. 8 mW/m<sup>2</sup>.

Një filozofi tjetër që shoqëron Planin e Përgjithshëm Urban është që të gjitha ndërtimet, si në zonën urbane (qytet), apo në zonen suburbane (fshat) të gjitha ndërtimet duhet të kenë për mbulesë atë të tipit çati, pse jo pjese të kësaj çatie të përshtatura me paisje si panele diellore për përfitim energjie, ndërtesa me çfarëdolloj kati. Mbulimi me çati na siguron jo vetëm termoizolim apo kursim energjie por edhe moskthim të energjisë diellore për shkak të së cilës kemi një rritje të temperaturave lokale, përpos një vizioni absurd joestetik.

Një koncept tjetër i Planit të Përgjithshëm Urban që duhet të shoqërojë funksionimin e një bashkie është arritja apo sigurimi i ndërtesave me Energji 0, të paktën e atyre që ndërtohen rishtaz, kjo dmth që të gjitha ndërtesat e planifikuara për ndërtim, do të nënshtrohen një procesi analitik të shfrytëzimit të energjive alternative. Ku rrjeti do të punojë me dy kahje, edhe të marre nga rrjeti kombëtar por edhe një zgjidhje lokale dhe specifike (mulli ere, panele diellorë, biomas) ti japi rrjetit kombëtar. Këto quhen ndërtesa të tipit me energji 0 dhe në rastin kur jep më shumë seç mer quhen ndërtesa me energji pozitive në përputhje të plotë me legjislacionin European.

*Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje*

Një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri është ajo elektrike, por në Korçë në veçanti gjatë muajve të dimrit ngrohja garantohet nga drutë e zjarrit. Më poshtë paraqitet përqindja e familjeve në Bashkinë Korçë sipas llojit të ngrohjes që përdorin në nivel Njësie Administrative:

NJESIA ADMINISTRATIVE	% E FAMILJEVE QË PËRDORIN DRU	% E FAMILJEVE QË PËRDORIN ENERGJI ELEKTRIKE	% E FAMILJEVE QË PËRDORIN GAZ
BULGAREC	99.27	0.09	0.17
DRENOVË	99.31	0	0.21
KORÇË	90.83	2.31	4.79
LEKAS	100	0	0
MOLLAJ	98.89	0	0.22
VITHKUQ	99.3	0	0
VOSKOP	99.57	0.11	0
VOSKOPOJË	99.29	0	0

Burimi: INSTAT

Për llogaritjen e konsumit të energjisë në rang Bashkie është përdorur një mënyrë projektimi nga të dhënat që gjenerohen në nivel vendi. Referuar të dhënave të INSTAT per konsumin e energjisë elektrike janë si më poshtë:

Në MWh	
Përdorimi nga konsumatorët	5,069,252
Familjarë	2,522,261
Jo Familjarë	2,546,991
Humbje	2,783.182
<b>TOTALI I KONSUMIT</b>	<b>7,793.736</b>

Për të llogaritur nivelin e Konsumit të Energjisë në nivel Bashkie janë përdorur llogaritjet e mëposhtme:

- Konsumi Familjar**

	Popullsia	Numri i familjeve në Shqipëri	Konsumi Familjar (MWh)	Mesatare konsumi për familje (MWh)
Shqipëri	2,886,026	721,507	2,522,261	3.5
Bashkia Korçë	75,699	18,925	<b>66,158</b>	<b>3.5</b>

Burimi: INSTAT, Përlllogaritjet IDRA<sup>7</sup>

- Konsumi jo familjar**

Nr. i Bizneseve Aktive	Konsumi jo familjar	Mesatare konsumi për biznes
------------------------	---------------------	-----------------------------

	(2015)	(MWh)	(MWh)
<b>Shqipëri</b>	<b>132,745</b>	2,546,991	19.2
<b>Korçë</b>	3,526	<b>67,654</b>	

Burimi: INSTAT, BASHKIA, Përlllogaritjet IDRA<sup>8</sup>

- **Humbje**

Duke marrë për bazë të njëjtin trend të humbjeve si në nivel kombëtar (55% e konsumit familjar dhe jo-familjar) përlllogaritjet që humbjet në nivelin e bashkisë së Korçës të shkojnë në **73 600 MWh**.


Tabela përfundimtare e konsumit të energjisë në Bashkinë e Korçës paraqitet më poshtë.

	Në MWh
<b>Përdorimi nga konsumatorët</b>	<b>133,811</b>
<b>Familjare</b>	66,158
<b>Jo Familjare</b>	67,654
<b>Humbje</b>	<b>73,596</b>
<b>TOTALI I KONSUMIT</b>	<b>207,408</b>

Burimi: INSTAT, BASHKIA, Përlllogaritjet IDRA

Gjithashtu edhe në rastin e analizës së fluksit të energjisë për të kuptuar hartëzimin e konsumit të energjisë nga banorët dhe bizneset e Bashkisë së Korçës, siç u përmend edhe më lart janë përdorur të dhënat e INSTAT Cencus 2011, që paraqet shpërndarjen e popullësisë në territor sipas rrjetit kuadratik prej 1km<sup>2</sup>. Konsumi i energjisë referuar tabelës së mësipërme për konsumatorët familjarë është 3.5 MWh, gjithashtu një peshë të konsiderueshme e zë konsumi jo-familjar, por duke qënë se nuk ekziston një hartëzim i shpërndarjes së bizneseve në territor grafikisht marrim në konsideratë vetëm konsumin e familjeve.





### Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Sipërfaqja e tokave bujqësore për Bashkinë Korçë është **14'811 Ha** dhe sistemi natyror me potencial për zhvillimin e pentarisë me një sipërfaqe prej **20'070 Ha**. Përsa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Korçë, analizojmë prodhimet bujqësore dhe blegtorale që prodhohen në territor, pasi zënë dhe peshën kryesore në këtë fluks.

Njësia	Territori gjithsej (ha)	Tokë bujqësore (ha)	Pyje (ha)	Kullota (ha)	Tokë e ndarë sipas ligjit (ha)	Tokë bujqësore në 2015 (ha)	Arë (ha)	Pemtore (ha)	Vreshta (ha)	Livadhe (ha)
Bulgarec	6076	4262	1780	34	4262	4262	3880	242	140	0
Drenovë	6215	2465	3000	750	2465	2465	2269.5	190	5.5	0
Mollaj	5120	1850	1900	1370	1850	1850	1390.4	440.6	19	0
Voskop	6238	3248	2500	490	3248	3226	2801.5	174	190.5	60
Vithkuq	16282	1281	8660	6341	1281.5	1281.5	1261.6	13.5	6.6	0
Voskopojë	5461	1223	3220	1018	1223	1217	706	27	0	484
Lekas	7349	482	3660	3207	482	482	476	6	0	0
<b>TOTAL</b>	<b>52741</b>	<b>14811</b>	<b>24720</b>	<b>13210</b>	<b>14811.5</b>	<b>14783.5</b>	<b>12785</b>	<b>1093.1</b>	<b>361.6</b>	<b>544</b>

### Prodhimet në bimët e arave

Kufizimi i sipërfaqeve për bimët kryesore, mbjellja në tokat më të mira ka rezultuar me rritjen e rendimenteve në bimët bazë. Kjo është reflektuar në prodhimet e realizuar (tabela më poshtë).

<i>Emërtimi</i>	<i>2005 (tonë)</i>	<i>2013 (tonë)</i>	<i>2014(tonë)</i>	<i>2015 (tonë)</i>
1.Drith buke	16028	17390	16135	18066
-Grurë	11055	12481	11611	13519
2.Patate	8109	15804	15990	16867
3.Fasule	472	462	525	532
4.Perime,bostan	9407	18583	19318	20145
5.Duhan	27	13	10	47

*Prodhimet në bimët kryesore të arave.*

Në përgjithësi prodhimi në bimët e ndryshme në vitet e fundit në tërësi është i stabilizuar me një rritje të lehtë në perime, patate. Në krahasim me vitin 2005 ka rritje të ndjeshme në patate dhe perime. Megjithatë në krahasim me vitin 1985 në vitin 2015 janë prodhuar më pak drithra buke **1174 tonë, patate 5172 tonë,dhe duhan 629 tonë.**

**Pemëtaria dhe vreshtaria** është aktivitet prodhues i shtrirë në të gjithë zonën rurale të Bashkisë Korçë. Në pemëtari konstatohet se në krahasim me vitet para 1990, është përmirësuar ndjeshëm teknologjia sidomos në format e krasitjes duke preferuar ato të ulëta për të lehtësuar shërbimet dhe vjeljen, është rritur po ashtu ndjeshëm numri i pemëve për ha. etj. Në vitin 2015 janë të mbjella me pemë frutore 1093 ha ose 9.2 për qind e sipërfaqes së tokës së mbjellë dhe 362 ha me vreshta ose 3 për qind të sipërfaqes së mbjellë.

*Numri i pemëve dhe prodhimi*

Numri i pemëve dhe prodhimi në disa vite tregohet në tabelën më poshtë.

<i>Emërtimi</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>
1.Pemë gjithsej (000/rr.	613.7	767	788.6
-Në prodhim	572	610.1	617
-Prodhimi (tonë)	20851	24521	28220

*Prodhimi i frutave.*

Sikurse shihet prodhimi i frutave është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në krahasim me vitin 1985 në shkallë rrethi, që është një nga vitet më të mirë, janë prodhuar afërsisht 3000 tonë më shumë fruta vetëm në këto ekonomi. Nga prodhimi gjithsej molla përbën 86 për qind, kumbullat 8.1 për qind dhe qershitë rreth 10 për qind. **Për të ardhmen kujdes duhet të përmirësohet struktura varietore e mollës duke synuar eksportin.**

### **Vreshtaria**

Duhet thënë se Bashkia e Korçës, bën pjesë ndoshta zona më e favorshme mikroklimatike dhe tokësore për prodhimin e rrushit. Fjala është për zonën nga Polena në Melçan. Në këtë zonë

krijohen mundësitë për një përmbajtje të lartë të sheqerit në kokërr. Prodhimi i rrushit tregohet në tabelën më poshtë.

<i>Emërtimi</i>	<b>2005</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>
1. Vreshta gjithsej (ha)	326	360	362	362
2. Prodhim rrush gjithsej (ton)	1071	1473	1656	1665
-Nga pjergullat	446	920	935	1034

*Prodhimi i rrushit.*

Në vitin 2015 në krahasim me vitin 2005 prodhimi i rrushit është rritur mbi 55 për qind. Komuna Voskop dhe Mollaj kanë pasur peshën kryesore të prodhimit.

### ***Prodhimet blegtorale***

Prodhimet blegtorale tregohen në tabelën më poshtë (në tonë):

<b>Emërtimi</b>	<b>1995</b>	<b>2011</b>	<b>2015</b>
1. Qumësht gjithsej	22065	19910	21439
-Lope	18884	16571	17028
-Dele	1581	2362	3076
-Dhie	1600	707	1362
2. Mish gjithsej	2010	3448	3077
-Gjedhi	1133	1423	1193
-Të imtash	665	1507	1469
-Derri	192	439	196
-Shpendësh	20	79	219
3. Vezë (000/kokrra)	3457	6987	5746

*Prodhimet blegtorale.*

Sasia e qumështit ka një rënie të lehtë ndërsa prodhimi i mishit dhe vezëve është rritur.

### **Konsumi i produkteve bujqesore**



Për të llogaritur konsumin e produkteve bujqësore në nivel Bashkie janë përdorur të dhënat mesatare për frymë të produkteve kryesore sipas burimit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujerave, dhe të dhënave të “Situatës Bujqësore të EU”<sup>9</sup>.


Sipas këtyre të dhënave ky konsum është sipas tabelës më poshtë:

Drithra	301	kg/fryme/vit
Patate	58	kg/fryme/vit
Mish	35	kg/fryme/vit
Qumesht	209	Lt/fryme/vit
Perime	200	kg/fryme/vit


Duke përdorur të dhënat e Censurit 2011 për vlerësimin e popullsisë së Bashkisë Korçe, janë përllogaritur sasitë e konsumit për produktet bujqësore dhe është vlerësuar

- i) nevoja për hyrje nga jashtë (kur prodhimi nuk mjafton), apo
- ii) nevoja për të nxjerrë në treg jashtë Bashkisë (kur prodhimi është me tepri).

Grafiku. Fluksi i Ushqimit (në ton)



Grafiku tregon se Korca ka potenciale të mëdha për të “eksportuar” Patatën, Perime dhe Qumesht. Nderkohe që ka nevojë për Drithera.



### Fluksi i mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen.

Studimi mbi mbetjet, nga njëra anë informon shoqërinë civile dhe publikun, nga ana tjetër jep gjendjen e menaxhimit të mbetjeve urbane, përsa i përket grumbullimit të tyre, trajtimit, reduktimit, riciklimit, kompostimit dhe groposjes, me qëllim përmirësimin e këtyre proceseve në të ardhmen, të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në mjedisin përreth dhe në shëndetin e popullsisë. Bashkia do të zhvillojë modelin e vet të depozitimit të mbetjeve, ku rindarja në shesh grumbullim dhe më pas vendgroposja, pa dyshim luajnë rolin më të rëndësishëm. Strategjia mbështetet mbi:

- Vlerësimin e grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbanë në shesh grumbullim;
- Pastrimin dhe disefektimin e vendeve përreth kontenerëve;
- Larjen dhe disifektimin e kontenerëve;
- Mirëmbajtjen e pikave të grumbullimit të mbetjeve urbane gjatë ditës; dhe
- Pajtueshmëria me kërkesat ligjore si cilësia e ajrit, zhurmat, dridhjet, rrjedhjet ujore dhe të lëngshme.

**Tab. - 15 Shkarkimet e mbetjeve**

Rryma e Mbetjeve	% Mesatare në Hedhjen e Mbetjeve Bashkiake	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/ditë (0.7kg/person/ditë)	Pesha e Mbetjeve Bashkiake të Shqipërisë/vit (266kg/person/vit)
		2,335 T/Ditë	852,360 T/vit
Organike	47.36	1,106	403,690
Dru	1.43	33	12,045
Letre	5.37	125	45,625
Kartoni	8.13	190	69,350
Total te Biodegradueshme	62.3	1,454	530,710
Plastike me densitet të ulët	8.46	198	72,270
Plastike me densitet të lartë	4.75	111	40,515
Qelq	5.75	134	48,910
Tekstile	5.27	123	44,895
Metale - Ferroze	0.56	13	4,745
Metale - Me Ngjyra	0.57	13	4,745
Mbetjet Spitalore	0.17	4	1,460
Produkte Gome	0.2	5	1,825
Mbetje Inerte	7.2	168	61,320
Mbetje nga produkte sanitare	3.25	76	27,740
MPEE	0.31	7	2,555
Bateritë	0.02	1	365
Prodhime të Mbetjeve nga Kafshët	1.08	25	9,125

**Burimi: Agjencia Evropiane e Mjedisit**

Problemet e administrimit të mbetjeve janë të shumta dhe të ndryshme. Zonat rurale nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve të cilat pastrohen nga ujërat dhe në këtë mënyrë zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore. Mbetjet bashkiake kanë një përqindje të lartë të mbetjeve organike dhe aktualisht në vendin tonë nuk kompostohen këto mbetje me qëllim që të reduktohet sasia e tyre në venddepozitime. Pjesa më e madhe e mbetjeve të krijuara (në peshë) janë të prirura të jenë substanca inerte, në veçanti mbetjet e ndërtimeve, por rreziqet më të mëdha janë të lidhura me vëllime të vogla (kryesisht industriale) të mbetjeve të rrezikshme. Mbetjet komunale kanë nevojë për një grumbullim të kushtueshëm dhe të zgjeruar, transportim dhe rregullim. Kondita të veçanta duhet t'u aplikohen kategorive të ndryshme, si p.sh. mbetjet nga shëndetësia. Sektori i mbetjeve paraqet një nga sfidat më të rëndësishme që ndesh Shqipëria.

**Menaxhimi i mbetjeve ne vend**

Menaxhimi i mbetjeve në vend është akoma në një nivel te ulët. Me sistem për grumbullimin e mbetjeve te ngurta janë pajisur vetëm qytetet, por jo zonat rurale. Sasia e mbetjeve që riciklohet është 10%. Kryesisht mbetjet asgjësohen në vend grumbullimit të mbetjeve. Përveç landfill-eve të Sharres dhe Bushatit dy venddepozitime të tjera të mëdha po planifikohen të bëhen brenda një afati të shkurtër: një në Qarkun e Korçës, në Maliq (mbështetur nga KfW) I cili do t'i shërbejë rajonit, si dhe një tjetër në Sarandë, Bajkaj (mbështetur nga Banka Botërore).

## **Menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme në vend**

Nuk ka një sistem të sigurtë për administrimin e mbetjeve të rrezikshme (atyre të prodhuara nga industrinë dhe ato shtëpiake). Sistemi i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme është shumë i dobët dhe pjesa më e madhe e grumbullimit të mbetjeve kryhet nga sektori privat, gjithashtu edhe impiantet e riciklimit janë në pronësi të sektorit privat. Sigurimi i këtyre aktiviteteve dhe sistemi i menaxhimit janë ende në fillimet e tyre dhe varen nga disponueshmëria e materialeve të riciklueshme me një cilësi të mirë.

### ***Industria e riciklimit***

Në shumicën e rasteve industria e riciklimit varet nga lëndët e para të riciklueshme që importohen në Shqipëri. Egziston një politikë dominuese dhe e përhapur e hapjes së gropave dhe e grumbullimit të mbetjeve në to. Instrumentet ekonomike për administrimin e mbetjeve janë të pakta dhe me vlerë të pakonsiderueshme.

### ***“Varrezat” e Automjeteve***

Vatra ndotjeje janë edhe “varrezat” e automjeteve që gjenden të shpërndara në shumë pika të hapësirave të bashkive të vendit, të cilat prodhojnë ndotje të përditëshme si në ujrat dhe në tokat përreth. Ato përmbajnë sasi të konsiderueshme substancash me shkallë të lartë ndotjeje, përfshirë naftën, vajrat, tretës dhe produkte të tjera petrokimike. Edhe pse në të gjithë Shqipërinë ka qendra dhe reparte për çmontimin e automjeteve të tilla, pjesa më e madhe e tyre nuk janë të pajisura me masat e mjaftueshme për parandalimin e ndotjes ose praktika të sigurta pune.



**Profili i të dhënave për fushat e mbetjeve në Bashkinë e Korçës**

Bashkia	Korçë	
Vendndodhja e fushës së mbetjeve	Drenovë, Voskop, Voskopojë, Bulgarec, Dishnicë, Belorta, Neviçisht, Polenë, Goskovë Poshtë, Lubonjë	
Sipërfaqja mesatare e fushave	1,300 m <sup>2</sup>	
Lartësia mesatare	~ 1 m	
Sipërfaqet gjithsej	14,300 m <sup>2</sup>	
Gjithsej sasia e materialit të depozituar	> 14,300 m <sup>3</sup>	
Lloji i mbetjeve të depozituara	Mbetje shtëpiake, inerte dhe dhera	
Përshkrimi i fushës së mbetjeve (gjendja: Tetor 2015)	<p>Kategoria A: Pas disa vjetësh, shumica e fraksioneve të mëparshme organike është mineralizuar pak a shumë në kompost/ dhé. Fraksionet që mbeten janë mbetjet inerte, plastike, skrap, qelq, lëkurë, tekstile, gomë dhe copa më të mëdha druri, si mobiljet.</p> <p>Në këto kushte, fushat e vjetra të mbetjeve përmbajnë pak a shumë materiale inerte me një potencial të ulët rreziku.</p>	
Pajisjet dhe infrastruktura	Asnjëra prej fushave nuk ka pajisje apo infrastrukturë.	
Ndikimet mjedisore/vërejtje	<p>Ndikime negative pamore (imazh i një vendi të papastër) shkaktohen kryesisht nga fushat e mëdha të mbetjeve me sasi të mëdha mbetjesh plastike dhe letre me ngjyrë të shpërndara. Ky imazh negativ ndikon edhe zonën përreth dhe për rrjedhojë turizmin në rajonin e Korçës.</p> <p>Shenjat e dukshme që kanë mbetur nga aktivitetet e hedhjes së pakontrolluar të mbetjeve në disa vende janë skarpitet e pjerrëta dhe kanalet e bllokuara të ujërave sipërfaqësore.</p>	



**Fusha e mbetjeve, Voskop**



**Fusha e mbetjeve, Goskovë Poshtë**



**Fusha e mbetjeve, Voskopjë**



**Fusha e mbetjeve, Neviçisht**



**Fusha e mbetjeve, Voskopjë**



**Fusha e mbetjeve, Neviçisht**

BASHKIA	Korça	Tregues të parashikuar për 2015			Nr.Biznesesh		Sasia e mbetjeve 2015 (ton/vit)		Sasia e mbetjeve 2015 (ton/ditë)	
		Banorë	Familje							
Njësia Administrative	(%)	Numër	Frymë/ familje	Numër	Të vegjël	Të mëdhenj	Të gjeneruara	Të mblidhura	Të gjeneruara	Të mblidhura
Korça	66.7%	69,447	3.0	23,149	1,871	408	29,478	27,512	113.4	105.8
Drenove	8.4%	8,725	5.0	1,745	61	18	1,592	1,259	6.1	4.8
Bulgarec	10.8%	11,240	4.3	2,596	90	49	2,051	1,622	7.9	6.2
Voskop	4.7%	4,847	3.9	1,251	55	2	884	700	3.4	2.7
Mollaj	5.4%	5,610	5.0	1,122	0	0	1,024	810	3.9	3.1
Voskopojë	1.7%	1,765	3.8	465	34	1	322	255	1.2	1.0
Vithkuq	1.9%	1,999	3.7	534	15	5	365	289	1.4	1.1
Lekas	0.5%	471	5.0	94	0	0	86	0	0.3	0.0
<b>TOTAL</b>	<b>100.0%</b>	<b>104,104</b>	<b>3.4</b>	<b>30,956</b>	<b>2,126</b>	<b>483</b>	<b>35,802</b>	<b>32,448</b>	<b>137.7</b>	<b>124.8</b>


### Sasia e gjeneruar e mbetjeve për Bashkinë Korçë<sup>10</sup>

Duke analizuar informacionet e mësipërme mbi sasinë e gjeneruar të mbetjeve dhe atë që mblidhet llogarisim sasinë që gjenerohet në ditë nga një familje për çdo familje sipas njësive administrative:

Korça	5 kg/ familje/ ditë
Drenova	3.5 kg/ familje/ ditë
Bulgareci	3 kg/ familje/ ditë
Voskop	2.7 kg/ familje/ ditë
Mollaj	3.5 kg/ familje/ ditë
Voskopojë	2.6 kg/ familje/ ditë
Vithkuqi	2.6 kg/ familje/ ditë
Lekasi	3.2 kg/ familje/ ditë

Këto të dhëna i hartëzojmë me anë të gridit 1km të INSTAT Cencusi 2011, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të përqendrimit të tyre në territor, ku gjithashtu kuptohet dhe mbulimi me infrastruktura shërbimi për heqjen e tyre.





## 2. Instrumentet dhe çështjet që influencojnë planifikimin e territorit

Bazuar në përcaktimet e rezultateve të pritshme në Termat e Referencës si dhe në zbatim të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore të tij, veçanërisht referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit” një ndër analizat e para të cilat zhvillohen në kuadër të hartimit të një dokumenti planifikimi është analiza dhe studimi i planeve të hartuara më parë ose në proces që ndikojnë në zhvillimin e territorit të Bashkisë. Metodologjia e hartimit të analizës së planeve të mëparshme është bazuar në një studim të dokumenteve të planifikimit, që për strukturim të informacionit ato janë ndarë në dy kategori kryesore: 1) Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë, që përmban jo vetëm analizat e planeve të mëparshëm territorial të hartuar për Bashkinë Korçë por edhe një pasqyrë të stetegjive ndërkombëtare, kombëtare dhe rajonale që ndikojnë në zhvillimin e Korçës; dhe 2) Dokumentimi dhe rishikimi i direktivave të planeve ekzistuese hapësinore kombëtare dhe sektoriale, standarteve dhe normave. Prej secilit dokument janë identifikuar objektivat dhe disa nga masat kryesore të cilat kanë implikime në hartimin e planit të ri të përgjithshëm vendor për Bashkinë Korçë.

### 2.2 Strategjitë dhe programet ndërkombëtare

**Strategjia 2020 e Evropës Jug-Lindore – Punësimi dhe prosperiteti në një këndvështrim Evropian (BE/ Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)**



Ky dokument është hartuar në vitin 2011, si përgjigje ndaj kërkesës së qeverive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në bashkëpunim me qeveritë e vendeve të këtij rajoni, për përgatitjen e një dokumenti në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me konkurrencën rajonale dhe strategjitë e rritjes.

Ky dokument fokusohet në pesë shtylla të modelit të ri zhvillimor:

- **Rritje e Integruar** – me fokus Tregjet Rajonale, ekonominë e orientuar drejt eksportit dhe -investimeve të huaja, etj.
- **Rritje e Zgjuar** – me fokus rritjen e konkurrueshmërisë Rajonale, udhëheqjen nga njohuria dhe novacioni dhe bazuar në kapitalin njerëzor, teknologjitë moderne të komunikimit dhe industritë kreative
- **Rritje e Qëndrueshme** – me fokus në infrastrukturën dhe energjinë e qëndrueshme, në përdorimin me efikasitet dhe ndjeshmëri të burimeve, sidomos atyre natyrore
- **Rritje Gjithëpërfshirëse** – me fokus avancimin përtej një shoqërie përjashtuese drejt një situatë ku të gjithë përfitojnë nga zhvillimi në mënyrë të drejtë
- **Qeverisje në funksion të rritjes** - me fokus qeverisjen transparente, funksionale dhe efikase

### Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Greqi 2014 – 2020



Programi Interreg II IPA i Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri – Greqi 2014 – 2020 është rezultat i një procesi të programimit të udhëhequr nga "Komiteti i Përbashkët i Programimit", i themeluar për përgatitjen e programit Interreg II IPA për bashkëpunimin ndërkufitar. Strategjia e këtij programi është:

"Për gjetjen e ekuilibrit mes zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkufitar midis popullsisë dhe rajoneve, institucioneve vendore, në përputhje me BE-në dhe politikën kombëtare, me qëllim adresimin e sfidave të përbashkëta nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta"

Prioritetet e programit në bazë të Aneksit III të rregullores IPA II

(BE) Nr 231/2014, përfshijnë:

- Promovimi i transportit të qëndrueshëm, informacionit dhe komunikimit (IC) rrjete dhe shërbime dhe investime në ujë, mbeturinave dhe energjisë sistemeve dhe pajisjeve ndërkufitare.

- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimin e ndryshimeve klimatike përshtatjen & zbutjen, parandalimin e rrezikut dhe menaxhimit.
- Vlerësimin e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- Rritja e konkurrencës në mjedisin e biznesit dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimeve.

Zona përfituese ndërkufitar shtrihen nga Deti Jon në liqenet e Prespës, dhe përfshinë: Rajonet e Grevenës, Kosturit, Follorinës, Arta, Thesprotia, Janinë, Prevezë, Zakynthos, Kerkyra, Kefallinia dhe Lefkada në Greqi dhe rajonet e Vlorës, Qarku i Gjirokastrës, Qarku i Korçës dhe Qarku i Beratit në Shqipëri.

### 2.3 Analiza e instrumenteve në nivel kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre

#### Plani i Përgjithshëm Kombëtar (draft)

Plani i Përgjithshëm Kombëtar është një nismë e marrë nga qeveria me propozim të Ministres për Zhvillimin Urban dhe Turizmin. Ky plan duhej të ishte bërë më parë dhe vonesa e tij ka rënduar situatën në terren, duke degraduar panoramën e përgjithshme me ndërtime të realizuara në mungesë të një plani kombëtar, dhe për më tepër kanë shkaktuar dëm ekonomik kombëtar pasi ndërkohë është stimuluar hartimi i planeve vendore dhe rajonale, të gjitha hartuar dhe miratuar në mungesë të një kornize politike kombëtare të planifikimit. Zhvillimet kaotike dhe shpesh informale në territor, si dhe mungesa e planifikimit dhe e kontrollit të territorit nga njësitë vendore, kanë dëmtuar rëndë edhe peizazhin natyror.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar do të orientojë përdorimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve dhe potencialeve të Shqipërisë. Brenda këtij kuadri do të ketë një vëmendje të veçantë për rivlerësimin e aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të burimeve natyrore.

Qëllimi i hartimit të një Plani të Përgjithshëm Kombëtar konsiston në krijimin e platformës drejtuese dhe të garancisë ligjore të nevojshme për një zhvillim të qëndrueshëm urban, ekonomik, social e mjedisor në territor.

Qëllimet specifike strategjike që synon të përmbushë Plani i Përgjithshëm Kombëtar, bazuar edhe në parimet e Ligjit të PT-së, janë:

- të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore,

- të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në nivel kombëtar e vendor, në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe
- interesave publike e private,
- të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit,
- të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë, instrumentet planifikuese dhe legjislacionin,
- të krijojë kushte të përshtatshme e të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë,
- të sigurojë që autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit, të hartojnë e të përditësojnë rregullisht instrumente të planifikimit, sipas kërkesave të tregut dhe nevojave sociale,
- të sigurojë që autoritetet e planifikimit të bashkërendojnë veprimtaritë e tyre për të nxitur planifikimin e harmonizuar e të integruar të territorit,
- të garantojë, sipas legjislacionit për ndërtimin, zbatimin e rregullave të sigurisë së ndërtimeve dhe të punimeve të ndërtimit për jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Bazuar në draft Planin e Përgjithshëm Kombëtar të publikuar nga AKPT dhe MZHU disa nga direktivat kryesore të cilat rrjedhin për PPV e Bashkisë Korçë janë:

**RAJONALIZIMI** - Një nga kërkesat që ploteson Planin e Përgjithshëm Kombëtar është krijimi i bazave për zhvillim rajonal.


Tre janë tipet e Rajoneve të përcaktuara nga PPK:

- RAJONE NDËRKUFITARE
- RAJONE EKONOMIKE KOMBËTARE
- RAJONE TË SPECIALIZUARA

**RAJONET NDËRKUFITARE** burojnë drejtpërdrejt nga Programet IPA Crossborder (Vetëm për periudhën 2014-2020 Shqipëria do të sigurojë një mbështetje financiare prej 75 milion eurosh.)

**Shqipëri – Greqi** (Fondi IPA 42.312.029€) përfshin: *Rajonin Korçë – Selanik, Rajonin Gjirokastrë – Janinë, Rajonin Sarandë – Korfuz*

**RAJONI KORÇË - SELANIK**, ka bashkëpunim ekonomik, potencial për zhvillimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në sektorin e turizmit, bujqësisë dhe të energjitikës.



### Rajonet nderkufitare (Burimi PPK)


RAJONET EKONOMIKE KOMBËTARE: aktualisht si një rajon i tillë i mirëfilltë performon vetëm rajoni ekonomik Tiranë Durrës, por Plani Kombëtar deri në 2030 mundëson fuqizimin edhe të 6 rajoneve të tjera me rëndësi kombëtare.

Rajoni Ekonomik Elbasan - Pogradec - Korçë me avantazhe të larta për lidhje me rajonin Durrës-Tirane duke formuar një zinxhir të rajoneve ekonomike.

Profili këtij rajoni: Tregëti (shkëmbim & përpunim) – Energji – Turizëm – Bujqësi  
Zhvillimet Strategjike:

1. Zona Kavajë – Rrogozhinë, si nyje logjistike
2. Elbasani si qendër primare, qendër logjistike, qendër kërkimi e inovacioni në fushën e energjisë, industrisë, transportit.
- 3. Korça, qendër primare, turistike, bujqësore por edhe energjitike.**
4. Pogradeci qendër e specializuar, turizëm liqenor, natyror -bujqësi.





Rajonet motorike (Burimi PPK)

## Ekonomia

*Për të mbështetur rajonalizimin e sukseshëm të territorit të vendit, PPK bazuar në parimet dhe orjentimet e mësipërme, konkludon në percaktimin në territor të 6 Poleve ekonomike parësore në nivel Kombëtar si rrjedhojë e intensifikimit të bashkëpunimit të qendrave urbane Brenda Zonave Ekonomike Funksionale që përbëjnë ato:*

1. Shkodër Lezhë
2. Tiranë Durrës
3. Elbasan - Korce-Pogradec
4. Fier - Vlore- Berat
5. Kukës - Has - Tropojë
6. Gjirokastër Sarandë

*Polet kryesore ekonomike mbështëteten nga potenciali për zhvillim ekonomik që ofron pozita e bashkëpunimit me rajonet ndërkufitare: Shqipëri Mali I Zi, Shqipëri Kosove, Shqipëri Maqedoni dhe Shqipëri Greqi.*

### Korce Pogradec -

---

*Fuqizimi i qytetit të Korces si qender primare urbane mbështëtet në projektet strategjike në këtë rajon të kryesuar nga realizimi i korridorit xiii. Thelbesor për fuqizimin e këtij poli është sigurimi i lidhjes së shpejt me infrastrukturën kryesore kombëtare, aeroporte dhe porte. Për këtë ppp sugjeron vlerësimin e mundësive për lidhjen e rajonit të Korces me portin e vlores dhe përmirësimin e lidhjeve me rajonin gjirokastër Sarandë. Aksesin më të mirë në portet lindore me këto dy pole ekonomike do ta binte korcen akom me atraktive për përqendrimin e investimeve strategjike. Aktualisht e karakterizuar nga vlera të larta të peisazhit natyror territorial, e pasur me parqe kombëtare, pyje, toka bujqësore, shfaq potencial për shfrytëzimin e infrastruktures së gazit, projekti tap që kalon nëpër territorin e saj. Afërsia me pika të shumta turistike si malore, liqenore e ben rajonin atraktiv për investime në fushën e turizmit.*

### **Projektet strategjike nderajonale dhe rajonale që propozohen nga PPK**

- *vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative*
- *vlerësimin e mundësisë së krijimit të parqeve fotovoltaike me qëllim shfrytëzimin e 2500 orëve vjetore diellore.*
- *Riaktivizim i linjes hekurudhore, pjesë e korridorit viii, për një lidhje të qendrueshme që mbështet zhvillimin e tregëtisë e transportin e qendrueshëm të mallrave nga deti I zi në portin e Durrësit.*
- *Projektin strategjik të rijetëzimit të itinerarit antik të rrugës egnatia në nxitje të turizmit që mbështet dhe vlerëson vlerat traditave dhe historinë e vendit të tyre.*
- *Mbështetje për nxitjen e turizmit elitare në zonat termale, turizmin malor në pika turistike si gjinari..etj.*

Duhet theksuar se për shkak të vendosjes qendrore që ka Elbasani në lidhje me shtrirjen gjeografike të territorit, përmirësimin e lidhjes me Tiranën në rrugën Elbasan-Tiranë, bashkëpunimi i tij me polin ekonomik Tiranë-Durrës është parësor, duke konsideruar në këtë kuptim një pol ekonomik me tre qendra primare, Tiranë-Durrës-Elbasan. Nga ana tjetër realizimi i boshtit qendror që do të lidhë Elbasanin me Beratën për të dalë në Gjirokastrë, rrit mundësinë e asociimit dhe vlerësimit të potencialeve të reja bashkëpunimi midis këtyre dy qendrave duke konsideruar një pol ekonomik qendrat Elbasan-Korçë-Berat., fuqizuar kjo edhe nga lidhjet e reja të propozuara për korcen me Beratën.

Dy variantet e ndërveprimit të përshkruara paraqiten në figurën mëposhtme.





## SISTEMI INFRASTRUKTUROR

*Objektivi:* Integrimi hapësinor, rritja e aksesueshmërisë së vendit dhe shpërndarje e balancuar e flukseve.

*Politika:* Organizimi i territorit në sistemin e hierarkizimit të qendrave urbane dhe zhvillimi i korridoreve të integruara të flukseve të infrastrukturës.

## TRANSPORTI

*Objektivi:* Multimodal dhe miqësor ndaj ambjentit konkurrues

*Politika:* Krijimi dhe konsolidimi i një sistemi të integruar multimodal mbarë Kombëtar, rritje dhe konsolidim i pikave të aksesit dhe të lidhjes së territorit.

Në sistemin e infrastrukturës së transportit, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

- Një sistem i integruar multimodal mbarë kombëtar
- Dy aeroporte të reja në Kukës dhe Delvinë
- Tre Stacione Intermodale Kombëtare në Fier, Elbasan, Berat, të cilat do të përmbushin nevojat e brendshme të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit.
- Pesë korridoret strategjike: Korridori i Gjelbër veri-jug, Korridori BluVeri-Jug, Korridori 8 Rruga e Arbrit, Korridori 10 segmenti Durrës- Kukës- Morinë, Boshti Qendror Jugor do të jenë të përfunduar dhe rehabilituar brenda vitit 2020 me sinjalistikë dhe masa mbrojtëse për uljen e numrit të aksidenteve.
- Gjashtë % do të rritet kontributi i sektorit të transportit në rritjen reale të PBB, brenda vitit 2030, me kompletimin e rrjetit rrugor kombëtar, i cili është tërësisht i përfshirë në Rrjetin Core (SETTO).
- Dhjetë Stacione Intermodale Ndërkombëtare në Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Kukës, Pogradec, **Korçë**, Vlorë, Sarandë, Gjirokastër, të cilat do të përmbushin nevojat ndërkombëtare dhe tranzitore të lëvizjes dhe shkëmbimit të modaliteve të transportit me vendet e tjera.

Për transportin ajror PPK sygjeron ish fushat aeroportuale në Shkodër dhe **Korçë** propozohen të ruhen të lira nga ndërtime për të vlerësuar mundësinë në një të ardhme për zhvillimin e transportit ajror.



**SISTEMI INFRASTRUKTUROR***Referuar Sistemit Infrastrukturor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:**Për Infrastrukturën e Transportit:*

- Zhvillimin e Qendrës së Vlorës si *QytetPortë*, nisur nga modalitetet portuale, hekurudhore dhe rrugore; si dhe Qendrës së Fierit si *QytetHub Multimodal*, duke qënë nyje strategjike e transportit rrugor dhe hekurudhor. Zhvillimin i qendrave Patos, Rroskovec, Kuvovë si *Hub-e Energjitike* dhe qendrës Lushnjë si Hub Bujqësor për rolin kryesor, që ka si nyja me e rëndësishme bujqësore në vend.
- Përmirësimin e kushteve dhe fuqizimin e kapacitetit akomodues të portit të Vlorës dhe Petroliferës, si nyjet portuale kryesore të transportit detar.
- Integrimin dhe funksionimin me kapacitet të plotë sipas modaliteteve të stacioneve të rrjetit hekurudhor: *Levan, Nartë dhe Rafineri* si stacione mallrash; *Vlorë, Fier, Lushnjë dhe Ballsh* si stacione qendrore, si dhe rigjallërimin e stacioneve për pasagjerë: *Dushk, Gradishtë dhe Libofshë*; Riaktivizimin e stacioneve *Novoselë, Kraps dhe Kasnicë* si stacione pasagjerësh.
- Shtimi i linjës hekurudhore drejt Kakavijës, duke bërë lidhjen nëpërmjet Ballshit me Memaliajn.
- Rrugën Pejshazhistike Blu* në këtë Zonë, përgjatë qendrave: *Divjakë- Pish Poro- Nartë- Vlorë- Dhërmi* (sipas projekteve prioritare të Ministrisë së Transporteve 2014).
- Rrjetin e bicikletave* i cili përshkon Zonën referuar rrjetit kombëtar të bicikletave propozuar nga PPK. Në këtë rajon kalojnë Itinerari Pejshazhistik Blu dhe Itineraret Horizontale Kombëtare.
- Projekte strategjike për shfrytëzimin e gazit TAP që kalon në këto territor. Realizimin e projektit për linjen *energjitike IAP të gazit*, (Fier-Mali i Zi-Bosnjë-Hercegovinë-Kroaci).-Te vleresohen mundësitë nga sektoret perkates për Ripërdorim të Termocentraleve ekzistues apo të rinj që përdorin energjinë nga gazi.
- Vlerësimin e potencialit natyror për diversifikimin të energjisë së rinovueshme dhe asaj alternative, duke konsideruar rrezatimin prej 2700orë/vit për ndërtimin e parqeve fotovoltaike .

**Projektet kryesore në fuqizimin e infrastructures:**

- *vlerësimin e potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë së rinovueshme duke shfrytëzuar erërat e forta në grykat e lumenjëvë.*
- *Perfundimi i linjave të interkonjeksionit 400kV që do të lidhin Elbasan-Fierzë-Kosovë dhe Burrel-Skavicë-Kosovë.*
- *linjen e gazit IAP – Kosovë*
- *aktivizimi i Aeroportit të Kukësit nisur nga fakti se përbën një potencial për këtë rajon dhe Veriun e vendit në tërësi.*
- *përmirësimin e infrastrukturës lidhëse mes qendrave Kukës-Has-Tropojë dhe në raport me qendrat kufitare në Kosovë, Prizren-Gjakovë-Pejë<sup>1</sup>. Infrastruktura do të shkurtojë distancat e udhëtimit nëpër këto qendra dhe do të forcojë e konkretizojë bashkëpunimin ndër-kufitar mes këtyre qendrave.*
- *rigjenerim të aksit Fushearrez- Tropojë, që do të thotë krahas rrjetit rrugor propozohet edhe trajektorja për bicikleta, nisur nga fakti që kjo rrugë kalon në Liqenin artificial të Fierzes (Lumi Drin), i cili është vend atraksioni për turizmin vozites dhe natyror. Gjithashtu në Fierzë mund të kryhet dhe shkëmbimi i modalitetit të transportit, Kjo pikë i referohet kryesisht Strategjisë Sektoriale të Transportit 2008- 2013 ku zbatohet sipas parimit të transportit të qëndrueshëm. Ky i fundit nënkupton optimizimin e kostos, sigurisë së lëvizjes dhe mbrojtjes mjedisore.*

## ENERGJIA

*Objektivi:* Zhvillimi i një rrjeti eficient energjistik

*Politika:* Diversifikimi drejt energjise së rinovueshme

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:

4 Korridore energjetike: TAP – IAP – WBR – Kosovë do të mundësojnë integrimin e sistemit energjistik të Shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës. Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit Europian dhe Kroacinë. Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit Europian;

Në sistemin e infrastrukturës energjitike, Plani i Përgjithshëm Kombëtar synon:

- **0 % import enegjie** - Shndërrimi i Shqipërisë nga një vend Importues i energjisë elektrike, në vend eksportues të saj; (Gjatë viteve të fundit varësia e vendit tonë nga importi i energjisë elektrike ka ardhur duke u rritur. Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje) rezultoi me rritje prej 44,5 % në 2014 duke arritur vlerën 3.356 GWh nga 2.323 GWh në 2013. Eksporti bruto i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti 288 GWh në vitin 2014 nga 1.425 GËh që përbënte një vit më parë)
- **Konsolidimi i Dy porte kryesore me infrastrukturë të përshtatshme për transportin e produkteve të naftës dhe të gazit të lëngshëm: Porto Romano dhe porti i Vlorës 2 - Terminali Petrolifera;**
- **4 Korridore energjetike: TAP – IAP – WBR – Kosove do** të mundësojnë integrimin e sistemit energjistik të shqipërisë në infrastrukturën energjitike të Ballkanit Perëndimor dhe Europës. Shqipëria përbën një korridor të rëndësishëm që lidh Greqinë me vendet e Bashkimit Europian dhe Kroacinë. Ky korridor siguron një mundësi për lidhje energjetike nëndetare mes Shqipërisë dhe Italisë, një nga ekonomitë më të mëdha të Bashkimit Europian;
- Një Rrjet eficient Energjistik ku do të ketë:
  - 20% përdorim të energjisë së rinovueshme;
  - 20% efincencë energjitike
  - 20% reduktim në emëtimin e CO2 në atmosphere; \*(Strategjia Kombëtare e Energjise 2013-2020)
- Realizimin e tre makro - Objektiva për krijimin e një tregu të brendshëm energjistik në nivel europian: **Konkurrueshmëri - Furnizim i sigurt - Qëndrueshmëri.**

**Konkluzione: Prioritet strategjike të infrastrukturës Energjitike**

*Rrjeti i shpërndarjes së elektricitetit dhe shpërndarjes së gazit në të ardhmen në Shqipëri parashikohet të jete I integruar me korridoret e transportit, të integruar në të gjithë vendin*

*Prioritet në këtë drejtim kanë:*

- *Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike në perëndim, në veri-perëndim, në kufi dhe në skajet veri-lindore të vendit me një akses më të zgjeruar në rrjetin kombëtar, psh.sigurimi i progresit në rrjetin kombëtar lidhës të propozuar nga linjat e transmisionit drejt Kosoves dhe Maqedonise.*
- *Fuqizimin e rrjeteve të furnizimit me energji elektrike brenda porteve ekzistuese e të propozuara*
- *Fuqizimi strategjik i rrjetit të furnizimit me energji elektrik që i shërben grupeve të veçanta të punësimit lidhur me kërkesat në zonat industrial të perpunimit me focus të vecante zonat e parashikuar si zona të lira ekonomike.*
- *Një integrim më të mirë midis rrjetit të elektricitetit në Shqipërine e Jugore e Jug lindore.*
- *Subjekt i vlerësimit duhet të behet potenciali për zgjerim i rrjetit të gazit TAP- IAP- KOSOVE-Mali iZI për të plotësuar, si për porta hyrëse ekzistuese por edhe për ato të propozuara duke përfshirë ku është e nevojshme investime shtesë për të përmbushur kërkesën e parashikuar që lind nga rritja e planifikuar në këto qendra. nevojat për zhvillimit industrial tregëtar..etj.*

**3.4 Sistemi bujqësor****BUJQËSIA**

*Referuar Sistemit Bujqësor, Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon:*

- Mbrojtjen strikte të sipërfaqes së tokave bujqësore duke frenuar informalitetin.*
- Bashkëpunimin ndërmjet fermerëve për të qënë konkurent në rajon.*
- Marrjen e masave nëpërmirësimin e rrjetit të kanaleve vaditëse / kulluese për tokat bujqësore.*
- Krijimin e një tregu rajonal bujqësorqë do të plotësojë zinxhirin ekonomiko-bujqësor në agro-përpunimin e produkteve bujqësore (prodhim + përpunim + tregtim).*

**PPK për Sistemin Bujqësor**

**Objektivi: Eficiencë për një sektor bujqësor konkurrues**

**Politika: ruajtje, konsolidim, modernizim**

Rreth 40 përqind të sipërfaqes së përgjithshme të Shqipërisë, klasifikohet si tokë bujqësore (24 përqind tokë arë dhe 15 përqind kullota), ndërsa pjesa tjetër e ndarë ndërmjet pyjeve (36 përqind) dhe funksioneve të tjera.

43 % e tokës bujqësore gati gjysma e saj, është e përqëndruar në pjesën më të populluar të ultësirës perëndimore bregdetare. Rreth 34 përqind e tokës bujqësore shtrihet në lugina lumenjsh dhe 23 përqind në zonën malore.

20% të PBB-së vjen si Kontribut i sektorit Bujqësor por kontributi më i madh i këtij sektori vjen në numrin e të punësuarëve në të, afro 50 %

Sfida më e lartë e këtij sektori është ulja e disbalancës tregëtar në raportin midis importit të produkteve agro-ushqimore (i rritur me ~40% në vitin 2012 krahasuar me vitin 2007, ndërsa eksportet janë rritur me ritëm edhe më të lartë, përkatësisht ~75% për periudhat përkatëse)

Politikat që mbështet Plani Kombëtar në këtë drejtim janë:

*Ruajtje*

*Konsolidim*

*Modernizim*

- Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore \_ me anë të politikave të densifikimit të zhvillimit urban. Me miratimin e Planit Kombëtar 2030 nuk lejohen ndërtime të reja në tokë bujqësore që nuk i shërben Sistemit Bujqësor.

- ne lidhje me mirefunksionimin e ekosistemit natyrore mbrohen nepermjet fashave/korridoreve të gjelberta pergjate vijave ujore (lumejve),

- ri-pyllezimin e sipërfaqeve të degraduara pyjore dhe mbjelljen e sipërfaqeve të reja pyjore në hapësirat e zonave të lira natyrore duke respektuar identitetin pyjore të zones perkatëse.

- Vendosja e një rrjeti të sukseshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhimi-grumbullim- perpunim- eksportim, me qëllim rritjen e vlerës së zinxhirit ekonomik.

- Ulja e koston dhe rritje e cilësisë nëpërmjet investimeve në:

- teknologjinë e prodhimit për modernizimin e saj;

- investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, kanale ujitëse, vaditëse, hidrovore.etj

- Integrim dhe bashkëpunim me sektorët e tjerë të ekonomisë:



- *Bujqësi-Turizem- ku veçantia e sektorit turistik shqipëtar identifikohet edhe nga produktet bujqësore karakteristike në shije e cilësi.*
- *Bujqësi- Transport— infrastruktura e transportit i shërben rrjetit eficient të shpërndarjes dhe grumbullimit të prodhimeve bujqësore.*
- *Bujqësi – Energji- ku energjia e përdorur në përpunimin e produkteve bujqësore shkon drejt përdorimit të burimeve të rinovueshme.*
- *Krijimi i qendrave/ poleve bujqësore dhe Profilizimi i këtyre të fundit sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor*
- *Krijimi i markave të produkteve karakteristike bujqësore shqipëtare Made in Albania. Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqipëtare.*
- *Bimë Mjekësore*
- *Pemë frutore arvore*
- *Ullinj dhe Vreshta*
- *Perime karakteristike të vendit*
- *Produkteve bujqësore të përpunuara*

### **Problematikat e Sektorit të Bujqësisë në Vend**

Në të kaluarën por edhe aktualisht verëhen demtime të fondit të tokës bujqësore që pakesojnë kufijte e tije siç janë ndertimet e paligjshme, zgjerimi i pa-argumentuar i hapësirave urbane në dem të tokës bujqësore, demtimi i shtreterve të lumenjeve ...etj. për shkak të reformes së tokës truallit bujqësore është i fragmentarizuar në parcela të vogla të cilat kushtojnë ndjeshëm përdorimin në shkallë të gjerë të mekanikës bujqësore. Mekanizimi i sektorit bujqësor mbetet ende një sfidë për tu përballur në vitet në vazhdim.

Lidhur ngushtë me sektorin ekonomik bujqësor qëndron njëherazi edhe *industria ushqimore* e përpunimit të produkteve bujqësore e cila si një degë e rëndësishme e ekonomisë Shqipëtare ka shënuar zhvillim të dukshëm dhe të qëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Rritje me të ndjeshme vihet re në nendëgen e përpunimit të qumështit, mishit...etj.

- ***Shpërndarja e / Fragmentarizimi Tokës Bujqësore***
  - Ndryshimet të sistemit politike
  - Kuadri ligjor, ligji 7501
- ***Levizjet Demografike (migrim + emigrim)***
  - Uljen e fuqisë aktive punëtore në këtë sektor. 75% e Sipas të dhenave të Bankës Botërore emigrantëve janë meshkuj<sup>11</sup>
- ***Ndertimet informale***

“Uzërpimin” e sipërfaqeve bujqësore në periferi të qendrave të mëdha urbane të vendit nga levizjet e brendshme të pakontrolluara demografike
- ***Permbytjet***
  - Lenien djerre (te papunuar) të sipërfaqeve bujqësore në veri dhe jug të vendit
  - Erozioni
  - Shpyllezimi

- amortizimi apo prishja e infrastrukturës mbrojtëse perkatese (digat mbrojtëse, portat e kontrollit, mosfunksionimi i hidrovoreve, zena e kanaleve kullues ...etj).
- nxjerrja e pakontrolluar e materialeve inerte nga shtrati i lumenjeve duke rrezikuar devijimin e rrjedhes se lumit, hedhja e mbeturinave industriale apo inerte pergjate brigjeve lumore
- **Amortizimi Infrastrukturore (sistemi i ujitjes + kullimit)**
- **Ndertimet informale + permbytjet**

### **Perqasja e Planit të Përgjithshëm Kombëtare ndaj Sektorit të Bujqësisë**

Edhe në sistemin Bujqësor, zhvillimi policentrik i vendit vendos theksin në nevojën e përcaktimit identifikimit të poleve kryesore bujqësore për vendin. Nisur nga pozicioni gjeografik i tokës bujqësore, klasifikimi i ekonomive vendore, historiku i zhvillimit në ekonomine bujqësore dhe rrjeti i infrastrukturës lidhëse, PPK propozon konsolidimin e 5 poleve bujqësore në qendrat urbane te; , Tiranë, Lushnjë, Sarandë dhe Korçë.

Përcaktimi i këtyre qendrave si pole bujqësore domosdoshmërisht nënkupton posedimin dhe ofrimin e disa faciliteteve kundrejt produkteve bujqësore.

Në keto qendra parashikohet ngritja dhe konsolidimi i

- qendrave kërkimore për analizimin e produktit bujqësorë,
- strukturave ndertimore me kapacitet të mjaftueshëm për grumbullimin, përpunimin dhe paketimin e produkteve të ndryshme bujqësore të grumbulluara nga fermerët vendas.
- krijimin e tregjeve lokale për promovimin dhe tregtimin e produkteve bio-organik pergjate fazes se hartimit të planeve të pergjithshme vendore
- ruajtjen e zonave të thella malore, pyjeve, foragjerëve si dhe të hapësirave të tjera të pershtatshme për kultivimin e Bimeve Aromatike nga nderhyrjet abuzuese informale me qëllim prezervimin e mënyrës spontantane të kultivimit dhe grumbullimit të llojeve të ndryshem të Bimeve Aromatike të cilet kane përdorim të gjerë në tregun farmaceutik
- Promovimin e lidhjeve për studim dhe zhvillim ndërmjet qendrave të inovacionit dhe të përpunimit të produkteve ushqimore me qëllim formimin e pikave/poleve bujqësore në vënd. Kjo mund të sjelli gjithashtu zhvillimin e turizmit bujqësorë në vënd.

### **Zhvillimi i Poleve Bujqësore / Agro-Perpunim**

*(Shkoder, Tiranë, Sarandë, Korça, Lushnje) “Prodhim + Grumbullim + Perpunim + Tregtim”*

Perkatesisht qytetet e emeruara si pole bujqësore për shkak të implementimit të strategjive të tilla janë Tirana, Shkodra, Korça, Lushnja dhe Saranda. Në secilin prej këtyre qyteteve Plani i Përgjithshëm Kombëtare bazuar në analizat e shumta infrastrukturore, ekonomike dhe sociale sugjeron ngritjen e qendrave të medha bujqësore ose zmadhimin dhe modernizimin e atyre egzistuese. Keto qendra bujqësore rekomandohen minimalisht të permbushin shërbimet e mëposhteme:

- 1) Posedimin dhe ofrimin e hapësirave të mjaftueshme depozitimi për të përballuar sasine e prodhimit bujqësore në stinat perkatese

- 2) Posedimin dhe ofrimin e kushteve dhe teknologjive perkatese për agro-perpunimin e produkteve bujqësore duke mundësuar njeherazi procesin e kontrollimit të cilesise se ushqimit sipas standarteve të Bashkimit Europian
- 3) Alokimin e dhomave laboratorike ku specifikisht për secilen kulture bujqësore të miren kampjone dhe të analizohet gjendja fizike e tyre
- 4) Posedimin e teknologjive të avancuara në fushen e kërkimit dhe të zhvillimit të farave dhe fidaneve me qëllim zhvillimin e sektorit bujqësore në ritmet e Bashkimit Europian
- 5) Posedimin e mundësive teknike dhe të personave të specializuar në fushen e marketingut të produktit bujqësore

### **Bio-Bujqësia / Bujqësia Organike**

*Bujqësia organike në vendin tone, fale kushteve klimatike, gjeomorfologjise se tokës bujqësore si dhe njohurive tradicionale të fermereve vendas posedon avantazhe shume të favorshme për tu zgjeruar dhe rritur akoma me shume si nendegje e sektorit të bujqësisë.*

*Tregu mesdhetare apo dhe ai Europian për shkak të zhvillimit të turizmit kulinare dhe elitare shfaq tendenca pozitive në konsumimin gjithmone e me teper të produkteve bio-organike.*

*Pertej rritjes se cilesise se produkteve ushqimore, bujqësia organike njeherazi shfaq impakt të ndjeshem në rritjen ekonomike të sektorit të turizmit. Në Shqipëri Agro-Turizmi, Turizmi Malore, Turizmi Liqenore / Detare / Lumore, Turizmi Kulturore, Turizmi Historik ...etj, janë të lidhura ngushte me identitetin kulinare të zonave perkatese. Mund të permendim zonat si Theth, Dardhe të Korçes, Voskopoje ...etj, si zona me potencial të larte për rritjen e tipeve tendryshme të turizmit fale dhe ushqimeve / produkteve bio të cilat ofrojne.*

### **Krijimi i fermave konkurruese**

- *Mospasja e një infrastrukturë të plote mbështetese në shërbim të zhvillimit të fermave në zonat rurale*
- *Levizjet e pakontrolluara demografike si dhe fenomeni i pakesimit të burimeve njerezore neper zonat e thella rurale*
- *Fragmentimi në parcela të vogla i truallit bujqësore*
- *Mungesa e mirefunksionimit të marketingut të produktit bujqësore vendas*

***efiçenca prodhuese e këtyre fermave mbetet për tu permiresuar si pasoje e fragmentimit të truallit bujqësore si baza e zhvillimit të aktivitetit ekonomik të fermave bujqësore.***

- *Njohja dhe mbrojtja e rolit të fermerëve si mbrojtës të burimeve natyrore*
- *Vlerësimin e potencialeve të sektorit të pylltarisë së vëndit duke shfrytëzuar hapësirat e degraduara pyjore si toka me potencial të mundshëm për kultivimin e produkteve lokale bujqësore*
- *Promovimin e sektorit ekonomik të pylltarisë (përpunimi i drurit/mobileri...) si një alternative e shtuar në ndërtimin e objekteve ekologjike (greenhouse)*
- *Nxitjen e turizmit rural nëpërmjet promovimit të hapësirave pyjore duke shndërruar shtegjet/kalimet/..(paths) e gjata natyrore si atraksione me potencialitet të lartë për zhvillimin turizmit aventurier*
- *Zhvillimi i turizmit rural dhe aktiviteteve të tjera të lidhura me turizmin si pershembull turizmi kulturore, turizmi natyrore dhe malore, turizmi i veres ...etj, duke mirembajtur / rikonstruktuar dhe vendosjes në shërbim të sektorit të akomodimit turistik të ndertesave/banesave/shtepiave tradicionale me vlera kulturore dhe arkitektonike për qëllime biznesi si akomodimi, ushqimi, koha e lire, tregtia ...etj.*

- Perpunimi / Marketinku në shkallë të vogël i produkteve bujqësore të tilla si qumesht delje dhe dhije, frutat/kepurdhat/bimet aromatike dhe mjekesore duke përfshirë mbledhjen e bimeve të egra dhe produkteve të tjera tradicionale me fokus përmirësimin e perpunimit të ushqimit në lidhje me standartet e higjenes dhe sipërmarrjes profesionale.
- Krahas zhvillimit të aktiviteteve tipike bujqësore në ferme rekomandohet zhvillimi i aktiviteteve bujqësore jotipike në ferme si përsëmbull bletaria dhe kultivimi i BAM-ve (Bime Aromatike Bujqësore).



### **Planet e Integruara Ndërsektoriale**

Planet e Integruara Ndër-Sektoriale në nivel qendror, PINS “Durrana” dhe PINS për “Bregdetin”, nuk sjellin asnjë detyrim për Bashkinë e Korçës.

### **Gazsjellësi Trans-Adriatik (TAP)**

Projekti për kalimin e tubit të transportit të gazit që kalon përmes Republikës së Shqipërisë, aktualisht, për shkak se nuk konsiston në shfrytëzimin e lëndës që kalon në të, bën që Bashkia të mos ketë përfitime relevante për zhvillimin e sektorit të energjisë.

Territorin e lirë për kalimin e infrastrukturës për tubacionet e gazit, bashkia e ka marrë në konsideratë për hartimin e planit. Në të ardhmen, sipas parashikimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, mund të ketë ndryshim të marrëveshjeve dhe ndoshta bashki të caktuara mund të bëhen përfituese, ose mund të shtohet edhe një rrjet shpërndarjeje për rajone të caktuara për shfrytëzimin e lëndës. Deri atëherë Bashkia e Korçës do të jetë në gadishmëri të propozimeve të reja.

### **Legjislacion dhe dokumenta strategjik në nivel kombëtar**

Një përmbledhje paraprake e dokumenteve strategjike është konsideruar në formë tabelare, përmbajtjen e të cilës e gjeni në aneks. Duhet sqaruar se ky listim nuk është shterrues pasi duhet të merren në konsideratë të gjitha strategjitë që janë në proces hartimi/draftimi dhe ende nuk janë miratuar nga organet kompetente.

### **Çështjet, zonat dhe objektet e rëndësisë kombëtare**

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 2 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 20.12.2012, “Përcaktimi i projektit të Gazsjellësit Trans – Adriatik (TAP) si çështje e rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit”, i cili në pikën 2 vendos “Shpalljen “zonë kombëtare” të korridorit me gjerësi 500m të Projektit TAP [...]”
2. Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”
3. Vendimi nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, “Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrisë të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të


Restaurimeve për periudhën 2014-2015”. Në këtë listë përfshihet edhe “Banesa e Vangjush Mios”, monument kulture i kategorisë së I-rë.

#### *Rregulloret për mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore*

Zhillimi i qendrës tradicionale të Korçës është rregulluar me anë të Vendimit 238/2005 “Rregullorja për Administrimin e Qendrës Historike dhe Urbane, Ansambli Arkitektural dhe Tradicional i Qytetit të Korçës”, në të cilin përcaktohen dy kategori mbrojtjeje:

**Qendra Historike** është një zonë absolutisht e mbrojtur që përfshin: Pazarin, pjesën e zonës përgjatë Bulevardit Republika, dhe disa grupime qendrash tradicionale. Ky vendim ngarkon Institutin e Monumenteve të Kulturës (IMK) të realizojë të gjithë projektet e restaurimit brenda Zonës Historike.

**Ansambli Tradicional & Arkitektural Urban** është një zonë me mbrojtje relative që përfshin pjesën e mbetur të qendrës tradicionale të qytetit; i njohur ndryshe si zonat e lagjeve rezidenciale të shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të. Për më tepër Vendimi i viti 2005 përfshin kategorizimin e Monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë dhe ndërhyrjet e lejuara, të vendosura nga Ligji mbi trashëgiminë Kulturore të vitit 2003.



*Përcaktimi i zonës së trashëgimisë kulturore dhe kufijve të qendrës së qytetit të Korçës*

### ***Statusi Ligjor i kufijve të qendrës së qytetit të Korçës***

Kufijtë e qendrës së qytetit u përcaktuan nga Vendimi 1 i 2003 “Për detyrimin e hartimit të Studimit Urban të qendrës së qytetit të Korçës”. Bazuar në këtë vendim e Bashkia ka patur mandatin që të përgatisë një plan të detajuar për këtë zonë. Kur VKM 238/2011 “ Per Shpalljen e Qendres Historike të Qytetit te Korces dhe Miratimin e Rregullores per administrimin e saj”.

### **Analiza e dokumenteve të planifikimit të hartuara më parë**

Dokumentat e planifikimit të hartuara më parë për qytetin e Korçës dhe ish-komunat që i janë bashkuar, që analizohen në këtë pjesë janë dy planet e fundit të Korçës që kanë ndikuar më shumë në transformimin e zonës urbane: Plani Rregullues i Përgjithshëm i vitit 1994 dhe Plani i Përgjithshëm Vendor i vitit 2014, ende ne fuqi, gjithashtu Plani Rregullues i Përgjithshëm i Komunës Voskopojë i miratuar në vitin 2007.

### **Plani Rregullues i Përgjithshëm i vitit 1994**

Në historikun e zhvillimeve urbane në Shqipëri pas periudhës 1944 - 1990 të Shtetit Socialist, ku çdo gjë ishte e “shtetit” dhe çdo gjë e vendoste “shteti”, dominonte stili i arkitekturës dhe urbanistikës sovietiko-lindore, në atë kohë datojnë dhe iniciativat e pajisjes së qyteteve dhe fshatrave me Plane Rregulluese të Përgjithshme. Pas viteve '90 ndryshimet politiko-ekonomiko-sociale, u pasqyruan në territor në trajtën e urbanizimit të pakontrolluar, në zaptimin e hapësirave publike, në ndërtime shumëkatëshe me dendësi të lartë në qendrat e qyteteve dhe informale në periferi. Në vitin 1993 miratohet Ligji 7693 “Për Urbanistikën”, ku përcaktoheshin rregullat e përgjithshme të vendosjes dhe arkitekturës së objekteve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç tokave bujqësore. Në këtë periudhë daton dhe Plani Rregullues i Përgjithshëm i qytetit të Korçës nisi hartimin në vitin 1991 dhe u miratua zyrtarisht në vitin 1994. Ky dokument parashikonte zhvillimin vetëm për qytetin e Korçës dhe u referohej instrumentave ligjor të kohës së Regjimit Socialist, prandaj dhe ndiqte kriteret për rregullimin e një qyteti socialist në kuadrin e një ekonomie të planifikuar të centralizuar.

Versioni i parë i PRRP i vitit 1991 përfshinte analizat e përdorimit të tokave, zgjerimin historik, lartësitë e godinave, densitetin e popullsisë, kategorizimin e rrjetit rrugor, infrastrukturën urbane, si edhe hartat sizmiologjike, hidrologjike dhe gjeologjike. ‘Vija e verdhë’ e Korçës ishte dizenuar si një vijë abstrakte ekliptike përreth qytetit. Versioni përfundimtar i modifikuar fare pak u miratua në vitin 1994 ka qënë në fuqi deri vonë në lidhje me përdorimin e hapësirave dhe çështjet e dhënies së lejeve për ndërtim, edhe pse jetëgjatësia e këtij dokumenti referuar legjislacionit të atëhershëm

ishte 10-15 vjet. Rekomandimet e këtij plani në një shkallë të gjerë korrespondojnë me gjendjen aktuale të ndërtimit brenda në qytet, edhe pse një pjesë e mirë e ifrastrukturave që parashikoheshin si: stacioni hekurudhor dhe disa akse rrugore nuk u realizuar asnjëherë. Për vet periudhën e ndryshimeve të rëndësishme në sistemin politik e social të vendit në periudhën e zbatimit të këtij plani, dhe mungesën e instrumenteve ligjore, duke mos marrë parasysh aspak ndryshimet e rëndësishme që po ndodhnin në atë periudhë në territor, dhe për më tepër duke injoruar fenomenin e ndërtimeve informale, dhe të problemeve që ekzistonin me ndryshimet e sistemit të pronësisë nga shtetërore në private, PRRP\_1994 ju nënshtrua disa modifikimeve të rëndësishme, të cilat u referohen tre zonave ish-industriale që ndryshuan destinacion duke u transformuar në zona rezidenciale miks, një tjetër transformim ju bë një zonë rezidenciale që u transformua në zonë rekreative, dhe modifikimi i fundit i takon zgjerimit të territorit të varrezave publike.

#### **Plani i Përgjithshëm Vendor i vitit 2014**

Para ndryshimeve të ndodhura nga reforma administrativo-territoriale, nga njësitë vendore që sot përbjën Bashkinë Korçë, që kanë patur një instrument planifikimi kanë qënë: Bashkia Korçë – një plan i hartuar nga TP DEVELOPMENT GROUP në kuadrin e projektit LAMP të Bankës Botërore dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit, dhe Bashkia Voskopojë.

Plani i Përgjithshëm Vendor i miartuar me Vendimin nr.13 datë 07.03.2014 nga KKT, analizonte territorin e qytetit të Korçës, një sipërfaqe prej 2143 ha, me një popullësi prej 89.000 banorësh. Në propozimet e këtij plani territori i qytetit është ndarë në 16 njësi strukturore, dhe 75 nën-njësi, për të cilat janë përcatuar treguesit e zhvillimit, mbi bazën e konceptit të zhvillimit hapësinor të parashikuar. Ky plan është hartuar bazuar në Vizionin, Qëllimet dhe Objektivat e qytetit dhe përmban një Plan Hapësinor Strukturore dhe një Plan Strategjik Investimesh Infrastrukturore. Gjithashtu, si pjesë e PPV-së është miratuar Plani i Përdorimit të Tokës dhe Rregullorja Vendore e Planifikimit.






Figure 1 - Skema e popozimit të zhvillimit sipas PPV së Bashkisë Korçës

Në mënyrë të përmblëdhur ky koncept mund të skematizohet në tre elementë:

Një pjesë e rëndësishme e dokumentit të planit që vlen të merret në konsideratë është Plani Strategjik i Investimeve në Infrastrukturë, i cili nxit projektet e investimit me përparësi të lartë, si më poshtë:

**Rehabilitimi i rrugëve** - Pjesa më e madhe e rrugëve rajonale, kryesore dhe dytësore të qytetit janë në kushte relativisht të mira, por kanë nevojë për përmirësime të zakonshme. Me ndryshimet territoriale vlen të rishikohen këto proporitete duke ndërmarrë dy skenarë kryesor: Rigjenerimin e rrugëve në zonat urbane, si dhe plotësimin e infrastrukturave lidhëse të qendrave të fshtarave me qendrën e bashkisë. Duke ndjekur përpjekjet e bashkisë gjatë viteve të fundit, pritet të përfundohen hapat e mëposhtme nëpërmjet programit për *“Rigjenerimin e Rrugëve dhe të Hapësirave”*:

- Asfaltimi i rrugëve të dëmtuara/të paasfaltuara
- Restaurimi i rrugëve me kalldrëme
- Rigjenerimi i bulevardeve urbane
- Masa për qarkullimin e trafikut dhe sigurinë në rrugë (përmirësimi i kryqëzimeve, sinjalistikës rrugore)
- Përmirësime të trotuareve
- Përmirësim të ekselit të njerëzve me aftësi të kufizuara


**Master plani i transportit** – Korça, që tani ka probleme të dukshme me qarkullimin për shkak të transportit të pakontrolluar dhe të planifikuar të viteve të fundit. Kjo situatë ka të ngjarë të përkeqësohet më tej për shkak të rritjes së parashikuar të automjeteve. Është e qartë se sistemi i transportit të qytetit aktualisht është larg të qenit i përgatitur për të trajtuar zhvillimin dhe rritjen e pritur, si rezultat Master Planit i Transportit për Korçën do të duhet të:

- Krijojë një hierarki rrugësh (me ngarkesa të shoqëruara të trafikut dhe me karakteristikat fizike)
- Riforcojë sistemin e transportit publik
- Ofrojë mjete alternative dhe plotësuese për të udhëtuar rreth qytetit (korsi për biçikleta dhe për këmbësorë)
- Zhvillojë rrugë të reja dhe rrugë aksesi
- Krijojë zona këmbësorësh

Master plani i transportit duhet të marrë parasysh zhvillimin e rrugëve, transportin publik dhe parkimin; si dhe të sigurojë më shumë lidhje ndërmjet lagjeve; të rrisë aksesueshmërinë nga të gjithë. Për më tepër, duhet të nxis modelet alternative të transportit dhe të theksojë nocione specifike për transportin publik. Plani ka propozuar zhvillimin e një sistemi rrugësh këmbësorësh dhe biçikletash që duhet të përdorin topografinë e sheshtë të qytetit dhe traditën urbane të përdorimit të biçikletave. Rrjetet e këmbësorëve dhe të biçikletave synojnë të çojnë në ulje të varësisë nga makinat dhe në ulje të nivelit të ndotjes, e nga ana tjetër të sjellin një ndikim shumë pozitiv mbi shëndetin dhe cilësinë e jetës publike.

**Zhvillimi i unazës së jashtme** - Plani i miratuar në fuqi, ka parashikuar shtrirje të qytetit përtej kufirit të zhvillimit të unazës ekzistuese dhe shtimin e aktiviteteve të reja rezidenciale dhe ekonomike. Kjo gjë ka sjell nevojën e specifikimit të një kufiri të ri zhvillimi urban në kohën e miratimit të Planit në vitin 2014, çka me ndryshimet territoriale administrative nuk është më e nevojshme, pasi territori i atërshtëm ku kjo unazë propozohet tashmë është pjesë e bashkisë Korçë. Kjo unazë e jashtme ka qenë e pranishme që në Planin Rregullues të vitit 1994, dhe synon të përmirësojë ndjeshëm aksesin dhe qarkullimin brenda dhe rreth qytetit dhe mbështet zhvillimin e zonave të reja ekonomike, krijuese dhe të banimit, në përputhje me parimet e një planifikimi të qëndrueshëm. Gjithashtu i shërben dhe trafikut drejt dhe nga qytete të tjera (në drejtimet Tiranë- Ersekë dhe Bilisht-Ersekë) duke lehtësuar ngarkesat e trafikut brenda qytetit dhe në veçanti përgjatë unazës së brendshme.

Gjithësesi, sygjerohet të rishikohet ky element me shtrirjen e re territoriale, pasi do të jetë e nevojshme ridimensionimi i këtij aksi, si dhe i nyjeve lidhëse me akset që shkarkojnë nga zonat rurale.



**Rrjeti i sipërfaqeve të hapura** - Plani bën thirrje për zhvillimin e një rrjeti të integruar hapësire të hapur që i referohet të gjithë qytetit. Hapësirat e konsiderueshme të gjelbra të qytetit, të tilla si kodrat e Moravës, kompleksi sportiv “Skënderbeu”, parku “Rinia” krijojnë një tërësi të vazhdueshme natyrore dhe mjedisore. Plani synon të rrisë në maksimum aksesin në hapësirat e mëdha të gjelbra, duke ofruar një gamë të gjerë korridoresh të gjelbra dhe duke nxitur zonat për biçikletat dhe këmbësorët. Për më tepër, sipërfaqet e hapura në nivel lagjeje do të duhet të rehabilitohen si kopshte xhepa në zonat e banimit të periferi të qytetit dhe në komplekset kolektive të banimit. Ndikimi i prithshëm do të jetë rigjenerimi i mjedisit urban dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe i mikroklimës.

Më konkretisht në plan përfshihen:

- Krijimi i një rrjeti të integruar të sipërfaqeve të hapura brenda qytetit, duke përfshirë kodrat, parkun Rinia, Kompleksin Sportiv “Skënderbeu”.
- Rigjenerimi i kompleksit sportiv ekzistues si një park urban i gjallë dhe publik duke i kushtuar rëndësi sportive dhe aktiviteteve rekreative.
- Vijimin e programit bashkiak “Për rigjenerimin e rrugëve dhe sipërfaqeve të hapura”.

- Krijimin e parkut “Shetro Park”, duke e konsideruar atë si pikë kryesore kreative dhe kalimi kohe të lirë.
- Rritje e mbjelljes së pemëve përgjatë rrugëve të qytetit (duke i kushtuar rëndësi pemëve që rriten shpejt).
- Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra të vogla (kopshtet xhepa).

Në kuadrin e ndryshmeve territoriale, vlen të rimerret në shqyrtim shfrytëzimi i parqeve natyrore si: Parku Kombëtar i Liqenit të Prespës dhe Parku i Drenovës, duke ndërtuar intenerarë natyror turistik përgjatë gjithë vitit.

**Rehabilitimi i vend depozitimit të mbetjeve** - Vend depozitimi aktual i mbetjeve shtrihet në jugperëndim të qytetit dhe ka 20 vjet që përdoret, pavarësisht nga fakti që nën të shtrihet rezervuari i basenit ujqor. Vend depozitimi i mbetjeve paraqet një kërcënim të madh për ndotjen ujore, gjë që përbën rrezik mjedisor dhe shëndetësor. Aktualisht po punohet për një projekt për heqjen e vend depozitimit dhe ndërtimit të një vend depozitimi rajonal mbetjesh në Maliq. Plani mbështet mbylljen e vend depozitimit aktual të mbetjeve dhe rehabilitim e tij në mënyrë që ky vend të transformohet në një **Park të Gjelbër dhe Kreativ** për qytetin. Kjo do të jetë zona më e rëndësishme e gjelbër në jug të qytetit që do të ketë kapacitet të mikpresë sporte të ndryshme, aktivitete që ushtrohen gjatë kohës së lirë, aktivitete kulturore dhe rekreative. Objektivat e këtij projekti strategjik investimesh të integruara janë:

- Eliminimi i një rreziku të madh shëndetësor
- Mbrojtja e burimeve ujore për gjeneratat e ardhshme
- Krijimi i një zone për aktivitete rekreative dhe të kalimit të kohës së lirë në nivel qyteti, e ku do të mund të vijnë dhe banorë nga zonat përreth.
- Ofrimi i një burimi potencial të ardhurash për bashkinë nga objekte të ndryshme ( të tilla si parku për kalimin e kohës së lirë, park për kurs golfi, etj.)
- Të vepruarit si katalizator për rigjenerimin gradual dhe përmirësimin e sektorit juglindor të qytetit, i cili aktualisht paraqet probleme të ndryshme.
- Ofrimi i një lidhje të re në formën e një korridorit të gjelbër, duke lidhur qendrën e qytetit me këtë destinacion të ri, me regjenerimin e lagjeve të ndërmjetme.
- Rehabilitimi i vend depozitimit do të kërkojë hapat e mëposhtme:
- Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor (VNM) për kontaminimin e zonës
- Planifikimin e detajuar fizik (mundësisht sipas studimit të Institutit Kombëtar të Monumenteve të Mjedisit)



- Rehabilitimin e vend depozitimit aktual dhe projektimin e peizazhit
- Zhvillimin e aktiviteteve rekreative, sportive, kulturore dhe çlodhëse
- Zhvillimin e një korridori të gjelbër që do të lidhë parkun rekreativ me qendrën e qytetit.

**Promovimi i Kodrave të Moravës** - Projekti për rehabilitimin e Kodrave të Moravës si zonë e gjelbër dhe krijimin e një **zone natyrore dhe çlodhëse** në nivel qyteti është një ndër projektet më të rëndësishme për qytetin e Korçës dhe ka si synim të:

- kthejë peizazhin natyror dhe imazhin shumë tërheqës nëpërmjet pyllëzimit të zonave të vazhdueshme dhe në veçanti të pjesëve më të dukshme të tij.
- sigurojë vijimin e kodrave në parkun “Rinia” dhe në zonën sportive të universitetit.
- përdorë potencialin e kodrave si element kryesor tërheqës për vizitorët për nxitjen e zhvillimit të turizmit.

Ripyllëzimi në rrëpirat e kodrave do të rrisë ndjeshëm cilësinë e peizazhit viziv të qytetit. Po ashtu, ai do të kontribuojë për uljen e kërcënimit të rrëshqitjeve të tokës dhe mungesës së stabilitetit të tokës. Parku natyror dhe i aktiviteteve do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e jetës për banorët dhe atraktivitetin e imazhit të qytetit.

**Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve** - Menaxhimi i hedhjes së mbetjeve në Korçë mbetet i kufizuar dhe i pamjaftueshëm. Mbetjet spitalore hidhen pa u trajtuar siç duhet, gjë e cila mund të çojë në rreziqe sanitare (kullime të mbetjeve sanitare në tokë, në ujëra nëntokësorë ose në atmosferë). Në mënyrë që të arrihet zhvillim i qëndrueshëm, Korça do të duhet të bëhet një qytet i pastër, i shëndetshëm dhe i sigurt, i cili garanton cilësinë e jetës për të gjithë banorët dhe mbron mjedisin e saj natyror. Si rezultat, zhvillimi i qytetit kërkon një sistem mbledhje dhe menaxhimi mbetjesh.

Komponentë të projektit përfshijnë:

- Zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës për sistemin e mbledhjes dhe menaxhimit të mbetjeve
- Planifikimin e integruar për menaxhimin e mbetjeve të ngurta në nivel rajonal; zbatimin e studimit rajonal të vitit 2005 duke i kushtuar përparësi trajtimit të mbetjeve mjekësore
- Rehabilitimin e vend depozitimit ekzistues dhe zhvillimin e një parku rekreativ në nivel qyteti (shih edhe projektin për rehabilitimin e vend depozitimit të mbetjeve)
- Krijimin e një programi bashkiak riciklimi dhe zhvillimin e një qendre përzgjedhje manuale
- Fushata dhe iniciativa pastrimi për pastrimin e qytetit nga mbeturinat
- Plan për menaxhimin e materialeve inerte

- Studim fizibiliteti për zhvillimin e qendrës së riciklimit

**Sistemi i kullimit** - Qyteti i Korçës aktualisht është i lidhur me një sistem të integruar ujërash të zeza dhe kullimi nëpërmjet tubacioneve të konsoliduara, pa pasur sistem veçmas për ujërat e zeza dhe veçmas për kullimin. Sistemi i integruar konsiderohet si problematik pasi kërkon mbingarkesë të panevojshme të rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të mbetura. Pra, Korça duhet të vijojë me ndarjen e sistemit të kanalizimeve nga sistemi i kullimeve, duke ndërtuar një sistem të ri kullimi nën tokë. Tipografia unike e Korçës do të jetë faktori përcaktues i sistemit të kullimit të qytetit. Në zonat që gjenden në rrëpirat kodrinore (baza tradicionale), forca e gravitetit dhe rrëshqitja natyrore do të përdoren për kullim dhe për furnizim me ujë. Në zonat e sheshta të qytetit, në veçanti në zonat që identifikohen si të prekshme ndaj përmbytjeve, infrastruktura e kullimit do të integrohet në sipërfaqen e tokës për të parandaluar përmbytjet e zonave të sheshta. Për kullimin e Kodrave të Moravës, plani nxit rindërtimin dhe funksionimin duhur të kanalit ujëmbledhës të Gjançit për mbledhjen e ujit të mbetur që rrëshqet nga faqet e kodrave. Në periudhën afatshkurtër do të bëhet një lidhje me sistemin e kanalizimeve në parkun “Shetro” në mënyrë që të shmangen përmbytjet.

Ndarja e sistemit të kullimit nga sistemi i ujërave të zeza do të çojë në ofrim më të mirë të shërbimeve si dhe në një organizim racional dhe të qëndrueshëm të ndërmarrjeve publike brenda qytetit.

### **Plani rregullues i përgjithshëm i fshatit Voskopoje**

Voskopoja si qendër historike zhvillohet sipas një Plani Rregullues të miratuar nga KRRrTRSh me Vendimin nr. 6, datë 21.07.2009, plan në të cilin janë miratuar zonat e ndërtimit, zonat e gjelbra, rrugët etj. Lidhur me këtë është hartuar një rregullore nga Instituti i Monumenteve të Kulturës për përcaktimin e ndërtimeve me gur, çatitë gri, rrugët me kalldrëm etj.

Nga viti 2000 e në vazhdim, Voskopoja për shkak të vlerave dhe statusit që mbart, është vënë në qendër të projekteve qeveritare dhe atyre të financuara nga Komuniteti Europian. Interes në këtë drejtim kanë paraqitur organizmat dhe shoqatat e huaja jofitimprurëse, që operojnë në qarkun e Korçës. Ajo është regjistruar nga UNESCO, si një nga trashëgimitë botërore në rrezik dhe si e tillë është vënë në qendër të programeve dhe projekteve për ruajtjen e vlerave që mbart. Në bashkëpunim edhe me shoqatën franceze “Patrimoine sans Frontieres” (*Trashëgimia pa kufi*), u restaurua kisha e Shën Thanasit dhe lidhur me këtë u botua vepra “Sikstina e Ballkanit”. Konkretisht, njësi administrative Voskopoje ka zbatuar “Planin Strategjik të Zhvillimit të

Komunës Voskopojë 2005-2010”, zbatimi i të cilit solli ndryshime të dukshme në zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit. U ndërtua rruga nacionale Voskopojë-Voskop me impakt të dukshëm në rritjen e numrit të vizitorëve, u krye rrjeti i kanalizimeve të ujërave, u ndërtua rezervuari i Gjonomadhit që ndikoi në rritjen e sipërfaqes së ujitur, u mbollën pemëtore të reja dhe u përmirësua mekanizmi i farave etj.

Në planin strategjik “Për zhvillimin afatgjatë e të integruar të Komunës Voskopojë”, përveç infrastrukturës dhe mjedisit një vend të rëndësishëm zë ndërhyrja për zhvillimin e kulturës së saj. Në zbatim të këtij plani në Voskopojë, me financim të Komisionit Europian u ndërmor një program mbështetës zhvillimi nga dy shoqata (*FERT & ADAD*) me drejtime prioritare bujqësinë, turizmin dhe vlerësimin e trashëgimisë (2008-2012). Në këtë vlerësim përveç kishave, programi konsistoi edhe në zhvillimin e vlerave artistike, artizanatit etj. Një grup i trajnuar artizanësh të punimeve të dorës, të leshit në vegël, shtija, grep, i promovon këto vlera në shërbim të kërkesave turistike. Programi bëri të mundur gjithashtu, ngritjen e një qendre të informacionit turistik, dhe pajisjen e hapësirës turistike me sinjalistikën e nevojshme turistike. Në fushën e turizmit u bënë promovime të vlerave nëpërmjet prodhimit të guidave dhe materialeve të tjera promovuese si edhe u trajnuan grupet e interesit që ofrojnë turizmin familjar. Është rikthyer tradita e hershme e organizimit të panairit në festën e Shën Prodhomit në 24 Qershor, në të cilin promovohen gjithë produktet tradicionale të Voskopojës.

Nisur nga ecuria e dukshme e zhvillimit të territorit si hapësirë turistike, përmirësimet e bëra në jetën social-ekonomike të komunitetit, rritja e numrit të vizitorëve në zonë, potencialet natyrore dhe kulturore që mbart si dhe nga interesi i institucioneve brenda dhe jashtë vendit, qendrore dhe lokale, për të investuar projekte zhvillimi në Voskopojë, është hartuar Planin Strategjik i Zhvillimit të Territorit 2012-2020. Ky plan përfshin të gjithë sektorët e zhvillimit, infrastrukturën dhe planin urbanistik trashëgiminë historike dhe kulturore, duke evidentuar potencialet dhe gjendjen aktuale për çdo njërin prej tyre. Gjithashtu janë përcaktuar nivelet e ndërhyrjes dhe aktorët bashkëpunues si dhe rezultatet që priten.

Voskopoja është një rast konkret zhvillimi që e bën më se të domosdoshme nevojën e investimeve nga qeverisja qendrore, kryesisht në infrastrukturën rrugore, ndërkohë që në të, janë duke u zbatuar projekte të rregullimit të territorit të brendshëm të saj nga organizma të huaja. Pra për një zhvillim të qëndrueshëm të territorit të saj, detyrimisht është i rëndësishëm koordinimi i projekteve lokale me projekte qeveritare në zonë, gjithashtu vlerësimi i aseteve kulturore e turistike të kësaj zone në tërësinë e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë.

### *Studimet e mërrparshme për Voskopojën*

Plani rregullues për Voskopojën, i vitit 1930, është aprovuar me vendimin e Këshillit Ministrave Nr.231, datë 25.04 1931, por që për shkak të ndryshimeve të shumta ka vetëm vlera historike. Në bazën hartografike që disponohet nga ky plan në Arkivin Teknik të Ndërtimit, bie në sy një sistem rrugor i dendur dhe gjerësia e rrugëve: më të ngushtat 8 dhe më të gjerat 10m.

Një studim urbanistik, hartuar para viteve '90, pjesërisht i zbatuar. Fleta e studimit nuk përmban vijë kufizuese ndërtimesh edhe pse emërtimi i saj është : “Plan rregullues”. Banesat janë të gjitha individuale, 1 Kat Guri me sipërfaqe mesatare 102 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe parcele mesatare 265 m<sup>2</sup>. Koeficienti i shfrytëzimit të territorit 0.38.

Master Plani i “Zonës me përparësi zhvillimin e turizmit Voskopojë” miratuar me Vendimin e KRRTRSh nr. 8, datë 7.05.2003. Gjatë hartimit të Planit Rregullues të Përgjithshëm janë respektuar kondicionet dhe drejtimit kryesore për zhvillim të dhëna nga ky Master Plan.

Vendimi nr.558, datë 1.8.2003 i Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e Voskopojës “Qendër historike” dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit”.

Vendim i KM nr.673, datë 10.10.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.558, datë 1.8.2003 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e Voskopojës “Qendër historike” dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit”.


### 3. Veçoritë Fizike dhe Mjedisore

#### 3.1 Topografia dhe Relievi

#### PËRFYTYRIM TOPOGRAFIK I PËRGJITHSHMËM

Bashkia e Korçës është njësi administrative vendore e cila shtrihet në Shqipërinë Juglindore. Ajo kufizohet më Veri me Bashkinë e Maliqit, në lindje me Bashkinë e Devollit në jug me Bashkinë e Kolonjës dhe në jugperëndim me Bashkinë e Skraparit. Në Lindje ka ndarje natyrore me kreshtin malor të Moravës, në Perëndim me kreshtin malor dhe kurrizin e Ostrovicës në veriperëndim. Rrafshnalta ( pjesë e Fushëgropës së Korçës) është ulje që ruhet në perëndim nga Masivi i Voskopojës e në jug nga Malësia e Vithkuqit. Përmidis tyre janë luginat me relievin rënës dhe derdhje të ujrëve për kah perëndimi. Fushëgropa e Korçës, është një gjeohapësirë fushore, ajo është konsideruar një gropore natyrore, e ruajtur nga të gjitha anët, në shtrirjen e saj. Daljet janë: në Grykë të Cangonjit që hap komunikimin me Bashkinë e Devollit, në rrjedhën e tij të mesme, qafa e Qarrit për në drejtim të Kolonjës.





**Figura 6 Hartë e relievit të territorit të Bashkisë Korçë**

## TIPARE TË RELIEVIT

Topografia e Bashkisë së Korçës përbën veçori të ndërthurjes më të mirë të relievit gjeohapësirës malore gjeografike të Shqipërisë Juglindore. Në këtë reliev janë të pranishëm tiparet : tepërmalore, malore dhe rrafshnaltë ( fushëgropë).

- Kurrizi i Ostrovicës është një barierë tepërmalore, në përfundim të Bashkisë së Korçës që pozicionohet në drejtimin jugverior, duke nisur nga Qafa e Martës, majën e Faqekuqit, majën e Ostrovicës deri mbi Mazrek që është shkallë veriperëndimor i bashkisë ( Njësia Administrative vendore e Lekasit ) Shtirja e Ostrovicës është në 17 km.
- Përfshirja e relievit tipik malor me: Malësinë e Voskopojës, Malësinë e Vithkuqit dhe Kurrizin e Moravës.
- Rrafshnalta e Korçës që lidhet me një pjesë të Fushëgropës së Korçës.

## NDARJA E RELIEVIT

Reliev fushor: 18 % . Kësilloj cilësohet vetëm fushëgropa pjesore e Korçës.

Reliev kodrinoro-malor 21 %, përfshin zonat që ngrihet butësisht mbi fushëgropë drejt malësisë së Vithkuqit dhe Voskopojës si dhe në juglindje ato të Floqit e në rritje drejt Qafës së Qarrit.

Reliev malor: 45 % , përfshin pjesëm e lartë të Moravës, Vithkuqit. Voskopojës, luginës së Lekasit ( Çemicës ) , ato të Osumit verior etj.

**Tepërmalor : 16 % . Kësilloj cilësohen : Kreshti i Ostrovicës Vithkuqit, Moravës.**

## INTEGRIM TOPOGRAFIK I NJËSIVE ADMINISTRATIVE VENDORE

Në ndarjen e re Administrative Territoriale Bashkia përmbledh këto Njësi Administrative Vendore :

1. Korçë.
2. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Qendër Bulgarec
3. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Voskop
4. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Voskopojë
5. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Lekas
6. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Vithkuq
7. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Mollaj
8. Njësia Administrative Vendore (NjAV) Drenovë

Në vështrimin gjeotopografik Bashkia e Korçës sipas shtrirjes territoriale në të të tashmen e saj përfshin:

- 1) Fushëgropa pjesore e Korçës, brenda së cilës përfshihen: Korça, Qendër- Bulgarec, NjAV Voskop ( pjesërisht), NjAV Mollaj ( pjesërisht) NjAV Drenovë( pjesërisht )
- 2) Malësia e Voskopojës ( NjAV e Voskopojës )
- 3) Malësia e Vithkuqit ( NjAV e Vithkuqit )
- 4) Kreshti Malor Moravës ( faqet perëndimore ) ku pjesërisht është NjAV e Drenovës.
- 5) Kreshti malor i Ostrovicës ( ku pjesërisht futen hapësira të NjAV të Lekasit, Vithkuqit )

**GJEOMETRIA E LARGËSIVE K O R Ç Ë DERI NË QENDRA DHE PIKA KARAKATERISTIKE**

FSHATRAT	Voskop	Turan	Ravonik	Qatrom	Polenë	Mborje	Drenovë	Mollaj
Largësia nga qendra e Korçës	8,5 km	4 km	4.2 km	6 km	9,8 km	2.0 km	4.5 km	7,5 km

FSHATRA	Boboshtic	Kamenice	Pulahë	Dërsnik	Floq	Goskovë
						E poshtëme

Largësia nga qendra e Korçës	7.0 km	13 km	13 km	13.5 km	16 km	6 km
------------------------------	--------	-------	-------	---------	-------	------

FSHATRAT	Melçan	Bulgarec	Dishnicë	Kuç I Zi	Shamoll
Largësia nga qendra e Korçës	6.5 km	6.0 km	5,8 km	14.0 km	8,5 km

Bashkia e Korçës ka shtatë Njësi Administrative Vendore: Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vitkuq, Mollaj dhe Drenovë.

KORÇA	Bulgarec	Voskop	Voskopojë	Lekas	Vithkuq	Mollaj	Drenovë
Largësia deri tek qendra NJ V.	4,9 km	7.4 km	15,9 km	22.7 km	19,8 km	7.0 km	4.5 km

Largësitë që jepen në tabelën e mësipërme janë në një gjeometri hapësinore me pikë fillimore Qendrën e Korçës dhe në takim me qendrën e secilës qendër të Nj.a. vendore. Ky është një tregues gjeometrik i shpërndarjes hapësinore të qendrave fshatare që përbëjnë Nj.a.v.

#### POZICIONIMI TOPOGRAFIK SI NDIKIM SHNDËRRUES URBAN.

Në këtë gjeohapësirë dhe reliev kaq të ndryshëm janë të mpleksuara histori të kulturës së jetesës (Kultura e Maliqit), duke sjellë zhvillime, jo vetëm në brendësi të Fushëgropës por edhe rrotull saj, që nga Korça, Voskopoja, Vithkuqi në shtrirjet urbane, në prirje edhe drejt lartësive malore përgjatë gjithë vijimësisë e mbijetesës Iliroshqiptare. Një ndërthurje e tillë topografike, nga kreshti tepërmalor Ostrovicës, në fushëgropë të Korçës, përfshirje të dy luginave të Devollit dhe Osunit, në platformat malore ku rrojnë gjurmë urbane historike si Voskopoja e Vithkuqi, gjer në shtegun e virgjër turistik të Dardhës, tradita historike zhvillimore gjen një larmi frymëmarrjeje urbane e cila kërkon rizgjim dhe rikonceptim.

Rritja e relievit, në lindje është e menjëhreshme, drejt kreshtit të Moravës. Ndërsa kjo rritje është e butë, në perëndim ku panorama lartësore i përngjan sistemit kodrinor. Për vlerësimin metabolik fushëgropa pjesore me Koçën dhe gjithë qendrat e banimit në fushë, bëhen nisje por edhe mbështetje për një frymëmarrje të re të zgjerimit të planëzimit urban edhe në periferi, për infrastrukturë dhe zhvillim sipas një rendi vlerësues dhe krahasimor të mundësive. Në këtë vështrim, ndryshimi dhe shndërrimi që do të ndodhë, varet shumë nga topografia, relievi, përbërësit e largësitë nga qendra dhe midis tyre, nga lartësia e relievit, pozicionimi.

Vështrimi i sotëm urban (qytetor) gjen në këtë topografi shtratin historik tradicional tërheqës, e zhvillimor, mbasi asnjë pjesë e kësaj gjeohapësire nuk mbetet e përhumbur, me gjithë shkatërrimin e ndodhur përgjatë luftrave e migracionit ndër shekuj. Jo vetëm Voskopoja e Vithkuqi, por shumë më tej, në skajin veriperëndimor të Njësisë së sotme Administrative të Lekasit janë gjurmë gjeneze e Muzakajve me rrënjë në Voskop e Lekas, në një zonë tepërmalore.

Ky relief tërheq për një rizhvillim dhe rikonceptim çka nuk përbën pengesë në gjetjen e hapësirave zhvillimore ekonomike, të rrugëve përtëritëse të turizmit, të shfrytëzimit të pasurive natyrore jo vetëm në Voskopoje, por edhe në një konceptim e fryme rizgjimi në Vithkuq, deri në Dardhë, në juglindje.

Gazsjellësi Transadriatik (TAP) që po realizohet është një vepër që kryhet, në këtë relief aq të larmishëm në një zonë në të cilën dhjetvjeçarët e fundit kanë ndodhur ndryshime si rrjedhojë e migracionit, gjer në një rrudhje të skajshme, por që por që dinamikat e fundit nuk janë vetëm një shpresë për Rilindjen Urbane edhe në skajet më fundore të strehëve jetësore që janë harruar.

## TOPOGRAFIA DHE SISTEMI RRUGOR

Bashkia e Korçës është një bashkëfrymëmarrje e sistemit rrugor Kombëtar sepse këtu përvijojnë degëzime dhe kalime të rrugëve nga Tirana në Korçë ku përthithen lidhjet me Elbasanin, Dibrën, Librazhdin, Pogradecin, Çorovodën, Kolonjën, Përmetin. Gramshin, Maliqin dhe Devollin.

Po kështu, Korça është brinjë e Koridorit të Tetë që lidh Shqipërinë me Greqinë e më tej. Nëpërmjet përbashkimit të sistemit rrugor Korça lidhet gjithashtu shtetin fqinjë të Maqedonise përmjet Pogradecit dhe Bashkisë së Pustecit.

## TOPOGRAFIA E UJMBLEDHJEVE KRYESORE KOMBËTARE.

Relievi i Bashkisë së e Korçës është pjesë e dy ujëmbledhjeve të mëdha kombëtare që kanë lidhje me lumin Devoll dhe Osumin në Jug. Kështu lugina e Devollit të Sipërm kalon në krahë të Bashkisë në fushëgropë, por ajo merr ujrat që rrjedhin nga relievi i Moravës dhe fushëgropës së Korçës, nga lugina dhe ujëmbledhja e Çemeritës dhe faqeve të Kreshtit të Ostrovicës.

Ndërkaq në jug relievi i Malësisë së Vithkuqit Përcjell format dhe ujarat e luginave jugore në lumin Osum.

UJËMBLEDHJA E FUSHËGROPËS, lidhet me vet ndërtimin kohor të fushës e cila veç gropores tektonike ka përcjell ujrat duke ndikuar në relief ndikuar përgjatë shtrirjes së saj drejt veriut, në fillimin e Devollit të Epërm ( Kanali i Dunavecit ) Në fushëgropë hyjnë ujrat që vijnë nga faqet e Moravës ato që rrjedhin nga Kamenicë , Floq e faqet veriore të Qafës së Qarrit, ato të Gjançit, Dërsnikut, Gjonomadhit, Vinçan- Damjanecit.

UJËMBLEDHJA E MORAVËS, lidhet përsjelljen e ujrave që rrjedhin nga kreshti i Moravës,, duke filluar nga Dardha në jug e gjer në pjerrësitë në Kuç të Zi e Neviçisht.

UJËMBLEDHJA E OSUMIT TË EPËRM, ka të bëjë me rrjedhat ujore që zbresin nga Malësia e Vithkuqit drejt fillimit të Osumit të Epërm. Kështu këtu permendim: ujëmbledhjen që vjen nga Gjançi, Rehova dhe Lubonja, ato që rrjedhëin nga lugina e Stratobërdhës dhe Treskës e së fundi lugina ujëmbledhëse e Lumit të Panaritit.



## UJËMBLEDHJA E ÇEMERICËS DREJT PELLGUT UJËMBLEDHËS SË DEVOLLIT TË MESËM.

Ujrat që rrjedhin drejt veriut nga lugina e Çëmericës dhe ajo e Mazrekut në NjAV të Lekasit, përcjellin ujrat dhe formësojnë relievin në Pellgun e Devollit të Sipërm. Harku Malor që fillon me kreun e Gjergjevicës ( maja e Lisies : 1714 metër) harku i relievit vijon me majën e Azinës ( 1854 metër) , qafën e Martës e kthim drejt Veriut : maja e Faqekuqit ( 2352 metër) majën e Ostrovicës ( 2383 metër ) . Në krahë të ujëmbledhjes së Çëmericës është edhe ajo e Mazrekut që kufizohet në veri me Çukën e Bofnjes.

## PËRSHKRIMET KUFITARE VENDORE TË BASHKISË SË KORÇËS.

### PËRSHKRIM I KUFIRI VENDOR I BASHKISË SË KORÇËS ME BASHKINË E MALIQIT ( VERI )

Tek Çuka e Bofnjes ( 2004 m ) vija ndarëse kalon drejt Lindjes, përgjatë kreshtit të relievit që ndan luginën e Brozdovecit deri në Lumin e Beçit që përfshin në Lindje Lavdarin (njësia administrative Lekas ) të Bashkisë së Korçës në kufi me Gurakuq të Bashkisë së Maliqit. Një nga nyjet kufindarëse të dy bashkive është ajo ku takohen lumi i Çëmericës me lumin e Beçit. Në veri të kësaj nyjeje mbetet fshati Protopapë i Bashkisë së Maliqit. Pas kësaj nyjeje kufiri ndarës vijon drejt majës së Sukaverit (lartësia 1374m) ku ndahet pronësia vendore e fshatit Osojë ( Maliq) dhe Xerje -Denas- Popovinë – Lavdar të Bashkisë së Korçës.

Në drejtim të Lindjes vija kufitare zbrit në përroin e Luadhes dhe mandej ngjitet në lartësinë 1401 ( maja e hijes së Bufit). Këtu merr një drejtim verior duke u ngjitur në majën e Shëdëlliut çka përfshin fshatin fundor të bashkisë së Korçës : Krushovë . Në vijim lindor është fundi i pronësisë vendore të fshatit Shipckë e cila përfshin rrjedhjen jugore të ujrave në kurrizin poshtë majës Mustaq (lartësia 1549) . Më tej kufiri zbrit në luginën e përroit të Bickës dhe prej këtu përfshin vijën veriore pronësore të kullota e pyjeve të fshatit Damjanec ( njësia administrative Voskop) i cili ndahet me fshatin Kloc që i përket Bashkisë së Maliqit. Këtu kufiri vijon përmidis përroit të Klocës duke përfshirë në Jug fshatrat Biranj dhe Lumalas ( Qendër Bulgarec) që i përkasin Bashkisë së Korçës. Në Veri të Bulgarecit kufiri vendor i Bashkisë vijon prej kanalit të madh të Dunavecit në një reliev tërësisht fushor duke përfshirë kufijt pronësorë të fshatit Shamoll dhe të fshatit Kuç i Zi që përkon me fillimin e relievit kodrinor dhe malor të Malit të Moravës. Prej fshatit Kuç i zi kufiri ngjitet në drejtimin lindor për kah kreshtit të malit të Moravës deri në pikën lartësore 1272 metë çka përkon edhe me kendin kufitar vendor të tre bashkive:Korçë,Maliq dhe Devoll.

### KUFIRI VENDOR I BASHKISË SË KORÇËS ME BASHKINË E DEVOLLIT ( L I N D J E )

Kufiri vendor i Bashkisë së Korçës në lindje ndan me Bashkinë e Devollit. E gjithë kjo vijë ndjek drejtimin jugor përgjatë kreshtit të Malit të Moravës. Ujëmbledhja dhe ujërrjedha e relievit të kreshtit malor, në faqen perëndimore i takon bashkisë së Korçës. Përreth 20 km ngrihet ky kresht ndarës që ka si pika njohëse dhe dalluese: majën e Lajthisë ( 1573 metër), majën e Çardhakut ( 1808 metër) majën e Bigllës ( 1762 metër ) Mandej kemi zbritje të relievit gjer në qafë të malit, ku ndodhet edhe fshati Dardhë.

### KUFIRI VENDOR I BASHKISË SË KORÇËS ME BASHKINË E SKRAPARIT ( P E R Ë N D I M )

Këndi Jugperëndimor që ndan tre bashkitë (Korçë, Skrapar, Kolonjë) është në gjeohapësirën fundore kufizuese të fshatit Grabockë (njësia administrative vendore Vithkuq) të Bashkisë së Korçës, në lartësinë 1035 metër mbi nivelin e detit. Grabocka mbështetet në Osum, që është larg jo më shumë se 2 km, por rrjedha e ujrave dhe kufijt pronësorë të Grabockës shtrihen gjer në rrjedhë të Osumit. Kurrizi malor në këtë hapësirë ndan Grabockën me Melckën (Skrapar). Pastaj vija kalon në drejtim të majës së Staraveckës (1575 metër). Relievi që bie në drejtim të lindjes përfshin Panaritin. Maja e Lirzës (1778 metër) ndan kreshtin ku kufizohen dy bashkitë : fshati Helmës – Staraveckë i Skraparit dhe dhe Panarit, i Korçës.

Në drejtimin verior vija kalon drejt qafës së Martës (1823metër) dhe fillimit të kreshtit malor të Ostrovicës (maja e Façekuqit 2352 metër). Në verilindje kreshti vijon me lartësitë 2379 dhe 2383, Qafa e Veshëzit (2083 metër) deri në majën e Ostrovicës (2346 metër). Kreshti i Ostrovicës në përgjithësi ndan të dy bashkitë: atë të Skraparit në perëndim dhe Korçës në lindje. Më tej kreshti vijon në verilindje. Nga maja e Ostrovicës vija ndarëse orjentohet drejt qafës së Beçit në perëndim, duke përfshirë një ujëmbledhje relievi që bie në drejtim të fshatit Mazrek, 1000 metër mbi nivelin e detit. Kreshti ndarës merr një kthesë harkore në drejtim të Çukës së Bofnjes (2004 metër) në përfshirje të ujrave që rrjedhin në drejtim të Mazrekut dhe Brozdovecit (nj.a. Lekas).

#### KUFIRI VENDOR I BASHKISË SË KORÇËS ME BASHKINË E KOLONJËS (JUG)

Si kënd orjentues i relievit përfshirës që ndan tre Bashki: të Korçës, me atë të Kolonjës (në jug) dhe të Skraparit (në perëndim) është shtrirja pronësore e fshatit Grabockë që mbështetet në Lumin Osum. Pastaj kufiri vijon përgjatë Osumit në lindje gjer në bashkimin e Osumit me lumin e Treskës (lartësia 584 metër) që përmbledh në very fshatin Trebickë dhe hapësirat pronësore të tij.

Më tej, vija ndarëse shkon për kah lindja në përfshirje të lumit të Treskës dhe të fshatit Treskë.

Trebicka është në lartësinë 1020 metër dhe përfshihet nga përroi dhe lugina e Panaritit si dhe lumi i Treskës dhe në jug Osumi. Në bashkimin e lumit të Osumit me lumin e Treskës lartësia është 584 metër. Treska ndodhet në luginë. Faqet malore ujëmbledhëse zbresin nga kurrizi i Kaltanjit (1373 metër), ngjitet në veri në pyllin e Ballabanovës (1395 metër) Këtu përfshihet fshati Stratoberdë me kurrizin malor si dhe ujërrjedhën nga lartësia 1468 metër (sektori i Sharrave) e përroi i Piqerrit. Në jug kufizon fshati Selenicë e Pishës (Bashkia e Kolonjës) Prej majës së Selenicës së Pishës kufiri vendor zbret në luginën e Roshanjit (përroi i Roshnjit) duke përfshirë në veri fshatin Lubonjë e Roshanj. Pastaj kufiri vendor vijon në pikën ndarëse së Qafës së Qarrit.


Më tej vija kufizuese ndan Pepellashin (Kolonjë) me Floqin (Korçë) në Gropat e Slanjës, maja e Shpellës.

Ujërrjedha vjen nga qafa e Floqit (1568 metër) dhe merr drejtimin për kah maja e Llofkës (1868 metër)

Në verilindje ujëmbledhja dhe ujërrjedha e Kamenicës përshin pronësinë e fshatit Kamenicë. Mandej vija ndarëse kalon përgjatë kreshtit malor që shkon në Dardhë ku fillon edhe mali i Moravës.


### 3.2 Klima

Bashkia e Korçës shtrihet në pjesën jug-lindore të Shqipërisë. Klima e territorit tokësor është e tipit kontinental lokal, me një temperaturë mesatare vjetore prej 11.4°C. Temperaturat mesatare mujore arrijnë rreth afërsisht 21.2 gradë në Korrik dhe Gusht, ku maksimumi arrin në gusht me 34.4 gradë. Temperatura mesatare më e ulët është gjatë Janarit, rreth 1.5 °C, me një minimum prej -17.2°C.



*Fig.-2 Harta e zonave klimatike (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)*


Pozicioni gjeografik, mbizotërimi i kodrave dhe maleve bën që territori i bashkisë së Korçës të futet në zonën ku dimri është i ftohtë dhe vera e freskët. Reshjet e pakta bien kryesisht në formë bore.



Korça ka klimë mesdhetare kalimtare (ose klimë mesdhetare kontinentale) me ndryshime të mëdha në temperaturë. Muaji më i nxehtë është gushti (25 °C) ndërsa muaji më i ftohtë është janari (2 °C). Mesatarisht gjatë vitit bien 710 mm reshje të cilat minimumin e arrijnë në verë ndërsa maksimumin në dimër, duke e bërë Korçën një qytet përgjithësisht të thatë krahasuar me pjesën tjetër të Shqipërisë së lagësht. Temperaturat në Korçën që përthith 2300 orë rrezatimin diellor, përgjithësisht mbeten më të ulta se pjesa tjetër e Shqipërisë perëndimore, por më të larta se pjesa veri-perëndimore për shkak të lartësisë mesatare në rrafshin e Korçës. Megjithatë janë regjistruar raste kur temperatura ka arritur deri në 40 °C ose më tepër.

Gjatë dimrit bien dhe reshje dëbore, ku në rajonin tonë e përreth trashësia shkon në mbi 0.5m ndërsa në lartësi të mëdha trashësia shkon deri në mbi 1m. Gjatë vitit në zonën tonë reshjet janë të shumta dhe sasia e tyre mesatare shkon nga 900-1300mm dhe më shumë reshje bien në mujin nëntor dhe dhjetor të vitit. Dëbora fillon të bjerë që në fundin e muajit Nëntor dhe vazhdon në mënyrë jo të qëndrueshme, deri në muajin Shkurt. Ky territor, pothuajse gjatë gjithë vitit, por veçanërisht në periudhën fundi i vjeshtës-fillimi i pranverës, rrihet nga erëra të ftohta.





**Fig. - 1 Harta fiziko gjeografike e shqipërisë**  
(Burimi: Perikli qiriazi 1988)

## PARAMETRAT KLIMATERIK

### ERA (DREJTIMI, SHPEJTËSIA)

Era më e shpeshtë është ajo që fryn nga veriu, sidomos në vjeshtë dhe dimër. Erërat që fryjnë nga jugu dhe juglindja dominojnë gjatë pranverës dhe verës. Erërat e juglindjes dhe lindjes janë të konsiderueshme. Periudhat e qeta dhe me erë ndryshojnë gjatë ditës, veçanërisht në verë. mëngjeset karakterizohen nga luhatjet mes erërave që fryjnë nga veriu dhe periudhave të qeta. Kushtet e motit ndryshojnë mjaft pasditeve, kur qetësia prishet nga erërat e jugut dhe juglindjes.

Era percaktohet si levizje horizontale e ajrit, ndersa levizja vertikale quhet rryme ajri.

### Karakteristikat

Shpejtësia mesatare vjetore e erës është rreth 2.1m/s. Shpejtësia më e madhe arrihet në stinën e pranverës me 2.5m/s, në dimër 2.2m/s, në verë 1.7m/s dhe në vjeshtë 2m/s. Erërat me shpejtësinë mesatare vjetore më të madhe janë ato me drejtim jug-perëndim (5m/s) dhe jug-lindje (4.8m/s), ndërsa ato me shpejtësi mesatare vjetore më të vogël janë ato me drejtim veri-lindje (2.8m/s). Përsa i përket drejtimit të erërave:

**Shpërndarja vjetore e drejtimeve të erës në %** (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)

Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
Korçë	51.2	10.3	5.5	7.1	5.8	2.2	13.2	2.4	2.3

**Shpërndarja gjatë dimrit e drejtimeve të erës në %**

Stacioni	Q	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW
Korçë	52.7	8.9	6.0	5.7	6.3	2.3	16.4	0.9	0.8

**Rastisja e shpejtësisë së erës në %**

<b>Shpejtësia në m/sek</b>	<b>0-1</b>	<b>2-5</b>	<b>6-10</b>	<b>11-15</b>	<b>15</b>
<b>Korçë</b>	56.9	27.1	14.1	1.4	0.5


*Shpejtësia më e madhe e erës në m/sek*

<b>Stacioni</b>	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>V</b>	<b>VI</b>	<b>VII</b>	<b>VIII</b>	<b>IX</b>	<b>X</b>	<b>XI</b>	<b>XII</b>
<b>Korçë</b>	40	26	28	26	24	20	20	22	20	29	24	30

*Siguria e shpejtësive të mëdha të erës në m/sek*

<b>Stacion</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>10</b>	<b>20</b>	<b>25</b>	<b>30</b>	<b>40</b>	<b>50</b>	<b>60</b>	<b>70</b>	<b>75</b>	<b>80</b>	<b>90</b>	<b>95</b>	<b>99</b>
<b>Korçë</b>	42	37	35	32	29	28	27	25	24	22	21	20	19	17	16	14


**Fig.- 2 Rajonizimi klimatik në Shqipëri (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**



Drejtimi i erës është kahu nga fryn era dhe merr emrin e tij sipas një prej 16 pikave të horizontit. Luginat shërben si një drejtues për rrymat ajrore dhe po të gjykojmë nga të dhënat e stacioneve meteorologjike drejtimi dominues, në të gjithë stinët, janë VL (20% të rasteve) dhe JP (10.4% të rasteve). Rrymat ajrore janë një ndër faktorët kryesorë të formimit të klimës. Në territorin në studim, drejtimi i erës gjatë vitit është i ndryshueshëm. Shpejtësitë e erës në territorin në studim janë në vartësi të periudhës së vitit. Vlerat më të mëdha të shpejtësive të erës vrojtohen në stinën e dimrit. Shpejtësitë maksimale të erës

me periudhë përsëritje një herë në 50, 20, 10 vjet janë respektivisht 30-33m/s, 28-30m/s, dhe 24-27m/s (sipas Kushteve teknike Hidrometeorologjike).


**Fig.- 3 Shpërndarja territoriale e sasisë vjetore të orëve me erë me erë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**



### Temperatura

Regjimi termik paraqet uniformitet të kенаqshem. Vleftat e temperatures mesatare vjetore pergjithesisht luhaten

rreth  $13.0^{\circ}$  C. Temperatura mesatare e janarit lekundet ne rreth  $2.9^{\circ}$ C. Ne figure paraqitet shperndarja e temperatures mesatare gjate vitit.



**Fig. – 4 Shpërndarja e temperaturës mesatare gjatë vitit (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**

Temperatura mesatare vjetore është  $10.5^{\circ}$ C. Rajoni dallohet për dimrin e ftohtë (temperatura mesatare e Janarit  $0^{\circ}$ C) dhe për verën e freskët (temperatura mesatare e Korrikut  $18.3^{\circ}$ C). Lidhur me temperaturën mesatare stinore, ajo është rreth  $1.7^{\circ}$ C në stinën e dimrit,  $9.3^{\circ}$ C në pranverë,  $19.3^{\circ}$ C në verë dhe  $11.5^{\circ}$ C në vjeshtë. Temperaturat skajore arrijnë: minimumi absolut  $-24.2^{\circ}$ C dhe

maksimumi absolut 35.5<sup>0</sup>C. Këto minimume janë pasojë e depërtimit të masave ajrore të ftohta dhe fuqizimit të tij nga forma e luginës së Devollit.

*Temperatura mesatare e ajrit në <sup>0</sup>C*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes	Ampl
Korçë	0.5	1.8	4.9	9.7	14.0	17.8	20.5	20.8	17.3	11.5	7.2	2.8	10.7	20.3

*Maksimumet absolute të temperaturës së ajrit*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
Korçë	17.4	18.6	26.3	27.2	33.2	34.9	37.0	38.5	34.5	29.0	22.1	16.1	38.5	9/08/45

*Amplituda e temperaturave ekstreme absolute*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
Korçë	38.3	36.1	41.3	37.7	33.2	32.3	30.6	32.9	32.9	32.2	31.6	39.1	61.5

*Temperatura maksimale absolute në sipërfaqen e tokës*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet	Data
Korçë	19.9	29.5	39.6	51.0	54.9	57.8	64.1	62.7	53.2	44.6	33.3	20.8	64.1	26/07/65

Stacio	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.	Data
Korçë	-27.0	-22.7	-21.1	-13.5	-4.3	-2.4	4.4	1.6	0.6	-5.7	-10.0	-21.3	-28.5	14/01/68

*Temperatura minimale absolute në sipërfaqen e tokës*

*Temperatura minimale absolute në 5 cm, mbi sipërfaqen e tokës*


Stacio	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.	Data
Korçë	-26.6	-19.1	15.1	9.6	-2.8	-2.4	-0.5	0.9	-4.5	9.9	-14.7	-21.5	-26.6	20/01/67



## DËBORA, RESHJET E SHIUT (MESATARET, VLERAT MAKSIMALE, VLERAT MINIMALE), PRECIPITIMI DHE AVULLIMI

Reshjet janë një prej faktorëve kryesorë që influencojnë regjimin klimaterik të zonës. Reshjet e shiut variojnë gjatë vitit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në balancën e ujit të liqenit dhe pellgut të tij ujëmbledhës. Niveli më i lartë i reshjeve normalisht shënohet në Nëntor-Janar dhe në pranverën e vonë, zakonisht në maj. Reshjet arrijnë nivelin më të ulët gjatë Korrikut dhe Gushtit. Reshjet mesatare të shiut në vit në basenin e liqenit shkojnë afërsisht 759 mm. Termi *reshje*, i përdorur në hidrologji, përfshin të gjitha format e ujit që vijnë nga atmosfera në tokë. Format kryesore të reshjeve janë: shiu, bora, bresheri, vesa etj. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishme të motit dhe të klimës.

**Fig.- 5 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**



Faktoret kryesore që kushtojnë sasinë, intensitetin, shpërndarjen vjetore, stinore e mujore të reshjeve, në zonën në studim janë: pozicioni gjeografik dhe veçoritë e relievit. Është e qartë se për një pellg, përgjithësisht, reshjet janë faktori kryesor i regjimit hidrologjik, sepse ato janë vetë edhe materiali kryesor që krijon rrjedhjen në hapësirë dhe kohë. Një karakteristike e përgjithshme e shpërndarjes së reshjeve në pellgun e Shkumbinit është se lartësia e tyre rritet nga Perëndimi në Lindje deri në pellgjet e degëve Gostime e Rapun (inklusiv) dhe pastaj zbrit nga Veriu në Jug. Reshjet atmosferike janë nga elementet më të rëndësishme të motit dhe të klimës.

### Reshjet

Korça dallohet për sasinë mesatare vjetore shumë të ulët të reshjeve me rreth 700mm në vit. Ndikimi kontinental i klimës zbutët nga regjimi mesdhetar i reshjeve ku në verë bien 12.5% të reshjeve vjetore.

**Lartësia e reshjeve R (mm) (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**

Stacion	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
Korçë	43	4.9	47	29	108	54	11	31.6	19	127	87	105
Korçë	69	23.6	83	27	114	54	7.6	18.5	10	153	113	129

Stacion	Vjet	Max	Data	Nr.dit
---------	------	-----	------	--------

Korçë	671.4	36.5	20. X	110
Korçë	805.0	28.5	20. X	134





*Lagështia relative mesatare e ajrit në %*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	79	76	69	63	64	61	54	52	61	70	78	80	64

*Mesataret mujore e vjetore të reshjeve në mm*

*Mesatare 35- vjeçare (1931- 1965)*

Stacioni	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet.
Korçë	70	68	53	54	58	42	21	25	44	85	112	89	722



**Fig. –6 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)**

Shperndarja e reshjeve brenda vitit ne territorin ne studim

është tipike mesdhetare, me reshje të shumta gjatë gjysmës së ftohtë të vitit dhe reshje të pakta gjatë gjysmës së ngrohtë me thatësire që mund të zgjatë disa muaj. Ndarja e vitit në dy gjysma viti është bërë duke ndjekur kriterin pluviometrik të muajve. Si gjysmë e ftohtë e vitit është marrë inkuziv periudha *tetor-mars* ndërsa ajo e ngrohtë periudha *prill-shtator*.

*Fig. –7 Harta e shpërndarjeve të reshjeve (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)*

Nga analiza e reshjeve, të dy periudhave, vihet re se reshjet e gjysmës së ftohtë të vitit janë me të mëdha se ato të gjysmës së ngrohtë, gjë që tregon karakterin mesdhetar të shpërndarjes së reshjeve në territorin në studim. Po të shohim ecurinë e sasive së reshjeve sipas renditjes kronologjike të muajve, do të veme re se kjo ecuri paraqet afërsisht trajtat e një kurbe paraboloidi me origjinë të vendosur në muajt me më pak reshje dhe me krahe në të dy drejtimet që ndjekin rritjen graduale të reshjeve sipas radhës së muajve. Muajt me më shumë reshje janë Nentori, Dhjetori e Janari, por reshjet me të shumta vëroqohen në muajin Nentor. Muaji me më pak reshje është Korriku. Nga sasia e reshjeve mbizoteron stina e dimrit, megjithatë vjeshta në disa raste barazohet me të.

### Dëbora

Në Shqipëri reshjet në formë bore bien kryesisht në muajt e dimrit dhe përfshijnë më tepër zonat malore të vendit sidomos ato që shtrihen në brendi të territorit. Mesatarja e lartësive maksimale të dëborës, për territorin në studim, është nga 15 deri 30 cm. Vlera mesatare e dendësisë së bores merret  $0.13 \text{ gr/cm}^3$ . Mesatarja e lartësive maksimale të bores ndryshon me ndryshimin e lartësive së vendit, mbi nivelin e detit sipas kësaj ligjeshie (shiko Kushtet Meteorologjike të Projektimit) :

ku:

$$Y = 2.3(H/100) + 3.7$$

Y – mesatarja e lartësive maksimale në cm, H- lartësia e vendit mbi nivelin e detit në m.

Ndryshimet klimatike nuk kanë më nevojë të paraqiten si një fenomen global që mund të ndikojë tek ekosistemet, si dhe tek sektorë të rëndësishëm të bujqësisë. Ndryshimet klimatike janë tashmë një kërcënim i njohur që, për t'u trajtuar siç duhet, duhet të merret në konsideratë në mënyrë të integruara, si pjesë e sfidave më të mëdha të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel global. Ndryshimet klimatike pritet që të rrisin frekuencën dhe madhësinë e ngjarjeve ekstreme si dëmet e shkaktuara nga përmblytjet, thatësira, zjarret nëpër pyje, valë të nxehti dhe rreziqe të tjera klimatike. Pritet gjithashtu që të shkaktojnë reduktim të drithërave dhe të ujit.

*Numri i ditëve me shtresë dëbore*

Stacioni	X	XI	XII	I	II	III	IV	V	ΣVjet
Korçë	-	0.7	6.3	12.3	11.4	3.8	8.3	-	34.8

## VLERËSIMI I NDRYSHIMIT DHE ADAPTIMIT


Qëllimi i vlerësimit N & A përfshin si modelimin klimatik dhe vlerësimin e integruar të ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorët kryesorë në zonat bregdetare të Shqipërisë. Këta sektorë kyç janë bujqësia, shëndetësia, burimet ujore, fatkeqësitë natyrore, turizmi, dhe biodiversiteti.

### Ndryshimet e parashikuara në regjimin e temperaturës

Për shkak të ndryshimit të mundshëm të temperaturës, Zona bregdetare shqiptare ka gjasa të bëhet më e ngrohtë. Të gjithë skenarët tregojnë një rritje të mundshme në temperatura vjetore që lidhen me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Veçanërisht:

*Fig. – 8 Harta e temperaturës në thellësi 100 metra në tokë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)*

- A1F1MI parashikon rritjen mesatare më të lartë pas 2014, me një rrotje të mundshme deri në 4.8 në 2100 (skenari më i lartë/max),
- A1BAIM parashikon një rritje mesatare prej 1.7°C me 2050 dhe 3.2°C (skenari mesatar), dhe
- B1IMA parashikon rritjen më të vogël pas 2040 (skenari më i ulët/min).



### Ndryshimet e parashikuara në regjimin e reshjeve

Të gjitha skenarët tregojnë një rënie të reshjeve vjetore në lidhje me 1990 për të gjitha horizontet kohore. Duke përgjithësuar rezultatet e tyre rezultojnë se reshjet vjetore kanë mundësi të ulen deri në -8,5% (nga -56,0 deri në 47,4%) në 2050; deri në -18,1% (nga -89,7% deri në 94,0%) në 2100

### Disa ndikime të përgjithshme

Si rezultat i ndryshimit të temperaturës dhe regjimit të reshjeve, janë parashikuar ndikimet e mëposhtme:



- Rritja e temperaturave minimale ditore më shumë se ato maksimale ka të ngjarë të ndodhë në të gjitha zonat e tokës
- Thatësira të shpeshta të gjata dhe me rrezik të madh zjarri janë të mundshme.
- Numri i ditëve me temperaturë mbi 35°C është parashikuar të rritet mesatarisht 10 ditë në vit deri 2100. Si pasojë e kësaj , numri i valëve të nxehta dhe i ditëve me temperaturë të ftohtë janë parashikuar gjithashtu të rriten.
- Ditët e freskëta dhe valët e ftohta janë shumë të mundshme të zvogëlohen. Dimërat e ngrohtë do të reduktojnë kërkesën e energjisë për ngrohje.
- Një rritje e numrit të ditëve me shira të rrëmbyeshëm që shkaktojnë përmbytje deri në 2100.
- Temperaturat e rritura të pranverës do të rrisin temperaturën e tokës, të mbjellat e verës në zonat e përshtatshme do të zgjasin periudhën e rritjes. Zgjatja e periudhës së rritjes është parashikuar të rritet me 26 ditë krahasuar me 1990.
- Si rezultat i reduktimit të reshjeve totale vjetore, zonat bregdetare mund të përjetojnë një rënie të përgjithshme. Kërkesa për ujë mund të rritet, veçanërisht në verë.
- Deri në vitin 2100 kushtet që do të jenë më të mira për turistët do të zgjerohen. Në verë kushtet do të ndryshojnë nga idealia në të shkëlqyeshme.

## NGJARJE TË PAZAKONTA KLIMATIKE

Ndër dukuritë e pazakonta klimatike bëjnë pjesë edhe ato që lidhen me regjimin e reshjeve. Shqipëria, si vend me klimë tipike mesdhetare, karakterizohet nga një regjim i çrregullt i reshjeve nga pikëpamja e shpërndarjes vjetore. Kjo shpërndarje karakterizohet nga një maksimum në muajt e dimrit (30-40% e reshjeve vjetore) dhe një minimum në muajt e verës (10%). Çrregullsia e reshjeve vihet re edhe në shpërndarjen e tyre gjeografike. Kështu, në shkallë lokale herë pas here ndodhin me ngjarje jo të zakonata si reshjet intensive brenda 24 orëve të shoqëruara në disa raste me përmbytje apo mungesa e theksuar e reshjeve që sjell thatësira të zgjatura.

Këto ndryshime të klimës do të ndikojnë edhe në rezervat ujore duke shkaktuar:

- Zvogëlim të rrjedhjes së ujërave sipërfaqësorë gjatë thatësirës së verës, veçanërisht në zonat jugore të Shqipërisë me 2% deri në 2030 dhe 5% deri në 2100;
- Keqësim të problemeve të ujit, veçanërisht atij të pijshëm, si gjatë stinës së verës për shkak të pakësimit të reshjeve, ashtu edhe gjatë vjeshtës për shkak të rritjes së turbullirës së ujit;
- Rritje e evapotranspiracionit për shkak të rritjes së temperaturës duke sjellë dhe zvogëlim të sasisë totale të ujit;




Fig.- 9 Harta e diellzimit të

Shqipërisë (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)




Fig. -10 Shpërndarja territoriale e sasisë

vjetore të orëve me diell (Burimi: Instituti meteorologjik Shqiptar, Libri Klimatologjia)




Fig. – 11 Harta e zonave dhe nenzonave klimatike (Burimi: Banka Boterore dhe UNDP, 2012)

## 4. Mjedisi dhe Ekosistemet

### 4.1 Habitati dhe biodiversiteti

#### BIODIVERSITETI

Qeveria Shqiptare ka hartuar një Strategji Kombëtare për Mjedisin në kuadrin e Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim qeveria Shqiptare do të rrisë me 3,5 miliard lek gjatë periudhës 2011- 2013 nivelin e shpenzimeve kapitale totale për të evidentuar dhe rehabilituar “pikat e nxehta” dhe për ndërtimin e vend-depozitimeve të mbetjeve të rrezikshme.

Gjeohapësira e Bashkisë së Korçës, ka një mjedis relativisht të gjelbër, kushtëzuar nga një reliev i larmishëm dhe bimësi natyore të pasur. Ndryshimet dhe dinamika që ka ndodhur në menaxhimin pa kriter të bimbësisë natyrore, ka lënë gjurmë, në biodiversitetin e Bashkisë, florën dhe faunën.

Që nga viti 1999, është adoptuar Strategjia dhe Plan i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB). SPVB është një dokument kyç që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat që duhen marrë lidhur me menaxhimin e biodiversitetit në Shqipëri për periudhën kohore 2000 – 2015, gjë e cila reflektohet edhe në Strategjinë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimet themelore të ruajtjes së biodiversitetit janë: (1)Përfaqësimi i të gjithë NjAV, në ndërgjegjësim të tyre, jo vetëm për zonat e mbrotura por në përgjithësi për burimet ujore, pyjet dhe kullotat, pejsazhin duke u përqendruar tek Zonat e Mbrojtura.(2.) Kuptimi dhe Mirëmbajtja e proceseve evolutive dhe ekologjike që mundësojnë një Biodiversitet të qëndrueshëm. (3\_). Ruajtja e specieve të llojeve të qëndrueshëm; (4) Ruajtja e grupeve të habitateve të mëdha natyrore aq sa mund të jenë elastike në një shkallë të gjerë nga shqetësimet rastësore dhe ato afatgjate. (5)Përmirësimi i menaxhimit të zonave dhe llojeve të mbrojtura ekzistuese duke u siguruar që objektivat e zonave janë përmbushur; ( 6 ) Zgjerimin e rrjetit të zonave të mbrojtura për të siguruar një mbulim të plotë të të gjithave habitateve. (7.) Përmirësimi dhe përshtatja e ligjeve ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit;(8) Përmirësimi i informacionit dhe i të dhënave për menaxhimin e biodiversitetit Në Bashki dhe në NjAV duhet të ndiqet:

- Planifikimi i menaxhimit të shtratit të lumenjve- menaxhimi i burimeve ujore;
- Përdorimi dhe ndotja e ujit- menaxhimi i burimeve ujore;
- Planifikimi i kufizimeve të përdorimit të tokës dhe – peizazhit;
- Menaxhimi i vend grumbullimit të mbetjeve - Menaxhimi i mbetjeve urbane

Integrimi i konsideratave dhe i prioriteteve të biodiversitetit është i rëndësishëm për këto zona. Prandaj një vëmendje e veçantë i është kushtuar azhurnimit dhe mbështetjes së iniciativave të mëparshme të integritit të lëna pas dore.

**Flora.** Bimesia pyjore është e pasur dhe përfaqësohet me ahun dhe halorët. Kjo bimesi është e përhapur në Moravë, Vithkuq, Ostrovicë. Në kreshtat e larta të maleve ka livadhe të pasura, ndërsa në vendet e ulta rriten dushqet e shkurre të cilat janë kryesisht hapësira kullimore. Këto pyje kanë një shpërndarje hapësinore tradicionalisht të njohur. Kështu në NjAV të Drenovës janë pyjet e faqes malore të Moravës të cilët vijnë deri në pyjet e Dardhës. Në këto hapësira dallojmë pyje të pishës, ahut, dushkut, dhe pishës së butë. Në Dardhë dallojmë pyje të pishës dhe Ahut.. Në NjAV të Vithkuqit, përfshihen pyje të shfrytëzuar dhe të degraduar në fshatin Stratobërdë dhe




Rehovë, e po kështu në lartësitë e malësisë së Vithkuqit ku ka përbërje të ahut dhe pishës. Në NjAV të Voskopojës ka pyje të pishës dhe ahut të dëmtuar e shfrytëzuar pa kriter. NjAV të Vithkuqit, Voskopojës dhe Lekasi t ka Florë e Faunë të pasur sidomos me kafshë të egra si Ariu, Ujku, Dhelpra, Dreri, Lepuri i Egër, dhe pyjet me Ah, Dushk dhe Pishë. Çaji i Malit dhe bimë të ndryshme mjeksore të cilat gjenden me shumicë në të gjithë zonën e Vithkuqit.

Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit

Tabela Masat përparësore për mbrojtjen e Biodiversitetit		
Masat	Përshkrimi	Masat kryesore përparësore publike
1	Zbërthim i kuadrit ligjor, në menaxhimin e Biodiversitetit. Përgjithësim, por dhe veçori të relievit dhe biodiversitetit në NjAV	Përmirësime afat-shkurtra të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës; zbatim i Ligjit të Biodiversitetit duke përfshirë trajnimin e e specilaistëve të NjAV
2	Njohje dhe menaxhim shkencor i zonave të Mbrojtura	Morava ( NjAV e Drenovës ), Menaxhimi i GJEOMONUMNTEVE të mbrojtura ( Voskopojë dhe Vithkuq )
3	Zhvillimi i Planeve të të zgjerimit të zonave të Mbrojtura në Voskopojë dhe Vithkuq.	Është menduar që të gjitha vendet të cilat janë përcaktuar para fundit të vitit 2012 do të kenë plane të menaxhimit të plotë deri në fund të 2015.
4	Rritja e Menaxhimit të Specieve të Mbrojtura, në malin e Moravës dhe ujëmbledhjen e Çemicës.	Ndërmarrja e fushatës për të zvogëluar numrin e armëve të zjarrit pa leje
5	Zbatim i Planeve të Menaxhimit të Zonës së Mbrojtur dhe Specieve në fushëgropën e Korçës.	Sigurimi i objektivave për menaxhimin e zonës së mbrojtur janë përfshirë si kritere kyç në udhëzuesin shëndetësor të MM.
6	Monitorimi i Biodiversitetit dhe Menaxhimi i Informacionit në krijim të një GIS për Biodiversitetin.	Bashkëpunim i Administratës së Bashkisë dhe NjAV për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Agjencisë së Pyjeve dhe Mjedisit.
7		

Njësia e Mbrojtjes Natyrore vepron si një qendër ekspertize për biodiversitetin, e cila do të sigurojë mbështetje dhe këshillim si për Ministrinë ashtu edhe për autoritetet lokale. Detyra tjetër kryesore e saj është hartimi i fazës së parë të të dhënave GIS si dhe sistemi i menaxhimit të informacionit për biodiversitetin si pjesë e EIMS. Kjo përfshin:

- Krahasimin, vlerësimin cilësor dhe futjen e të dhënave për të kompletuar fazën e parë të procesit të sistemimit të informacionit për biodiversitetin.
- Sigurimi i aksesit në sistemit të informacionit për biodiversitetin për të mbështetur integrimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit- Prezantime nëpërmjet internetit dhe CD -së në dy nivele (publike dhe administrative).



**Fig. – 1 Harta e habitateve kryesore të rajonit të Korçës ( Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)**  
**FAUNA**

Amfibët dhe Reptilët Herpetofauna e zones gjezon një pasuri llojore të rëndësishme mesatare.

**Tab. – 2 Amfibët e pranishëm në zonë ( Burimi: Agjensia Kombëtare e mjedisit)**

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	Bombina variegata	LRnt
2	Bufo bufo	LRt
3	Bufo viridis	LRnt
4	Rana balcanica	VU
5	Rana dalmatina	LRlc
6	Rana graeca	LRnt
7	Triturus vulgaris	LRlc

VU – te Perkeqesuar, LRnt – Rrezik i Ulet pothuajse të kercenuara, LRcd - Rrezik i Ulet në varesit të masave mbrojtëse, LRlc – Rrezik i Ulet pak të prekura.

Llojet më të zakonshme të amfibeve përfshijnë *Bombina variegata* dhe *Rana balcanica*. Midis reptileve vlen të përmendet prania e *Natrix natrix*, *Elaphe quatrolineata*, *Malpolon monspensulanum*, *Testudo hermanni* etj. Të gjithë amfibët e pranishëm në zonë vlerësohen si të kërcënuar në kontekstin kombëtar. Vetëm *Rana balcanica* i përket kategorisë Vulnerabel. Statusi i llojeve të tjera i takon kategorisë Rrezik i Ulet. Pothuajse të gjithë reptilet e rajonit futen në listen e kuqe të vendit. Pjesa më e madhe i takon kategorisë Rrezik i Ulet, dy lloje (*Elaphe quatrolineata*, *Elaphe situla*) cilesohen si te Perkeqesuar (Vulnerabel).

**Reptilet e pranishëm në zonën e projektit ( Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)**

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	<i>Anguis fragilis</i>	NE
2	<i>Coluber caspius</i>	
3	<i>Coluber gemonensis</i>	LRnt
4	<i>Coluber jugularis</i>	LRlc
5	<i>Coronella austriaca</i>	LRnt
6	<i>Elaphe longissima</i>	LRnt
7	<i>Elaphe quatrolineata</i>	VU
8	<i>Elaphe situla</i>	VU
9	<i>Emys orbicularis</i>	LRnt
10	<i>Lacerta viridis</i>	LRlc
11	<i>Malpolon</i>	NE
12	<i>Natrix natrix</i>	LRlc
13	<i>Natrix tessellata</i>	LRnt
14	<i>Podarcis muralis</i>	NE
15	<i>Testudo hermanni</i>	LRnt
16	<i>Vipera ammodytes</i>	LRlc

CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura.

**Shpendët**

Në zonë janë të pranishëm rreth 39 lloje shpendësh, të cilët jepen në tabelën e mëposhtme së bashku me statusin kombëtar të ruajtjes.

**Shpendët e pranishëm në zonë ( Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)**

Nr.	Emertimi latin	Stat. Kom
-----	----------------	-----------

1	<i>Ixobrychus minutus</i>	
2	<i>Nycticorax nycticorax</i>	VU
3	<i>Ardeola ralloides</i>	VU
4	<i>Egretta garzetta</i>	VU
5	<i>Ardea cinerea</i>	VU
6	<i>Ciconia ciconia</i>	CR
7	<i>Anas penelope</i>	
8	<i>Anas creça</i>	
9	<i>Anas platyrhynchos</i>	
10	<i>Pernis apivorus</i>	EN
11	<i>Circaetus gallicus</i>	
12	<i>Circus aeruginosus</i>	
13	<i>Circus cyaneus</i>	
14	<i>Circus pygargus</i>	
15	<i>Açipiter nisus</i>	EN
16	<i>Buteo buteo</i>	VU
17	<i>Falco naumanni</i>	VU
18	<i>Falco tinnunculus</i>	VU
19	<i>Falco columbarius</i>	VU
20	<i>Falco peregrinus</i>	VU
21	<i>Perdix perdix</i>	
22	<i>Coturnix coturnix</i>	
23	<i>Phasianus colchicus</i>	CR
24	<i>Rallus aquaticus</i>	

<b>Nr.</b>	<b>Emertimi latin</b>	<b>Stat. Kom</b>
25	<i>Tyto alba</i>	VU
26	<i>Strix aluco</i>	LRnt
27	<i>Asio otus</i>	LRnt
28	<i>Asio flammeus</i>	
29	<i>Upupa epops</i>	VU
30	<i>Jynx torquilla</i>	LRnt
31	<i>Picus viridis</i>	LRlc
32	<i>Dendrocopos major</i>	
33	<i>Dendrocopos syriacus</i>	
34	<i>Dendrocopos minor</i>	
35	<i>Acrocephalus scirpaceus</i>	LRnt
36	<i>Acrocephalus arundinaceus</i>	
37	<i>Sitta europaea</i>	LRnt
38	<i>Remiz pendulinus</i>	VU
39	<i>Corvus frugilegus</i>	

*CR- Teper e Rrezikuar, E – E Rrezikuar, VU – Vulnerabel, DD – Mungese te Dhenash, LRnt – Rrezik i Ulet thuajse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit, LRLc –*



*Rrezik i Ulet pak te prekura. NE – Te Pavleresuara*

Ne baze te tabelës vërejmë se prej 39 llojeve të shpendeve të pranishëm në zonë 22 prej tyre janë të rrezikuara në shkallë kombëtare. Prej këtyre 17 llojeve i përketin kategorive të larta të rrezikimit (CR, EN, VU).

**Gjitarët.**

Në zonë numërohen rreth 20 gjitarë nga të cilët 6 janë të rrezikuara në shkallë kombëtare. Prej këtyre 3 llojeve bien në kategoritë e larta të rrezikimit (CR, EN, VU). Nga mishngrënësit takohen dhelpra (*Vulpes vulpes*), baldosa (*Meles meles*), dhe nuselalja (*Mustela nivalis*). Pyjet dhe mjediset ujore të zonës janë zona me rëndësi të vecantë për lakuriqet e natës (lloje të gjinive *Rhinolophus*, *Myotis*, dhe *Pipistrellus*) të cilët i vizitojnë ato për ushqim dhe pirje uji. Gjitarët e pranishëm në zonë së bashku me statusin e tyre kombëtar të ruajtjes janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

**Tab. Llojet e gjitarëve ( Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)**

Speciet	Emri shqip	Statusi kombëtar i ruajtjes
Erinaceus concolor	Iriqi	
Talpa sp.	Urithi	
Crocidura sp.	Hundegjati	
Rhinolophus ferrum-equinum	Lakuriqnate hundpatkua i madh	LRcd
Rhinolophus blasii	Lakuriqnate hundpatkua i Blasius-it	LRnt
Rhinolophus euryale	Lakuriqnate hundpatkua i Mesdheut	VU
Myotis myotis	Lakuriqnate veshmiu i madh	
Myotis blythi	Lakuriqnate veshmiu i vogël	
Pipistrellus pipistrellus	Pipistreli i zakonshëm	
Pipistrellus savii	Pipistreli i Savi-it	
Pipistrellus kuhli	Pipistreli i Kuhl-it	
Lepus capensis	Lepuri	
Microtus epiroticus	Miu i Ondrias-it	

Microtus thomasi	Miu i Thomasit	LRnt
Apodemus sylvaticus	Miu i pyllit	
Mus spicilegus	Miu i maqedonise	
Vulpes vulpes	Dhelpra	
Lutra lutra	Lutra, lunderza	VU
Meles meles	Baldosa	EN
Mustela nivalis	Nuse lalja	

### Fauna në habitatet tokësore.

Tokat kullosore, arat dhe arat e braktisura që të shndërruara në toka barishtore në afërsi të vendbanimeve dhe fshatrave, sigurojnë mbajtje të një numri të lartë specimesh zogjsh, më së shumti zogjve të vegjël (Rendi: *Passeriformes*/*Harabelorët*). Në dimër, fushat e hapura përdoren nga tufa trishtilash shoqëruar nga harabela të tjerë të vegjël. Në verë, fushat e hapura sigurojnë terrene shumëzimi për Shkurtën - *Coturnix coturnix*. Gardhet dhe pemët e ndryshme frutore në vendet e hapura vizitohen nga Gushëkuqi - *Erithacus rubecula*, Cerla e zakonshme - *Miliaria calandra*, Harabeli - *Passer domesticus*, Cerri - *Troglodytes troglodytes*, lauresha (*Alaudidae*) dhe shumë lloje trishtilash.

Zonat shkurre sigurojnë një habitat të rëndësishëm dimërimi për shumë lloje zogjsh, të cilët shumëzohen në lartësi më të larta dhe lëvizin poshtë në zonat shkurre për t'iu larguar motit të keq. Zogjtë tipikë janë Bilbilthi kokëzi - *Sylviaatricapilla*, Bilbili kokëzi gushëbardhë - *Sylvia melanocephala*, Cerla - *Emberiza spp*, Bilbili i kënetave - *Cettia cetti*, etj. Gjatë stinëve të pranverë-verës, shkurret mbajnë një gamë të gjerë specimesh zogjsh, si Bilbilthi gushëkuq - *Sylvia cantillans*, Përqeshësi i vogël i ullinjve - *Hippolais pallida*, etj. Gjatë migrimit, shkurret përdoren edhe si zona ku mund të ndalojnë edhe lloje si Pupëza - *Upupa epops*, Gargulli - *Merops apiaster*, Qafëdredhësi - *Jynx torquilla*, Mëllenja - *Turdus merula*, etj. Avifauna në pyjet tranzite (bimësia drunore ndërmjet shkurreve dhe pyjeve të larta) dominohet nga zogj të vegjël (Rendi *Passeriformes*). Më karakteristiket janë Bilbili (*Sylvia spp*), Gushëkuqi (*Erithacus rubecula*), Cerri (*Troglodytes troglodytes*), Pupëza (*Upupa epops*), Cerla (*Emberiza spp*), Mbretëthi dhe Mbretëthi vetullbardhë (*Regulus regulus* and *R. ignicapillus*), Gardalina (*Carduelis carduelis*), Mëllenja (*Turdus merula*) dhe Grifsha (*Garrulus glandarius*).

Brezat gjethegjere të përziera bartin një numër llojesh zogjsh karakteristik si qukapikët (fam. *Picidae*), Qukapiku i gjelbër - *Picus viridis*, Qukapiku i zakonshëm larosh - *Dendrocopos syriacus*, Qukapiku i vogël larosh - *Dendrocopos minor*, etc.), trishtilët (Trishtili i madh - *Parus major*, Trishtili i kaltër - *Parus caeruleus*, Trishtili i madh i murrmë - *Parus lugubris*), mëllenjat dhe përsëri grifshat. Lloji i gjitarit më të zakonshëm në zonën e Peizazhit të Mbrojtur është vidra (*Lutra lutra* (VU)), e cila është një tregues i mirë biologjik i gjendjes së ekositemit. Gjithashtu takohen edhe gjitarët e mëdhenj si ariu - (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), kaprolli (*Capreolus capreolus*) dhe derri i egër (*Sus scrofa*).

Lakuriqët e natës përfaqësohen kryesisht nga *Myotis nattereri*, *Nyctalus leisleri*, *Rhinolophus ferruequinum*, *R. blasii*. Gjitarë të tjerë dhe më shumë të përhapur në zonën e mbrojtur janë shqarthe (*Martes foina*), vjedulla (*Meles meles*), nuse-lala (*Mustela nivalis*), dhelpra e kuqe (*Vulpes vulpes*), ketri i kuq (*Sciurus vulgaris*), lepuri (*Lepus europeus*), iriqi (*Erinacues concolor*), gjeri (*Glis glis*), gjumashi i lathjise (*Muscardinus avellanarius*), minjtë e drurit/arave (*Apodemus flavicollis*, *A. sylvaticus*, *A. mystacinus*), hundegjates (*Crocidura sp*), urithi (*Talpa stankovici*) dhe miu i fushës (*Microtus sp*).

Amfibët dhe zvarranikët janë të zakonshem në zonën e mbrojtur. Gjatë ciklit të tyre të jetës ata janë të lidhur me habitate të ndryshme, sidomos me habitatet ujore për riprodhim dhe funksione të tjera.

Në Bashkinë e Korçës ka disa specie amfibësh të cilat janë në rrezik të zhduken dhe lloje me rrezik më të ulët.

Amfibët e pranishëm në zonë ( Burimi: Agjensia Kombëtare e Mjedisit)

Nr.	Llojet	Stat. Komb.
1	Bombina variegata	LRnt
2	Bufo bufo	LRt
3	Bufo viridis	LRnt
4	Rana balcanica	VU
5	Rana dalmatina	LRlc
6	Rana graeca	LRnt
7	Triturus vulgaris	LRlc

VU – te Perkeqesuar, LRnt – Rrezik i Ulet pothuajse te kercenuara, LRcd - Rrezik i Ulet ne varesit te masave mbrojtese, LRlc – Rrezik i Ulet pak te prekura.

Ndër shpendët në zonë janë disa lloje që cilësohen në gjendje të kujdesit për moszhukje të tyre.

Të tilla janë CR- Teper e Rrezikuar, (*Phasianus colchicus*)

– Rrezik i Ulet thujse te kercenuar, LRcd – Rrezik i Ulet ne varesi te konservimit (*Jynx torquilla*) LRlc –


Rrezik i Ulet pak te prekura (*Phasianus colchicus*)

NE (*Pernis apivorus*) – Te Pavleresuar

## PEJSAZHI DHE ZONAT E MBROJTURA

Bashkia e Korçës në sajë të relievit të saj aq të larmishëm ka pejsazhe me një bukuri të rrallë natyrore. Të tilla janë: Kreshti i malit Ostrovicës, Kreshti i Moravës, Livadhet e Voskopojës,

Iugina e Çemicë, kanionet e Voskopojës, Livadhet e Ostrovicës, Lëndinat e Voskopojës, pyjet e Dardhës, Ujëmbledhësi i Gjançit, Mali i Rungajës.



**Bredhi i Drenovës** është Park Kombëtar. Kjo zonë është shpallur e mbrojtur me VKM nr.96, datë 21.11.1966 dhe ka një sipërfaqe prej 1378 ha. Ndërkaq ka edhe monumente të tjerë të bimësisë si : Pisha e Shëndëllisë që ndodhet në lartësinë 1200 – 1300 m mbi nivelin e detit, në afërsi të fshatit Mborje, ka një sipërfaqe pyjore prej 10 ha me drurë pisha të zezë; Rrapet e qytetit (Shënmëria) të cilët gjenden në qytetin e Korçës, 850 m mbi nivelin e detit; Pishat e Voskopojës, ndodhen në afërsi të fshatit homonim, 1250 – 1300 m mbi nivelin e detit, e përfaqësuar me një pyll pisha të zezë (*Pinus nigra*), me formë drejtkëndëshe dhe sipërfaqe prej 20 ha., *Bleri i Shën Pjetrit* i cili gjendet në Vithkuq,; Pisha e Makrezës që gjendet në afërsi të fshatit Vithkuq. Janë të njohura si monumente natyrore : *Varreza e fosileve* në Voskopojë , *varrezë fosilesh* në Lumalas ( Teqeja e Melçanit) , *Guri i Capit* në malin e Moravës, *Tre gurët, tre kokonat*, po ashtu në Moravë. Të gjitha sa përshkruam më sipër përbëjnë një potencial real dhe atraktiv në fuhsë të turizmit malor.



## 4.2 Territori dhe nëntoka

### NDËRTIMI GJEOLOGJIK

Në ndërtimin gjeologjik të Bashkisë ë Korçës, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, sedimentarë, magmatikë dhe metamorfikë. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologjiko-tektonike e facialo-strukturale, zona tektonike e Mirditës, Krasta-Cukalit dhe ajo e Krujës. Në ndërtimin gjeologjik, veçohen një shumëllojshmëri e madhe shkëmbinjsh, me mosha të ndryshme formimi, duke filluar nga ato më të vjetër Silurian-Devonian, e deri në depozitimet e formimet Kuaternare të sotme.

Kjo analizë ka për qëllim t'i sigurojë qeverisjes lokale e qendrore informacionin bazë gjeologjik, të pasurive minerale, të pasurive ujore, të rreziqeve gjeologjike, të aspekteve gjeomjedisore dhe të gjeomonumenteve, i cili do të ndihmojë për ndërtimin e politikave me të qarta në drejtim të administrimit të territorit, të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologjiko-tektonike e facialo-strukturale, zona tektonike e Mirditës, Krasta-Cukalit dhe ajo e Krujës, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë.

### SHTRESAT DHE PËRBËRJA E TYRE


Në ndërtimin gjeologjik të Bashkisë së Korçës, marrin pjesë të tre llojet shkëmbore, si sedimentarë, magmatikë ashtu dhe metamorfikë, të formuara në kohë e hapësira të ndryshme, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë.

#### Depozitimet Kuaternare (Q)

**Depozitimet e Pliocen-Pleistocenit të poshtëm** - Në hartën gjeologjike, dallohen nga ngjyra e verdhë në bezhë. Janë formime tipike liqenore. Nga anarfolgjike, këto depozitime përfaqësojnë zona kodrinore. Trashësia e këtyre depozitimeve arrin 40-50m.

*Depozitime aluviale të Pleistocenit (Qp)* - Depozitimet aluviale përfaqësohen kryesisht nga tërecat akumulative dhe erozionale-akumulative. *Depozitime proluviale-aluviale-të Pleistocenit (Qp)* - Depozitimet aluviale-proluviale janë të lidhura me ekzistencën dhe veprimtarinë e rrjeteve hidrografike të shkurtër dhe me prurje të përkohëshme.

*Depozitime aluviale-proluviale liqenore të Pleistocenit (Qp)* - Këto depozitime janë formuar në liqenë të brendshme, të cilët përshkoheshin nga lumenjtë, si dhe derdheshin përrrenjt, duke formuar kështu formacionë liqenore të ndërthurura me ato aluviale dhe proluviale. Trashësia e këtyre depozitimeve, sipas të dhënave gjeofizike dhe shpimeve hidrogeologjike është në Korçë rreth 100 m.



**Fig. - 3 Harta Gjeologjike e Bashkisë së Korçës, shk. 1:200,000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

*Depozitimet e fundit të shpateve (deluvione-koluvione) të Pleistocen-Holocenit (Qp-h)*- Këto lloj depozitimesh takohen në fundin e shpateve (koluvionet) të Pleistocenit, takohen gjerësisht, përgjatë vargmaleve gëlqerorë, dhe në fundin e shpateve malore ofiolitike..

*Depozitime proluviale të Pleistocen-Holocenit (Qp-h)*. Këto lloj depozitimesh lidhen me periudhat ndërakullnajore, me natyrën e përrenjëve të rrëmbyeshëm dhe të përkohshëm, të cilët kanë formuar konë të fuqishme të përbërë nga konglomeratë dhe zhavorë të pa diferencuar.

*Depozitimet akullnajore të Pleistocen-Holocenit (Qp-h)* - Këto depozitimeve akullnajore përfaqësohen nga morena fundore e ballore, të përbërë nga materiali i trashë copëzor, me shkallë të keqe përpunimi, rallë mesatare, të përzierë me material të imët ranoro-argjilor.

*Depozitimet e aluviale të Holocenit (Qh)*- Këto depozitime lidhen me formimet dhe depozitimet e tërëcave të ish shtratit të lumenjve, si dhe depozitimeve të sotme të shtratit të lumenjve

*Depozitimet eluviale, deluviale dhe koluviale të Holocenit (Qh)*- Formimet koluviale, eluviale dhe deluviale, në mjaft raste i përkasin një diapazoni më të gjërë (së paku nga Pleistoceni i vonshëm deri më sot).

*Depozitimet aluviale-kënetore të Holocenit (Qh)*- Këto depozitime takohen kryesisht, në zonat fushore,

*Depozitimet kënetore dhe liqenore-kënetore të Holocenit (Qh)*- Këto depozitime janë tipike në fushëgropën e Korçës. Karakteristike e këtyre formacioneve është, prania në to e torfave.


*Shkëmbinjtë magmatikë* - Në formacionin vullkanogjen mbizotërojnë bazaltet në formën e llavave jastëkore, rrymave llavore e më rrallë shkëmbinj piroklastikë.

*Shkëmbinjtë metamorfikë ( $\mu J$ )* - Në këta shkëmbinj futen shkëmbinjtë metamorfikë subofiolitik dhe serpentinitet, si sequenca shkëmbinjsh sedimentarë të dinamometamorfizuar. Shtroja metamorfike subofiolitike takohet në pjesët periferike të brezit ofiolitik, në formën e një brezi të ngushtë, në zonën e kontaktit në buzën kontinentale


## ZONAT GJEOLIGO-TEKTONIKE

Bashkia e Korçës ndodhet në skajin JL të Shqipërisë (Albanideve). Albanidet i përkasin sistemit të rrudhosur alpin-mesdhetar. Në kuadrin krahinor marrin pjesë, tre zona të ndryshme gjeologo-tektonike e facialo- strukturale, të cilat janë pjesë përbërëse e gjeologjisë së Shqipërisë. Ato janë: 1-zona e Mirditës, 2-zona e Krasta-Cukalit dhe 3-zona e Krujës (Grup autoresh 1999; Aliaj 1987; Tagari etj. 1993).

Lëvizjet neotektonike aktuale sot, kanë diferencuar relievin e sotëm. Prania e lëvizjeve neotektonike vihet re në ekzistencën e formimit të tarracave lumore të lumenjve, që takohen në këtë territor, në fund të grykave depërtuese të lumenjve.



*Skicë tektonike e Qarkut Korçë, në shkallën 1:500 000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*



**Fig. – 5 Hartë e njësisve tektono-strukturee rajonit Korçë-Pogradec e më gjerë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

**KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE**

Në gjeohapesiren e bashkisë Korçë, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuaternar. Ato shpesh nuk përfaqësojnë domosdoshmerisht përbërjen litologjike të bazamenteve shkëmbore. Për këtë arsye, për qëllime gjeologjiko-inxhinierike, në kemi bërë një rivlerësim dhe rigrupim të kufijve moshore litostratigrafike, kriteri vlerësues i së cilit ka qënë evidentimi i përbërjeve litologjike me veti të përafërta gjeoteknike dhe sjellje





Gjeohapësira e Bashkisë së Korçës, fillon që nga male të larta, veri, në lindje, perëndim, jug.. Brenda këtij territori gjenden zona fushore të sheshta, ose gati të sheshta, pllaja, shpate kodrash të buta deri mesatare, shpate malore të pjerreta deri të thikëta, shpate të luginave lumore të formave të ndryshme, deri në kanione, si dhe liqenet artificiale si ai i Gjançit etj. Për lehtësi vlerësimi të gjithë territorin e bashkisë e kemi ndarë në 3 njësi kryesore morfologjike: 1-*Njësia morfologjike fushore* 2-*Njësia morfologjike kodrinore* 3-*Njësia morfologjike malore*.

**Nënnjësia fushore** ka përhapje në fushëgropën e Korçës, janë fusha të sheshta me kuota nga 813,0 m mbi nivelin e detit deri në 950 m.n.d në pjesët jugore. Energjia e relievit merr vlera të vogla nga 0.0 m/km<sup>2</sup> arrin deri në 50m/km<sup>2</sup> në rrethina. Këto vlera dëshmojnë për një proces akumulimi në këtë fushëgropë. Aktualisht janë zona me përparësi të zhvillimit bujqësor, agrokultural, blektoral. Hidrografia është e pasur me ujra nëntokësore dhe të tipit artezian.

**Njësia morfologjike kodrinore** zhvillohet në rrethinat e fushëgropave dhe rrethina të territorit të bashkisë. Menjëherë sapo përfundon njësia fushore (fushëgropave) shfaqen format e kodrave të cilat kanë kuota nga 900 m.n.d. deri në1200 m.n.d. Në vartësi të strukturave gjeologjike, ku ato gjenden, shfaqen edhe forma relievi tipike, si p.sh. relievet kodrinore të strukturave monoklinale dhe relievet kodrinore të strukturave të rrudhosura

Është pikerisht kjo njësi morfologjike e prekur së tepërmi nga erozioni dhe fenome shpati të tipit rrëshqitjessë dherave dhe të shkëmbinjve

**Njësia morfologjike malore** ze pjesën verilindore, lindore, juglindore, jugperendimore, të territorit të bashkisë. Ajo fillon me shpatet malore të Malit të Thatë vargmalit të Moravës, malit të Ostrovicës, malit të Zi, Rungajës, malit të Omit etj. Kuotat e kësaj njësie variojnë nga 1000 deri në 2000 m.n.d., ecila gjendet në malin e Kuq dhe që përfaqëson kuotën më të lartë të bashkisë Korçës. Format morfologjike të kësaj njësie varen shumë nga përbërja litologjike e shkëmbinjve rrënjësore dhe në përgjithësi janë të dy llojeve: forma morfologjike të përcaktuara nga shkëputjet tektonike dhe format morfologjike karstike. Format karstike të relievit shfaqen, në fushëpërhapjen e shkëmbinjve gëlqerore në Lavdar-Voskopojë, Makerz-Rugaje. Në këto shpate shfaqen më së shumti fenomeni i rrëzimeve, por edhe ai i rrëshqitjeve shkëmbore. Shpatet përshkohen nga përrenj e perroska, të cilat në përgjithësi kanë karakter sezonal, drejtimi i lëvizjes së ujrave në to është kryq shtrirjes së shpateve.

Në përgjithësi kjo njësi morfologjike është e pyllëzuar dhe pjesa më e madhe e saj edhe zonë e mbrojtur në të cilën nuk lejohen ndërtimet.

Në gjeohapësirën e bashkisë Korçës, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuaternar. Për këtë arsye, për qëllime gjeologjiko-inxhinierike, në kemi bërë një rivlerësim dhe rigrupim të kufijve moshore litostratigrafike, kriteri vlerësues i së cilit ka qënë evidentimi i përbërjeve litologjike me veti të përafërta gjeoteknike.





Fig. – 1 Harta gjeologjiko-inxhinierike Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

## ZONIMI I TERRITORIT MBI BAZËN E KUSHTEVE GJEOLGJIKO-INXHINIERIKE



Për kryerjen e zonimit të territorit të bashkisë Korçë, është patur parasysh që në përputhje me shkallën e hartës, të jepen të dhëna të trojeve të ndryshme dhe përshtatshmërisë së tyre ndaj ndërtimeve që kryhen mbi to, nëpërmjet vetive të tyre gjeoteknike, si dhe të dhëna për ekspozimin e këtyre trojeve ndaj elementeve të rrezikut gjeologjik. Pra bëhet një kombinim i të dhënave që disponohen për territorin, duke e ndarë atë në zona, nënzona dhe sektore, të cilët në vetvete kanë kushte të përafërta gjeologo-inxhinierike dhe që janë të ekspozuar ndaj rrezikut gjeologjik në shkallë të caktuar. Për ndërtimin e hartës së zonimit të territorit për përshtatshmërinë ndërtuese që kanë trojet në të, janë marrë në konsideratë 3 kritere (Konomi, N. (2015): - Kriteri litologo-gjeologo-inxhinieri-Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik

- Kriteri morfologjik



*Fig. – 2 Harta e zonimit për përshtatshmërinë ndërtuese të trojeve, Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

**Kriteri litologo-gjeologo- inxhinierik** ka qenë kriter bazë mbi të cilin është ndarë territori në zona që karakterizohen nga një farë shkalle homogjeniteti i kushteve ndërtuese të trojeve që gjenden në to. Duke u bazuar në këtë kriter, territori ndahet në 5 zona:

1. Zona e përhapjes së shkëmbinjve të fortë, në hartë paraqitet me vija horizontale.



2. Zona e përhapjes së shkëmbinjve mesatare, në hartë paraqitet me vija vertikale.
3. Zona e përhapjes së shkëmbinjve të dobët, në hartë paraqitet me kombinim të vijave horizontale dhe atyre vertikale.
4. Zona e përhapjes së dherave pa kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta majtas.
5. Zona e përhapjes së dherave me kohezion, në hartë paraqitet me vija të pjerrëta djathtas.  
Kriteri i ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik mund të jetë i lidhur me kriterin morfologjik, dhe lidhja e tyre është organike dhe e pandashme, ose mund të mos jetë i lidhur me të.

## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME


Në gjeohapësirën e bashkisë Korçë, gjejnë përhapje shkëmbinj dhe dhera me litologji të ndryshme, të moshave nga Triasiku e deri në Kuarternar. Përbërësit litologjike të trojeve janë klasifikuar në shkëmbinj dhe në dhera. Shkëmbinjtë janë klasifikuar si të fortë. Dherat janë klasifikuar me kohezion dhe pa kohezion. Elementët e rrezikut gjeologjik janë të hedhura në hartë në sipërfaqet ku ato shtrihen, dhe në tekst përshkruhen të grupuara.

Zonimi i gjeohapësirës për përshtatshmerinë ndërtimore merr në konsideratë 3 kritere kryesore: a) kriteri litologo- gjeologo- inxhinierik; b) kriterin e ekspozimit ndaj rrezikut gjeologjik dhe c) kriterin morfologjik. Si kriter ndihmës është përdorur edhe ai sizmik.

1. Ky studim shërben për planifikuesit urbane, për të zgjedhur dhe orientuar punimet e ndërtimit në territorin e bashkisë Korçë.
2. Vetitë fiziko-mekanike të përbërësve litologjike, të treguara në këtë tekst, nuk duhet të shfrytëzohen për llogaritje të ndërtimeve të veçanta në çfarëdo pjesë të teritorit të bashkisë Korçë.
3. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin pa zhvillim të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, duhet të jenë të thjeshta dhe të marin në konsideratë vlerësimin e parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës.
4. Studimet gjeologo- inxhinierike që kryhen për ndërtimet në sektorin me zhvillim të vogël të fenomeneve të rrezikut gjeologjik, përveç vlerësimit të parametrave gjeoteknike të shtresave të tokës, duhet të japi të dhëna të plota për fenomenet e rrezikut gjeologjik që mund të kërcënojnë këto ndërtime, si dhe të rekomandojë edhe masat mbrojtëse përkatëse, me qëllim eliminimin apo mosaktivizimin e fenomeneve të rrezikut.
5. Studimet gjeologo-inxhinierike që kryhen në sektorin me zhvillim të madh të fenomeneve të rrezikut gjeologjik duhet të jenë shumë të thelluara, ku të jepen të dhëna për atë çka ka ndodhur dhe të llogaritet mirë efikasiteti i masave mbrojtëse që mund të rekomandohen.
6. Është e domosdoshme që gjeologu inxhinierik duhet të jetë prezent në çdo mbledhje të keshillit të bashkisë, kur shqyrtohen dhe merren vendime të kërkesave për zhvillim urban, të të gjitha niveleve dhe llojeve apo specifikave të ndryshme. Kjo zgjidhet duke i detyruar këshillat e bashkive që të dërgojnë kërkesën për pjesëmarrje të specialisteve gjeologe.

### 4.3 TEKTONIKA


Rajoni në studim preket nga forcat tektonike orogjenike. Shkëputjet tektonike janë shumë aktive, dhe në relief shprehen me kontraste të theksuara. Pasojë e tyre janë dhe lëvizjet e shpeshta sizmike, që trondisin zonën. Epiqendrat e tërmeteve përqëndrohen kryesisht gjatë shkëputjeve ose zonave të shkëputjeve aktive. Kështu, zonat e burimeve sizmike përcaktohen nga dy instrumenta fundamentalë: nga profili i sizmicitetit dhe nga regjimi tektonik i sotëm i rajonit në shqyrtim.




*Harta e zonave sizmogene me potencial sizmik të pritshëm (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Nga konsideratat e regjimit tektonik të sotëm dhe të dhënat e katalogut të tërmeteve (Sulstarova etj., 2005a), sizmiciteti rajonal është ndarë në 9 zona të burimeve sizmike (Sulstarova etj., 2005b), që përfshijnë njëfarë ripërcaktim të 8 zonave të trajtuara për Shqipërinë (Aliaj, 2003) së toku me një zonë që modelon tërmetet në rajonin e Shkupit (Talaganov etj., 2003), si dhe në modelin sizmotektonik të vitit 2004 (Aliaj etj., 2004).

Gjeohapësira e Bashkisë së Korçës përkon me : zonën 4. **Zona Korçë-Ohër (KO) me  $M_{max}=6.9$ ;**



**Fig. – 2 Harta Neo-Tektonike e Shqipërisë**  
*(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*




SIZMIKA  
 Shkalla 1: 130000  
 BASHKIA KORÇE  
 BURIMI: IDRA

*Harta sizmiologjike e rajonit (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

**Karakteristikat sizmotektonike të zonës**

*Harta aktive e shkëputjeve në Shqipëri  
(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

Lidhja e ngushtë midis tërmeteve dhe zonave të shkëputjeve aktive është evidentuar për secilën prej këtyre të fundit, duke përcaktuar edhe potencialin sizmik maksimal të pritshëm, bazuar në të dhënat e deri sotme për sizmicitetin (Aliaj, 1988). Në hartën aktive (shiko figurën) përfaqësohet intensiteti i pritshëm për kushtet e tokës mesatare për 100 vitet e ardhshme, me një normë probabilitet 70%. Në bazë të përpunimit



statistikor për të gjitha të dhënat e tërmeteve të ndodhur ka një qasje sipas së cilës ka gjasa që intensiteti i tërmeteve të të pritshëm të jetë të paktën deri në 8,5-9 ballë ose me magnitudë 6,0-6,5.



*Fig. Harta e shpejttimeve maksimale referencë në truall të fortë (tipi A sipas EN 1998), për periudhë rikthimi 475 vjet (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*




E tillë është edhe harta e paraqitur me poshtë, e përpiluar në vitin 2003 në kuadër të projektit “Vlerësimi i Rrezikut në Shqipëri” – PNUD. Sipas kësaj hartë, shpejtimi maksimal referencë në truall të fortë për periudhë rikthimi 475 vjet për zonën Shirokë është 0.275g. Bashkia e Korçës sipas hartës së mësipërme i takon ngjyrimin të kafejtë të fortë për: “Projektimin e strukturave për rezistencë ndaj tërmetit”)

Përveç hartave të shpejtimit referencë në truall shkëmbor, studimet paraqesin të dhëna mbi rrezikun sizmik, të shprehur në terma të shpejtimit maksimale (PGA) si dhe si vlera spektrale për periode 0.1, 0.5, 1.0 dhe 2.0 sekonda (shih hartën)

#### AKTIVITETI SIZMIK

Të dhënat historike për aktivitetin sizmik, janë relativisht të mangëta. Qarku i Korçës është prekur nga tërmete historike me intensitet deri në 8 ballë (MSK-64) dhe gjatë shekullit të kaluar, nga tërmete me magnitudë 5.3 deri 5.6.




**Fig. – 6 Harta e shpejtiveve maksimale referencë në truall shkëmbor, për periudhë përsëritje 475 vjet, sipas botimit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

Sipas kesaj harte, shpejtimi maksimal reference ne truall te forte per periudhe rikthimi 475 vjet per Qarkun Korçe eshte 0.25g.

**Fig. - 7 Harta e shpejtiveve maksimale referencë në truall shkëmbor, për periudhë përsëritje 475 vjet, sipas botimit “Sizmiciteti, sizmotektonika dhe vlerësimi i rrezikut sizmik në Shqipëri” – 2010 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

Nisur nga aktiviteti sizmik historik, ndërtimi gjeologjik si dhe nga studimet e lartpërmendura, mund të thuhet se rajoni ndodhet në një zonë aktive nga pikëpamja sizmike.







Fig. - 8 Harta e intensiteteve sizmike sipas MSK 1964( Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




Fig. - 9 Spektrat e shpejttimeve ( Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



## Risku sizmik për rajonin



Referuar rrezikut sizmik (që është i konsiderueshëm), vulnerabilitetit të veprave të ndërtimit ekzistuese (që është relativisht i ulët) si dhe shkallës së ekspozimit të këtyre veprave ndaj rreziqeve sizmike (që është e ulët, nisur nga dendësia e popullsisë së komunës), mund të thuhet paraprakisht se risku sizmik nuk është i lartë. Megjithatë, shkalla e ekspozimit të strukturave ndaj rreziqeve sizmike ka ardhur duke u rritur, sidomos pas viteve '90 me rritjen e intensitetit të ndërtimeve në zona të.

**Fig. Harta e Intesiteteve maksimale të vrojtura për periudhën 1800-2005**

(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)




**Risku sizmik për Qarkun Korçë, (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**



#### 4.4 Burimet Ujore

Në qarkun e Korçës kanë përhapjen akuiferë të llojeve të ndryshme. Sipërfaqen më të madhe në shkallë qarku e zënë, jo akuiferët në masën 31% të gjithë sipërfaqes së tij. Akuiferët karbonatik karstik zënë rreth 19% të gjithë sipërfaqes së tij. Ato ndërtojnë pjesët më të larta malore si mali i Thatë, Rakickës, etj. Akuiferët karbonatikë karstikë përmbajnë burime ujore nëntokësore të mëdha. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, kanë përhapje më të kufizuar dhe shtrihen në zonat fushore, si fushë-gropa e Korçës me një lartësi mesatare 820-850m mbi nivel të detit. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri mesatare përhapen në rreth 9.4% të territorit të qarkut. Edhe këto akuiferë përmbajnë burime ujore nëntokësore të rëndësishme. Në figurën e mëposhtme jepen sipërfaqet e tipeve të ndryshme akuiferë në qarkun të Korçës.

**Fig. 1 - Sipërfaqet e akuiferëve sipas llojeve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**



1. Akuiferë me porozitet ndërkokrrizor e ujëmbajtje mesatare (13%),
2. akuifer me porozitet poro/çarje dhe ujëmbajtje mesatare deri të ulët (25%),
3. akuifer me porozitet çarje me ujëmbajtje mesatare deri të ulët (12%)
4. akuifer me porozitet çarje-karst me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme-shumë e lartë-e ulët (19%) dhe
5. joakuifer me porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësorë në sasi të shfrytëzueshme (31%).




Fig. 2 – Hartë hidrogeologjike e rajonit Korçë (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)


## AKUIFERËT ME POROZITET NDËRKOKRRIZOR

Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor (të shkriфтë) me ujëpërcjellshmëri mesatare deri të ulët, lidhen me depozitimet kuaternare aluviale, liqenore të formuara nga depozitimet e lumenjve si Devolli dhe Dunaveci, depozitime të cilat ushqehen si nga lumenjtë e sipërpërmendur, ashtu edhe nga akuiferët karstik dhe me çarje. Ata janë njëstresorë dhe me ujëpërcjellshmëri të ulët si në Pogradec. Vetëm në fushën e Devollit janë me nivel të lirë, kurse i gjithë akuiferi i Korçës është me presion me vetëderdhje. Ky akuiferë është i pasur me burime ujore nëntokësore, dhe shërben për furnizim me ujë të pijshëm të Bashkive Korçë, Maliq dhe të shumë komunave. Ujërat nëntokësore shfrytëzohen me anë të shpimeve, prurjet e të cilave variojnë nga 1 në 12-45 l/s. Vetitë fiziko-kimike të tyre në përgjithësi janë të mira, ato janë të ëmbla e me fortësi mesatare. Shtimi i rezervave të shfrytëzueshme mund të bëhet, mbështetur në menaxhimin e integruar të tyre në zonën Turan- Bulgarecit.

### Akuiferi i Korçës


Akuiferi i Korçës bën pjesë në gropat e brendshme të Shqipërisë dhe quhet ndryshe fusha e Korçës dhe Devollit, dhe është klasifikuar me ujëmbajtje mesatare. Ai përbëhet nga depozitimet aluviale të lumit Devoll dhe Dunavec, ku lumi Devoll ka një gjatësi të përgjithshme (196 km)





**Fig. 3 - Profili gjatësor i akuiferit me porozitet ndërkorrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare i Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

dhe prurje mesatare shumëvjeçare në derdhje në lumin Seman rreth  $49.5\text{m}^3/\text{s}$ . Trashësia e aluvioneve e përqendruar në 4-8 nënakuiferë shkon nga 5-20m sipas të dhënave të shpimeve (Gelaj, A, Mamaj, A etj, 2003). Ujërat që lidhen me këtë akuifer, janë ato që kanë përhapje pothuajse në të gjithë ultësirën e Korçës. Ky akuifer përbëhet nga disa nën akuiferë.



**Fig. 4 – Hartë hidrogeologjike e rajonit Korçë në shk. 1:200,000 (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**

Ujrat nëntokësor përqëndrohen në 4 - 8 horizonte zhavorore-zhuresh (me përzierje të vogël rëre) në jug deri në qendër të strukturës dhe rërash (me përzierje zhuri) në sektorin verior dhe veriperëndimor. Kolektor i këtyre ujërave është vetë ultësira e Korçës. Rreth 80 % e shpimeve japin ujë me vetëderdhje, prurjet e të cilave arrijnë deri në 10-57 l/sek. Në sektorët jugor koeficientët e ltrimit, prurjet specifike, kanë respektivisht këto vlera esatare: 4 m/ ditë dhe 0,3 l/sek/m. Duke u larguar për në qendër të ultësirës parametrat e mësipërm pësojnë një rritje të theksuar duke pasur vlerat 15-64 m/ditë dhe 2-5 l/sek/m. Në pjesën veriore vërehen përsëri ulje të këtyre parametrave duke arritur 3-28 m/ditë dhe 0.3-1.4 l/sek/m. Ujëdhënia e puseve me vetëderdhje luhetet në vlerat 0.5-5 l/sek deri në 20-57 l/sek. Gradienti hidraulik (I) për horizontin I-IV ka vlerën 0.02. Rryma natyrale nëntokësore jugore rezulton 520m<sup>3</sup>/dite. Drejtimi kryesor i lëvizjes së rrymës ujore nëntokësore, rezulton të bëhet nga jugu në veri. Ushqimi i ujërave nëntokësore në ultësirën e Korçës bëhet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike, në sektorët jugor të ultësirës dhe në ato sektor ku horizontet ujëmbajtëse dalin pothuajse në sipërfaqe dhe akuiferët e tjerë në verilindje.

Ujërat nëntokësore artezianë kanë veti fiziko-kimike të mira. Në këtë akuifer janë llogaritur shtim i kapaciteteve ujore nëpërmjet burimeve dinamike Qd=430-512 l/s



#### **Akuiferët e shkrifët me ujëpërcjellshmëri të ulët**

Në këtë akuifer me ujëpërcjellshmëri të ulët janë klasifikuar akuiferi i Fushës së Korçës dhe një pjesë e fushës së Devollit. Këto akuiferë lidhen me depozitimet Kuaternare të përbëra nga zhure, brekçie shpatore, etj. Lidhja hidraulike e ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nuk është e mirë. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuiferë janë të pakta. Ata shërbejnë për furnizim me ujë të pijshëm të komunitëve të vegjël. Shfrytëzimi realizohet me anë të burimeve dhe në depozitimet lumore e konuset e derdhjes edhe me anë të shpimeve. Vetitë fiziko-kimike të tyre në përgjithësi janë të mira, ato janë të ëmbël e me fortësi të ulët. Prurjet e puseve me vetëderdhje janë 0.2-1 l/sek, prurjet specifike variojnë q= 0.06-1.9 l/sek/m. Koeficienti i filtrimit varion vlerat 0.5-1m/dite. Rezervat e shfrytëzueshme në këto akuiferë bëhen nëpërmjet burimeve dhe shpimeve.




Akuiferët janë me presion dhe në disa zona kanë karakter artezian. Përdoren për furnizim me ujë të pijshëm të komuniteteve të vegjël. Deri në thellësi 300m ujërat nëntokësore janë të ëmbla e me fortësi mesatare deri të madhe. Më në thellësi ato kalojnë në ujëra të kripura. Ujërat nëntokësore të këtij akuiferi nga ana e vetive fiziko – kimike përgjithësisht janë të mira, pa ngjyre, pa ere, pa shije dhe me një temperature deri me 16°C, mineralizimi i përgjithshëm ka vlera 0.445 – 0.55 gr/litër, ndërsa fortësia e përgjithshme luhartet në vlerat 14 – 18° gjermane. Në baze të përbërjes kimike, ujërat e mësipërme janë të tipit hidrokarbomat kalciumi me përzierje hidrokarbonat – kalçium – magneziumi. Ushqimi kryesor i këtyre ujërave behet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike duke patur këtu një përputhje të zonës së ushqimit me zonën e shtrirjes së akuiferit që po përshkruajmë. Rëndësia e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore të akuiferit, duke pasur për bazë shkallën e vogël të ujëmbajtje së tij nuk e kalojnë rëndësinë me karakter lokal.

**Akuiferi Morave etj.** Ky akuifer ka shtrirjen e vet në sektorët lindore të ultësirës në malin e Moravës, me disa vende në jug të ultësirës dhe në disa sektorë shumë të kufizuar në Malin e Thate. Depozitimet ujëmbajtëse këtu janë konglomeratet bazale ranorët etj. Pjesa më e madhe e burimeve të këtij horizonti që dalin në malin e Moravës kanë prurjet e tyre që luhaten nga 0.1 – 1.5 l/sek. Në sektorin e minierës së qymyrit të Mborje – Drenovës nga ranorët dalin burime me prurje 0.03 – 0.1 l/sek, por duhet theksuar që takohen edhe burime me prurje deri në 6 l/sek. si burimi i Dishnicës. Nga pikëpamja e vetive fiziko – kimike këto ujëra janë të freskëta, pa ngjyre, pa ere, me një temperature 11 – 13°C, mineralizimi i përgjithshëm luhartet nga 0.345 – 0.482 gr/litër. Fortësia e përgjithshme ka vlera 11 – 14°gjermane. Ushqimi i horizontit ujëmbajtës që po përshkruajmë bëhet për llogari të infiltrimit të reshjeve atmosferike, në vende ku horizonti ujëmbajtës del në sipërfaqe dhe nga ujërat nëntokësore të formimeve rrënjësore të tjera. Pra në këtë akuifer kemi burime Dinamike rreth  $Q=150$  l/s.

### Akuiferët me porozitet çarje

Në këtë akuifer kemi klasifikuar shkëmbinjtë magmatik dhe metamorfikë, por kryesisht ultrabazikët. Shkëmbinjtë ujëmbajtës të këtij kompleksi janë serpentinitet, peridotitet nëpër çarjet e të cilëve qarkullojnë ujëra nëntokësorë nga kuotat e larta në kuotat më të ulta. Shkalla ujëmbajtje së shtresave të këtyre shkëmbinjve është jo uniforme dhe në vartësi të çarshmërisë së tyre. Pothuajse gjatë të gjithë kontaktit të shkëmbinjve ultrabazike në ultësirën e Korçës takohen burime me prurje që luhaten në vlerat nga 0.1-3l/sek.

**Fig. 5 – Hartë e përshkueshmërisë së ujërave nëntokësorë (Burimi: UNDP, S. GURI<sup>1</sup>)**




Ujërat nëntokësore të shkëmbinjve ultrabazike nga ana e vetive fiziko – kimike janë të freskëta, pa ngjyre, pa ere, transparentë, me një temperaturë që luhatet nga 11 – 14°C. Mineralizimi i përgjithshëm luhatet nga 0.176 – 0.436 gr/litër. Fortësia e përgjithshme ka vlera 11 – 15°gjermane. Ujërat nëntokësore të depozitimeve janë të tipit hidrokarbonat – magneziumi. Ushqimi i këtij kompleksi bëhet kryesisht për llogari të reshjeve atmosferike në sipërfaqen e shtrirjes së tij. Në periudhën me reshje të shumta prurjet e burimeve shtohen, ndërsa në periudhën e thatë si pasojë e mungesës së reshjeve, debiti i burimeve ulet në mënyrë të ndjeshme. Ky akuifer ka një përhapje që nga Luarasi, Stratobërdha, Masivi i Orenit dhe në një pjesë e Vallamarës. Ujërat nëntokësore të shkëmbinjve ultrabazike kanë rëndësi vetëm për furnizim me ujëra nëntokësore të qendrave të vogla të banimit deri komuna. Pra në këtë akuifer kemi burime Dinamike Q=150 l/s.

### Akuiferët me porozitet çarje- karst

Akuiferët e çarë e karstikë me ujëpërcjellshmëri që ndryshon në kufij shumë të gjerë, vende-vende me vlera shumë të larta të saj, lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë të Triasikut. Tipi i këtij akuiferi ka përhapjen të konsiderueshme në qarkun e Korçës dhe shtrihen në një sipërfaqe prej 666.15km<sup>2</sup>, e përkthyer në përqindje për sipërfaqen që zë ky akuifer në qark rreth 19% e sipërfaqes së tij. Në këto akuiferë fenomeni i karstit është shumë i zhvilluar, e për rrjedhojë ata mbajnë burime ujore të mëdha. Në zonat karstike koeficienti mesatar i infiltrimit të dobishëm shkon deri në 0.6 - 0.7. Sasitë më të mëdha të burimeve ujore nëntokësore drenojnë kryesisht në kuota të ulta me burime sipërfaqësore. Ujërat nëntokësore në këto akuiferë kanë cilësi të mirë dhe përdoren gjerësisht edhe për furnizim me ujë të pijshëm. Nga këto akuiferë furnizohet me ujë

<sup>1</sup> S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I 'Hot Spoteve' Shqiptarë, 2012

të pijshëm shumë njësi, si dhe një pjesë të Korçës me rreth  $0.5\text{m}^3/\text{s}$ . Sasi të tjera të rëndësishme përdoren në industri e në bujqësi.



Ky akuifer ka një prurje dinamike  $Q_d=4\text{ m}^3/\text{s}$ . Akuiferët janë shumë vulnerabël ndaj ndotjes njerëzore.

**Fig. 6 - Shpërndarja hapësinore e fenomenit karstik (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)**


Nga pikëpamja hidrogjeologjike zonat karstike që rrethojnë ultësirën e Korçës dallohen nga këto veçori: nga infiltrimi shumë i lartë i reshjeve atmosferike dhe nga një ujëpërcjellshmëri e madhe. Ujërat nëntokësore karstike drenojnë drejt kuotave më të ulta duke krijuar dalje natyrore në formën e burimeve me një regjim shumë të ndryshueshëm. Përveç këtij antiklinali të madhe kemi në formë

njollash edhe disa akuiferë të vegjël si i Barmashit, Guri i Kuq, Vithkuqit, Vodice etj ku nga secili kemi nga një burim të konsiderueshëm me prurje  $Q=30-100\text{ l/s}$ . Ujërat e këtij akuiferi janë të freskëta, pa ere, pa ngjyre dhe shije me një temperaturë  $9-15\text{ }^\circ\text{C}$ , mineralizimi i përgjithshëm i ujërave nëntokësore të këtij akuiferi ndryshon nga  $0.205 - 0.423\text{ gr/litër}$ , fortësia e përgjithshme luhartet në vlerat  $6-14\text{ }^\circ$  gjermane. Ujërat janë të tipit hidrokarbonat – kalçium dhe me rrallë hidrokarbonat – kalçium – magneziumi. Ushqimi i ujërave nëntokësore karstike që lidhen me gëlqerorët masivë të Kretakut dhe të Triasikut në përgjithësi bëhet për llogari të reshjeve atmosferike dhe infiltrimit të ujërave të liqenit të Prespës. Regjimi i prurjes së këtyre burimeve kushtëzohet nga faktorët klimatike dhe hidrogjeologjike. Në periudhat me lagështire kemi një rritje të theksuar të prurjeve të burimeve si rezultat i intensifikimit të rënies së reshjeve dhe të ngritjes së nivelit të liqenit të Prespës, nëpërmjet çarjeve tektonike që përshkojnë këtë zonë. Duke patur për baze shkallën e madhe ujëmbajtëse të këtij akuiferi, rëndësia e ujërave nëntokësore të tyre për qëllime furnizimi është mjaft e madhe.

## BURIMEVE UJORE DHE BURIMET UJORE SIPËRFAQËSORE(VLERËSIMI I TYRE)

Përveç liqeneve si pasuri ujore e rëndësishme në këtë qark janë edhe lumenjtë si ai i Devollit, i cili përshkon në drejtim tërthor pjesën veriore të ultësirës, prej grykës së Cangonjit në lindje deri në Maliq në perëndim. Lumi i Devollit rreshtohet i dyti për nga gjatësia me 295 km. Ky lumë

buron nga malet e Gramozit (jashtë kufijve të vendit tonë) dhe prej andej futet në luginën e Bilishtit, duke formuar tre tarraca. Në bazë të të dhënave të stacionit hidrometrik të Orman – Pojanit, nivelet dhe prurjet minimale të lumit Devoll, në ultësirën e Korçës takohen në muajt Gusht – Shtator dhe kanë respektivisht vlerat 6-2cm dhe  $1.88 - 3.11\text{m}^3/\text{sek}$ , ndërsa vlerat maksimale takohen në muajt



**Fig. 7 – Hartë e potencialeve të pritshme ujore**

(Burimi :S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptarë, 2012)

Nëntor – Prill dhe kanë vlerat  $339 - 416\text{cm}$  dhe  $22.9\text{m}^3/\text{sek}$ . Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e lumit Devoll janë të tipit Hidrokarbonat – Kalçium – Magneziumi me një mineralizim të përgjithshëm  $M_p = 0.3 \text{ gr/litër}$  dhe një fortësi të përgjithshme  $F_p = 11^\circ\text{Gjermane}$ . Lumi i Dunavecit buron në jug të ultësirës së Korçës, në pjesën malore të saj të përbërë nga shkëmbinj ultrabazike dhe gëlqerorë. Tani Lumi i Dunavecit kalon nëpër një shtrat të ri. Gjatë rrjedhjes së tij nga Jugu në Veri në këtë lumë derdhen degë të vogla të tij si lumi i Kamenicës, i Dersnikut, Voskopit, Drenovës, Dvoranit etj. Regjimi hidrologjik i lumit Dunavec ashtu si dhe lumi Devoll, është në vartësi të plotë të reshjeve atmosferike nivelet dhe prurjet maksimale të këtij lumi takohen në muajin Mars, duke arritur respektivisht vlerat  $393-448 \text{ cm}$  dhe  $6.96\text{m}^3/\text{sek}$ . Nga pikëpamja hidrokimike ujërat e këtij lumi janë të tipit Hidrokarbonat - Magnezium – Kalciumi me Mineralizim të përgjithshëm  $M$ .

### Burimet ujore nëntokësore (Vlerësimi i burimeve dinamike të U.N. dhe shfrytëzimi i tyre)

Qarku Korçë është i njohur për burime të Konsiderueshme dinamike të ujërave nëntokësore. Akuiferët karstikë dhe ato ndërkokrrizor vlerësohen me ujëmbajtje shumë të lartë-mesatare, dhe paraqesin rëndësi të madhe në furnizimin e qendrave të mëdha të banuara me ujë të pijshëm. Nga burimet karstike furnizohen gjithashtu edhe qytetet e tjera si ai i Devollit, Ersekës dhe një pjesë e Korçës. Nga akuiferët Kuaternare furnizohet me ujë qyteti i Korçës nga puset e Turanit në sasinë  $Q=300 \text{ l/s}$  dhe të gjitha komunat që e rrethojnë fushë-gropën e Korçës. Në këto akuiferë janë kryer edhe një numër i madh shpimesh “ilegalë” që shfrytëzohet nga persona privatë. Sasitë e tyre nuk janë të evidentuara. Burimet ujore shfrytëzohen gjerësisht dhe në bujqësi për vaditje. Disa nga



kaptazhet, kryesore që përdoren për furnizim me ujë të pijshëm në mënyrë të përqëndruar janë dhënë në tabelën

Vendndodhja	Sasia që shfrytëzohet	Pika ujore
Emërtimi	l/s	Burim apo shpim
Turan-Korçë	300	shpim
Vreshtas-Podgorie	8	shpim
Sheqeras-Korçë	4.5	shpim
Bulgarec-Korçë	100	shpim
Vloçisht-Korçë	3	shpim
2km në P.të lagjes Greluos-Vithkuq- Korçë	30-40	burim
Në qender të fshatit Kapshtice	10-14	burim


**Tab. – 1 Shfrytëzimi kryesor i burimet dinamike për furnizim me ujë të pijshëm**

Akuiferi	Burimet dinamike të UN,	Shfrytëzimi i UN	Përdorimi
Akuiferi i poroz i Korçës	0.512	0.4	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi poro-çarje i Gorë-Mokër	0.15	0.07	Furnizim me ujë të pijshëm
Akuiferi çarjesh i Valamare-Orenik,	0.15	0.1	Furnizim me ujë të pijshëm
Jo akuifere	0.07	0.05	Furnizim me ujë të pijshëm
<b>Shuma</b>	<b>4.83</b>	<b>1.1</b>	

**Tab. – 2 Burimet dinamike të UN dhe përdorimi i tyre për furnizim me ujë të pijshëm**

Sic shihet edhe nga tabela burimet e përgjithshme dinamike në qarkun e Korçës vlerësohen minimalisht 4.832 m<sup>3</sup>/s (pasi burimet janë marre me prurjet minimale). Rezerva që mund të përdoren për furnizim me ujë të pijshëm janë edhe rreth 3.712m<sup>3</sup>/s, kryesisht nga akuiferi karstik.

**Fig. 8 – Hartë e përshkueshmërisë ujore të shkëmbinjëve sipërfaqësore (Burimi : S. GURI, UNDP, Vlerësimi Mjedisor dhe Rehabilitimi I ‘Hot Spoteve’ Shqiptarë, 2012)**



### Presionet mbi akuiferët

Presionet mbi akuiferët e qarkut Korçë janë përqëndruar në:

- Kërkesën më të madhe për burimet ujore (bujqësia dhe turizmi) në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur disponibiliteti i burimeve të ujërave nëtokësore është më i ulëti;
- Rritjen e vazhdueshme e të pa pakontrolluar të një numri të madh shpimesh privatë për furnizim me ujë pijshëm dhe industri;
- Shfrytëzimi pa kriter i shumë shpimeve të vjetër e të rinj të kryer në akuiferë me presion;
- Ritmet e larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

### **Burimet ekzistuese të ndotjes**

#### **Burimet ujore**

Karakteristikat e përgjithshme të këtyre ujrave janë paraqitur këtu poshtë:

- Turbiditet i lartë, meqënëse regjimi i rrjedhjes është i rrëmbyer, ujrat transportojnë sasi të mëdha lëndësh në suspension.
- Ndotje bakteriale e lartë. Ndotja e shkaktuar nga njeriu ose industria është praktikisht ekzistente.
- Temperatura e ulët. Këto ujra e kanë origjinën nga burime ose nga shkrirja e borës ose e akullnajave.
- Tregues ngjyrë të ulët. Këto ngjyra nuk kanë kohë të tresin lëndët vegjetale, të cilat janë burimi kryesor i ngjyrës.

#### ***Ndotja e ujit të pijshëm***

Në rajonin në studim, në adresë të sigurimit të shëndetit publik, mjaft e rëndësishme është cilësia e ujit të pijshëm. Por, ky ujë nuk shfaq probleme higjieno-sanitare, sepse kemi:

- Furnizimi me orar të pakufizuar, duke siguruar presion konstant të ujit;
- Jo Amortizim të rjetit ujësjellës;
- Ndërhyrjet nuk janë pa kriter në tubacionet e ujësjellësve;

Por nga ana tjetër mund të shfaq së shpejti problem sanitarë për shkak se:

- kemi ruajtje të dobët të brezave të mbrojtjes sanitarë të vendburimeve ujore për shkak të ngritjes mbi to të ndërtesave apo mbjelljes së tokës fare pranë burimit, duke përdorur edhe shumë kimikate;
- klorinimi më shumë seç duhet i ujit;


Të gjithë këta faktorë bëjnë që shëndeti publik të jetë nën kërcënimin e vazhdueshëm të përhapjes së sëmundjeve me rrugë hidrike. Nga ana tjetër, në rajonin në studim mungojnë pjesërisht ose

tërësisht të dhënat nga ekzaminimet bakteriologjike të ujit, për shkak të mungesës së laboratorëve dhe personelit

#### 4.5 Pasurite Minerale

##### MINIERAT AKTIVE NË BASHKINË E KORÇËS KARIERAT DHE STOQET E TYRE

Në Bashkinë e Korçës janë aktive disa punime minerare si për krom, bakër, qymyre, argjila, gurë dekorativë, gëlqerorë, gëlqeror pllakor, inerte lumi etj. Aktiviteti minerar privat në Bashkinë e Korçës ka filluar në vitin 2000 dhe janë efektive rreth 25 leje minerare shfrytëzimi të cilat kanë një shpërndarje jouniforme, nga të cilat 15 janë për shfrytëzimin e gurëve gëlqeror, nga 2 leje janë për qymyr guri dhe për ranor silicor dhe nga 1 leje për gëlqeror të mermerizuar, krom, bakër, argjilë dhe gëlqeror pllakor.



*Bllok diagrama e lejeve të shfrytëzimit në Bashkinë e Korçës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar).*







*Harta e Vendndodhjes se Mineraleve (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*

**Minerali Bakërit gjndet në vendburimet e mëposhtëme:**

**Vendburimi Bregu i Gështenjës** - Është vendburimi me i madh i bakrit në Bashkinë e Korçës me vendndodhje në fshatin Rehovë. Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit). Po kështu në Rehovë janë edhe edhe **Vendburimi Kanisqeli**, **Vendburimi Dushku i Trashë**. Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit, me pak kalkozinë). Morfologjia e trupit është thjerrëzore dhe vendoset brenda bazalteve në një zonë me çarje.




Fig. –2 Harte Metalogjenike (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)





Fig. – 3 Prerje e Vendburimit Bregu i Gështenjës ( Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

**Objekti Lubonjë** – me vendndodhje në fshatin Lubonjë të NJAV të Vithkuqit. Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, markazit, me pak kalkozinë). Morfologjia e trupit është thjerrëzore dhe vendoset brenda bazalteve në një zonë me çarje .

**Objekti Vithkuq** - Trupi xeheror është i tipit piritoz (kalkopirit, pirit, sfalerit, me pak kalkozinë), dhe trashësi mesatare 10 ml. Morfologjia e trupit është thjerrëzore-damarore dhe vendoset në kontaktin e bazalteve me aglomeratet.

**Fig. Harta gjeologjike ku pasqyrohen vb e bakrit në zonën e Rehovë**  
(Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)



### Objekti Shipcke-Voskopojë

Vendndodhja:

Voskopojë. Rezervat e llogaritura për këtë objekt janë: 101.000 ton (C1+ C2) me përmbajtje mesatare të Cu-1.% me teksturë pikëzore.






Fig. – 5 Harta e Pasurive Minerale (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

**MINERALET JOMETALORË (SHKËMBINJTË INDUSTRIALË)**

**Argjilat.** Argjilat në Bashkinë e Korçës kanë rezerva dhe i përkasin tipit lagunor, lagunore-ndërmalorë. Mbi bazën e këtyre resurseve dhe kushteve të përshtatshme për shfrytëzim prej kohësh janë ndërtuar fabrika tullash, tjegullash për industrinë e ndërtimit.

**Vendburimi Troktoliteve Treste -** Bashkia Korçë, Janë pjesë të sipërme të kompleksit ofiolitik të përbërë nga minerali i plagjioklazit dhe olivinës. Kombinimi i këtyre dy ngjyrave jep veti dekorative këtyre shkëmbinjve. Janë vlerësuar nga ana e ndërmarrjes gjeologjike të Korçës, por nuk janë kryer punime shpimi për të vlerësuar bllokshmërinë e tyre. Rezervat llogariten mbi 1 000 000 m<sup>3</sup>.



**Gëlqerorët** - Gëlqerorët zënë sipërfaqe të konsiderueshme në Qarkun e Korçës. Një pjesë e mirë e tyre janë studiuar për tu përdorur si material ndërtimi dhe një pjesë për veti dekorative.

Nr.	Nr. i në hartë	Vendburimi ose objekti.	Bashkia	Rezeruva Gjeologjike në %	Përmbajtja e komponentëve të			Perspektiva
					CaO	MgO	Fe <sub>2</sub> O <sub>3</sub>	
1	96	Shtylle	Korçë	12000	53			Hapur
2	100	Obj.Vithkuq	Korçë	61	52			Hapur

*Tab. – 2 Vendburimet dhe objektet për gurët gëlqeror*

**Gëlqerorëve konglomeratike të Polenës** - I përkasin Bashkisë së Korçës. Këta gëlqerorë kanë gjetur përdorim të gjerë si materiale ndërtimi (prodhim qoshesh, kolonash për ndërtesat private) ashtu edhe si lëndë e parë që kanë përdorur artizanet e vjetër e të rinj për prodhimin e objekteve artistike si shatërvanë, kolona, skulptura të ndryshme.

### Lëndët e para energjetike Qymyret

Qymyrbajtja në Bashkinë e Korçës, lidhet me depozitimet molasike të ultësirave të mbivendosura mbi zonat e brendshme dhe ato të jashtme si dhe janë të moshave

**Pellgu qymyrbajtës i Mborje-Drenovës: me vendndodhje në** NjAV të Drenovës. Shtrihet nga përroi i Boboshticës në jug, deri në përroin e Mborjes në veri.





Fig. 8 - Profil Skematik v.b Qymyreve të Mborje-Drenovës (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)

Nr	Nr. Hartë	Vendburimi ose objekti.	Bashkia	Rezervat 000/ton	Përmbajtja e komponentëve te dobishëm					Perspektiva
					Fuqia	H2O	Fe	Volative	Sqfur	
1	77	Vb Kuçi i Zi	Korçë	2552	2800	2,14	57.5	26,42	3.5	E hapur
2	92	Vb. Mborje-Drenovë	Korçë	4420	2864	1,77	53.5	23,79	3.94	E hapur
							8			

Tab. Vendburimet dhe objektet per mineralin qymyre

Gjeohapësira e Bashkisë së Korçë ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen për kërkimin e naftës dhe gazit. Ky rajone është mbuluar nga punime të ndryshme gjeologjike si rievime në shkallë 1:50 000 dhe 1:25 000. në vitet 1968,1972,1976, punime tematike përgjithësuese në vitin 1973, etj

*Fig. - 10 Harta e rajonizimit naftëgazmbajtëse në Shqipëri (Burimi: Shërbimi Gjeologjik Shqiptar)*



## PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

- Bashkia e Korçës ka gjeoresurset natyrore dhe kanë përhapje të mëdha mineralet e metalore, kryesisht Kromi, Bakri etj.
- Përpunimi i këtyre pasurive në afërsi të vendburimeve do të rrisë të ardhurat ekonomike si dhe interesin për shtimin e rezervave gjeologjike me punime kërkim – zbulimi.
- Mineralet e dobishme jometalore për Bashkinë e Korçës janë të përdorur për industrinë e ndërtimit si material inert, për veti dekorative, si dhe atë të prodhimit të agregateve karbonatike të përdoruara gjerësisht në infrastrukturën rrugore, etj.
- Lënda e parë karbonatike (gëlqerorët), argjilat gjenden në territorin e Bashkisë të Korçës dhe plotësojnë kushtet sasiore e cilësore të nevojshme në fushën e industrisë së ndërtimit, infrastrukturës, etj.
- Të dhënat e fituara për lëndën e parë argjilore, në vendburimet e këtij qarku na çojnë në përfundimin se janë të përshtatshme për tu përdorur në industrinë e qeramikës së trashë (tulla, tjegulla) dhe të çimentos.
- Për mineralin e bakrit: Rivënia në punë e minierave ekzistuese, përpunimi në vend i mineralit të bakrit do të çonte në shtimin e punimeve të kërkim-zbulimit për shtim të rezervave në gjithë objektet e këtij qarku.
- Për shkëmbinjtë dhe mineralet industrialë interes të veçantë kanë rërat kuarcore të cilat pas një pasurimi në rrugë të lagur mund të përdoren si lëndë e parë për fajance dhe qelq. Gëlqerorët, troktolitët, të kompletuar me studime mbi bllokshmërinë si dhe uniformitetit të ngjyrës paraqesin interes për tu përdorur për vetitë dekorative.
- Të rivlerësohet efektiviteti i përdorimit të qymyreve të Bashkisë së Korçës si lëndë djegëse për përdorim në prodhimin e tullave, tjegullave, prodhimit të energjisë, në situatat e sotme të rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

## NDIKIMET MJEDISORE TË INDUSTRIË MINERARE

Bashkia e Korçës, në të gjithë NjAV (Qyteti i Korçës, Qëndër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë), disponon një gamë mineralesh si: krom, bakër, qymyre, argjila, gurë dekorativ, gëlqeror, gëlqeror pllakor, inerte lumi etj, shfrytëzimi i të cilave, krahas rëndësisë ekonomike sjell edhe impakte negative në ndotjen e mjedisit. Përveç shfrytëzimit të këtyre mineraleve me punime nëntokësore apo në qiell të hapur, (me karriera), burime ndotjesh janë edhe stoqet e mineraleve përkatëse apo të sterileve të tyre, si fabrikat e pasurimit të mineraleve, me dampat e tyre përkatëse, (sidomos të bakrit), për vet përbërjen e tyre lëndore (kimizmin), granulometrinë e imët të tyre, (0,074mm), sasinë e madhe të materialit të tyre si dhe mos mbajtjen nën kontroll rigoroz, paraqesin një rrezik potencial për mjedisin. Jonet e metaleve të rëndë që vazhdimisht kalojnë në tretje, sjellin rrisqe serioze në bimësinë dhe gjallesat që jetojnë në ambiente tokësore dhe ujore të ndotura nga këto jone.



Minierat e mbyllura dhe stoqet e tyre të sterileve dhe të mineraleve. Në Bashkinë e Korçës, përpara dhe gjatë viteve '90, industria minerare ka qënë ndër degët e zhvilluara, e cila krahas zhvillimit ekonomik, ka sjellë rrisqe negative mjedisore, si në toka, në ujëra dhe në ajër. Kryerja e këtyre punimeve të shfrytëzimit, si me miniera ashtu edhe me karriera, me stoqet e tyre, sjellin rrisqe të theksuara negative në ekosistemet natyrore ku ato veprojnë, duke krijuar mjaft probleme në ndotjen e ambientit dhe në prishjen e ekuilibrave ekologjike të mjedisit. Konkretisht për këtë Bashki probleme gjeomjedisore sjellin kryesisht minierat dhe karrierat e bakrit, të kromit, karrierat për materiale ndërtimore, inertet lumore etj, (me stoqet e sterileve të tyre) si në: Kanisqel, Dushku i trashë, Voskopojë, Drenovë etj. Këto me tretësirat që krijojnë nëpërmes agjentëve atmosferik, sjellin pasoja në ekosisteme, dhe bëhet shumë pak për rehabilitimin e ambienteve të ndotura. Ka damba që janë rehabilituar dhe mbuluar me bimësi spontane.

Ndotje e tokave ndodhin nga: (a) Gërmimet sipërfaqësore; (b) Shembjet, rrëshqitjet, vidhisjet (c) depozitimet (stoqet) e mëdha të sterileve, (shpesh edhe të mineraleve përkatëse).

Kjo dukuri ndodh edhe gjatë transportimit nëpër përrenj, lumenj dhe liqene si dhe në tokat përreth, duke ndikuar kështu në strukturën e tokave dhe në përbërjen e tyre litologjike, dëmtim të kullotave dhe të bimësisë, dalje të hinkave në sipërfaqe nga shembja e punimeve nëntokësore dhe dëmtime shtëpishë. Në kushtet e agjentëve atmosferikë si lagështia e oksigjeni, ndodhë procesi i oksidimit dhe elementet e çliruar shpërndahen nga rrjedhjet ujore sipërfaqësore si dhe me ane të vaditjes, në tokat poshtë minierës, duke shkaktuar ndotje të tyre, ku ndikojnë edhe ndotjet që vijnë nga pluhurat që ngrihen nga dherat e karriera dhe stoqeve të sterileve, si pasojë e të cilave rrjedh degradimi i florës dhe faunës së këtyre zonave. Përveç kësaj nga pusët e shfrytëzimit, grykat e galerive, gropat e karriera (shfrytëzimi sipërfaqësor), ngashembjet dhe rrëshqitjet e krijuara, rrezikohet jeta e njerëzve dhe e kafshëve.

Ndotja e ujërave. Në ndotjen e ujërave sipërfaqësore, rol luajnë edhe shkarkimet e lëngëta urbane, industriale dhe bujqësore, që janë dukuri të cilat në mënyrë progresive ndikojnë në uljen e cilësisë së ujërave të lumenjëve, të liqeneve dhe të mjedisit në përgjithësi. Shkarkimet e lëngëta urbane, që përmbajnë lëndë organike, komponime të tretëshme të fosforit dhe të azotit, (të cilat favorizojnë procesin e eutrofikimit), bakterie dhe viruse patogjene, metale të rëndë si dhe lëndë që prishin pamjen e ujërave dhe u japin atyre erë të keqe. Cilësia e rënduar e ujërave, është një kërcënim si për shëndetin e njerëzve ashtu edhe për ekosistemin në përgjithësi. Substancat ndotëse pasi kalojnë në ujrë e lumenjëve ose të liqeneve, sillen në mënyra të ndryshme: disa treten dhe pësojnë zhvendosje për shkak të rrymave ujore, disa të tjera përthithen nga grimcat e ngurta pezull dhe sedimentojnë, ndërsa të tjerat mund të hyjnë në cikle biokimike të ndryshme, duke kaluar nga njëri organizëm në tjetrin.

## 5. Përdorimi i Tokës dhe Infrastruktura

### 5.1 Sistemet territoriale dhe përdorimi i tokës

Analiza e sistemeve territoriale dhe përdorimit të tokës vjen si rezultat i gjetjeve nga skanimi i territorit dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese. Skanimi i territorit është kryer nga grupi i projektimit, formuar nga stafi i bashkisë në bashkëpunim me ekspertët konsulentë vendas e të huaj, duke shfrytëzuar të dhënat ekzistuese të bashkisë, të dhëna nga imazhet satelitore, vizitat në terren, të dhëna zyrtare nga institucione qendrore, etj.

Territori aktual i Bashkisë së Korçës, vjen si rezultat i shkrirjes së shumë njëjive administrative të mëparshme (Bashki dhe Komuna) në një territor të vetëm administrativ sipas Reformës Administrativo-Territoriale<sup>12</sup>. Sipërfaqja e re e territorit në studim të bashkisë se re, është rritur rreth 38 herë.

Sipas VKM nr. 671 për “Miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, shtojca 1, njësitë administrative vendore, për qëllime të planifikimit, ndahen në 5 sisteme territoriale si më poshtë:

- sistemi Urban (UB)
- sistemi Natyror (N)
- sistemi Bujqësor (B)
- sistemi Ujor (U)
- sistemi Infrastruktural (IN)




Figura 7 harta e 5 sistemeve territoriale

Nga analiza e sistemeve territoriale rezulton se sistemi natyror është dominues në territorin e bashkisë, duke zënë rreth 70% të sipërfaqes totale të territorit. Sistemi natyror gjendet i shpërndarë gjithandej në territor, por vërehet një dominim i theksuar nga pjesa perëndimore e territorit të bashkisë, e cila karakterizohet më së shumti nga një reliev malor e kodrinor. I dyti në sipërfaqen që zë në territorin e përgjithshëm është sistemi bujqësor me sipërfaqen e dytë më të madhe në rang kombëtar. Në këtë sistem bazohet edhe një pjesë shumë e rëndësishme e ekonomisë vendore e rajonale e territorit.

Ndërsa, në sistemin urban, vërejmë menjëherë që shtrirja nuk është shumë e madhe (duke krahasuar me qytetet e mëdha si Tirana, Durrësi, etj.) dhe nga ana tjetër është e përqendruar kryesisht rreth qytetit të Korçës, që shtrihet në zonën lindore të territorit të bashkisë. Pjesa perëndimore, përveçse në disa qendra njësisish administrative, në përgjithësi sistemi urban karakterizohet nga një shtrirje e vogël dhe me pak popullsi.

Tabela 3 të dhënat e shtrirjes sipas sistemeve

Sistemet territoriale	Sipërfaqe (Ha)	Sipërfaqe (%)
Sistemi Urban	2180	2.7
Sistemi Natyror	57620	71.4
Sistemi Bujqësor	20070	24.9
Sistemi Ujor	290	0.4
Sistemi Infrastruktural	440	0.6
	<b>80600</b>	<b>100</b>

Nga analiza e sistemit urban vërejmë se territori me karakter urban mbizotëron kryesisht në qytetin e Korçës i cili mban edhe përqendrimin më të madh të popullatës së Bashkisë (rreth 67%)<sup>13</sup>. Nga tendencat e fundit të zhvillimit në territor mund të vihet re një tendencë në rritje të zhvillimeve të njësisive administrative të Bulgarecit dhe Drenovës në drejtim të qytetit. Nëse konsiderojmë edhe popullatën e këtyre njësisive si pjesë e kësaj njësie territoriale, atëherë rezulton se ajo mban rreth 85% të presionit të zhvillimit të të gjithë Bashkisë.

Pjesa tjetër e sistemit territorial urban përbëhet kryesisht nga njësi me karakter rural ose gjysëm-urban.




Figura 8 hartë e sistemit urban



Në sistemin natyror përfshihen peizazhet, hapësirat e paprekura të natyrës, korridoret ekologjike, pyjet, kullotat dhe çdo hapësirë tjetër që në përputhje me legjislacionin në fuqi përfshihet në kategorinë bazë të përdorimit “natyrë”.




Figura 9 hartë e sistemit natyror

Korça konsiderohet një qendër urbane me pasuri të rralla peizazhistike në rang kombëtar. Në territorin e saj vërehen një larmi e madhe tipologjive të relievit dhe mënyra se si duke udhëtuar rrëshqitet në mënyrë të menjëhershme nga njëra te tjetra. Qyteti shtrihet në një rrafsh fushor ku është gjenden tokat më pjellore në vend dhe që zënë sipërfaqen më të madhe të pacopëzuar. Nga të gjitha anët qyteti i Korçës është e rrethuar me male të larta, si: vargmali i Moravës, Mali i Thatë, malet e Gorës, Voskopojës, Vithkuqit, Qarrit dhe Grabovicës. Nga fusha për në male terreni thyhet me disa formacione kodrinore si ato të Shën Thanasit, Shëndëllisë, Dvoranit, Kamenicës, etj. Përrenj të shumtë zbresin faqeve të maleve, veçanërisht në ato të Moravës, duke furnizuar lumin e Devollit dhe atë të Dunavecit. Nëpër këto terrene gjenden tipologji të ndryshme banimi, secila zhvilluar sipas vendit dhe kohës, kush më e lashtë e kush më bashkëkohore. Në lartësinë e Korçën, në terren fushor shtrihet edhe Bulgareci. Në terrene kodrinore gjenden zona të urbanizuara si Drenova, Mborja, Boboshtica, etj. Në lartësinë e maleve gjenden vendbanime të lashta e të shquara për vlerat e tyre kulturore, arkitekturore e peizazhistike si Voskopoja, Dardha e Vithkuqi. Kjo pasuri e madhe kulturore, historike, arkitekturore e peizazhistike ka tërhequr vazhdimisht vizitorë vendas e të huaj për të shëtitur zonën.






Figura 10 pika atraksioni për itinerare të mundshme turistike

Korça llogaritet si një bashki e pasur me pyje e kullota, të cilat nga të dhënat llogaritet të arrijnë rreth 39'500 ha. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e pyjeve, pas reformës Administrativo-Territoriale, i është transferuar si funksion Bashkive që në fillim të vitit 2016, nëpërmjet vendimeve të Këshillit të Ministrave.

Pyjet kanë një shtrirje të madhe dhe të shpërndarë në territorin e bashkisë, ndër të cilat përfshihet edhe një zonë e mbrojtur kombëtare e kategorisë II<sup>14</sup>, për “Bredhin e Drenovës”. Ato përbëjnë rreth 45% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit dhe 64% të sistemit natyror.

Për qëllim të reduktimit të ndërhyrjeve mbi fondin pyjor, i cili është degraduar si pasojë e mbi-shfrytëzimit dhe dëmtimeve të tjera, me synim përmirësimin dhe rehabilitimin e gjendjes së pyjeve, qeveria ka shpallur me ligj<sup>15</sup> një moratorium nëpër të gjithë fondin pyjor të Republikës për 10 vite. Moratoriumi pritet të ketë një efekt shumë të madh në mbarëshkrimin e zonave pyjore, veçanërisht në zonat ku prerja dhe shfrytëzimi i lëndës drusore për qëllime tregtare ka degraduar tokën. Ndër këto zona në Bashkinë e Korçës mund të përmendim pyjet në njësitë administrative të Vithkuqit dhe Voskopit. Në njësinë e Vithkuqit thuajse të gjitha sipërfaqet pyjore janë të degraduara në një gjendje vegjetative shumë të dobët. Ndërsa në njësinë e Voskopit, dëmtime të ngjashme shihen në masivet me pishë të zezë dhe në ato të lisit.

Sipas llogaritjeve të Bashkisë të nevojave komunitare për lëndë drusore për ngrohje, rezulton se nevojitet afërsisht 130'000 m<sup>3</sup> dru zjarri<sup>16</sup> për ngrohje.

Bujqësia është prodhimi bazë në ekonominë e fshatrave të rrethit Korçë. Sot bujqësia është plotësisht e privatizuar. Komuniteti nuk është i organizuar në grupe dhe në përgjithësi nuk pëlqehet bashkimi i tokave me njëri-tjetrin duke menduar se ajo ishte vetëm një mënyre e socializmit. Bimët bujqësore që kultivohet më shumë janë drithërat. Në këtë zonë, toka bujqësore është e

konsiderueshme dhe shumë pjellore. Kjo zonë shquhet për prodhimin e grurit dhe misrit të rrushit Moskat, rakisë dhe verës cilësore që nxirren prej tij, të mollës starkinkë, të qershisë e dardhës, domates, specit dhe mjaft prodhime të tjera cilësore me rendimet të lartë dhe njëherësh të lakmueshme për tregun Korçar dhe më gjerë, po kështu përmendim rendimente të larta në foragjeret që sigurojnë edhe bazën ushqimore të blegtorisë dhe natyrisht mjaft cilësore janë edhe prodhimet blegtorale. Mjaft prej fermerëve zotërojnë makineri bujqësore për të punuar tokën. Mesatarisht, rreth 50% e sipërfaqes bujqësore është futur në përdorim, ndërsa pjesa tjetër janë toka të refuzuara, të lëna djerrë dhe trajtohen si livadhe dhe kullota për blegtorinë. Ndër territoret e njësive administrative (ish-Komuna) ka me mijra ha toka të refuzuara, shifer kjo e lartë e cila tregon për vëmendjen që i duhet kushtuar këtij procesi në dhënien e një destinacioni për të pasur qëndrueshmëri dhe produktivitet maksimal.




Figura 11 hartë e sistemit bujqësor

Fshatrat që kanë më shumë tokë bujqësore për familje dhe për banorë janë Damjanec, Polenë, Vinçan, Goskovë. Duhet theksuar se një prej faktorëve që ka rritur diferencën e madhe që ekziston midis fshatrave lidhur me tokën bujqësore është fakti se kanë lëvizur mjaft banorë drejt zonave urbane, si në Korçë dhe në vende të tjera. Në disa fshatra si Voskop, Dërsnik, Polenë dhe Goskovë sigurohen të ardhura më të larta nga përdorimi i tokës bujqësore, sepse në këto fshatra është përqendruar edhe pjesa më e madhe e popullsisë së njësive administrative.

Siç mund të vërehet nga karakteristikat e mësipërme të bashkisë dhe nga analizat që do të pasojnë, sistemi bujqësor zë një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin urban dhe ekonomik të saj, i cili përballet me shumë problematika. Kalimi nga një bujqësi që zhvillohej sipas ligjeve të socializmit, në një ekonomi të tregut të lirë e gjeti bujkun dhe specialistët e bujqësisë të pa përgatitur.

Problemi themelor që ka bujqësia është ai strukturor. Aktualisht ai konsiderohet pengesë e rëndësishme sidomos në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të këtij sektori. Por bujqësia ndeshet edhe me probleme të tjera. Zhvillimi ekonomik i vendit ndikon në zgjidhjen optimale të tyre.

Një nga problemet më parësore me natyrë strukturore të bashkisë është pronësia mbi tokën. Ky problem është shkaktuar nga mënyra e ndarjes së tokës “për frymë të popullsisë”. Me ferma të vogla, ku rreth 40% e të cilave kanë më pak se 1 ha tokë, ndërsa rreth 50% kanë 1-2 ha, kanë ardhur një sërë dizavantazhesh, si:

- të ardhura të vogla për familjen fermerë;
- pengesa në përdorimin efektiv të tokave bujqësore (fraksionizim);
- pengesa në përdorimin racional të sistemit të ujitjes;
- pengesa në përdorimin e inuteve që rrisin prodhimin;
- disavantazhe të mëdha për tregtimin e produkteve, etj<sup>17</sup>.

Siç u përmend dhe më lart, një fenomen tjetër dëmtues për tokën bujqësore është braktisja e tokave. Në shumë fshatra si Damjanec, Dersnik, Goskove Poshte, Goskove Lart, Vinçan, Voskop, një pjesë e sipërfaqes së tokës bujqësore janë toka të braktisura të cilat janë lënë djerrë dhe trajtohen si livadhe dhe kullota për blegtorinë. Në këtë zonë ka rreth 954.7ha toka të braktisura, tregues i cili duhet vlerësuar për një menaxhim të integruar e funksional, me potencial ekonomik për të gjithë territorin e Komunës.

**Tab.14 Të dhëna për tokat e braktisura**

Nr.	Fshati	Sip. toke e braktisur	Propozimet sipas përdoruesve ha				Të mbetet e tillë
			Tokë bujq.	Foragjere/livadh	Pemëtore vreshtë	Ripyllëz.	
1	Voskop	107.1		107.1			107.1
2	Dersnik	57.4		57.4			57.4
3	Polene	162.3		162.3			162.3
4	Vincan	12.6		12.6			12.6
5	Goskove Lart	85.4		85.4			85.4
6	Goskove Poshte	57.7		57.7			57.7
7	Damjanec	472.3		472.3			472.3
	<b>KOMUNA</b>	954.7		954.7			954.7

Prej fillimit të viteve 1990, kolapsi i sistemit të centralizuar ekonomik çoi në ndërtimin e grumbujve të banesave informale në periferi të qytetit, kryesisht përgjatë rrugëve që çojnë në vendbanime të afërta si Voskopoja, Erseka e Polena. Gjithsej ALUIZNI ka miratuar 5 zona informale në territorin e bashkisë, të cilat nuk paraqesin probleme aq të mëdha në krahasim me ato në bashki të tjera e të mëdha si Tirana, Durrësi, Kamza, etj. Bazuar në të dhënat e ALUIZNI-t, mund të vihet re se këto zona kanë një formë shumë kompakte me një tipologji pak a shumë të vazhduar ndërtimi. Ato janë të ndërtuara që nga viti 1990 deri në 2006, me disa dhjetëra objekte për secilën zonë, kryesisht me funksion banimi. Sipërfaqja që zënë është e vogël duke okupuar jo më shumë se 10-30 ha, vendosur kryesisht në pronë private. Shumica e objekteve janë 1-2 kate lartësi. Një përjashtim bën zona e zhvilluar në lindje të Korçës në drejtim të fshatrave Barç dhe Mborje, në të cilën lartësia e ndërtimit është relativisht e madhe.






Figura 12 vendndodhja e zonave informale të miratuara nga ALUIZNI

Korça ka trashëguar zona industriale të madha të zhvilluar në periudhën e Regjimit Socialist kryesisht në pjesën veriperëndimore të qytetit përgjatë aksit hyrës nga Tirana. Zona të tjera me aktivitete ekonomike janë zhvilluar përgjatë aksit rrugor të Bilishtit (veri-lindje), pas Varrezave (jug-lindje) dhe përgjatë rrugës së Polenës (jug-perëndim). Prej vitit 1990, aktiviteti industrial ka degraduar shumë, duke lënë sipërfaqe të mëdha të tokës dhe objekte të braktisura. Në të dy anët e aksit në drejtim të Tiranës, zona ish-industriale është degraduar dhe për rrjedhojë ka tërhequr zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me ndërtimet, si edhe aktivitete të tjera komerciale. Megjithatë, vihen re edhe tendenca të reja për zhvillimin e zonave industriale që ndjekin rrugët kombëtare automobilistike, si ajo për në pikën kufitare të Kapshticës.







Figura 13 hartë e zhvillimit industrial dhe ekonomik

Nga ana tjetër Korça ka ruajtur dhe zhvilluar hapësirat e lira dhe të gjelbëruara. Kjo vihet re kryesisht në qytetin e Korçës ku ka një kërkesë të fortë lokale për përmirësimin e hapësirave të ndryshme publike. Bashkia është shumë e përgjegjshme për rëndësinë e hapësirave të lira të mirëmbajtura dhe gjatë viteve të fundit, janë realizuar shumë projekte rehabilitimi në kuadrin e projektit “Rigjenerimi i Hapësirave të Gjelbërta”. Megjithatë gjatë viteve ka pasur edhe humbje të konsiderueshme të tyre siç mund të vihet re në Kodrat e Moravës. Kodrat, shkëmbinj të dhe vendet e pjerrëta të Moravës rrëzë së cilës shtrihet qyteti, në të kaluarën kanë qenë publike dhe të pyllëzuara. Duke pasur procesin e kthimit të pronave pas viteve '90, pjesët kodrinore u janë rikthyer ish-pronarëve. Mangësitë në procesin e kontrollit të zhvillimit janë reflektuar në humbje të mëdha të zonave të pyllëzuara nga prerje masive dhe e pakontrolluar e drurëve, e cila ka shërbyer kryesisht për ngrohje rezidenciale të banorëve lokalë gjatë dekadave të fundit.

Një faktor shumë i rëndësishëm zhvillimi ekonomik dhe urban për Bashkinë e Korçës, vjen drejtpërdrejt nga reforma administrative, duke i transferuar bashkisë shumë asete të ish-komunave. Mundësia për t'i shfrytëzuar ama, varen shumë nga regjistrimi i këtyre aseteve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive për t'i vlerësuar si asete dhe përdorur në treg. Bashkia duhet të procedojë me regjistrimin e këtyre pronave menjëherë. Duke qenë se lista e aseteve është e gjatë, e rëndësishme për Bashkinë është të planifikojë me prioritet dhe të bëjë dokumentacionin gati për ta regjistruar pranë zyrave vendore. Ngritja e një grupi pune është e domosdoshme për këtë proces, për të përgatitur dokumentacionin e nevojshëm<sup>18</sup>.








**Figura 15 hartë e sistemit infrastrukturor**

Sistemi i infrastrukturave – në këtë sistem përfshihen gjithë rrjetet e inftsatruktës rrugore, ku është është vënë re një cilësi jo shumë e mirë e lidhjes midis fshatrave/periferisë dhe qendrës urbane të Korçës. Për shkak edhe të relievit dhe cilësisë aktuale, sistemi i infrastrukturave është më i rëndësishmi në listën e projekteve strategjike. Gjithashtu një element mjaft i rëndësishëm në këtë sistem, që është edhe konsideruar çështje e rëndësishme kombëtare është gjurma e projektit të gazsjellësit TAP. Kjo linjë gazi e përshkon gjithë territorin e Bashkisë Korçë në një gjatësi prej rreth 50 km dhe plotësohet me një fashë buffer-ike prej 500m në gjithë shtrirjen e saj. Vetë projekti që sapo ka fillur synon një sërë investimesh në infrastrukturë e rrugë lidhëse që do të jene funksionale edhe për vet zonën.



**Figura 16 hartë e nevojave për konvertim sistemesh territoriale**

Në propozimet e planit përpara i takon zhvillimit të territorit, dhe në mënyrë të veçantë ndërtimit, bazuar në analizat territoriale, synohet konsolidimi i zonës urbane duke kufizuar urbanizimin e zonave të reja, me qëllim mbrojtjen tokës bujqësore mjaft e çmuar për zhvillimin e ekonomik të bashkisë Korçë. Në vlerësimin paraprak të sistemeve, duke përdorur si informacion kryesor njollën e urbanizimit si sistemi i urbanizuar dhe informacionin hartografik të Corine Land Cover për sistemin bujqësor, vihet re një mbivendosje e ketyre gjeometrive në GIS. Duke shqyrtuar zonat e mbivendosjes së sistemit urban me ato bujqësor qartësisht dallohen zhvillimet pas viteve '90 kryesisht në zonën rurale, përgjatë akseve rrugore kombëtare, si dhe në periferi të bashkitë së vjetër të Korçës, që kanë qënë edhe subject i proceseve të legalizimit në vite. Në propozimin e planit parashtrahet ndryshimi i sistemit bujqësor në urban në këto zona, që faktikisht janë të ndërtuara aktualisht, por që ende konsiderohen si asete të bujqësisë. Në pjesën më të madhe ky ndryshim do të bëhet në periferi të qytetit, në bashkimin me njësitë administrative të Drenovës dhe Qendër Bulgarecit, si dhe në zonat urbane në qendrat e fshtrave ku ka ndodhur ndërtimi.

Përpara i takon sistemeve të tjera, nuk parashikohen ndryshime dhe tjetërsime, për vet faktin që synohet konsolidim dhe rikualifikim ambjental në përgjithësi i tyre.



## 5.2 Furnizimi me ujë të pijshëm, kanalizimet e ujërave të zeza dhe infrastruktura e vaditjes dhe e kullimit të ujërave për tokat bujqësore

### 5.2.1 Uji i pijshëm

Qyteti i Korçës ka një furnizim me ujë të pijshëm nga më të mirët në Shqipëri si për sa i përket burimeve, kohëzgjatjes (24 orë) ashtu edhe për rrjetin e shpërndarjes dhe sasisë për banorë (direktiva 11 evropiane për ujin është 200l/d/b). Gjatësia e këtij rrjeti arrin në rreth 120km ka mundësuar uljen e humbjeve në rrjet, përmirësimin e stacionit të pompave si dhe sasinë e depozitimit. Ky furnizim me ujë i qytetit të Korçës realizohet nga ujësjellësi qytetit i ndodhur në fshatin Turan ku është ngritur dhe stacioni i pompave. Në tërësi janë 4 puse arteziane të cilët janë rreth 150 m të thellë, nga të cilët një ndodhet në fshatin Turan, ndërsa tre të tjerët poshtë fshatit Porodinë. Puset janë të rrethuar dhe hermetikë. Nga këta puse për arsye shfrytëzimi sa më racional, dy janë në shfrytëzim ndërsa dy të tjerët janë lënë rezervë. Në puset e qytetit merren mostra 2-3 herë në vit direkt në pus. Uji kalon nga këto puse nga stacioni i pompave të Turanit ku bëhet dhe klorinimi i ujit. Që atje me pompa ngjitet në depot e ujit në kodrat e qytetit dhe me anë të rrjetit, i cili është brenda çdo parametri, hermetik me tubacione që janë shtrirë në të gjithë qytetin e Korçës nga ku shpërndahet uji. Tubacionet janë të reja bashkëkohore dhe përveç qytetit të Korçës kanë shtrirje dhe në 2 fshatrat përreth si Turani dhe Cifligu të cilët furnizohen nga rrjeti i qytetit të Korçës. Ujësjellësi monitorohet çdo dite nga ana e drejtorisë duke marrë mostra uji në 16 pika, nga të cilat 15 pika janë fikse dhe 1 pikë është e lëvizshme sipas problemeve që paraqesin qytetaret. Përqindja e klorit ka tendencën të ruhet konstante.




Figura 17 hartë e sistemit të furnizimit me ujë në zonën e qytetit

Përveç ujësjellësit, qyteti i Korçës ka edhe 11 çezma me vetërrjedhje, nga të cilat një pjesë janë me një origjinë qindra vjeçare. Edhe atyre ju bëhet analiza çdo tre muaj. Emrat e tyre janë: 1. Shetro 2. Cezma E Amzes 3. Ish Fabrika E Çorapeve 4. Ish-Fabrika E Miellit 5. Papallambro 6. Radamec 7. Lulishtja Shën Mëria 8. Partizani 9. Rr. Pano Xhamballo 10. Rr. Niko Kovaci 11. Rr. Petraq Shamo.

Po ashtu nga monitorimi dhe analizat, uji i Korçës rezulton pa ndotje bakteriologjike

Pavarësisht që momentalisht situata hidrike dhe pastërtia e ujit të kësaj zonë është e brenda standardeve, sipas UKKO zona ujëmbajtëse kërcënohet nga ndërtimet dhe nga aktivitetet e pakontrolluara në zonë. Kjo ndodh pasi në këto zona të mbrojtura nuk ka masa efektive lidhur me kanalizimet e ujërave, llojin e ndërtimeve dhe destinacionin e tyre dhe për pasojë janë shtuar mbetjet industriale dhe ato urbane duke e kërcënuar pastërtinë e kësaj zone. PPV i qytetit të Korçës duhet të marrë në konsideratë zbatimin e kriterëve lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare duke kërkuar zbatimin e kriterëve shumë të forta lidhur me llojin e aktivitetëve (depo karburantesh, industri kimike, blegtori, magazina si dhe për shërbime të tjera), lejet e ndërtimit etj. Është e domosdoshme, në bazë edhe të ligjit, që të gjitha këto aktivitete përpara se të marrin lejet dhe të lidhen me rrjetin e ujërave të zeza duhet të paraqesin një projekt lidhur me trajtimin paraprak të mbetjeve dhe të ujërave. Zbatimi i propozuar për zonat e mbrojtura do të ishte një zgjidhje përfundimtare për këtë çështje.

Në fshatra, në përgjithësi nuk ka probleme me burimet për furnizimin me ujë. Problem përbëjnë shpeshherë tubacionet e shpërndarjes të amortizuara, mungesa e matësve të ujit, abuzimet me ujin e pijshëm duke u përdorur për vaditje, etj.<sup>19</sup>

Në territorin e bashkisë kanë përhapje akuiferë të llojeve të ndryshme. Akuiferët karbonatikë karstikë, kanë përhapjen më të vogël dhe zënë rreth 19 % të sipërfaqes së tij, por janë me të rëndësishmit në Bashkinë e Korçës dhe përbëjnë një burim të veçantë për bashkinë e Pogradecit gjithashtu. Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor, përhapen në fushën e Korçës dhe Devollit. Depozitimet e papërshkueshme, kryesisht flishi (jo akuiferët) kufizojnë akuiferët karbonatikë. Këto depozitime luajnë një rol shumë të rëndësishëm në krijimin e kushteve për drenazhimin e ujërave nëntokësorë, nga këto masivë, me burime me prurje të madhe. Jo-akuiferët zënë sipërfaqen më të madhe të qarkut rreth 31 %.

Prurja e burimeve luhet nga 0,001 deri në 3000 l/sek. Burimet nën 1 l/sek drenazhojnë në depozitimet flishore ose në kuota të larta në depozitimet karbonatike. Burimet me prurje të larta drenazhojnë në kuota të ulëta për në drejtim të liqenit të Ohrit.

Burimet e përgjithshme dinamike të ujërave nëntokësorë në territorin e bashkisë janë vlerësuar rreth 4'832m<sup>3</sup>/s. Përbërja kimike e ujërave nëntokësorë është e mire, e tipet hidrokimike që mbizotërojnë janë hidrokarbonat-kalcium, hidrokarbonat-kalcium-magnezi etj.

Rezervat ujore për perspektivën e zhvillimit të qytetit të Korçës dhe komunave përreth kësaj fushe është akuiferi ndër-kokrrizore me ujë-mbajtje mesatare, i cili ka burime, por të kufizuara. Zona perspektivë për shtim kapaciteti ujore rekomandohet të jetë zona Turan-Bulgarec. Ky shtim i sasisë së shfrytëzimit kërkon projekt të mirëfilltë analitike.

### 5.2.2 Kanalizimet e ujërave të zeza dhe ujërave të shiut

Qyteti i Korçës aktualisht është i lidhur me një sistem të integruar ujërash të zeza dhe kullimi nëpërmjet tubacioneve të konsoliduara, pa pasur sistem veçmas për ujërat e zeza dhe veçmas për kullimin. Sistemi i integruar konsiderohet si problematik pasi kërkon mbingarkesë të panevojshme të rrjetit të kanalizimeve dhe të impiantit të trajtimit të ujërave të mbetura. Pra, Korça duhet të vijojë me ndarjen e sistemit të kanalizimeve nga sistemi i drenazhimit, duke ndërtuar një sistem të ri drenazhimi nën tokë. Tipografia unike e Korçës do të jetë faktori përcaktues i sistemit të kullimit të qytetit. Në zonat që gjenden në rrëpirat kodrinore (baza tradicionale), forca e gravitetit dhe rëshqitja natyrore do të përdoren për kullim dhe për furnizim me ujë. Në zonat e sheshta të qytetit,

në veçanti në zonat që identifikohen si të prekshme ndaj përmbytjeve, infrastruktura e kullimit do të integrohet në sipërfaqen e tokës për të parandaluar përmbytjet e zonave të sheshta. Ndarja e sistemit të kullimit nga sistemi i ujërave të zeza do të çojë në ofrim më të mirë të shërbimeve si dhe në një organizim racional dhe të qëndrueshëm të ndërmarrjeve publike brenda qytetit.

Në shumicën e zonave të banimit në njësitë administrative, drenazhimi i ujërave nuk përbën problem përmbytjeje, për shkak të pjerrësisë së terrenit. Por, për sa i përket ujërave të zeza, pavarësisht perceptimit të banorëve nga anketat, mungesa e kanalizime në zonë dhe përdorimi i gropave të improvizuara për derdhjen e tyre, përbën një kërcënim serioz për cilësinë e jetesës dhe mjedisit në zonë<sup>20</sup>.




Figura 18 hartë e rrjetit të kanalizimeve për ujrat e zeza për zonën e qytetit

### 5.2.3 Mbetjet e ngurta

Menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane sipas legjislacionit në fuqi është i decentralizuar, që do të thotë se kryhet në nivel njësie administrative. Aktualisht në Bashkinë e Korçës, mund të vërehet një dallim i theksuar në sistemin e menaxhimit të mbetjeve nga qyteti te fshatrat. Në qytet, grumbullimi i mbetjeve bëhet nëpër kontejnerë grumbullues të cilët pastrohen rregullisht. Mbetjet e depozituara në kontejnerë përfundojnë aktualisht në dy landfille të Korçës<sup>21</sup>, deri kur të përfundojë ndërtimi i landfillit rajonal i Maliqit. Një realitet tjetër mund të vërehet në zonat rurale të cilat akoma nuk janë të mbuluara mirë nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa më e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të rrugëve, të cilat zhvendosen nga përrenjtë ose grumbullohen në vend-depozita të hapura në natyrë. Shpeshherë këto vend-depozitime bëhen burim kontaminimi për tokën, sëmundjeje për gjënë e gjallë, prishje të peizazhit, etj. Duke qenë se në zonat rurale, tipi i mbetjeve të gjeneruara është kryesisht bujqësore, shumë familje e kryejnë vetë asgjësimin e tyre përmes djegies në gjendje të lirë.<sup>22</sup>

Nga përlogaritjet e përafërta të bëra nga grupi studimor rezulton se në këtë zonë mund të formohen jo më tepër se 200 ton mbetje urbane në ditë ose rreth 6'000 ton në muaj, që po ti shpërndajmë në njësinë e madhe, nga njëra anë nuk përbën ndonjë ndotje të madhe, por nga ana tjetër paraqet vështirësi për grumbullim dhe sistemim të tyre.

Materiali	Përbërja në %	Sasia ton/vit 2009	Sasia ton/vit 2015	Potenciali per Kompostim
Organik	53,70	17248	18860	18860
Letër dhe karton	10,54	3385	3702	3702
Plastikë e riciklueshme	13,70	4400	4812	
Qelq	5,25	1686	1844	
Metale	0,70	225	246	
Lëndë Drusore	0,62	199	218	218
Tjetër	15,50	20,80	5444	
<b>Totali i vlerësuar</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>	<b>100,00</b>	<b>22780</b>

#### ***Përbërja e mbeturinave në rajonin në studim***

Nga monitorimi i situatës rezulton se gjenerimi i mbetjeve urbane ka pasur tendencë rritje ndërsa gjenerimi i mbetjeve inerte ka pasur luhajtje. Pavarësisht investimeve për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve urbane, ai mbetet ende një problem shumë i rëndësishëm që ndikon mjedisin dhe shëndetin, veçanërisht në zonat rurale. Mbetjet depozitohen në vend-depozitime të përkohshme të caktuara që nga njësitë e mëparshme të qeverisjes vendore. Organizimi i grumbullimit, transportimit, depozitimit dhe asgjësimit të mbetjeve paraqet vështirësi të mëdha dhe kosto shumë të larta financiare për t'u përballur nga buxheti i bashkisë, veçanërisht për ato zona të urbanizuara me popullatë të ulët dhe larg qendrave të njësive administrative ose qytetit. Ndërkaq ende vazhdojnë depozitimet e mbetjeve në vende të pa autorizuar, si përgjatë brigjeve të rrjedhave ujore, rrugëve pak të frekuentuara, gropave, etj. Diferencimi i mbetjeve urbane që në origjinë nuk aplikohet dhe problem shumë të madh përbën groposja e padiferencuar e mbetjeve urbane me ato industriale e inerte. Ka probleme me teknikën e përdorur për pastrimin dhe transportimin e mbetjeve, pasi ajo është e vjetër dhe nuk plotëson standardet minimale për këtë shërbim.

Direktivat Europiane mbi të gjitha caktojnë objektivat, procedurat dhe kriteret e përgjithshme, detyrime të veçanta e të rëndësishme dhe kohën për të arritur këto objektiva. Në vendet anëtare të BE, administrata lokale krijon ligjin dhe rregulloren me anekset teknike për realizimin dhe funksionimin e landfillit (vend-groposje). Për parandalimin dhe menaxhimin e mbetjeve është vendosur një rend prioriteti në hierarkinë e mbetjeve:

- a) Parandalim;
- b) Përgatitje për ripërdorim;
- c) Riciklim;
- d) Rikuperim tjetër, p.sh. rikuperim energjie;
- e) Groposje.



Teknika që përdoren aktualisht janë ripërdorimi, riciklimi dhe groposja, ku dy të parat (riciklimi dhe rikuperimi) funksionojnë në rrugë gjysëm-informale ose plotësisht informale private, ndërsa e fundit është e organizuar me mangësitë e veta në nivel politikash publike.

Zgjidhjet teknike për eliminimin e mbetjeve të ngurta me një kosto efektive duhet të jenë të pranueshme edhe nga ana sociale. Menaxhimi i mbeturinave urbane është më kompleks se thjesht vend depozitimi i tyre në vend groposje të kontrolluar inxhinierike (landfill). Ndaj theksojmë nevojën e trajtimit të këtij shërbimi që në grumbullimin, largimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta urbane, e cila konsiston në:

- zbrazjen e kontejnerëve me makinën e përshtatshme teknologjike vetëshkarkuese;
- mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10m nga çdo kontejner;
- Pastrimin dhe fshirjen me fshesë me dorë të sipërfaqes prej 30m<sup>2</sup> rreth çdo pike grumbullimi;
- Dezinfektimin e brendësisë së kontejnerëve dhe sipërfaqes përreth, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori;
- Rivendosja e kontejnerëve të sistemuar në vendin e caktuar;
- Transportin e mbeturinave në fushën e përpunimit të tyre me makinat teknologjike vetëshkarkuese.
- Kontejnerët të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike në mjedisin urban të paracaktuar nga njësia vendore përkatëse. Dezinfektimi bëhet pas zbrazjes së çdo kontejneri, duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike.

## 5.2.4 Infrastruktura e vaditjes dhe kullimit




Figura 19 hartë e sistemit ujitës të bashkisë

Pothujse të gjithë njësitë administrative kanë probleme me ujitjen e bimëve. Njësitë administrative kryesore si Mollaj, Drenovë, Voskop dhe një pjesë e Bulgarecit janë ujitur nga kompleksi i Gjançit, nëpërmjet dy krahëve kryesorë: nga Floqi dhe Pulahë. Një pjesë e Komunës Bulgarec ujitet me Kanalin e Ventrokut. Dy janë problemet kryesorë:

I pari ka të bëjë me mungesën e infrastrukturës së ujitjes si pasojë e shkatërrimit të saj në fillim të viteve 1990. Për fat të mirë rezervuari i Gjançit nuk është dëmtuar shumë. Por dëmtim kanë pësuar kanalet kryesore nga 60 - 100% dhe të gjithë elektrostacionet. Probleme kanë dhe rezervuarët Gjonomadh, Lavadar etj.

Problemi i dytë ka të bëjë me menaxhimin e ujitjes. Për shkak të mungesave të sasive të nevojshme të ujit për vaditje, në shumë fshatra uji menaxhohet në nivele bashkësish bujqish, e për rrjedhojë shumë zona në vazhdim të kanaleve mbeten pa furnizuar mjaftueshëm, ndër të tjera<sup>23</sup>.




Figura 20 hartë e vjetër e rrjetit ujtës të Gjançit

do të mund të shmangej ndjeshëm edhe shkaku i problemit të dytë.

Zgjidhja e problemit të parë kërkon shumë investime. Projekti më madhor është riabilitimi i kanaleve kryesorë në të dy anët në jugë të fushës së Korçës (që lidhen me rezervuarin e Gjançit me aftësi ujtëse 6050 ha.). Duhet rehabilituar rreth 40 km kanale kryesorë, rreth 50 km kanale të dytë, rreth 30 vepra arti në kanalet kryesorë. Për këtë është mirë të bëhet një projekt kompleks dhe vit pas viti të kërkohen investime nga qeveria. Rrjeti i kanaleve të tjera të përballohen nga vetë fermerët. (Riparim rezervuarësh, kanale etj. ka dhe në zonat malore).

Me zgjidhjen e problemit të parë,

### 5.3 Rrugët dhe transporti

Përsa i përket projekteve të infrastruktures të transportit, përveç disa detyrimeve që burojnë nga Plan i Përgjithshëm Kombëtar, i cili aktualisht është në proces hartimi, projekte konkrete të tilla praktikisht mungojnë. Ndonse sipas Kodit Rrugor, siç do e analizojmë më poshtë duhet të ishin bërë në vijimësi që mbas aprovimit të tij. Planet Urbane të Trafikut (PUT) dhe Planet Kombëtare të Trafikut (PKT) apo dhe Planet Urbane të Transportit (PUTr), nga të cilat mund të trashëgojmë një “Kadastër të Rrjetit Rrugor” urban dhe kombëtar, mbi bazën e të cilës mund të planifikojmë më mirë “Land use”, duke përdorur në çdo rast standartet e duhura .

Nga analizat del se në vitet 2011 dhe 2012 na rezulton se kemi patur një rënie të shkallës të motorizimit në Korçë respektivisht me – 827 mjete (ose -3.66 %) dhe - 992 mjete (ose – 4.39 %), fenomen që shpjegohet me vendimin për të siguruar çregjistrimin e mjeteve jashtë përdorimi pa paguar taksat e prapambetura, dhe më tej në vitet 2013, 2014 dhe 2015 kemi patur një rritje me +1513 (ose 6.69 %) ,+2606 (ose 11.53%) dhe 3642 mjete (ose 16.12 %) të dhëna këto që shërbejnë për të parashikuar rritjen e shkallës të motorizimit dhe të flukseve të trafikut, krahas ndryshimeve demografike, social ekonomike dhe legjislativë e administrative për perjudhën horizont të PPV (2031).

Nga Plan i Përgjithshëm Vendor i vitit 2014, disa elementë karakteristik të zhvillimit të transportit mund të vihen re lehtë. Në mënyrë të përmbledhur mund të skematizohen si më poshtë:

**Tre Unazat Koncentrike:** Unaza e parë përbëhet nga baza historike e qytetit të shekullit të XIX, të zhvilluar në rrëzë të Malit të Moravës, e cila është një zonë shumë e rëndësishme për identitetin e qytetit dhe, si rezultat, duhet të konservohet dhe të ri-kualifikohet/përforcohet me aktivitete të reja të prezantuara në strukturat ekzistuese dhe në strukturat e reja, duke u harmonizuar me karakterin arkitekturor të zonës. Unaza e dytë është qyteti i shekullit të XX, i cili mban ende gjurmët e epokës socialiste dhe përfshihet brenda kufijve të unazës ekzistuese. Ndërhyrjet e planifikimit në këtë zonë duhet të synohen të arrijnë rigjenerimin dhe ri-zhvillimin e saj. Së fundmi, unaza e tretë formohet nga unaza e re e jashtme e propozuar, që përbën dhe kufirin e ri afatgjatë të zhvillimit. Kjo zonë duhet të zhvillohet si një zonë shumë-funksionale me zhvillim rezidencial të hapësirave të gjelbra të organizuar në sektorë të pavarur duke përfshirë grupe ekzistuese informale dhe të ndarë në përdorime të tjera, të tilla si zonat industriale ose infrastruktura sociale me shkallë të gjerë



dhe në nivel qyteti. Zhvillimi duhet të kryhet sipas një plani të detajuar, ndërsa përparësitë duhet të përcaktohen sipas kërkesës ekzistuese.

**Tre Akset e Zhvillimit:** Aksi i parë i zhvillimit shpalolet drejt hyrjes kryesore në qytet kur vjen nga Tirana dhe karakterizohet nga aktivitete me ndikim të ulët, aktivitete të shitjes me shumicë dhe aktivitete ekonomike/tregtare mikse që përshkojnë të gjithë qytetin për të arritur në qendër të qytetit. Aksi i dytë formohet përgjatë hyrjes në qytet nga Bilishti dhe Kapshtica dhe do të mirëpresë aktivitete ekonomike/tregtare me ndikim produktiv të ulët dhe mikse. Një aks i tretë zhvillimi del nga qendra e qytetit përgjatë rrugës që të çon në hyrje të qytetit kur vjen nga Erseka dhe pritet të ketë një karakter më pak intensiv rezidencial dhe tregtar.


**Tre Korridoret e Gjelbra:** Korridori i parë përcaktohet nga Kodrat e Moravës në vendin ku gjendet Monumenti i Varrezave të Dëshmorëve, i cili futet në qytetin historik nga lindja. Korridori i dytë përcaktohet nga Parku Rinia, i cili vijon në zonën universitare dhe vijon më tej. Së fundmi, do të zhvillohet një aks i tretë i gjelbër rigjenerimi në drejtimin nga pazari në vend depozitimin aktual të mbetjeve, i cili duhet të rehabilitohet e të kthehet në një zonë çlodhëse.



Figura 21 Koncepti i zhvillimit hapësor të PPV të Qytetit të Korçës

Për shkak të ndryshimit të njësive administrative, që janë shoqëruar me zgjerim terriore, 496km rrugë duhen trajtuar në vazhdim si rrugë urbane, nga të cilat rrugët lidhëse të qendrave të reja administrative me qytetin e Korçës duhet të klasifikohen si rrugë urbane të kategorisë së dytë, rrugët lidhëse të fshatrave me qendrat administrative si rrugë urbane të kategorisë së tretë, si dhe rrugët brenda fshatrave pjesë e Bashkis të re Korçë, duhet të konsiderohen e trajtohen si rrugë urbane lokale.





**Figura 22 Mobiliteti për punë për çdo njësi administrative sipas llojit të mënyrës të udhëtimit**

Nga analiza e treguesve të mësipërm na rezulton se nga zonat e reja administrative, mobiliteti për në punë në total në ditë i përmbledhur sipas mënyrave të udhëtimit tregon se kryhen 12'634 udhëtime/ditë, ose 59% e mobilitetit realizohet me këmbë ose biçikleta, 6'802 udhëtime/ditë ose 31 % realizohen me autovetura ose motor dhe vetëm 2'195 ose 10% udhëtime/ditë realizohen me mënyrat e tjera të mundshme të udhëtimit në këto njësi, si: minibus, taksi ose tren. Për nivelin e zhvillimit ekonomik dhe varfërisë që kemi në këto zona justifikohet një përqindje e lartë e udhëtimit në këmbë dhe me biçikleta, tregues ky i favorshëm përsa i përket “mënyrës së sjelljes” të banorëve që janë të prirur për të përdorur mënyrat e transporteve “pa karbon”. Nga ana tjetër, përdorja në një masë vetëm prej 10% e transporteve publike me autobus<sup>24</sup>, tregon shkallën e ulët të ofertes që i ofrohet këtyre zonave për përdorimin e këtyre mënyrave për efekt të largësisë nga qendra (periferialiteti), gjendja e keqe e rrugëve që lidhin këto njësi, por dhe organizimi i dobët i pamjaftueshëm i shërbimeve nga bashkia, që jo në çdo rast aplikohet sipas parimeve themelore të organizimit të shërbimeve të transportit. Parimi bazë për zgjidhjet që duhet të realizojmë kur hartojmë PPV është “parimi i zgjidhjeve të qëndrueshme”, e cila në kuadrin e mobilitetit urban duhet të merret në konsideratë që kur studiohet dhe të vendoset nga ekuilibrat në fushat e “ekonomisë”, “mjedisit” dhe “barazinë sociale”.




Figura 23 Hartë e klasifikimit të rrugëve në rrjetin rrugor të qytetit të Korçës





Figura 24 Kategorizimi i rrjetit rrugor Bashkia Korçë

Nëse fokusohemi te vlerësimi i karakteristikave gjeometrike dhe të trafikut të rrugëve të kategorive të veçanta, kërkohet të zbatohet kriteri bazë i projektimit, që parashikon lidhjen e çdo rruge, vetëm me rrugë të tjera të të njëjtës kategori ose të kategorisë paraardhëse ose pasardhëse si në figurën më poshtë, i cili nuk është zbatuar për ndonjë studim të klasifikimit të rrjetit rrugor urban në Korçë dhe as në realizimin e skemave të qarkullimi. Duhet të nënvizojmë se në studimet e analizuara të ofruara nga autoritetet lokale gjatë projektit, referencat në kriteret e Kodit Rrugor dhe udhëzimet e nxjerra në bazë të tij nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit janë të mangëta.


Klasifikimi në fjalë nuk përfshihet, përkundrazi kërkon, studimin e ndërveprimit ndërmjet transportit rrugor dhe llojeve të tjera të transportit. Po kështu një vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet



klasifikimit funksional të ndërveprimeve, me stacionet hekurudhore, aeroportet, portet dhe stacionet e transportit me teleferik, të cilat do të detajohen në Planin Territorial të PPV të Bashkisë Korçë.

Figura 25 Organizimi i Rrjeteve rrugore Urbane ne baze te “hierarkisë” te rrugëve

Në territorin e bashkisë është aktualisht e mundur që të zhvillohet edhe transporti ajror. Pozita gjeo-strategjike në rajon, i jep Korçës një avantazh shumë të madh konkurrues për shfrytëzimin e kësaj mënyre transporti me efikasitet dhe leverdi të lartë<sup>25</sup>.



#### 5.4. Konsiderimet nga direktivat kombëtare në mënyrat e transportit

Si pjesë e rëndësishme e rajonit, Bashkia e Korçës mirëpret dhe respekton direktivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar në infrastrukturën e transportit, duke ruajtur perspektivën e zhvillimit vendor dhe duke respektuar atë kombëtar, në mënyra të ndryshme transporti si: hekurudha e propozuar, aeroporti i propozuar, itineraret e biçikletave, korridori i gjelbër, etj.

### 6. Zhvillimi Social dhe Ekonomik

#### 6.1 Sektoret Ekonomike


Perlllogaritjet e llogarive kombetare dhe rajonale ne Shqiperi sipas te dhenave te INSTAT kane shkuar deri ne nivelin e Qarkut/Prefektures dhe nuk zbresin deri ne nivel te territorit te Bashkise se re. Ne kete rast analiza e indikatoreve ekonomik do te duhet te behet ne nivel Qarku per te pare trende te rendesishme. Gjithsesi ne kete rast duhtt te merret parasys se brenda Qarkut te Korces, bashkia e re e Korces eshte ne nivele me te mira te zhvillimit ekonomik se bashkite e tjera si ajo e Pogradecit, Maliqit apo e Devollit Si rrjedhoje te dhenat qe analizohen ne nivel qarku, kur projektohen per Bashkine e Korces jane me te mira.

Qarku i Korces ze 5.8% te peshes se Prodhimit te Brendshem Bruto te Shqiperise, duke ardhur ne renditje Qarku i 6-te pas Tiranës, Fierit, Durrësit, Elbasanit, dhe Vlores. Kjo e ben rajonin e Korces nje rajon me rendesi e peshe kombetare dhe si i tille trajtohet edhe nga Plani i Pergjithshem Kombetar.

Sipas te dhenave te vitit 2013 nga INSTAT, Bujqesia eshte dega ekonomike qe kontribuon me 39% te peshes ne Vleren e Shtuar Bruto (VSHB) per Qarkun e Korces duke qene ne kete menyre dega me e rendesishme per qarkun ne nivele shume me te larta se sa kjo dege eshte per mesataren e vendit (22.5%).

Nderkohe Industria Prodhuese ze vetem 7.8% te peshes se VSHB-se, duke qene ne nivele shume me te ulta se mestraja e vendit (14.4%). Ky eshte nje tregues qe kerkon vemendje ne planin strategjik pasi eshte poshte potencialeve te tij per kete qark. Po keshtu poshte mesatares se vendit jane edhe Ndertimi (8.8% ne peshe vs. 11.9% ne nivel kombetar) dhe Aktivitetet e Pasurive te Paluajtshme.

Ndarja e degeve ekonomike te VSHB-se per Qarkun e Korces,



Deget Ekonomike	Korce	Shqiperi
<i>Bujqesi/Pylltari &amp; peshkim</i>	39.1	22.5
<i>Industri Prodhuese</i>	7.8	14.4
<i>Ndertim</i>	8.8	11.9
<i>Tregti</i>	17.6	18.2
<i>Administrata Publike &amp; Mbrojtja</i>	13.8	12.8
<i>Aktivite te pasurive te paluatjshme</i>	5.6	7.3
<i>Aktivite Financiare</i>	2.4	2.6
<i>Te tjera</i>	4.9	10.3

Burimi: INSTAT dhe perpunimi nga IDRA & Bolles-Ëilson, 2014

Struktura ekonomike e qytetit të Korçës dhe njësisve administrative të Bashkisë Korçë, jepet në tabelën mëposhtme:

Njesia	Struktura ekonomike
Korçë	Industria e lehtë, tregtia, shërbimet
Drenovë	Bujqësia (panxharsheqeri, perimet)



Lekas	Bujqësia (drithërat), blegtoria
Mollaj	Blegtoria, Pemetaria (Mollet)
Bulgarec	Bujqësia (drithërat), Sherbime
Vithkuq	Blegtoria
Voskop	Bujqësia (drithërat)
Voskopojë	Bujqësia, Blegtoria, Turizmi

### Struktura e Bizneseve

Nga te dhenat e bashkise per vitin 2015 rezulton se ne territorin e Bashkise se re operojne, 3526 biznese aktive<sup>2</sup>. Rreth 17 % e bizneseve kategorizohen si biznese te medha dhe 83% si biznese te vogla.

### Bizneset Aktive ne territorin e Bashkise Korce

Njesia	Biznes Madh	i Biznes Vogel	Total	Biznesi Total (ne %)	
Korce	427	2254	<b>2681</b>	76%	<b>92%</b>
Bulgarec	99	229	<b>328</b>	9%	
Drenova	45	200	<b>245</b>	7%	
Mollaj	16	97	<b>113</b>	3%	<b>8%</b>
Voskop	5	88	<b>93</b>	3%	
Voskopoja	11	31	<b>42</b>	1%	
Vithkuq	5	19	<b>24</b>	1%	
<b>Total</b>	<b>608</b>	<b>2918</b>	<b>3526</b>	<b>100%</b>	

Burimi: Bashkia Korce

Bizneset jane te perqendruara thellesisht ne qytetin e Korces (76%) dhe ne dy njesite fqinje me qytetin, Bulgarec dhe Drenove. Eshte per tu theksuar se te tre keto njesi permbledhin 92% e te gjitha bizneseve te bashkise dhe te gjitha njesite e tjera kane vetem 8% te bizneseve aktive. Kjo eshte nje shenje e qarte e perqendrimit te bizneseve ne kete zone duke krijuar nga njera ane nje pol te rendesishem ekonomik per tu fokusuar bashkia (vijimesia Bulgarec-Korce-Drenove) por edhe nje disbalance zhvillimore qe duhet trajtuar per njesite e tjera administrative.

Shpendarja e Biznesit te madh – Bashkia Korce

	Biznes i Madh (nr)	% Biznesi Madh	
Korce	427	70%	<b>94%</b>
Bulgarec	99	16%	
Drenova	45	7%	
Mollaj	16	3%	<b>6%</b>
Voskop	5	1%	
Voskopoja	11	2%	
Vithkuq	5	1%	
<b>Total</b>	<b>608</b>	<b>100%</b>	

Burimi: Bashkia Korce


Aq me e theksuar behet kjo diference kur shqyrtohet shperndarja e bizneseve te medha ne territor. Kjo shperndarje ne fakt nxjerr ne pah edhe nje karakteristike tjeter. Duket se ka nje peshe me te madhe te bizneseve te medha ne Njesine Administrative te Bulgarecit, ku gjenden rreth 16% e te gjitha bizneseve te medha te Bashkise (krahasuar me peshen e bizneseve totale ne kete njesi) duke nenvizuar faktin se sidomos zona hyrese

<sup>2</sup> Nga te dhenat e bashkise mungojne te dhenat per Njesine Administrative Lekas, per numrin e bizneseve. Megjithate duke pasur parasysh madhesine e vogel te popullise per kete njesi ( vetem rreth 800 banore) numri I bizneseve ne kete njesi nuk ka pothuajse fare peshe ne totalin e bizneseve te Bashkise.



ne Korce e cila i perket kesaj njesie ka krijuar tashme nje pol te rendesishem sherbimesh dhe deri diku industrie qe perben nje aset per bashmkine pro kerkon gjithashtu vemendje ne trajtim.



Duke ju referuar te dhenave qe ka nxjerre INSTA per Njesite e Bashkise se Korces persa piperkete punesimit sipas sektoreve duket qartazi dominimi i sektorit te Bujqesise per njesi te tilla si Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Voskopoje. Nderkohe qe Korca ka nje peshe tejet te madhe te sektorit te Sherbimeve, eshte interesante te vihet re qe Sektori i Industrise rezulton me punesim te larte ne Njesite Adminisntrative te Drenoves dhe Bulgarecit (32,8% dhe 22.2% respektivisht). Po keshtu vihet re punesim relativisht i larte ne kete sektor ne Njesine e Mollajt (19.7%). Duke gene se Mollaj ka potenciale per industrine e agropunimit ( te fokusuar ne perpunimin e frutave kryesisht) ky indikator eshte nje shenje tjetere qe ky sektor ka mundesi te zhvillohet ne kete njesi.

### Punesimi sipas sektoreve dhe Njesive Adminisntrative



Burimi: INSTAT, Census 2011





**Konkluzione:**

Sic shihet, të ardhurat vendore qe përbëjnë rreth 45 % të të ardhurave në total të Bashkisë, varen kryesisht nga puna që bën Drejtoria e Të ardhurave Vendore, për Planifikimin, Mbledhjen, Kontrollin, dhe Rakordimin e te dhenave. Është shumë e rëndësishme që struktura e kësaj Drejtorie kyce të funksionojnë sipas këtyre sektoreve. Një nga pikat më të forta të kësaj drejtorie duhet të jetë Sektori i sistemeve IT dhe i Statistikave. Ndërthurja që kjo drejtori ka me dy databaza të rëndësishme rajonale ate te ZRPP-se vendore dhe DPSHTRR-se është e strategjike për këtë sektor për të arritur nëpërmjet sistemeve të vilen të dhenat për të krijuar bazen e saktë të tatueshme për Pronat, dhe mjetet.

Njëkohësisht, është shumë e rëndësishme me sisteme inteligjente të nxirren raporte statistikore qe bëjnë automatikisht te lexueshme realizimin e te ardhurave gjendjen e tyre në cdo kohë .



evidentimin e debitoreve në cdo kohe etj. Duke ndihmuar keshtu sektoret e tjere për të përmbushur detyrimet e tyre.

Një problematikë tjetër vihet re në përpunimin e të dhënave nga Njësitë Administrative, e cila sigurisht do të jetë burim të ardhurash dhe do të njehsohet me pjesën tjetër të të dhënave sa më shpejt. Dhe përdorimi i sistemeve eficiente ndihmon në ndarjen e statistikave sipas nevojave të përdorimit të bashkisë, me njësi administrative etj.

Gjithashtu të dhënat që mund të mblidhen nga sektorë të ndryshëm psh turizmi, por mund të mos rakordojnë plotësisht mes tyre dhe te dhenave nga drejtoria e të ardhurave.

Mungesa e një Baze të Dhënash të konsoliduar që furnizon Bashkinë me Statistika është e domosdoshme për të rritur eficiencën e Bashkisë në çdo departament. Që mban, perditëson, faturon, gjeneron statistika dhe raporte ne cdo kohe për evidentimin e gjendjees.

## Bujqesia

Bujqesia eshte sektor prioritar per zhvillimin ekonomik te Bashkise se re te Korces, i percaktuar si i tille edhe ne Planin e Pergjithshem Kombetar. Në zonën rurale të bashkisë Korçë zhvillojnë aktivitetin 9167 ferma, një numër relativisht i madh në krahasim me sipërfaqen e tokës, duke rezultuar ne ferma me madhesi te vogel , nje fenomen ky i njohur edhe ne nivel kombetar. Ne Bashkine e Korces rreth 40 për qind e fermave kanë më pak se 1 ha tokë, rreth 50 për qind 1-2 ha dhe 10 për qind mbi 2 ha. Gjithashtu njësitë rurale të Bashkisë Korçë, ndeshen me fragmetarizimin e parcelave të tokës që përbëjnë sipërfaqen e një ferme. E thënë ndryshe një fermë e ka tokën në 3-4-5 parcela. Ky fragmentarizim pengon mekanizimin si dhe perdorimin racional te sistemeve vaditese.

Njësitë vendore	Sip.a mes. e fermës (ha)	>0.5ha	0.5-1 ha	1-1.5 ha	1.5-2 ha	mbi 2 ha
Bulgarec	1.9	367	431	756	1053	634
Drenovë	1.7	183	874	632	118	23
Lekas	1.4	89	52	25	20	8
Mollaj	2	760	162	15	20	43
Vithkuq	1.5	115	304	89	40	8
Voskop	2	0	164	509	694	264
Voskopjë	1.7	7	171	353	175	9

Pothuajse tërësisht fermat ne Bashkine e Korces jane te formes familjare. Duhet theksuar se kjo tipologji nuk eshte vetem ne rastin e Bashkise Korce por eshte ne nivel kombetar. Format e tjera të organizimit ose mungojnë ose janë fillimet e veta. Dhe këtu eshte fjala per forma me baze kooperimin. **Kjo lloj forme organizimi me baze kooperimi duhet stimuluar ne planin strategjik te Bashkise.**

## Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit

Pothuajse të gjithë komunat kanë probleme me infrastrukturen e ujitjes dhe te kullimit. Komunat kryesore si Mollaj, Drenovë, Voskop dhe një pjesë e komunës Bulgarec janë ujitur nga kompleksi i Gjançit, nëpërmjet dy krahëve kryesorë: nga Floqi dhe Pulaha. Një pjesë e Komunës Bulgarec ujitej me Kanalën e Ventrokut.

Nga analiza e gjendjes dalin dy probleme kryesore:

- Mungesa e infrastrukturës së ujitjes si pasojë e shkatërrimit të saj në fillim të viteve 1990. Nderkohe që rezervuari i Gjançit nuk është dëmtuar kanalet kryesore këtu pesuar demtime të mëdha dhe po ashtu probleme kanë edhe elektrostacionet. Probleme kanë dhe rezervuarët Gjonmadh, Lavadar etj. **Projekti më madhor është rehabilitimi i kanaleve kryesore në të dy anët në jug të fushës së Korçës (që lidhen me rezervuarin e Gjançit me aftësi ujitëse 6050 ha.). Duhet rehabilituar rreth 40 km kanale kryesore, rreth 50 km kanale dytesore dhe rreth 30 vepra arti në kanalet kryesore.**
- Problemet e menaxhimit të ujitjes. Aktualisht uji për ujitjen e bimëve administrohet nga Shoqatat e ujitjes në njesite administrative që veprojnë dhe mbi bazë fshati. Keto shoqata megjithatë kanë funksionim të dobët. **Nje rol me thelbësor i Bashkise ne bashkrendimin e aktivitetit me keto shoqata do të përmirësonte punën e tyre dhe efikasitetin e menaxhimit të sistemit të vaditjes.**

## Tregtimi i produkteve bujqësore

Nje nga problemet me themelore të fermerëve të Bashkisë Korçë është gjetja e tregut për produktet e tyre bujqësore. Produktet e fermerëve vuajnë edhe konkurrencë të mallrave të importit.

Faktorët kryesorë janë:

- **Mungesa e sistemeve të magazinimit frigoriferik dhe pikave të grumbullimit. Disa produkte sidomos perimet e njoma, frutat prishen shpejt.**
- **Mungesa e një sistemi të informacionit të tregut për të përcaktuar çmimet e blerjes/shitjes, kërkesën, ofertën për produkte të ndryshme bujqësore që do të orientonte fermerët drejt produkteve dhe tregjeve të caktuara.**
- **Prodhimi në përmasa relativisht të vogla nga shumica e fermerëve. Kjo sjell dobësimin e fuqisë në treg të fermerit. Për këtë arsye duhet hallka e grumbullimit.**
- **Largësia nga tregjet për komunat malore dhe ngandonjëherë mungesa e rrugëve.**

## Agro-perpunimi

Rajoni i Korçës është një nga prodhuesit e mëdhenj të mishit dhe sallameve, bulmeteve, pijeve alkoolike dhe jo alkoolike, përpunimit të kërmillit e më tej. Sektori i industrisë ushqimore është bërë një faktor i rëndësishëm i punësimit për Rajonin e Korçës. Përpunimi i frutave dhe zrazaveve, përpunimi i qumështit, prodhimi i verës, prodhimi i vajit, miellit etj., kanë regjistruar rritje. Shumica e kompanive që operojnë në këtë sektor janë klasifikuar të vogla ose të mesme.

**Nje nga sektoret me pak të shfrytëzuar për përpunim është ai i frutit të molles. Nga njera anë Korça është rajoni kryesor i prodhimit të molleve, me një njësi administrative (Mollaj) të dedikuar thuhet ekskluzivisht për këtë prodhim, nga ana tjetër ka një industri shumë fillestare të përpunimit, trajtimit dhe paketimit të këtij produkti të rëndësishëm.**

## Turizmi

Turizmi është një nga sektoret që ka pasur zhvillimin më të madh në rajonin e Korçës në këtë dekadë të fundit. Është një nga sektoret strategjike për zhvillimin ekonomik të zonës, i përmendur edhe nga Plani i Përgjithshëm Kombëtar.

Ky turizëm është multidimensional dhe gjithë-vjetor përfshin:

- **Turizmin kulturor**

Bashkia e Korçës ka një potencial kulturor-historik të jashtëzakonshëm për tu shfrytëzuar dhe në kontekstin e turizmit. Njohja, rivlerësimi dhe marketimi i këtyre vlerave mund të sjellë një zhvillim të rëndësishëm për këto zona të mbetura pa ndërhyrje. Investime në infrastrukturën publike mund të japin një perspektivë zhvillimi banorëve vendas, si dhe turistëve vendas dhe të huaj një dimension të ri kulturor-turistik. Bashkia Korçë ka një numër të madh objektesh kulturore, historike e si muzeume, qendra kulturore e biblioteka, si dhe numëron rreth 128 objekte kulturore e natyrore që konsiderohen në mbrojtje të qytetit, sipas statuset përkatëse.

Qyteti i Korçës njihet dhe për panairët e veçanta të organizuara në periudha të ndryshme të vitit. Ndër to mund të përmendim Panairin e Poçerisë, i cili zhvillohet javën e Pashkëve Ortodokse dhe Panairin e Krishtlindjeve. Gjithashtu në qytet organizohen dhe festa të ndryshme si, Karnavalet, Festa e Lakrorit, Festivali i Ushqimit, Festa e Birrës. Ndër aktivitetet kulturore mund të përmendim Koloninë Ndërkombëtare të Piktoreve dhe Simpoziumin Ndërkombëtar të Skulptoreve.

- **Eko-turizmin**

Turizmi i lidhur me natyrën është një tjetër mundësi në rritje për territorin e bashkisë Korçë. Zona të tilla si Dardha, Voskopoja (e cila ka edhe një dimension kulturor-historik të rëndësishëm) apo Vithkuqi janë zona me potenciale të mëdha për këtë lloj turizmi.

- **Turizmin kulinar/gastronomik**

Gatimet tradicionale të Korçës tashmë janë një markë e njohur turistike. Vende të tilla si Boboshtica, Dardha, Voskopoja por edhe vete qyteti i Korçës frekuentohen nga turistët vendas dhe të huaj edhe me një orientim të dukshëm nga çështja e gatimeve lokale.

**Njohja e mirë e potencialit kulturor-historik, përcaktimi i aktiviteteve kulturore në lidhje me to dhe kalendari i tyre duhet të shtrihet në mënyrë të tillë që të stimulojë turizmin multisezonal, duke i dhënë mundësi qytetit të ketë vizitorë në çdo sezon. Prandaj dhe kalendari i aktiviteteve kulturore, nuk i shërben thjesht veprimtarisë kulturore të këtij qyteti por ai tashmë ka dhe dimensionin e tërheqjes së turistëve në këtë Bashki.**

**Turizmi kulturor mund të japë një zhvillim të rëndësishëm vecanërisht në Njësitë Administrative duke i njohur dhe profilizuar ato sipas specifikave të vecanta që kanë të përmendura dhe në paketën e strategjive të planit.**

**Njohja nga ana e Bashkisë, e Tablosë së plotë lidhur potencialin e Turizmit shumëdimensional, krijimi i një databaze të dhënash krijimi i zyrës së Turizmit pranë Bashkisë, 24-orë/7 ditë, duke ju përgjigjur çdo qytetari për informacion në lidhje me pikat turistike, aksesueshmërinë, akomodimin, kulinarinë, sigurinë etj do të ishte e domosdoshme për këtë sektor në rritje i cili duhet menaxhuar me kujdes. Fletëpaosje,faqe**


online që jep informacion të bollshëm për çdo turist, përfshirja në rrjete sociale turistike ndërkombëtare gjithashtu është një opsion që duhet të vlerësohet.

Ndërtimi i një strategjie afatmesëm në lidhje me Turizmin, duke ndërthurur të gjithë faktorët gjemjedisor, kulturor etj do të ishte i domosdoshëm për këtë fazë zhvillimi që po merr ky sektor për Bashkinë Korçë, si dhe njohja e avantazheve që vijnë nga sektorë të tjerë, nga transporti, nga zonat kufitare me destinacion turistik dhe jo vetëm, etj.

### Industria Minerare

Territori i Bashkisë së Korçës, disponon një gamë mineralesh si: krom, bakër, qymyr, argjila, gurë dekorativ, gëlqeror, gëlqeror pllakor, inerte lumi etj.

Vendburimet kryesore janë si me poshte:



Aktiviteti minerar privat në rrethin e Korçës ka filluar në vitin 2000 dhe janë efektive rreth 25 leje minerare shfrytëzimi të cilat kanë një shpërndarje jouniforme, nga të cilat 15 janë për shfrytëzimin e gurëve gëlqeror, nga 2 leje janë për qymyr guri dhe për ranor silicor dhe nga 1 leje për gëlqeror të mermerizuar, krom, bakër, argjilë dhe gëlqeror pllakor.

Lënda e parë karbonatike (gëlqerorët), argjilat gjenden në territorin e qarkut të Korçës dhe plotësojnë kushtet sasiore e cilësore të nevojshme në fushën e industrisë së ndërtimit, infrastrukturës, etj.

Të dhënat e fituara për lëndën e parë argjilore, në vendburimet e këtij qarku çojnë në përfundimin se janë të përshtatshme për tu përdorur në industrinë e qeramikës së trashë (tulla, tjegulla) dhe të çimentos.



Rivënia në punë e minierave ekzistuese të bakrit, përpunimi në vend i mineralit të bakrit do të çonte në shtimin e punimeve të kërkim-zbulimit për shtim të rezervave në gjithë objektet e këtij qarku.

Për shkëmbinjtë dhe mineralet industriale interes të veçantë kanë rërat kuarcore të cilat pas një pasurimi në rrugë të lagur mund të përdoren si lëndë e parë për fajance dhe qelq. Gëlqerorët, troktolitet, të kompletuar me studime mbi bllokshmërinë si dhe uniformitetit të ngjyrës paraqesin interes për tu përdorur për vetitë dekorative.

Efektiviteti i përdorimit të qymyreve të zones mund të rivleresohet si lëndë djegëse për përdorim në prodhimin e tullave, tjegullave, prodhimin të energjisë, në situatat e sotme të rritjes së çmimit të energjisë elektrike.

### **Industria e konfeksioneve**

Kjo industri përbën një faktor të rëndësishëm në ekonominë rajonale. Është dega më e madhe në kuptimin e numrit të ndërmarrjeve, me të punësuar kryesisht gra. Në shumicën e rasteve shoqëri të përbashkëta Shqiptaro – Greke, kompanitë punojnë në sektorin e konfeksioneve. Gjithë lënda e parë vjen nga jashtë dhe produktet eksportohen totalisht gjithashtu.

### **Sektori i Ndërtimit**

Në rajonin e Korçës ka disa kompani ndërtimi, që kryesisht veprojnë në fushën e ndërtimeve private dhe ndërtimeve tregtare, shërbime ndërtimi për projekte publike dhe në prodhimin e materialeve të ndryshme të ndërtimit. Disa nga ndërmarrjet e ndërtimit kanë krijuar struktura të mirëorganizuara dhe përpiqen të krijojnë marrëdhënie kooperimi internacionale. Ndërtimi ka paraqitur një dinamikë të lartë ekonomike dhe përbën një potencial të madh për rritjen e ekonomisë dhe punësimit. Pavaresisht se projkesioni i popullsisë është në rënie për bashkinë e Korçës, tregu i shtëpive për banim në qytetin e Korçës për shkak edhe të levizjeve demografike drejt qendrës së urbanizuar nga zonat ruale por edhe të kthimit të emigranteve, *do të mbetet i qëndrueshëm në perspektivën afat mesme*

## 6.2 Situata Social-Ekonomike

### Arsimi

#### Niveli Arsimor

Bashkia e Korces eshte nder ato rajone qe tregon nje nivel me te larte te arsimit te popullise krahasuar me mesataren kombetare dhe me Bashki te tjera te ngjashme ne Shqiperi. Rreth 32% e popullise 15 vjec e lart ka te perfunduar arsimin e mesem dhe rreth 14% ka te perfunduar arsimin e larte. Keto shifra jane deri diku me te larta (me te mira) se mesatarja kombetare por duke pasur parasysh qe mesataren kombetare e ngre lart Bashkia e Tiranës me numrin e madh te atyre qe kane mbaruar arsimin e larte, Bashkia Korce shfaqet me mire se shume bashki te tjera te ngjashme ne Shqiperi.

Gjithashtu shkalla e analfabetizmit, ne nivelin 2.3% per bashkine e Korces, eshte me e ulet se shkalla e analfabetizmit mesterisht ne nivel kombetar (2.8%). Ky nivel eshte me i ulet edhe krahasuar me bashki te tjera te ngjashme.

	Niveli I analfabetizimit	% e popullise me arsim e-9 vjecar	% e popullise me arsim te mesem	% e popullise me arsim te larte
Shqiperi	2.8%	52.1%	31.4%	11.8%
<b>Bashkia Korce</b>	<b>2.3%</b>	<b>49.4%</b>	<b>32.2%</b>	<b>13.7%</b>
Bashkia Elbasan	3.50%	53.90%	29.90%	10.80%
Bashkia Fier	2.8%	52.1%	31.4%	11.8%
Bashkia Vlore	2.70%	44.4%	36.2%	14.4%
Bashkia Shkoder	2.70%	52.20%	31.90%	11.50%
Bashkia Tirane	1.6%	31.4%	39.6%	25.3%

Burimi: Census 2011, perpunim IDRA & Bolles-Ëilson

Njesite me nivelin me te larte te analfabetizmit jane ato te Voskopojes (4.1%), Drenoves (3.9%) dhe Mollaj (3.6%). Nderkohe qe duke perjashtuar qytetin e Korces, njesita administrative pjesen dermuese te popullise 15 vjec e lart e kane me nivel arsimor 8-9 vjecar qe reflekton edhe natyren ruralo-bujqesore te ketyre zonave.

Njesia	Niveli i analfabetizimit	% e popullise me arsim e-9 vjecar	% e popullise me arsim te mesem	% e popullise me arsim te larte
BULGAREC	2.9	71.47	20.74	3.72
DRENOVË	3.9	59.11	21.73	5.16
KORÇË (Qytet)	2.0	39.79	37.97	18.49
LEKAS	0.6	79.81	15.14	3.79
MOLLAJ	3.6	74.66	16.74	3.12
VITHKUQ	1.3	69.84	24.8	2.76
VOSKOP	2.1	72.3	20.34	3.45
VOSKOPOJË	4.1	70.71	19.49	3.27

**Bashkia e Korces shfaq nje avantanzh krahasues persa i perket nivelit arsimor te popullise kur krahasohet me bashki te tjera te ngjashme. Nje element i tille konsiderohet i rendesishem persa i perket cilesise se forces punetore.**


### **Aksesi ne arsim**

Ne Bashkine e re te Korces gjenden 51 kopshte, 52 shkolla 9-vjecare dhe 12 shkolla te mesme. Nderkohe qe funksionon vetem 1 (nje) Cerdhe publike, ndersa ka dy te tilla ne sektorin privat.

Kopshtet ne qytetin e Korces jane ndertime te viteve 70-85 dhe vetem nje kopsht i ri eshte ndertuar vitet e fundit. Gjithsesi duhet thene se me perjashtime te vogla eshte nderhyre pothuajse ne te gjitha ndertesat e kopshteve per ti rikonstruktura ( ne qytet). Persa i perkete kopshteve ne njesite adminstrative ato jane te bashkangjitura ne godinat e shkollave te fshatrave. Te gjitha kopshtet ne Njesite Adminsitrativte jane pa ushqim. Duhet theksuar se ofrimi i sherbimit te kopshteve ne klasa shkolloare eshte jashte standarteve te kesaj grupmoshe.

Ne qytetin e Korces nga 11 shkolla 4 i jane neshruar rikonstruksionit te plote ndersa 7 te tjera kane nevojte per nje gje te tille. Ne njesite administrative gjendja infrastruktorore e godinave eshte me problematike.

% e nxenesve ne arsim te mesem dhe profesional ne  
Bashkine e Korces



*Burimi: bashkia Korce, perpunim IDRA – Bolles-Wilson*

Jane 5 shkolla te mesme te pergjithshme ne Bashkine e Korces nga te cilat 3 gjenden ne qytetin e Korces dhe 2 te tjera jane shkolla te bashkuar ne njesine administrative te Voskopit dhe te Mollajt.


Eshte per tu theksuar se Bashkia e Korces ka nje mbulim shume te mire (ne nivele shume me te larta se mesatarja kombetare) me arsim profesional. Jane rreth 50% e te gjithe nxenesve te regjistruar ne arsim e mesem qe vazhdojne arsimin profesional ne Bashkine e Korces sipas te dhenave te bashkise.

Bashkia e Korces ka 7 shkolla profesionale:

- Shkolla mekanike "Demir Progri"
- Shkolla e Ndertimit
- Agrobiznesi "Irakli Terova",
- Teknologjika "Isuf Gjata"
- TIK "Fan Noli",
- Shkolla e gjuheve te huaja "Faik Konica"
- Shkolla e muzikes "Tefta T. Koco".



SISTEMI ARSIMORE  
Ndarja sipas kategorive  
Shkalla 1: 120000



BASHKIA KORCE  
BURIMI: MAS  
PERPUNIMI: IDRA

Figura 26 Harta e shperndarje se shkollave kopshteve

### Konkluzione

Infrastruktura e objekteve ekzistuese është një nga problemet kryesore në ofrimin e shërbimit arësor, godina të vjetra të amortizuara jashtë standarteve, ngrohja etj. Megjithëse ka pasur investime në vitete e fundit, nuk ka përfunduar ende rikonstruksioni i të gjithë godianve aktuale.

**Ndërtimi i Cerdheve dhe Kopshteve te reja në Njësitë Administrative ku nuk ka te tilla, si dhe në qytet në zonat e urbanizuara dhe ne rritje për ti krijuar akses të barabartë të të gjithë banorëve në shërbimet publike.** Qyteti ka nevojë për te pakten 2 (dy) cerdhe te reja nje ne Jug dhe nje ne veri te qytetit. Gjithashtu mund te hapen edhe 4 cerdhe ne qendrat e Njesive Administrative Bulgarec, Drenove, Voskop, Mollaj. Ri-planfikimi i funksioneve për shkollat ekzistuese që nuk përdoren, duke i kthyer ato në kopshte në ato Njësi Administrative ku nuk ka te tilla. Riorganizimi i stafit, do të contë dhe ne rritje te efciences, duke ulur raportin edukator-fëmijë.

**Mbulimi me shërbim arësor ne njesite administrative ka nevojë te shihet dhe konsolidohet duke u fokusuar jo thjesht tek aksesit ne nje godine shkollore por ne cilesine e standarteve te kerkuara (bashkimi i shkollave ne njesi me te madhe duke siguruar transport nxenesish nga qendrat e vogla rurale/fshatrat).**

**Per institucionet arsimore te bashkise Korce jane te domosdoshme zhvillime projektsh per efciensen e energjise.**

**Per shkollat profesionale duhet pare hapja e degeve te reja qe kane kerkesa ne tregun e punes, tej atyre tradicionale. Hapja e degeve ose stimulimi i të rinjve (me bursa psh) nga njësitë**

administrative për degë profesionale që kanë lidhje me profilin që do të ketë njësia administrative në turizem kulturor, apo sportiv, natyror, etj.

## Shendetesia

Shërbimi i kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimi spitalor është një shërbim i centralizuar në nivel qeverisje vendore. Edhe pse shpesh është diskutuar decentralizimi i sistemit të kujdesit shëndetësor parësor, ende s'ka ndodhur. Por si shkalla e parë e kujdesit shëndetësor të qytetarëve aksesit në këtë shërbim është shumë i rëndësishëm. Gjatë këtyre viteve janë konsoliduar institucionet bazë që ofrojnë këto shërbime, si poliklinikat, qendrat shëndetësore, ambulancat dhe shërbimet e veçanta të konsultorit të fëmijëve dhe të gruas, të përfshira në këto institucione. Sipas Instat qarku i Tiranës, Korçës dhe Elbasanit kanë numrin më të lartë të këtyre institucioneve ku është përqëndruar pjesa kryesore e popullsisë, po sipas Instat, qytetet e mëdha shpesh duke pasur dhe shërbimet e specializuara në kujdesin parësor, spitalore kanë përqëndrimin më të madh të institucioneve shëndetësore publike. Dhe rrjedhimisht dhe kualifikim më të lartë e specializim unik për semundshmëri të caktuara. Numri i shtretërve në spitale në Shqipëri ka rënë në spitale me rreth 13% midis 2003 dhe 2013( sipas Instat)

Korca funksionon dhe si qendër rajonale shëndetësore cfarë i siguron punësim, një fuqi punëtorë më të kualifikuar, si dhe ndërveprimi më Bashkitë e tjera brenda Qarkut.

Institucionet	Qarku Korçë	Bashkia Korçë
Numri i poliklinikave	5	
Numri i Qendrave shëndetësore	40	7
Numri i Ambulancave	214	4
Numri i Konsultoreve të fëmijëve	249	
Numri i Konsultoreve të gruas	244	

Aktiviteti i spitaleve, 2013, Qarku i Korçës, përfshin 4 Spitale, 752 shtreter , te shtruar rreth 16000-17000 paciente ne vit.

## Punesimi

Analiza e papunesise kerkon se pari kuptimin e perkufizimeve te papunesise qe lidhen me indikatorët statistikore te raportuar.

INSTAT perdor dy lloje te dhenash mbi tregun e punes:

- Te dhena administrative ( Zyrat e Punes)
- Te dhena nga Anketa e Punes


Te dyja burimet kane nevojë per nje trajtim te kujdesshem kur u referohemi shifrave. Ne rastin e te dhenave administrative jane dy probleme me perkufizimin:

- Te papune quhet ata te cilet jane regjistruar ne zyrat e punes si te tille. Pra cdo person i cili nuk eshte i regjistruar atje nuk llogaritet ne segmentin e te papuneve.
- Cdo person ne fshat qe ka toke/are konsiderohet i punesuar (pavaresisht sezonalitetit apo mundesise qe me kete toke te mund te mbaje gjithe familjen).

Ne rastin e te dhenave nga anketa e punes gjithashtu ka nje problem me perkufizimin. Të punësuar, sipas INSTAT konsiderohen persona që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës (një jave). Konceptin ne kete rast e “deformon” disi ideja e punes qe behet ne fermen/token e vete te personit pasi konsiderohet i punesuar qofte edhe sikur te kete punuar pak gjate javes se references. Keta persona qe punojne ne token e tyre, edhe ne qofte se prodhojne vetem per vetkonsum (pra nuk shesin prodhimet e tyre) konsiderohen te punesuar.

Te dhenat me te plota per papunesine te cilat shkojne deri ne nivel njesie administrative, per Bashkine e Korces, vijne nga Censusi 2011.


### Niveli i papunesise ne Bashkine e Korces sipas njesive administrative



Burimi: Census 2011,  
Perpunimi IDRA & Bolles-  
Wilson

### Niveli i papunesise se te rinjve sipas njesive administrative

Te dhenat tregojne qe nga Papunesia vuajne me se shumti Drenova (34.9%), qyteti i Korces (28.9%) dhe Bulgareci (24.4%). Jane pikerisht keto 3 njesi qe jane vijimesi e njera-tjetres dhe qe mbajne peshen me te madhe migrimit te brendshem. Kjo zone eshte edhe zona qe duhet te jete fokus i politikave per nxitjen e punesimit duke krijuar kushtet e nevojshme per sipermarrje, rigjenerim dhe krijim




industrië perpunuese, infrastrukturë të pershtatshme për shërbime dhe mundësi tregjesh grumbuluese për zonat e tjera.

Papunesia e të rinjve (mosha 15-24 vjeç) është edhe më shqetësuese duke kapur shifra deri në 60% të këtij segmenti moshor për qytetin e Korçës dhe Nj.A. të Drenovës.

Nderkohe që duhet theksuar se pavarësisht se shifra e papunesisë e raportuar për njësitë e tjera administrative (si Lekas, Vithkuq e deri diku Voskopojë, Voskop e Mollaj) është relativisht e ulët, kjo vjen për shkak të kategorizimit të popullsisë aktive për punë në këto zona si e punësuar pasi ka gjendje të keqe bujqësore.

Te punësuar me rruge vs. Te vetpunësuar



Burimi: Census 2011, Perpunimi IDRA & Bolles-Ëilson

page. Përjashtim ben qartësisht qyteti i Korçës ku rreth 72% e të punësuarve janë me pagesë dhe 29% deklarohen të jenë të vetpunësuar.

Ne fakt në sume raste ekonomia bujqësore e këtyre zonave është në nivelin e vetkonsumit dhe nuk krijon të ardhura të majftueshme për familjet prandaj ky tregues duhet trajtuar me kujdes nga politikat e punësimit.

Pikërisht për shkak të natyrës bujqësore të njësive administrative në këto njësi dominojnë të vetpunësuarit kundrejt atyre të punësuar me

## Mirëqenia Social Ekonomike

### Mbrojtja shoqërore dhe varfëria

Ndihma Ekonomike përbën një nga programet e Mbrojtjes Sociale, që jepet në formën e një pagese mujore në para për familjet dhe individët që kanë më shumë nevojë për mbështetje nga shteti. Shpërndarja e numrit të përfituesve të ndihmës ekonomike në Bashkinë Korçë, është:



## Familjet me ndihmë ekonomike

NJËSIA ADMINISTRATIVE	FAMILJE N/E	NR. FRYMËVE	NR. FAMILJE KOMPENSIM ENERGJIE	FONDI ENERGJI	SHUMA NË LEK
Qyteti	945	2444	218	281784	3658294
Njësitë	235	836	84	108192	730659
Shuma	1180	3280	302	389976	4388953

Burimi: Bashkia Korçe

## Fondi mesatar i ndihmës ekonomike: Vjetari statistikor 2015: Instat

Qarku	2010	2011	2012	2013	2014
Shqipëria	334 437	362 579	360 921	387 987	297 447
Tirana	36 149	45 894	49 172	64 670	34 282
Korça	25 930	29 877	28 319	28 398	25 503

## Bashkia Korçë: Vjetari statistikor 2015: Instat

Ndihma ekonomike	Total
Korçë	1073
Drenovë	59
Lekas	40
Mollaj	51
Bulgarec	10
Vithkuq	25
Voskop	26
Voskopojë	25

Familje me ndihmë sociale dhe përfitimet e tjera<sup>3</sup><sup>3</sup> Grafiku IDRA,

## Sfidat lidhur me skemën e Ndhmës Ekonomike.

Një reforme e gjerë e skemave të NE-së dhe PAK-ut po ndodh me mbështetjen e Projektit për Modernizimin e Asistencës Sociale (PMAS) të Bankës Botërore. Lidhur me këtë skemë, Bashkitë do të kenë mundësi të krijojnë databasat e tyre për të gjithë qytetarët që trajtohen në skemën e ndihmës ekonomike dhe sociale.

Hapi kryesor është evidentimi i familjeve sidomos në zonat e thella të njësive administrative për të pasur një njohje të mirë të regjistrit të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike në të gjithë bashkinë.

Krijimi i kësaj databaza dhe lidhja me shërbimet e tjera sociale mbetet një sfidë dhe një mundësi për të përmirësuar situatën sociale në bashki, punësimin, ri-integrimin social, dhe akses në shërbime të tjera të bashkisë. Sepse dalja nga skema ekonomike e këtyre familjeve duhet të jetë fokusi kryesor i Bashkisë, dhe ndihma e fëmijëve të këtyre familjeve të përfitojnë nga skema e arësimit, me qëllim zbutjen e varfërisë.

Kursimet nga ky fond i ndihmës ekonomike do të shërbejnë Bashkisë për investime të tjera në fushën sociale, krijimin e qendrave të shërbimeve sociale të specializuara.

## Aftësia e kufizuar.

“Pagesa e Aftësisë së Kufizuar” (PAK) është pjesë e programit të Mbrojtjes Sociale dhe shërben për të mbështetur njerëzit me aftësi të kufizuara dhe përmirësuar cilësinë e jetesës. Aktualisht PAK është mekanizmi i vetëm për mbështetjen e tyre, pasi vlerësohen për nivelin e aftësisë së kufizuar nga komisionet mjekësore të caktimit të aftësisë për punë (KMCAAP).

Shpenzimet për pagesat e aftësisë së kufizuar janë rritur ndjeshëm në vitet e fundit dhe tashmë përbëjnë pjesën kryesore në shpenzimet e Mbrojtjes Sociale. Kjo është shkaktuar nga indeksimi i lartë i përfitimit dhe mbulimi i zgjeruar. Masa e pagesës për aftësinë e kufizuar është shumë më e lartë se masa e NE-së.

Sfidat e mëtejshme të politikës lidhen me vlerësimin e kritereve të aftësisë së kufizuar, rishikimin e masës së pagesave të aftësisë së kufizuar në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane dhe riintegrimin e PAK-ut me shërbimet sociale dhe shëndetësore.

Bashkia Korçe, duhet të planifikojë në të gjitha projektet e saj, si dhe investimet ndërhyrje për personat PAK, duke i siguruar barazi, modiskriminim, aksesueshmëri, autonomi, përfshirje etj.

## Shërbimet e Kujdesit Shoqëror

Keto shërbime janë pjesë e Programit të Mbrojtjes Sociale, të financuara nga buxheti i shtetit. Aktualisht ka mangësi në mbulimin e të gjithë nevojave për shërbime të grupeve vulnerabël në nivel kombëtar. Shërbimet të kujdesit shoqëror të specializuara janë siguruar nga organizatat jofitimprurëse e financuara në baza vullnetare ose nga partnerët. Shërbimet mund të gjenden kryesisht në zonat e mëdha urbane dhe shumë pak në zonat rurale.

Ndryshe nga skemat e pagesave të NE dhe PAK, sfida këtu është ngritja e një sistemi shërbimesh të kujdesit shoqëror që të mund mbulojë më gjerë nevojat e grupeve në nevojë për shërbime shoqërore të integruara dhe efikase.

Sfidat e mëtejshme e Bashkisë mbetet njohja e nevojave për shërbime specifike, të oganizuara në

qendra ofrimi shërbimesh, si në qytet dhe ne zona rurale si dhe plotësimi i tyre, duke ofruar dhe donacione të ndryshme për ti ofruar këto shërbime, ose bashkëpunime me shoqata te specializuara duke ju ofruar asete ne perdorim. Për të siguruar, barazi në ofrimin e shërbimeve, dhe për të rritur cilësinë e jetës në cdo personi dhe familje në territorin e Bashkisë Korçe.




Figura 27 hartë e qendrave shëndetësore në Bashkinë e Korçës

Ofrimi i shërbimeve në qendra ditore kundrejt atyre rezidenciale, është një kërkesë në rritje nga standartet e ofrimit të shërbimeve.

### Kategoritë e personave me paaftësi të cilët marrin shërbime pranë bashkisë Korçë.

Shuma e pagesave për të gjitha kategoritë e paaftësive, rreth 40 600 000 Lekë

Kategoritë	Nr. i Personave
Invalidë	3073
PAK	1983
Kujdestarë	178
Të verbër	247
Kujdestarë	91
Paraplegjikë/Tetraplegjikë	159
Kujdestarë	152
TOTALI	5883

Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuar dhe e kujdestarëve në Bashkinë Korçë<sup>4</sup>:

Ndihma sociale	Persona me aftësi të kufizuar	Të verbër	Paraplegjikë dhe Invalide Tetraplegjikë	Total pune
<b>Drenovë</b>	98	21	11	148
Kujdestarë	13	6	11	0
<b>Lekas</b>	12	4	0	8
Kujdestarë	1	1	0	0
<b>Mollaj</b>	77	7	12	71
Kujdestarë	13	4	6	0
<b>Bulgarec</b>	158	14	18	219
Kujdestarë	21	8	18	0
<b>Vithkuq</b>	33	5	2	34
Kujdestarë	4	1	2	0
<b>Voskop</b>	79	11	5	66
Kujdestarë	2	3	5	0
<b>Voskopojë</b>	30	3	0	33
Kujdestarë	5	1	0	0
<b>Total</b>	<b>487</b>	<b>65</b>	<b>48</b>	<b>579</b>
<b>Kujdestarë</b>	<b>59</b>	<b>24</b>	<b>42</b>	<b>0</b>

125

## Strehimi

Sipas të dhënave nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, të regjistruara si kërkesa për strehim figurojnë rreth 2400 kërkesa, por kjo shifër gjithmonë sipas sektorit të strehimit mund të mos jetë e saktë plotësisht. Për këtë arsye Verifikimi i kësaj liste është në proces, pasi mendohet të ketë dhe regjistrime fiktive për efekt dokumentash në Greqi etj. Sipas drejtorisë mendohet se numri i saktë është rreth 700.

Gjithsesi duke iu referuar dhe Ligjit të Strehimit, kompetencave dhe decentralizimit gjithmonë e më të madh që po marrin Bashkitë për funksionin Social, iu takon Bashkive të bëjnë planet 10-vjeçare të strehimit duke përdorur të gjithë burimet e mundshme financiare. **Përdorimi i aseteve të bashkise për ndërtimin e banesave me kosto të ulët, do të ishte një mjet shumë i mirë për të plotësuar kërkesat për strehim në një afat të shkurtër të Bashkisë Korçë. Duke pasur tokën, do të ishte më e lehtë të gjenden burimet financiare nga shteti apo donatorë të ndryshëm.**

Nr.	Numri i familjeve që kanë aplikuar për strehim që nga muaji Janar i vitit 2005	Banesa sociale me	Banesa me kosto të ulët	Truall të pajisur me infrastrukturë	Bonus strehimi	Total
	Nga këto kategoritë sipas nenit 5, të ligjit nr. 9232/2004					

<sup>4</sup> PPV Korçë, faqe. 70



1	Apl. L. 9232, dt 13.05.2004	1255	1202		<b>2457</b>
2	Krvefamiare grua e divorcuar	492			<b>492</b>
3	Fam. një prind ngark. fëmijë	425			<b>425</b>
4	Invalidë gjithsej	466	140		<b>606</b>
	Të verbër	7			<b>7</b>
	Paraplegji	36			<b>36</b>
	Invalidë	423	140		<b>563</b>
5	Jetimë	31			<b>31</b>
6	Familje me shumë fëmijë	202	49		<b>251</b>
7	Cifte të reja deri 55 vjeç	15	51		<b>66</b>
8	Të moshuar në pension vetë	13			<b>13</b>
9	Emigrantë të kthyer	38	35		<b>73</b>
10	Emigrantë jashtë shtetit	19	50		<b>69</b>

Burimi: PPV Korça

## Demografia

Analiza demografike është baza mbi të cilën mbështeten të gjitha elementet planifikuese të planit të përgjithshëm vendor. Duke pasur parasysh të gjitha zhvillimet demografike, levizjet e medha migratore të 20-25 viteve të fundit, është shumë e rëndësishme një analizë e thelluar në këtë aspekt.

Se pari, duhet theksuar se momentalisht në Shqipëri ka dy lloje burimesh që përdoren në lidhje me shifrat e popullsisë:

1. Të dhënat e popullsisë sipas Gjendjes Civile
2. Të dhënat e popullsisë sipas Censurit të vitit 2011

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat e regjistrit të Gjendjes Civile për çdo njësi administrative të bashkisë së Korçës.

BASHKIA	Popullsia	% ndaj totalit	Nr. Familje	Gjinia		Grupmoshat		
				Meshkuj	Femra	0-14 vjeç	15 -64 vjeç	>65 vjeç
Korçë	86,693	67%	29,870	42,294	44,399	10,025	64,000	12,668
Drenovë	10,650	8%	3,559	5,519	5,131	1,318	7,831	1,501
Mollaj	6,607	5%	1,802	3,385	3,222	1,143	4,654	810
Vithkuq	2,397	2%	707	1,219	1,178	335	1,650	412
Bulgarec	14,030	11%	3,913	7,197	6,833	2,398	9,782	1,850


Voskop	5,953	5%	1,632	3,080	2,873	1,030	4,134	789
Lekas	828	1%	337	426	402	64	625	123
Voskopojë	2,647	2%	781	1,368	1,279	444	1,893	310
<b>Total</b>	<b>129,805</b>		<b>42,601</b>	<b>64,488</b>	<b>65,317</b>	<b>16,757</b>	<b>94,569</b>	<b>18,463</b>
				<b>50%</b>	<b>50%</b>	<b>13%</b>	<b>73%</b>	<b>14%</b>
Urbane	<b>67 %</b>							
Rurale	<b>33 %</b>							

Burimi: Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile, Janar 2016

Sipas Gjendjes Civile, Bashkia e Korces ka nje popullsi prej **129 805 banore** (Janar 2016). Rreth 67% e gjithë kesaj popullsie banon ne Qytetin e Korces. Njesia Administrative me e madhe pas qytetit te Korces, eshte Bulgareci me 14 030 banore ( rreth 11% e totalit te Bashkise) e ndjekur nga Drenova me 10 650 banore (8% e totalit te Bashkise). Te dyja keto njesi kane nje lidhje direkte me qytetin duke qene zgjatime te tij nga ana veriore (Bulgarec) dhe ana jugore (Drenove). Se bashku keto njesi te lidhura ne menyre direkte perbejne rreth **86% te totalit** te popullsisë se bashkise se Korces.


Njesite e Mollaj (6 607 banore) dhe Voskopit (5 953 banore) mund te konsiderohen si njesi adminsitative mesatare nga pikepamja demografike me nga 5% te totalit te popullsisë secila. Ndersa njesite e Vithkuqit (2 397 banore) dhe Voskopojes (2 647 banore) mund te konsiderohen si nje si te vogla demografikisht me rreth 2% te totalit te popullsisë secila. Njesia e Lekasit eshte nje rast i vecante i Bashkise se Korces, me nje popullsi prej vetem 828 banoresh ne nje siperfaqje shume te madhe gjeografike. Nje njesi demografikisht shume e vogel ne nje hapësire shume te madhe territori.

Rreth 13% e popullsisë, sipas Gjendjes Civile, eshte e moshes 0-14 vjec, qe nenkupton moshen e femijeve, me se shumti ne arsim te detyrueshem (e rendesishme sidomos per planifikimin e arsimit parauniversitar). Rreth 73% e popullsisë eshte ne moshen 15-64 vjec qe nenkupton moshen aktive per pune dhe 14% e popullsisë eshte ne moshen 65 vjec e lart, qe




nenkupton moshen ekonomikisht jo-aktive.

Ndersa kemi konsideruar deri tani shifrat e dhena nga Regjistri I gjendjes Civile eshte per t'u vënë re diferenca që ekziston midis ketij numri dhe atij që ka vlerësuar Censusi i vitit 2011 për Bashkinë e Korces. Numri i raportuar nga Censusi 2011 per Bashkine e Korces eshte rreth 41% me i ulet numri qe raporton Drejtoria e Pergjithshme e Gjendjes Civile per 2016 (shiko grafikun). Nje diference e tille eshte shume konsiderueshme dhe mund te ndikojë ne perlogaritjet e ndryshme te planit te pergjithshem vendor.



Sipas te dhenave te INSTAT, kjo diferencë vjen kryesisht si pasojë e migrimit (të jashtëm e te brendshem), pra personave/familjeve që janë larguar dhe jetojnë diku tjetër por që figurojnë ende në regjistrat e gjendjes civile në ato zona.

Krahasimi i dy burimeve nxjerr edhe nje problem tjetër persa i perket strukture moshore te popullsisë. Nderkohe qe te dhenat e Gjendjes Civile nxjerrin ne pah nje strukture moshore solide persa i perket segmentit ekonomikisht aktiv (15-64 vjec) me 73% te popullsisë totale, Censusi 2011 rezulton me nje ulje te peshes se ketij segmenti duke e cuar ne nivelin e 68% te popullsisë totale te bashkise. Hipoteza qe mund te ngrihet ne kete rast eshte se pikerisht kjo moshe ekonomikisht aktive mund te jete ajo qe ka qene pjese e levizjeve migratore me shume se segmentet e tjera moshore.



Popullsia në Bashkinë e Korces anon qartazi nga pesha e saj URBANE me 67% te te popullsisë totale kundrej 33% te asaj RURALE. Ky është një raport edhe me i mire krahasuar me treguesin në nivel kombëtar ku 57% e popullsisë konsiderohet Urbane dhe 43% Rurale (Burimi: INSTAT).

Nga pikepamja e ofrimit te sherbimeve publike, nje raport i tille e favorizon Bashkine ne planifikim duke qene se ka nje perqendrim te larte popullsie ne zonat ku infrastruktura eshte relativishti me e konsolidiaur dhe ku aksesis ne institucione eshte me i larte.

### Raportet e Varesise (Popullsi ekonomikisht

#### Aktive kundrejt Jo-aktive)

Struktura moshore e popullsisë eshte e rëndesishme per te vleresuar raportet e varesise se atyre segmenteve qe me gjasa jane te varura ekonomikisht (femije + te moshuar) dhe qe jane

“konsumatore neto” ndaj atyre qe jane me gjasa ekonomikisht aktiv, (Prodhues Neto). Ndryshimet ne kete raport jane te domosdoshme per te pare se cfare politikash mbeshtetese jane te nevojshme nga pikepamja sociale dhe ekonomike. Nje nivel i larte varesie nenkupton qe popullsia aktive dhe ekonomia ne pergjithesi perballet me nje barre te madhe per te mbeshtetur dhe ofruar sherbime sociale tek moshat e reja dhe moshat e vjetra.

Te dhenat e perpunuara per Bashkine e Korces tregojne qe treguesi i varesise per kete bashki eshte ne nivele me te mira se treguesi per Shqiperine ne total, nese do te nisemi ng ate dhenat e Gjendjes Civile. Sipas ketyre te dhenave treguesit i Varesise se Pergjithshme per Korcen eshte 37%, qe do te thote se per cdo 100 persona ekonomikisht aktive jane per tu mbeshtetur 37 persona ekonomikisht jo-aktive ( femije dhe te moshuar). Ky tregues per Shqiperine eshte 43%. Ne terma konkrete kjo do te thote se, sipas gjendjes civile, kjo Bashki ka nje popullsi aktive me peshe te madhe duke krijuar nje potencial te madh njerezor per zhvillimin ekonomik. Kjo popullsi e ka moshen aktive, dhe nese ekzistojne mundesite per punesim mund te behet nje aset i rendesishem ekonomik.

Megjithate ka nje problem kur te dhenat krahasohen me ato qe sugjeron censusi 2011. Sipas ketij Censusi edhe struktura moshore nuk eshte ajo qe raporton Gjendja Civile. Censusi 2011 e nxjerr Raportin e Varesise se Pergjithshme 47%, duke nenkuptuar qe pesha e popullsisë ekonomikisht aktive eshte me e ulet sesa ajo e raportuar nga Gjendja Civile. Hipoteza me e qendrushme eshte qe kjo popullsi, ne kete moshe aktive, eshte me e prirur te emigroje/migroje dhe prandaj ky raport ndryshon (pra ky segment ka levizur me shume nga Bashkia e Korces ne drejtim te zonave te tjera brenda apo jashte Shqiperise).

	Gjithsej	0-14 vjec	15-64 vjec	65+ vjec
Bashkia Korce - Gj.C 2016	<b>129,805</b>	<b>16,757</b>	<b>94,569</b>	<b>18,463</b>
Bashkia Korce- Census 2011	<b>75,994</b>	<b>12,222</b>	<b>51,394</b>	<b>12,108</b>
<b>Struktura ne %</b>				
Bashkia Korce - Gj.C 2016	100	13%	73%	14%
Bashkia Korce- Census 2011	100	16%	68%	16%
Shqiperi - GJC 2016	100	18%	69%	13%
Shqiperi - Census 2011	100	20%	68%	12%

Raporti i Varesise Totale - Korce	
Bashkia Korce- Gj.C 2016	37%
Bashkia Korce - Census 2011	47%
Shqiperi - INSTAT 2016	43%
Shqiperi - Census 2011	47%




Njesia	Gjendja Civile 2016			Census 2011		
	Varesia Totale	Varesia e te rinjve	Varesia e te moshuarve	Varesia Totale	Varesia e te rinjve	Varesia e te moshuarve
Korçë	35%	16%	20%	46%	22%	24%
Drenovë	36%	17%	19%	51%	25%	26%
Mollaj	42%	25%	17%	55%	31%	24%
Vithkuq	45%	20%	25%	55%	25%	30%
Bulgarec	43%	25%	19%	50%	28%	22%
Voskop	44%	25%	19%	51%	29%	22%
Sheshit qendror të Voskopojës, në të cilin ndodhet një monument i periudhës së realizmit socialist, do t'i bashkëngjitet një infrastrukturë e re bashkëkohore që do të shërbejë për riorganizimin e hapësirës qendrore dhe aktiviteteve në të.

Pjesa e lapidarit vetë do të lihet e paprekur. Poshtë shkallareve, në anën e djathtë të tij do të vendosen shkllët që dërgojnë te Dhoma e Historisë.

Nga ana e kundërt e Dhomës do të vendoset një hapësirë e re komplekse që do të shërbejë për hapësira ekspozite, rekreative dhe vrojtimi të peizazhit nga sheshi qendror. Hapësira përreth do të rregullohet gjithashtu me 7 vend-parkime të cilat do të vijëzohen në tokë duke përdorur teksturën ekzistuese të shtrimit të sheshit.






Figura 36 skicë e sheshit qendror të Voskopojës të rikonceptuar në perspektivë





## Fisha e projektit 2

Titulli i projektit	By-Pass-Verior qytetas										
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Permiresim i sherbimeve te Transportit Qytet i paster, pa ndotje; -Rritja e sigurise per banoret Korca Bashki me infrastruktur e Logjistikë bashkohore transporti si "Porta Kryesore" Juglindore e vëndit në Koridorin VIII										
Përshkrimi i Projektit	Eliminimi i trafikut ne mjedisin e brendshem urban, i lidhur me praninë e trafikut te Koridorit VIII , qe mund te mos anashkalohet nga By-Pass-Verior qytetas dhe qe duhet te shmang nga mjedisi I brendshemi qytetit flukset e trafikut qe vijne nga juglndja dhe nga Njesit e rja administrative dhe kane destinacion jasht qytetit te Korces										
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<p>- <b>Planifikimi I Projektit, fazave te tij /planifikimi financiar</b> Pjes e Planit te Transportit te Bashkis . By-Passi do te projektohet per tu realizuar ne tre Faza Faza e pare: 1,1957km, Faza e dyte: 2,0068km , Faza e trete: 0.9533km</p> <p>- <b>Sensibilizimi I komunitetit si dhe vleresimi I Impaktit Mjed</b> Të promovohet për tu përfshirë në "Planin te Transportit te Bashkis Korce bypass-e, në ktegorin e Atostradë Urbane që përshkon pjesen veriore dhe perendimore të qytetit në aksin SH75 (në Kategorin A1 per tu bashkuar ne pjesen Veriore të Qytetit të Korçës në aksin SH3, në drejtim të Kakavisë (Kategoria A ), Studim fisibiliteti</p> <table border="0"> <tr> <td>- Miratimi I Projektit sipas baze ligjore ne fuqi</td> <td>Plani Kombetar I Transportit</td> </tr> <tr> <td>- Miratimi I Buxhetit</td> <td>Qeveria</td> </tr> <tr> <td>- Procesi I Tenderimit</td> <td>Autoriteti Rrugor Shqiptar</td> </tr> <tr> <td>- Procesi I Zbatimit</td> <td>MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar</td> </tr> <tr> <td>- Procesi I Monitorimi e Kolaudimit te Projektit</td> <td>Auditim i Siguris Rrugore MIT- ARRSH</td> </tr> </table>	- Miratimi I Projektit sipas baze ligjore ne fuqi	Plani Kombetar I Transportit	- Miratimi I Buxhetit	Qeveria	- Procesi I Tenderimit	Autoriteti Rrugor Shqiptar	- Procesi I Zbatimit	MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar	- Procesi I Monitorimi e Kolaudimit te Projektit	Auditim i Siguris Rrugore MIT- ARRSH
- Miratimi I Projektit sipas baze ligjore ne fuqi	Plani Kombetar I Transportit										
- Miratimi I Buxhetit	Qeveria										
- Procesi I Tenderimit	Autoriteti Rrugor Shqiptar										
- Procesi I Zbatimit	MIT- Autoriteti Rrugor Shqiptar										
- Procesi I Monitorimi e Kolaudimit te Projektit	Auditim i Siguris Rrugore MIT- ARRSH										
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Institucionale dhe ligjore										
Partnerët	Institucionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit,										
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	- Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimi Qeveria										
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	Indikatorët qe masim Realizueshmerine e Projektit dhe pershkrim I Impaktit qe do te kete Projekti I Realizuar Qytet i paster, pa ndotje; -Rritja e sigurise per banoret										



## Fisha e projektit 3


Titulli i projektit	<b>KRYQEZIMET ME RRJETIN KRYESOR QENDROR SHQIPTAR</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	<b>Permiresim i sherbimeve te Transportit:</b> Projekti eshte hartuar per te ulur vonesat dhe radhet e makinave ne disa nga kryqezimet me te ngarkuara ne rrejtin e rrugeve primare.qehyne dhe dalin ne qytetin e Korces nepermjet nepermjet rrjetit rrugor qendror nga drejtimi nga Tirana , Pika kufitare e Kapshtices dhe rruga qe lidhet me Erseken dhe te aksit juglindor (shif pikat me rreth te kuq ne harten me poshte)
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, cfare do te arrije : Ne perputhje me rezultatet e modelimit dhe simulimeve te trafikut ne flukset e pritshme te trafikut ne koridorin VIII sipas sipas studimit te ANTP jane percaktuar nyjet e kryqezimeve me te rendesishme te renditura me poshte: - Nyje kryqezimi Nr. 1 ne bypass-in verior – hyrja dalje per Tirane indrtuar ne by-pasin e qytetit me kategori A1 - Nyje kryqezimi Nr. 2 ne bypass-in verior – hyrja dalje per Kapshtic indrtuar ne by-pasin e qytetit me kategori A1 - Nyje kryqezimi Nr. 3 ne bypass-in ne pjesen juglindore te qyteti ne drejtim te Ersekes Fazat e zbatimit te ketij projekti lidhen ne menyre te drejteperdrejte me zbatimin e projekteve te By-pasit
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	Per cdo nyje kryqezimi ne disnivel parashikohen fazat e meposhtme: - Projektimi sipas funksioneve te rrugeve qe lidh kryqezimi; - Blerja e tokes per zgjerim te karrexhatave; - Ndertimi i mbikalimit ose nenkalimit; - Asfaltim; <i>Veprimet Strategjike Faza A</i> Ndertimi i dy kryqezimeve ne disnivel si me poshte: (Kjo faze varet nga zbatimi i projektit 1.1.1.2: - Nyje kryqezimi Nr. 1 ne bypass-in verior ne drejtim te Tiranes - Nyje kryqezimi Nr. 2 ne bypass-in drejtim te Kapshtices Faza B Ndertimi i nje kryqezimeve ne disnivel ose rrethrotullim i madh ne varsi te flukseve te trafikut te llogaritura si me poshte: - Nyje kryqezimi Nr. 3 ne bypass-in per ne Ersek
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Institucionale dhe ligjore : - Krijimi I departamentit te transportit ne Bashkia - Matjet e trafikut
Partnerët	Institucionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit: <b>Bashkia Korce &amp; ARRSH</b>
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	<b>Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimit</b> <i>Kostoja e vleresuar e ndertimit</i> 6 000 000 Euro Qeveria dhe Bashkia <i>Rrisqet</i> Bashkia nuk ehste ne gjendje te perballoje koston e ketyre investimeve.
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	Indikatoret qe masim Realizueshmerine e Projektit dhe pershkrim I Impaktit qe do te kete Projekti I Realizuar : <i>Justifikimi i Projektit</i> - Rritje e sigurise ne rruge; - Trafik i lehtesuar; - Ulje e bllokimit te trafikut. <i>Objektivi i gjere</i> Eliminimi i trafikut qe kryqezohet me mjedis urban,te automjeteve te lehte dhe t rend, i lidhur me pranine e aksit kombetar koridori VIII <i>-Impakti i Pritur</i> Ndertimi i mbikalimeve do te lehtesoj dukshem trafikun ne te gjitha pjeset e qytetit si dhe do te rrishte treguesit e trafikut per qytetin e Korces <i>Faza e projektit</i> Draft project <i>Vleresimi I prioriteteve</i> Afat shkurter <i>Pergatitja e projektit</i> Dy vjet



*Punimet e Zbatimit* Pesë vjet

#### Fisha e projektit 4

Titulli i projektit	<b>PROJEKT I PERMIRESIMIT TE KRYQEZIMEVE RRUGORE ne Qytet</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Permiresim i sherbimeve te Transportit : Bllokime te shpeshta te trafikut perreth qendres se qytetit
Përshkrimi i Projektit	<p>Ku konsiston projekti, cfare do te arrije : Disa kryqezime te rendesishme qe ndodhen perreth zones qendrore te Qytetit te Korces, te cilet kane aktualisht ngarkese te madhe trafikute dhe kane shfaqur probleme sigurie dhe funksionimi, do te permiresohen persa i perket shtrirjes dhe sinjalistikes rrugore. Ne kete projek jane perfshire 5 kryqezime (shih hartën me poshte). Permiresimi i kryqezimeve do te koordinohet me masa te tjera ne drejtim te investimeve kapitale. (ku eshte e zbatueshme te realizohen keto projekte ).</p> <p><i>Objektivi i gjere</i> Transport me i mire urban dhe zhvillimi i aftesise se planifikimit struktural si baza per nje zhvillim pozitiv te qytetit.</p> <p><i>Objektivi Specifik</i> Permiresimi i sistemit te menaxhimit te trafikut nga Bashkia</p>
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<p>Per secilin nga kruqezimet jane parashikuar keto masa veprimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Projektimi sipas funksioneve te rrugeve qe lidh kryqezimi;</li> <li>- Blerja e tokes per zgjerim te karrexhatave</li> <li>- Parashikimi i sistemit kullues</li> <li>- Trajtimi i trotuareve</li> <li>- Instalimi i semaforeve (nese duhet).</li> <li>- Instalimi (nese duhet) te shenjave te trafikut.</li> <li>- Instalimi (nese duhet) i tabelave te levizshme per stacionet dhe itinerarin e autobuseve</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Instrukionale dhe ligjore	<p>Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Instrukionale dhe ligjore :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngritja e departamentit te Transportit ne Bashki</li> <li>- Matje trafiku</li> </ul>
Partnerët	Instrukionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit Bashkia & Konsulenti
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	<p>- Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimit :</p> <p><i>Kostoja e vleresuar e ndertimit</i> 300 000 Euro , burimet e financimit nga Bashkia Korce</p> <p><i>Rrisqet</i> Buxheti i kufizuar</p>
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	<p>Indikatorët qe masim Realizueshmerine e Projektit dhe pershkrim I Impaktit qe do te kete Projekti I Realizuar :</p> <p><i>Projekti do te siguroj</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritje te kapaciteteve te kryqezimeve;</li> <li>- Rritje te sigurise se kembesoreve;</li> <li>- Rritje te sigurise se automjeteve;</li> <li>- Zvogelim kohes se humbur ne kryqezime;</li> <li>- Rritje te frekuences te sherbimeve te transportit publik.</li> </ul> <p><i>Impakti i Pritur</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qytet i paster, pa ndotje</li> <li>- Rritja e sigurise per banoret</li> </ul>



## Fisha e projektit 5


Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret : REHABILITIMI I RRUGEVE URBANE TE QYTETIT</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Permirosim i sherbimeve te Transportit : Gjendja ekzistuese e rrjetit rrugor kerkon nje projekt teresor per rehabilitimin e tij.
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, cfare do te arrije : Projekti konsiston ne rehabilitimin e rrjetit te rrugeve paresore dhe dytesore te qytetit Korces (afersisht 121 km) duke perfshire marrjen e ketyre maseve: - nga trajtimi i siperfaqes dhe shtrimit per te perfunduar me rindertimin dhe parashikimin e sistemit te drenazhimit, ne varesi te gjendjes aktuale te cdo nyjeje. Te gjitha kryqezimet midis rrugeve te kategorise se pare e te dyte do te permisohen nga ana strukturore dhe funksionale. Sinjalistika vertikale dhe horizontale dhe shenjat rrugore jane te pershira ne projekt. Priori tetet do te percaktohen ne pjesen e dyte te studimit.
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<i>Veprimet Strategjike</i> <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Faza A - Percaktimi i standarteve per rehabilitimin e rrugeve dhe cmimi per njesi. - Percaktimi i programit per rehabilitimi e rrugeve. - Dhenja e perparise sipas analizes ekonomike, funksionimit dhe gjendjes aktuale te rrugeve. - Pergatitja e projektit teknik dhe dokumentave per tender per dy vitet e para te zbatimit te projektit <input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Faza B1, B2, etj. - Zbatimi i punes bazuar ne dy vitet e para te ndertimit; - Pergatitja e projektit teknik dhe dokumentave per tender per dy vitet e para te zbatimit te projektit. <i>Impakti i Pritur</i> - Qytet i paster, pa ndotje - Rritja e sigurise per banoret. <i>Rrisqet</i> Buxhet i kufizuar. <i>Kostoja e vleresuar e ndertimit</i> Shenim: Veprimet Baze Strategjike
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Institucionale dhe ligjore: Krijimi I departamentit te transportit prane Bashkis dhe trajnimi i stafit
Partnerët	Institucionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit : <span style="float: right;">Bashkia</span>
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	- Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimit : Bashkia e Korces & Fondi i Zhvillimit Rajonal . 46 000 000 Euro vlersohet kostoja paraprake e te gjithes koston se projektit.Duke marre parasysh kerkesat e medha per fonde Konsulenti propozon te perfshihen vetem disa faza ne projektin 10 vjecar per rehabilitim e rrugeve. Shuma fikse vjetore per te gjithes kohezgjatjen e projektin 15 vjecar mund te percaktohet nga nje politike e pershtatshme financiare
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	- Indikatoret qe masim Realizueshmerine e Projektit dhe pershkrim i Impaktit qe do te kete Projekti I Realizuar : Vlersimi I gjendjes te rrjetit rrugor nepermjet percaktimit te “nivelit te komoditetit ne transport” ne Bashki nepermjet treguesit “IRI” i percaktuar nga BB si kriter per mirmbajtjen e rrjetit Rrugor Qendror Shqiptar ne kontraten e fundit per programin e Mirmbajtje te rrjetit rrugor me nje fond prej 120 miljon \$ me MIT <i>Rezultatet e pritshme te Projektit</i> - <input type="checkbox"/> Ulja e koston per mirembajtjen e mjeteve. - Rritje e kapacitetit lidhes te transportit - Rritje te shpejtesise mesatare te udhetimit. - <input type="checkbox"/> Permisim i sigurise - <input type="checkbox"/> Permisim i mjedisit. <i>Objektivi i gjere i ketij projekti eshte</i> krijimi i nje mjedisi qe mundeson nje zhvillim teresor dhe miqesor ndaj mjedisit te Bashkise. <i>Objektivi Specifik</i> Rehabilitimi i rrugeve qe ndikojne ne zhvillimin e qytetit

## Fisha e projektit 6

Titulli i projektit	<b>Titulli i Projektit Konkret RREGULLORE E KLASIFIKIMIT RRUGEVE URBANE</b>
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	<b>Permiresim i sherbimeve te Transportit:</b> Problemet e rregullimit te trafikut dhe te parkimit ne qytetin Korces kane nevojte per nje Rregullore te Klasifikimit te Rrugeve Urbane ne Qytetin e Korces .
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, cfare do te arrije : Qellimi i ketij projekti eshte percaktimi i klasifikimit te rrjetit rrugor urban, i karakteristikeve gjeometrike, funksionin dhe prioritetet e rrjetit rrugor, ne perputhje me prioritetet funksionale, administrative dhe organizative te percaktuara sipas Kodit Rrugor te Shqiperise.
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimi I Projektit, fazave te tij /planifikimi financiar</li> </ul> <p>Ky projek po pregaditet nga Konsulenti , duke prodhuar grafina e rrjetit rrugor ne GIS , dhe do te plotesohet ne vijim nga Stfi i Bashkis , perkatesisht nga departamenti i urbanistikes dhe i Transportit (propozuar qe te ngrihet prane Bashkis se re) duke realizuar inventarizimin e rrjetit rrugor si nje baze enevojshme te dhenash per nje planifikim shkencor te gjithe projekteve dhe studimeve te transportit ne kete bashki</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sensibilizimi I komunitetit si dhe vleresimi I Impaktit Mjedisor</li> </ul> <p>Nepermjet ketij projekti ,qytetaret duhet te njihen me ndryshimet qe do te kryhen ne te ardhmen ne rrjetin rrugor urban te qytetit te tyre , per te dhene mendime dhe sygjerime praktike ne kete drejtim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Miratimi I Projektit sipas baze ligjore ne fuqi</li> </ul> <p>Projekti mbeshitet ne kerkesen per hartimin e PUT sipas Kodit Rrugor dhe miratohet nga Keshilli Bashkiak</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Miratimi I Buxhetit</li> </ul> <p>Behet nga Bashkia per te mbuluar shpenzimet per vrojtuesit qe do te punojne ne teren per plotesimin e te dhenave te nevojshme te percaktuar ne manualin perkates qe do pergaditet nga konsulenti.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesi I Tenderimit Bashkia</li> <li>- Procesi I Zbatimit Bashkia</li> <li>- Procesi I Monitorimi e Kolaudimit te Projektit Bashkia</li> </ul> <p>Shenim: Veprimet Baze Strategjike : Kryesisht do te punohet nga ekspertet e gjisit ne bashki dhe te dhenat plotesuese qe kerkohen nga formulary per plotesimin e te gjithe te dhenave te ketij inventarizimi ,dhe qe me pas do te hidhen ne Bazen e te dhenave GIS sin je baze te dhenash per te gjithe projektet e te ardhmes .</p>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Institucionale dhe ligjore : Ne kete kuader eshte propozuar ngritja e “Departamentit te Transportit” ne Bashki
Partnerët	Institucionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit : Konsulenti dhe Bashkia Korce
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimit :</li> </ul> <p>Kosto e ketij projekti do te shperndahet ne kohe pasi projekti do te realizohet ne faza , fillimisht ne inventarizimin e rrjetit rrugor primar , pastaj te rrjetit rrugor sekondar dhe ne fund te rrjetit rrugor terciar (lokal) Burimet financiare do te jene te Bashkis . Kosto e perafert 300 000, Euro</p>



<p>Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti</p>	<p>Indikatorët që masim Realizueshmërinë e Projektit dhe përshkrimi i Impaktit që do të ketë Projekti I Realizuar :</p> <p>Produkti i këtij projekti fillimisht do të jetë një “Manual” i cili do të përdoret për të përditësuar me përmirësimin progresiv të rrjetit rrugor duke iu referuar çdo rrugë me standartet përkatëse gjeometrike dhe funksionale.</p> <p><i>Projekti do na siguroj</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Inventarin e rrjetit rrugor të Korçës në përputhje me sistemin e identifikimit të rrugëve;</li> <li>- Klasifikimin dhe përcaktimin funksional për çdo rrugë të rrjetit rrugor të Korçës;</li> <li>- Krijimi i manualit të parë për rrugët urbane. Të këtij qyteti</li> </ul> <p><i>Objektivi i gjere</i></p> <p>Mbeshtetje për transportin ekzistues dhe inkurajimi i strukturave të reja të transportit që janë premtuese për zhvillimin e levizshmërisë për Korçën dhe rajonin metropolitan të Bashkisë.</p> <p><i>Objektivi Specifik</i></p> <p>Perforcimi i kapaciteteve të administratës qytetare për mbështetjen e transportit dhe trafikut në qytet. Dizajni urban dhe planifikimi i infrastrukurës rrugore duke u mbështetur në standartet bashkekohore dhe database të përpikta.</p> <p><i>Rrisqet</i> Mundësi të kufizuara të stafit ekzistues të bashkisë për të realizuar inventarin e plote të rrjetit rrugor të qytetit pa trajnimin e duhur.</p> <p><i>Faza e projektit</i> Koncept.  <i>Vlerësimi i prioriteteve</i> Afatmesëm.  <i>Punimet e Zbatimit</i> Një vit.</p>
---	--



## Legjenda

- Rr.kryesore kombetare
- Rr.kryesore urbane
- Rr.lokale urbane
- Rr.dytesore urbane

SKEMA E HARTIMIT TE  
GRAFIT TE RRJETIT  
RRUGOR

**Fisha e projektit 7**

Titulli i projektit	
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik: Permiresimi i Sherbimeve te Transportit Programi: Programi I Zhvillimi te Transportit
Përshkrimi i Projektit	Ku konsiston projekti, cfare do te arrije
Fazat e Projektit Dhe Termat Kohor	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimi I Projektit, fazave te tij /planifikimi financiar</li> <li>- Sensibilizimi I komunitetit si dhe vleresimi I Impaktit Mjedisor</li> <li>- Miratimi I Projektit sipas bazez ligjore ne fuqi</li> <li>- Miratimi I Buxhetit</li> <li>- Procesi I Tenderimit</li> <li>- Procesi I Zbatimit</li> <li>- Procesi I Monitorimi e Kolaudimit te Projektit</li> </ul> <p>Shenim: Veprimet Baze Strategjike</p>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Per te beret e mundur realizimin e projektit, te evidentohen me pare nderhyrjet Institucionale dhe ligjore
Partnerët	Institucionet Pergjegjese per Realizimin e Projektit,
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kostimi I Projektit dhe Burimet e financimit</li> </ul>
Treguesit e Monitorimit dhe Rezultatet e pritshme nga Projekti	Indikatorët qe masim Realizueshmerine e Projektit dhe pershkrim I Impaktit qe do te kete Projekti I Realizuar

**Fisha e projektit 8**

Titulli i projektit	Rregjistrimi I Aseteve Vendore pranë ZVRPP Korçe
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik: Zhvillimi i potencialit Bashkiak per krijimin e nje klime atraktive për tërheqjen e investimeve vendase dhe te huaja në Korçe, si dhe bashkepunim ndërkufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundesive per punesim. Programi: Program specific për menaxhimin e Aseteve
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në fuqizimin ekonomik të Bashkisë, duke rritur kolateralin e saj</li> <li>- do te zgjeroje mundësitë e përdorimit të asetëve vendore për qëllime publike</li> <li>- Do të krijojë mundësi për zhvillim dhe bashkëpunim me sektorin privat</li> <li>- Do të krijojë mundësi për thitjen e kapitalit të huaj dhe vendas</li> <li>- Do të rrisë mundësinë për të krijuar të ardhurave vendore të tjera.</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Do të ishte e nevojshme nje marëveshje me ZVRPP Korçe, për rregjistrimin pa tarifë të asetëve vendore, ose VKM për të shmangur këtë pagesë për të gjitha Bashkitë.
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	

**Fisha e projektit 9**

Titulli i projektit	Hartimi i strategjise per terheqjen e kapitalit te huaj dhe promovimin e mundesive per investime ne Bashkine e Korces - Bashkepunim me AIDA
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik: Zhvillimi i potencialit Bashkiak per krijimin e nje klime atraktive për tërheqjen e investimeve vendase dhe te huaja në Korçe, si dhe bashkepunim ndërkufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundesive per punesim. Programi: Program specific për tërheqjen e kapitalit të huaj në Korçe
Përshkrimi i Projektit	Ky project do te orientoje me mire Bashkinë për të gjithë synimet dhe masat që duhet te marre në drejtim të përthithjes se investimeve te huaja dhe vendase ne Korçe. <ul style="list-style-type: none"> <li>- Do te jape masat konkrete qe do te merren per te arritur keto objective</li> <li>- Do te orientojë buxhetet dhe investimet</li> <li>- Do te hape një perspective të re per mundesi zhvillimi ekonomik e punesimi.</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Miratim Brenda strukturave te Bashkise
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj

Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	30.000 Euro
--	-------------

**Fisha e projektit 10**

Titulli i projektit	Plan Masash për përdorimin e Aseteve vendore
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik: Zhvillimi i potencialit Bashkiak per krijimin e nje klime atraktive për tërheqjen e investimeve vendase dhe te huaja në Korce, si dhe bashkepunim ndërkufitar me qëllim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundesive per punesim. Programi: Program specific për menaxhimin e Aseteve
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në fuqizimin ekonomik të Bashkisë, duke rritur kolateralin e saj</li> <li>- do te zgjeroje mundësitë e përdorimit të aseteve vendore për qëllime publike</li> <li>- Do të krijojë mundësi për zhvillim dhe bashkëpunim me sektorin privat</li> <li>- Do të krijojë mundësi për thitjen e kapitalit të huaj dhe vendas</li> <li>- Do të rrisë mundësinë për të krijuar të ardhurave vendore të tjera.</li> <li>- Do të shmangë shpenzimet e tepërta që ka Bashkia në menaxhimin e tyre</li> <li>- Do të balancojë kërkesën gjithmonë e më në rritje për asete të Bashkisë për nevoja publike të ndryshme.</li> <li>- Do të menaxhojë në mënyrë të drejt shpërndarjen e tyre sipas funksioneve duke shmangur vendimmarrjet e shpejta.</li> <li>- Hedhja e tyre në GIS me funksione, sip, dhe cdo informacion të duhur do te ndihmojë në planifikimin e të dhënave të ndryshme në lidhje me asetet vendore.</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Instrukionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	



## Fisha e projektit 11

Titulli i projektit	Ndërtimi I një Sistem I integruar me Institucionet qendrore dhe lokale ZVRPP, DPSHTRR, TATIMET, NJA , të cilat janë të lidhura me bazen e Tatueshme të pushtetit vendor. Rivleresimi I sakte I bazes se tatueshme vendore me qellim maksimizimin e te ardhurave vendore (qyteti dhe Njesite e reja Administrative)
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Zhvillimi i potencialit bashkiak per krijimin e nje klime atraktive per terheqjen e investimeve vendase dhe te huaja ne Korce si dhe bashkepunimi nder-kufitar me qellim zhvillimin e biznesit dhe rritjen e mundesive per punesim. Programi ; Program Specifik per zhvillimin e biznesit dhe finacave vendore te qendrueshme
Përshkrimi i Projektit	Ky projekt do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërtimi I një sistemi te integruar i cili do te kete ne kohe reale te dhenat për basen e tatueshme ne te gjithë bashkine, qender dhe NJA si dhe I lidhur me ZVRPP, dhe DPSHTRR</li> <li>- Njohje me te mire te bazes se tatueshme</li> <li>- Shpejtesi ne mbjedhjen e informacionit dhe Planifikimit</li> <li>- Gjenerim Statistikash sipas nevojave për Planifikim Strategjik dhe njohjes se situates faktike</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Akt- Marreveshje me ZVRPP dhe DPSHTRR
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	

## Fisha e projektit 12

Titulli i projektit	Hartimi I nje strategjie lokale per zhvillimin e bujqesise (infrastruktura per te ngritur nje sistem te kontrolluar te produkteve nga fermeri te konsumatori)
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Ngritja dhe fuqizimi i nje rrjeti te mbeshtetjes institucionale dhe infrastrukurore per zhvillimin e Bujqesise ne Bashkine e Korces si nje motorr i zhvillimit ekonomik te zones ne teresi Programi ; Programi i mbeshtetjes Institucionale per Bujqesine
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në orientimin e Bashkisë për këtë sector të ri të transferuar</li> <li>- Perkthimin e strategjive qendrore ne ato locale</li> <li>- Menaxhim më të mirë të këtij sector per te krijuar mundesi zhvillimi ekonomik per banoret</li> <li>- Fuqizim të fermereve nepërmjet ndihmes se pushtetit local ne zinxhinir ushqimor</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	30.000 Euro

**Fisha e projektit 13**

Titulli i projektit	Verifikimi dhe dixhitalizimi i Bonitetit
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Ngritja dhe fuqizimi i nje rrjeti te mbeshtetjes institucionale dhe infrastrukturore per zhvillimin e Bujqesise ne Bashkine e Korces si nje motorr i zhvillimit ekonomik te zones ne teresi Programi ; Programi i mbeshtetjes Institucionale per Bujqesine
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë :
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	

**Fisha e projektit 14**

Titulli i projektit	Ndërtimi i tregut të bagëtisë për zonën e qytetit
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Ngritja dhe fuqizimi i nje rrjeti te mbeshtetjes institucionale dhe infrastrukturore per zhvillimin e Bujqesise ne Bashkine e Korces si nje motorr i zhvillimit ekonomik te zones ne teresi Programi ; Programi i mbeshtetjes Institucionale per Bujqesine
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimin e shitjes se bagetisë</li> <li>- Rritjes se kontrollit nga ana e bashkise si fiscal ashtu edhe higjieno-sanitar</li> <li>- Eleminim e ndotjes,</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	12.000.000 lek

**Fisha e projektit 15**

Titulli i projektit	Hartimi I nje strategjie lokale per zhvillimin e bujqesise (infrastruktura per te ngritur nje sistem te kontrolluar te produkteve nga fermeri te konsumatori)
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Transformimi I Korces ne Destinacion Turistik me shume dimensione, kultuor, artistic, natyror, eko-turizem, të shijes etj. Programi ; Program i zhvillimit te Turizmit
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në orientimin e Bashkisë për këtë sector ekonomik te rendesishem</li> <li>- Perkthimin e strategjive qendrore ne ato locale</li> <li>- Menaxhim më të mirë të këtij sector per te krijuar mundesi zhvillimi ekonomik per banoret</li> <li>- Menaxhim me te mire fiscal</li> <li>- Orientim te investimeve per te nxitur kete sektor</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	20.000 euro

**Fisha e projektit 16**

Titulli i projektit	Ngritja e nje strukture informuese per turizmin ne sheërbim te turisteve vendas e te huaj (7 ne 24) ku te informohet mbi cdo gje, nr. E shtreterve te lire, cmimet, info per turistet per farmaci spitale nr. Emergjente kulinari etj.
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Transformimi I Korces ne Destinacion Turistik me shume dimensione, kultuor, artistic, natyror, eko-turizem, të shijes etj. Programi ; Program i zhvillimit te Turizmit
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në orientimin me te mire te Turistëve dhe nxitjen e Multi- Turizmit</li> <li>- Nje orientim me te mire të Bashkise lidhur me Fluksin sezonet dhe problematikat qe duhen zgjidhur</li> <li>- Stimulim te bizneseve vendase</li> <li>- Njohje te mire të bizensit local nga ana e Bashkise</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	6.000.000 lek

**Fisha e projektit 17**

Titulli i projektit	Projekt per sistemin qendror te ngrohjes per qytetin e Korces
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit bazuar në burimet vendore të Bashkisë Programi : Programi per Menaxhimin e Energjise Alternative
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në orientimin e Bashkisë për të përdorur burime alternative të energjise se sektorë të ndryshem të shërbimev publike</li> <li>- Do të ndihmojë në gjejtjen e rugeve me eficiente nga pikepamja e eleminimit të ndotjes se mjedisit, dhe asaj financiar.</li> <li>- Do të krijojë mundësi të reja për Zhvillimin Ekonomik të Bashkisë Korce</li> <li>- Do te hape mundesi për shfrytëzimin e energjise alternative per ngrohje, ndricim etj..</li> <li>- Do te krijoje munds për ulje te shpenzimeve publike të qytetit</li> <li>- Do ta beje Korce, bashki pilot në rajon</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	

**Fisha e projektit 18**

Titulli i projektit	Rigjenerimi i kurorës së gjelbër të Moravës
Objektivi Strategjik/ Programi (SËOT)	Objektivi Strategjik : Mbrojtja dhe zhvillimi i mjedisit bazuar në burimet vendore të Bashkisë Programi : Programi per Menaxhimin e Energjise Alternative
Përshkrimi i Projektit	Ky project do të ndikojë : <ul style="list-style-type: none"> <li>- Do te rrisë kuroren e gjelbër dhe elminoje ndotjen ne mjedis</li> <li>- Do të krijojë mundësi për turizem mjedisor</li> <li>- Ndërgjegjësojë qytetaret e Bashkisë për rëndësinë që kanë pyjet për situatën mjedisore të bashkisë së tyre,etj</li> </ul>
Ndryshimet e nevojshme Institucionale dhe ligjore	Brenda strukturave te Bashkisë
Partnerët	Bashkia, FZHR, donator të huaj
Burimet e nevojshme per realizimin e projektit	20.000.000 lek



## VI. Vlerësimet e qytetarëve

### 9. Anketat dhe rezultatet e nxjerra prej tyre

#### 9.1. Objektivat dhe metodologjia

IDRA & Bolles-Wilson përgatitën dhe kryen një anketë përfaqësuese të popullsisë së Bashkisë së Korçës me këto objektiva:

- Matjen e vlerësimit që kanë qytetarët në lidhje me aspekte të ndryshme të jetesës në këto zona
- Matjen e vlerësimit për një sërë shërbimesh publike të ofruara në zonat ku ata jetojnë
- Vlerësimin e prioriteteve të ndryshme që kanë qytetarët në lidhje me jetesën e tyre

Anketa, është zbatuar me një metodologji rigoroze për të siguruar përfaqësueshmërinë dhe rastësinë e përzgjedhjes së personit për tu anketuar. Ajo është një platformë shumë e rëndësishme për të mbledhur dhe analizuar opinionet, vlerësimet, dhe eksperiencat e qytetarëve për çështje të zhvillimit strategjik të Bashkisë.

Anketimi u krye gjatë periudhës mars-prill 2016. Numri i të anketuarve ishte gjithsej 600. Të gjithë personat e intervistuar i përkasin moshës 18 vjeç e lartë. Nga këta 600 të anketuar, 300 janë përzgjedhur me banim në zona rurale ndër të gjithë territorin e bashkisë, ndërsa 300 të tjerët në zona urbane.

Për mënyrën e përzgjedhjes së tyre është përdorur një metodologji që të intervistuarit të ishin sa më rastësor. Në fillim territori është ndarë në njësi primare të kampionimit në zona gjeografike të mbuluara sipas qendrave të votimit. Këto njësi janë grupuar në zona urbane dhe rurale. Përzgjedhja e njësive primare të kampionimit më tej është bërë sipas një algoritmi që ka probabilitet proporcional me madhësinë e njësisë (në këtë rast, numrin e votuesve). Për çdo zonë të përzgjedhur janë kryer nga 10 – 20 intervista (në varësi të numrit total për njësi) nëpërmjet metodës së rrugës rastësore: çdo derë e n-të majtas, personi me ditëlindjen më të fundit në familje që ka mbushur moshën 18 vjeç.

Metoda që është përdorur për të kryer intervistat ka qenë në formën e pyetësorit ballë-për-ballë, ku çdo pyetësor ka zgjatur afërsisht 15-20 minuta.


#### 9.2. Rezultatet

##### 9.2.1 Vlerësimi për qytetin / fshatin

Përgjithësisht vlerësimet që vijnë nga banorët e zonave rurale të Korçës janë më ulëta se ato që vijnë nga banorët e qytetit, përveç çështjes së punësisimit ku banorët e qytetit e vlerësojnë më keq se ata të zonave rurale të bashkisë.

Vlerësimi më negativ që e tejkalon mesin e shkallës nga 1 deri në 5 (ku 1= Shkëlqyeshëm dhe 5= Shumë keq) është “Qyteti/fshati juaj si një vend për të punuar”. Çështjet e punësimit janë çështjet më problematike si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale.

Gjithsesi, është për tu vlerësuar fakti që në përgjithësi ndjesia që kanë të anketuarit në lidhje me qytetin/fshatin e tyre si një vend për të jetuar, është përgjithësisht e mirë (2,3 dhe 2.5 pikë mesatarisht në shkallën e vlerësimit).



### 9.2.2 Vlerësimi i aspekteve të ndryshme të komunitetit / zonës


Sipas vlerësimeve të të anketuarve në Bashkinë e Korçës, ka diferenca midis atyre që jetojnë në qytetin e Korçës dhe atyre që jetojnë në zonat e tjera rurale të njësive administrative.

Banorët e zonave rurale vlerësojnë më keq dimensionin e Arsimit dhe Kulturës, pra problemet me cilësinë e infrastrukturës shkollore, mundësive për arsim cilësor, për arsim profesional dhe mungesën e aktiviteteve kulturore. Po kështu Mjedisi Urban, vlerësohet më dobët në këto zona

rurale, duke nënkuptuar cilësinë e ndërtimeve, hapësirat publike, dhe mundësitë për të zhvilluar pronën private.


Ekonomia vlerësohet gjithashtu më së shumti negativisht si nga ata që banojnë në zonat rurale ashtu edhe nga ata që banojnë në qytet.

Ndërkohë që Mobiliteti vlerësohet qartazi pozitivisht nga ata që banojnë në qytetin e Korçës dhe deri diku pozitivisht nga ata që banojnë në zonat rurale. Ky dimension përmbledh, cilësinë e rrugëve, mundësitë për të lëvizur me makinë, biçikletë dhe këmbë, fluksin e trafikut dhe mundësitë për parkim. Po kështu pozitivisht vlerësohet edhe Siguria dhe Mjedisi Natyror.



### 9.2.3 Përparësitë që duhet të ketë bashkia

Qytetarët janë pyetur në lidhje me një sërë çështjesh nëse vlerësohen sipas tyre si Përparësi e Lartë, Mesatare, e Ulët apo Aspak Përparësi. Në grafikun më poshtë janë paraqitur rezultatet për këto çështje sipas atyre që e kanë vlerësuar çështjen përkatëse si “Përparësi e lartë”.



% e atyre që janë përgjigjur “Përparësi e lartë”

Duke analizuar përgjigjet e banorëve të qytetit të Korçës dhe atyre të njësive administrative (rurale), qartazi dallohet një diferencë në vlerësimin e përparësive. Kjo përbën një sfidë për Bashkinë pasi në tërësi duhet të veprojë me dy “strategji” të veçanta, një që ti përgjigjet prioriteteve të qytetit dhe një tjetër që të trajtojë prioritetet (e ndryshme) në zonat rurale.

Në seksionin më poshtë trajtohen këto zona më vete.


### *Qyteti i Korçës (Urbane)*

**Nxitja e punësimit** është përparësia kryesore që vlerësojnë qytetarët, banorë të qytetit të Korçës. Pavarësisht instrumentave të kufizuar që mund të ketë Bashkia për këtë çështje, qytetarët kërkojnë një rol më aktiv të Bashkisë në këtë drejtim.

Është interesante të vihet re që edhe “**strehimi**” ka dalë si çështje prioritare në nivele të mëdha nga vlerësimi i qytetarëve. Kjo do të thotë që Bashkia duhet të gjykojë dhe vlerësojë nevojat për strehim të popullsisë, si të atyre që janë në nevojë por edhe të atyre që kërkojnë strehim më cilësor se ai që kanë aktualisht.

Qytetarët e Korçës, kanë nxjerrë si prioritete edhe **Mjediset për të Rinjtë, për të Moshuarit, Mjedise Kulturore** dhe ato **Sportive**. Këto duhet të jenë në vëmendje të Bashkisë për qytetin e Korçës për periudhën në vazhdim.






### Zonat rurale

Banorët e zonave rurale në bashkinë e Korçës kanë shumë më shumë nevoja sesa banorët e qytetit të Korçës. Pothuajse të gjitha çështjet e përmendura ( përveç Varrezave dhe Strehimit) janë vlerësuar si Përparësi e Lartë nga më shumë se 50% e të anketuarve. Kjo do të thotë që vëmëndja ndaj këtyre zonave duhet të jetë e gjithanshme për të gjitha dimensionet.

Ndër ato prioritetet që spikasin veçanërisht për këto zona janë **Nxitja e Punësimit** (94%) **Sistemet Vaditëse** (85%) dhe ato **Kulluese** (75%), **Tregje për Prodhime Lokale** (82%) dhe **Ambjente Tregtare** (78%).

**Infrastruktura rrugore, Trotuarët, Ndriçimi rrugor dhe Sistemet e Transportit** janë gjithashtu prioritetet për këto zona.






### 9.2.4 Marrja e një hua-je

Burimet financiare të bashkisë për të trajtuar të gjitha prioritetet e qytetarëve janë të kufizuara. Pikërisht për këtë arsye të anketuarve ju është bërë një pyetje nëse do të ishin dakord që bashkia të merrte Hua Finaciare për të përmirësuar shërbimet publike.

Banorët e zonave rurale janë dakord për marrjen e huasë (67%) ndërkohë që banorët e qytetit të Korçës janë të ndarë në këtë drejtim – rreth 46% janë dakord ndërsa rreth 40% nuk janë dakord.

Megjithatë qytetarët nuk shprehen aq entuziastë kur pyeten nëse do të ishin dakord edhe po qe se huaja do të sillte rritje të tarifave dhe taksave vendore. Më shumë se gjysma e tyre nuk janë dakord nëse do të kishte rritje tarifash.







### 9.2.5 Sektorët ekonomik më premtues

**Bujqësia, Blegtoria, Agro-përpunimi dhe Turizmi** janë sektorët që janë më premtues për të siguruar rritje ekonomike sipas të anketuarve. Nuk ka ndryshime të mëdha midis atyre që banojnë në qytet dhe atyre që banojnë në fshat përveç faktit që Turizmi shihet shumë më premtues si sektor, nga ata që jetojnë në qytetin e Korçës. Kjo vjen edhe nga fakti që ky qytet ka përjetuar një rritje turizmi të konsiderueshme në vitet e fundit.

Ky vlerësim duhet marrë parasysh edhe nga Bashkia gjatë hartimit të strategjisë së zhvillimit.





### 10. Dëgjesa publike me qytetarët

Më datën 26 maj 2016, pranë mjediseve të bibliotekës së Korçës u mbajt dëgjesa për hartimin e dokumentit të Strategjisë së Zhvillimit për Bashkinë e Korçës.

Dëgjesa, përveçse nevojën për informim dhe përfshirje të banorëve, shërbeu për të marrë vlerësimet dhe mendimet e tyre për rezultatet e paraqitura. Për prezantimin e rezultateve, në dëgjesë publike ishin të pranishëm vetë Kryetari i Bashkisë Korçë, nënkryetari, specialistë të grupit të punës nga drejtoritë e bashkisë, si dhe ekspertë të grupit të konsulencës për të asistuar me prezantimin e çështjeve teknike të përmbajtjes së dokumentit të paraqitur në prezantim. Roli i kësaj të fundit ndihmoi shumë për të lehtësuar komunikimin për shpjegimet e nevojshme për qytetarët.



Figura 37 foto nga dëgjesa publike





Figura 38 foto nga dëgjesa publike



Figura 39 foto nga dëgjesa publike

Në dëgjësë pati pjesëmarrje të gjerë nga komuniteti banues dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit, duke përfshirë edhe mediat lokale e kombëtare. Nga të pranishmit pati mjaft pyetje interesante dhe produktive në shërbim të përmirësimit të dokumentit të Strategjisë të cilat janë reflektuar në vijim. Përmbajtjen e tyre e gjeni në aneks.



## VI ANEKS

### 1. Platforma GIS

Përshkrim i përgjithshëm i platformës

Në bazë të ligjit nr.107/2014 për “Planifikimin e Territorit” të ndryshuar çdo e dhënë që sigurohet nga Njësitë e Qeverisjes Vendore duhet të botohet në Regjistrin elektronik Kombëtar të Planifikimi të Territorit (këtëj e tutje, Regjistri). Sipas kërkesave teknike e ligjore për formatin e të dhënave që botohen në Regjistër, baza e të dhënave që disponojnë njësitë e qeverisjes vendore duhet të jenë në një format të përpunueshëm elektronik dixhital. Ndërkaq të dhënat që botohen duhet t’i japin mundësi përdoruesve që, sipas kategorive të tyre, të zbulojnë, shikojnë dhe shkarkojnë informacionet e regjistruara. Për këto dhe të tjera, zyrat e planifikimit urban pranë njësite të qeverisjes vendore duhet të kenë në dispozicion të tyre një infrastrukturë bazë që t’i mundësojë atyre grumbullimin, përpunimin, arkivimin dhe ri- shfrytëzimin e të dhënave të arkivuara, sa më lehtë dhe me efikasitet të jetë e mundur. Metodrat e punës dhe cilësia e produkteve duhet të ketë gjithashtu harmoni me qasjen e Bashkimit Europian


<sup>26</sup> e më gjerë, në fushën e planifikimit dhe të zhvillimit të territorit.

Për t'iu përgjigjur nevojave të Bashkisë dhe kërkesave të parashtruara më lart, konsulenti ka ideuar dhe përgatitur modelin dhe kërkesat teknike që do t'i paraprijnë një platforme të shumë-qëllimshme sipas Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS), si rekomandim për bashkinë, për ta përshtatur si strukturë bazë për të dhënave të saj.

Në mbështetje të Vendimit për Regjistrin <sup>27</sup>, programet kompjuterike të rekomanduara që të përdoren nga njësitë e qeverisjes vendore për qëllime të komunikimit elektronik, do të jenë sipas standardeve të hapura (*open standards* – d.m.th.: me standarde që janë të hapura dhe të disponueshme për përdorim e përpunim të gjerë publik).

## MODELI IMENAXHIMIT TË INFORMACIONIT

Sistemi i integruar i planifikimit kërkon që informacioni në regjistër të krijohet, ruhet, mirëmbahet, administrohet dhe përditësohet në mënyrë të pavarur nga autoritetet e planifikimit në nivel kombëtar e vendore, institucionet e tjera publike dhe persona juridikë të autorizuar.



Skema 1 Mënyra e mbledhjes së të dhënave në RKPT

Administrimi i informacioni elektronik në bazën e të dhënave të Bashkisë administrohet në një rrjet të integruar e shumë-qëllimësh bazash të dhënash, të cilat qëndrojnë të pavarura dhe ndërveprojnë ndërmjet tyre. Aksesimi në bazën e të dhënave sigurohet përmes përdoruesve të veçantë të cilëve iu lejonet akses në server për të thirrur informacionin e kërkuar dhe për të

ngarkuar të dhënat e reja sipas kërkesës e nevojës.



*Skema 2 Ndërveprimi i llojeve të ndryshme të të dhënave*

Tipet e të dhënave të arkivuara mund të jenë të ndryshme në varësi të llojit të informacionit të regjistruar dhe strukturës së gjuhës së programeve me të cilat përpunohet ky informacion. Për sa i përket llojit të informacionit ato mund t'i përkasin disa kategorive si më poshtë:

Demografike	Hapsinore	Shërbime	të Tokës
popullsia	zona të mbrojtura	shëndetësia	urbane
banesa	objekte të rëndësishme të veçantë	infrastruktur	bujqësor
siendia		sistemet e urgjencave	pyj
zonat e banimit	burimet energjitike	pikat e informacionit	kullota
përdorimi i tokës	pellgjet lumore	transporti publik	prona të bashkisë
	gjelbërim	transporti urban dhe interurbane	zoonimi
	zonat	furnizimi me energji elektrike	ndarjet kadastrale
		universitet	ndarjet

Informacionet e mësipërme mblidhen dhe përditësohen periodikisht.

Mirëmbajtja dhe përditësimi i informacioni për bazën e të dhënave të serverit duhet të kryhet nga autoritetet kombëtare e vendore të planifikimit dhe institucionet e tjera publike. Mbledhja e informacionit bazohet te kërkimi i të dhënave në mënyrë të pavarur dhe sipas parimit që ai mblidhet vetëm një herë nga burimi. Pastaj, të dhënat e akumuluar duhet të mblidhen dhe integrohen te serveri i të dhënave pranë bashkisë.

Duke qese se nga burimi, të dhënat mund të vijnë përmes instrumenteve dhe metodave të ndryshme të grumbullimit, formati në të cilin ato mblidhen mund të ndryshojë shumë nga njëra te tjetra si dhe nga ai i cili mund të përdoret programet që i integrojnë atë në serverin e të dhënave të bashkisë. Ato mund të variojnë si më poshtë:



- tabelore



- tekst



- imazhe




- grafikë



- ortofoto

- vektorial



- dixhitale

01001101  
00110110  
10001101

- të printuara



- të skanuara



- etj.



Prandaj, është e rëndësishme që të kuptohet dhe të parapërgatitet një model se si do të konvertohen të dhënat, në përputhje me formatin në të cilin mblidhen nga burimi, për t'u integruar në server. Të gjitha këto të dhëna duhet të ruhen në formën origjinale në server ose të konvertuara sipas një formati lehtësisht të përpunueshëm dhe të integrueshëm te regjistri i informacionit hartografik (platforma GIS).

Për mënyrën e organizimit të bazës së të dhënave sipas tipeve të formateve të kërkuara, mund ti referoheni Manualit Teknik të Regjistrimit në linkun e mëposhtëm:

<http://www.planifikimi.gov.al/sites/default/files/Manual%20i%20RPT.pdf>

#### KËRKESATTEKNIKE

Krijimi i sistemit operativ për bazën e të dhënave të integruara në GIS për bashkinë, sipas modelit të mësipërm kërkon sigurimin e infrastrukturës bazë me të cilën do të operohet serveri. Në varësi të sasisë së informacionit, personelit që do të angazhohet në të dhe lehtësisë së përdorimit që i nevojitet bashkisë, sistemi mund të organizohet në forma të ndryshme. Më poshtë do të paraqesim dy opsione të mundshme orientuese për bashkinë, e cila mund të adaptojë me përpikmëri njërin prej tyre, ose mund të zgjedhi një opsion të tretë që i përshtatet më mirë duke iu referuar dy modeleve që ne propozojmë. Secili prej tyre duhet të jetë në gjendje:

- të ruajë sasi të mëdha informacioni
- të sigurojë akses në çdo kohë, sipas nevojës, për tipet e informacionit të ruajtura në të
- të mundësojë përpunimin e të dhënave në mënyrë të saktë dhe të shpejtë
- të sigurojë mundësinë për konvertimin e të dhënave sipas formatit të kërkuar për integrimin e tyre në sistemin GIS
- të ofrojë siguri për ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave në çdo kohë (back-up system)
- të sigurojë mbrojtjen e të dhënave nga programe ose persona të pa-autorizuar që synojnë kopjimin, modifikimin ose fshirjen e informacionit

*Kërkesat teknike për secilin opsion do të specifikohen më poshtë.*

#### Opsioni 1 - Stand-alone workstation

1 server i operueshëm nga një kompiuter

Ky opsion konsiston në sigurimin e një kompiuteri bazë i cili do të shërbejë si

server qendror për kryerjen e të gjitha funksioneve e nevojshme për t'iu përgjigjur nevojave të bashkisë në mënyrë të pavarur nga sisteme të tjera (stand-alone).

Kërkesat teknike:

- Kompiuter Desktop
- Procesor me 4 bërthama, 64-bit
- 16GB RAM
- Karte grafike: të veçantë (expansion card) e rendit 2 GB RAM
- Kujtese: 5TB
- 2 Ekrane të hollë LED 25”
- Tastierë + Mouse
- UPS


#### Opsioni 2 - Arkitektura Klient/Server

1 server për grumbullimin e të dhënave i menaxhueshëm nga disa operatorë.

Edhe pse QGIS është funksional pa patur nevojën e një serveri qendror, sugjerojmë arkitekturën klient/server si mënyrën më të mirë për të organizuar dhe menaxhuar materialet/fajlet brenda një institucion (me rrjet).

Për këtë nevojitet një server qendror ku të ruhen të dhënat e punës, dhe ku kompjuterat (klientët) do të aksesojnë/editojnë këto material nëpërmjet QGIS.

*Figura 2 Arkitektura Client/Server*



Materialet nga Serveri mund të shkarkohen lokalisht, të përpunohen me QGIS dhe me pas të ruhen përsëri në serverin qendror ose mund të hapen direkt nga rrjeti nëpërmjet QGIS (Project -> Open... -> adresa e fajlit në rrjet)

Kërkesat teknike për secilin operator (client):

- Kompiuter Desktop
- Procesor me 4 bërthama, 64-bit
- 8GB RAM
- Karte grafike: të veçantë (expansion card) e rendit 2 GB RAM
- Kujtese: 2TB
- 2 Ekranë të hollë LED 25”
- Tastierë + Mouse
- UPS


#### Programi QGIS

QGIS është një aplikacion desktopi open-source i Sistemeve të Informacionit Gjeografik që mundëson shikimin, editimin, dhe analizen e të dhënave gjeografike.

Faqja Zyrtare: <http://ëëë.qgis.org/>

#### Shkarkimi

Vizitoni faqen zyrtare të QGIS (<http://ëëë.qgis.org>) dhe klikoni butonin ‘Doënlod Noë’.



## Instalimi

Instalimi është i thjeshtë. Mjafton të klikoni instaluesin dhe të ndiqni udhëzimet. Më poshtë mund të shihni disa screenshoo. Pasi të keni përfunduar, QGIS do të ketë instaluar dy aplikacione në sistemin tuaj:

1. QGIS Desktop
2. QGIS Broëser

QGIS Desktop është programi kryesor ku kryhet leximi, editimi dhe analiza e të dhënave gjeografike.

QGIS Broëser është një tool që ju ndihmon të shfletoni lehtësisht fajlet me të dhëna gjeografike në sistemin tuaj.

Dokumentacioni zyrtar për të mësuar rreth përdorimit të QGIS gjendet në [http://docs.qgis.org/2.8/en/docs/user\\_manual/](http://docs.qgis.org/2.8/en/docs/user_manual/)

## **2. Materiale nga konsultimet dhe informimet me grupet e interesit dhe komunitetin.**

Në vijim të kësaj faqe, gjeni materiale dhe botimet nga konsultimet dhe informimi me grupet e interesit dhe qytetarët.



**Të dhëna nga hartimi i buxhetit të bashkisë me pjesëmarrje**

KOMUNA VOSKOP – Takim i datës 20.11.2015

Problematikat e ngritura

## Dërsnik

1. Nuk është kryer regjistrimi fillestar
2. Problem me tokën e zënë. Nuk kanë dokument hipotekor, por iu është shpërndarë me Ligjin 7501
3. Sipërfaqet e tokës që prek projekti TAP – nuk kanë dokument pronësie dhe njëkohësisht nuk po e shfrytëzojnë tokën deri në zgjidhjen e problemit
4. Uji i pijshëm (ka projekt)
5. Përmbytjet e Dunavecit
6. Kabina elektrike në mes të shkollës
7. Mungesë doktori

## Voskop

1. Ura e re e Dunavecit
2. Brigjet e lumit mbi urën
3. Rruga Polenë – Voskop (500m) – problem me pronësinë private
4. Rruga Korçë – Voskop
5. Rrugët e fshatit Voskop

## Damjanec

1. Rruga Vinçan – Damjanec (3km)
2. Kabinë elektrike e rrënuar
3. Uji i pijshëm

## Goskovë Poshtë

1. Uji i pijshëm (ka projekt për ujësjellësin)
2. Kanalizimet e ujërave të zeza
3. Kanalizimet e ujërave të bardha
4. Kanalet kulluese
5. Kopësht për fëmijët
6. Ruajtja e pronës
7. Kanali i Gjançit (duhet të ndërtohet deri në 2016)

## Vinçan

1. Uji i pijshëm
2. Ambulanca në gjendje jo të mirë dhe pa doktor
3. Probleme të riparueshme në 2 Ura

## Polenë

1. Rruga Korçë – Polenë (Ravonik –Qatrom-Polenë-Dersnik)
2. Derdhja e kanalizimeve të ujërave të zeza në kanale ndot ajrin
3. Ndrëçimi i rrugëve
4. Sistemi vaditës është me saraçineska – problem vjedhja e tyre
5. Mungesë doktori
6. Topografët privatë kryejnë matje pa praninë e komshinjve dhe krijojnë probleme me pronën

## Prioritetet

1. Gjetja e mënyrës për përgatitjen e dosjes për regjistrimin e pronës në fshatin Dërsnik (prioritet pronat që preken nga TAP)
2. 2 degëzimet e Gjançit dhe kanali i Vondrokut. Grup pune dhe hartimi i projektit për kanalet e dyta. Bashkëpunim me Bordin e Kullimit për pastrimin e kanaleve (Bordi të verë në dispozicion makineritë – Bashkia të paguajë naftën)
3. Menaxhimi i sistemit vaditës
4. Uji i pijshëm – UKKO
5. Dëmtimet dhe meremetimet e vogla në rrjetin e ujësjellësit mund të përballohen nga Bashkia
6. Projekti i ndriçimit të rrugëve të fshatit
7. 3 Urat – hartimi i projekteve për rikonstruksionin e tyre
8. Spostim i kabinës elektrike dhe 2 shtyllave në fshatin Dërsnik
9. Rruga Korçë – Polenë (projekti është gati)
10. Rrugët e fshatrave
11. Rruga Korçë – Voskop (projekt nga Autoriteti Rrugor)
12. Doktorët në fshatra (Shërbimi Shëndetsor)

Ka shumë mbivendosje me pronat dhe në Dërsnik mungon regjistrimi fillestar



## KOMUNA DRENOVË – Takimi i datës 24.11.2015

Problematikat e ngritura

## Moravë

1. Asfaltimi i rrugëve
2. Ujësjiellës – Kanalizime
3. Shtesat pa leje në pallate
4. Ndërtimet pa leje në pronë publike
5. Pastrimi i vendmbeturinave

## Drenovë

1. Rrugët (planimetria e tyre problematike dhe asfaltimi)
2. Kanalizimet e ujërave të shiut
3. Përmbytje nga përrenjtë – prita për ujërat e malit
4. Shërbimi i gjendjes civile (nuk shërben nëse nuk ke paguar taksat)
5. Lagjja Lart nuk ka akses për shkak të plevicave dhe inerteve të akumuluar
6. Mungon furnizimi me ujë për shkak të mungesës së administrimit
7. Kontrolli i cilësisë së ujit – ndotja për shkak të pularisë
8. Vatra e kulturës – Rikonstruksion ose pajisje me mjete
9. Rruga e varrezave (nga asfalti tek varrezat)
10. Punëtorë që të kujdesen për varrezat

## Ravonik

1. Kanalizimet e ujërave të zeza
2. Shkolla në gjendje të keqe – banjat jashtë
3. Ambulanca – kioskë – në gjendje të keqe

## Boboshticë

1. Mungesë e tregut për produktet bujqësore
2. Konsulencë nga ekspertë të bujqësisë dhe blegtorisë (mungon agronom/veteriner)
3. Taksa e tokës të mos mblidhet në fillim të vitit, por 3 muajt e fundit të vitit
4. Ndriçimi
5. Kanalizimet e ujërave të zeza
6. Kanalet kulluese
7. Pastrimi i plehrave
8. Krijimi i aksesit në monumentet e kulturës

## Dardhë

1. Rrethimi i varrezave
2. Meremetimi i zyrave të ish komunës

### Qatrom


1. Patrimi i plehrave
2. Kanali ujitës
3. Mungesa e Vatrës së Kulturës (e cila ka ekzistuar, por i është kthyer privatit)
4. Mungesa e zyrave

### Zape (përpara fshatit Boboshticë)

1. Kanali i ujërave të zeza të burgut (erë të keqe)
2. Pastrimi i kanalizimeve brenda në fshat
3. Përdorimi i transportit urban (nga pensionistët)

### Prioritetet

1. Pastrimi i rrugëve nga ndërtimet pa leje, nëse ato pengojnë aksesin për në banesa
2. Administrimi i mbetjeve
3. Aksesin për në destinacionet turistike
4. Pastrimi i ambientit
5. Ujësjellës – Kanalizime + Administrim me matësa
6. Vatra e Kulturës – do të diskutohet që pajisjet e Teatrit të Korçës, për shkak të rikonstruksionit, ti kalojnë Vatrës së Kulturës në Drenovë
7. Konsulenca e fermerëve – Drejtori a e Bujqësisë ka në strukturën e saj një agronom dhe një veteriner për çdo ish komunë. Do të shikohet përfshirja e profesionistëve në strukturën e Bashkisë
8. Projekte për vaditjen
9. Rruga për në varreza
10. Kanali i burgut
11. Do të diskutohet me operatorin e shërbimit të transportit që të përfshihen në shërbim dhe fshatrat rreth Korçës. Sipas rastit do të vendoset dhe për pajisjen me kartën e pensionistit



## KOMUNA BULGAREC – Takimi i datës 27.11.2015

Problematikat e ngritura

## Çiflik

1. Përmbytjet – Kanalet janë problematikë pavarësisht pastrimit të tyre pasi nuk kanë kapacitet mbajtës për ujërat për vijnë kryesisht nga qyteti i Korçës
2. Pastrimi i kanaleve – 2 kanalet e kullimit brenda në fshat
3. Rrugët nuk janë të sigurta për këmbësorët
4. Zyrat e fshatit nuk funksionojnë – ka patur një sallë, por tani nuk funksionon
5. Rrethimi i shkollës
6. Ambientet e shkollës janë në gjendje shumë të keqe

## Bulgarec

1. Pritat
2. Rrugët – të hidhet granit në disa rrugë
3. Rrjeti elektrik – shtylla druri të cilat paraqesin rrezikshmëri
4. Uji i pijshëm – 15% i zgjidhur, pjesa tjetër problematike
5. Mungon ndriçimi rrugor
6. Ujërat e zeza janë problematike dhe duhet menduar një zgjidhje për të gjithë fshatin
7. Rrugët janë tepër të ngushta dhe mungon aksesi
8. Tensioni i energjisë elektrike
9. Janë 3-4 km rrugë, të cilat duhet të shtrohen me asfalt
10. Është i nevojshëm dhe disinfektimi për minjtë, të cilët dëmtojnë të mbjellat

## Biranj

1. Rrugët
2. KUZ
3. Pastrimi i kanaleve
4. Kabinat elektrike (2 kabina)

## Barç

1. KUZ
2. Problemi me pronarin në rrugën e silikatit, i cili do të bllokojë rrugën
3. Kanalet ujëmbledhëse
4. Uji i pijshëm – matësit duhet të dalin jashtë shtëpive për menaxhim më të mirë
5. Varrezat rrezikojnë nga përrrenjtë

## Melçan

1. Problematikat e KUZ mund të zgjidhen me një investim të vogël
2. Uji i pijshëm kërkon administrim më të mirë



3. 2 Përrenjtë mund të sjellin përmbytje të rrezikshme
4. Rruga Melçan – Korçë është shumë e ngushtë
5. Rruga Melçan – Lumalas është shumë e shkatërruar
6. Shkolla në Melçan është në gjendje shumë të keqe
7. Rrugët e lagjeve janë në gjendje shumë të keqe
8. Kabine elektrike është gati në rënie
9. Linja e tensionit të lartë është devijuar për shkak të një ndërtimi dhe kabllot kanë shkëputje me erën
10. Pastrimi i plehrave dhe menaxhimi i tyre
11. Mosrespektimi i ligjit në zënien e rrugëve (janë ngushtuar shumë)

#### Lumalas

1. Problem me firmën e ndërtimit - qentë dhe kullimet
2. Rruga për në shkollën në Lumalas është e pakalueshme
3. Minat e guroreve që nxjerrin granil shkaktojnë lëkundje të banesave
4. Rrugët duhet të përballojnë ngarkesa të rënda për shkak të transportit nga guroret
5. Kabina elektrike e pasiguruar nga shiu
6. Shtyllat e drurit mbahen nga kabllot
7. Duhet një kanal kullues tek shkolla
8. Rruga e varreve është e pakalueshme – të paktën të hidhet çakull

#### Porovinë

1. Rrugët janë të gjitha problematike
2. Menaxhimi i plehrave është i domosdoshëm
3. Rruga Vinçan – Porovinë është shumë e dëmtuar (përdoret nga nxënësit)
4. Duhet zëvendësuar pompa tek shkolla
5. Ura që lidh dy lagjet rrezikon të bjerë
6. Ndriçimi është shumë problematik
7. S'ka varreza

#### Dishnicë

1. Vadijtja mungon tërësisht për tokat nën rrugën nacionale. Mbi rrugën nacionale përdoret ujë i pijshëm për vadijtje
2. Rruga e kishës në fshatin lart është shumë problematike

#### Prioritetet

1. Pastrimi i fshatrave – aksion i përgjithshëm
2. Lirimi i hapësirave publike – aksion për lirimin e rrugëve
3. UKUZ – duhet të mirë administrohet
4. Furnizimi me energji elektrike – do të diskutohet në OShEE
5. Vadijtja – zgjidhja është e vështirë sepse nuk ka furnizim, mbase mund të zgjidhet me kanalin e Vondroikut



KOMUNA MOLLAJ – Takim i datës 15.12.2015

### Problematikat e ngritura

#### Dvoran

1. Problem me rrugët nëpër lagje
2. Kanalizimi i ujërave të zeza është sipërfaqësor
3. Ndriçimi rrugor
4. Tension i ulët i energjisë elektrike në banesa
5. Transporti urban – lidhja me qytetin
6. Regjistrimi fillestar i pronave
7. Problem me venddepozitimin e plehrave para shkollës
8. Shkolla ka nevojë për pastrues, roje dite, terren sportiv dhe një sallë aktivitetesh

#### Kamenicë

1. Furnizimi me ujë
2. Kanalizimet
3. Lumi
4. Shkolla

#### Pulahë

1. Për shkak të terrenit të pjerrët ka problem me ujërat e bardha
2. Ka mbetur 300m rrugë e paasfaltuar nga investimi i mëparshëm në hyrje të fshatit
3. Restaurimi i kanalit të Gjançit ka shkaktuar dëme në infrastrukturë
4. Probleme me kanalizimet e ujërave të zeza
5. Ndriçimi i rrugëve

### Floq

1. Ujësjetësi ka patur një investim por ka nevojë akoma
2. Kanalet e ujërave të zeza dhe të bardha
3. Kanalet vaditës
4. Ndriçimi i rrugëve
5. Rrugët t lagjeve

### Dvoran

1. Rruga e re Korçë – Drenovë shkakton dëmtime në kanalin vaditës
2. Rrugët e fshatit
3. Kanalet kullues
4. Uji i pijshëm
5. Nuk është kryer regjistrimi fillestar
6. Ekzistojnë 6-7 familje të cilat nuk janë lidhur me rrjetin e kanalizimeve dhe derdhen ujërat e zeza në kanal
7. Plehrat – mungesa e koshave të plehrave
8. Ka nevojë për pastrimin e kanalit

### Kamenicë

1. Probleme me bllokimin e rrugëve gjatë rreshjeve të dëborës
2. Plehrat mbledhen njëherë në 2 javë
3. Është i nevojshëm rrethimi i varreve

### Bollovodë

1. Ka nevojë për urë
2. Probleme me pronësinë në kuadër të TAP

### Prioritetet

1. Rrugët e brendshme të fshatrave
2. Kanalizimet e ujërave të zeza
3. Uji i pijshëm – financim për ujin e pijshëm me UKKO
4. Furnizimi me energji në një nga lagjet Dvoranit – konsulencë me OSHEE
5. Linja e urbanit – do të shikohet në planin e transportit publik
6. Pastrimi i lumit mbi fshat – do të fillojë pastrimi në bashkëpunim me bordin e kullimit
7. Rrugët e parcelave - mund të shfrytëzohen inertet nga punimet duke i depozituar për krijimin e rrugëve midis parcelave
8. Problemi me kanalin e Gjançit - do të verifikohet
9. Vjedhja e kabllit të ndriçimit rrugor është një problem shumë shqetësues
10. Shkolla e Kamenicës – shkollë e re
11. Ujësjetësi në Pulahë

12. Pastrimi i rrugëve – shumë shpejt kontrata për makineritë
13. Rrethimi i varrezave – Thanasi
14. Vadijtja – do të fillojë në fillim të 2016
15. Kanalizimet e ujërave të bardha
16. Rruga e Shtyllës që lidh Bollovodën është përcjellë tek TAP si prioritet
17. Skema e menaxhimit të plehrave do të shikohet (problematike mbledhja e kazanëve)
18. Terreni sportiv në shkollën e Dvoranit



## KOMUNA VITHKUQ – Takim i datës 16.12.2015

Problematikat e ngritura

## Vithkuq

1. Ujësjiellësi i fshatit
2. Asfaltimi i rrugëve të fshatit
3. Dëmtimet e rrugëve nga TAP
4. Problemi i kullotave dhe pyjeve
5. Kanalizimet e ujërave të zeza janë kryer
6. Rrugët me kalldrëm duhen rinovuar
7. Probleme me pastrimin e lumit

## Lubonja

1. Ujësjiellësi i fshatit duhet të administrohet për lidhjet e paligjshme
2. Duhet ndëruar rruga e fshatit
3. Kanalet vaditës dhe kanalet kullues – një pjesë është realizuar por duhet të realizohet dhe pjesa tjetër
4. Bllokimi i rrugës nga reshjet e dëborës
5. Pastrimi dhe sistemimi i lumit të fshatit
6. Punonjës për pastrimin e rrugëve
7. Nuk është kryer regjistrimi fillestar

## Panarit

1. Rruga e Panaritit
2. Ujësjiellësi i fshatit është i amortizuar, depërtojnë ujërat e zeza
3. Ura e Panaritit që u shkatërrua nga rreshjet duhet përforcuar
4. 4 ura që lidhnin lagjet e fshatit i ka marrë lumi gjatë rreshjeve të fundit
5. Shkolla e Panaritit – është e re por tjegullat duhen zëvendësuar
6. Ka vetëm 2 mësues për 32 nxënës
7. Kopshti nuk funksionon
8. Linja e energjisë elektrike është e amortizuar (shtylla, kablllo, të gjitha)

## Leshnjë

1. KUZ derdhen në lumë në mes të fshatit
2. Plehërat depozitohen të gjitha në lumë
3. Rruga nga lagjja poshtë deri në varrezat është e shkatërruar



4. Shkolla – dhoma e kopshtit gati në të rënë
5. Kanalet kullues janë të amortizuara
6. Ka nevojë për ngritjen e pritave përgjatë lumit, i cili depërton nëpër fusha
7. Ka nevojë për kanale vaditës
8. Çatia e amortizuar e vatrës së kulturës

#### Prioritetet

1. Ujësja do të investohet nga UKKO – 3,500,000 euro
2. Duhet të përmirësohet menaxhimi i ujit të pijshëm
3. Moratoriumi për pyjet – do të priten vetëm dru për ngrohje
4. Kullotat do të mirëadministrohen
5. Kalldrëmet e Vithkuqit – do të hartohen projektet dhe preventivat nga zyra megjithëse prioritet para rrugëve ka rrjeti inxhinierik nëntokësor
6. Do të diskutojmë me ZVRPP për regjistrimin fillestar
7. Pastrimi – Ndërmarrja e shërbimeve publike + staf + organizimi i ri
8. Pastrimi i kanaleve të kullimit, lumenjve dhe përrenjve
9. Zënia e rrugës nga dëbora – do të merren hua mjetet nga shoqëri private për të hapur rrugët. Ura e Floqit deri në Shtyllë, hapja e rrugës nga dëbora do të bëhet nga TAP
10. Rruga në Panarit – do të investohet nga TAP një pjesë e saj
11. Shkolla e Panaritit – Merimetimet nga Drejtoria Mbështetëse e Arsimit e cila ka një listë të ndërhyrjeve të nevojshme për çdo shkollë
12. Prioritet rruga deri në varrezat – momentalisht mund të parashikohet mirëmbajtje
13. Vatra e kulturës – do të shihet gjendja dhe do të bëhet preventivi



# RAPORT

Sot, më datë 16.01.2016, u organizua takimi me publikun për Planin e Detajuar Vendor të "Parkut Sportiv". Të pranishëm ishin dhe specialistët e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, të cilët dhanë sqarime në lidhje me propozimet e PDV-së së "Parkut Sportiv".

Pas sqarimit mbi propozimet e PDV-së, të pranishmit u sqaruan dhe mbi mekanizmat e zhvillimit të tokës. Bazuar në kërkesat e takimit të parë, ku pronarët shprehën shqetësime në lidhje me zhvillimin e pronave të tyre, ata u sqaruan se Bashkia Korçë ka për qëllim jo vetëm shpronësimin e sipërfaqeve të pronës private në kuadër të kryerjes së investimeve për interes publik por dhe hartimin e një programi partneriteti publik – privat nëse vetë pronarët shprehin interes në lidhje me të.

Një problematikë tjetër që u ngrit gjatë takimit, në lidhje me pronësinë në zonë, ishin rastet e sipërfaqeve të njohura me pronarë, me vendim gjyqësor dhe rastet e objekteve me të drejtë parablerjeje. Për sa kohë që zgjidhja e këtyre problematikave nuk është pjesë e mekanizmave të zhvillimit të tokës të parashikuara në Ligjet dhe Rregulloret e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, zgjidhja e tyre iu përket organeve të tjera vendimmarrëse.







Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit  
të Zhvillimit të Territorit

**Elda TONA**

Përgjegjëse e Sektorit të Planifikimit  
të Territorit dhe Projekteve



# RAPORT

## Dëgjesë publike për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

### “Analiza dhe Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese”

Sot, më datë 29.02.2016, u organizua dëgjesa publike në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, me temë “Analiza dhe Vlerësimi i Gjendjes Ekzistuese”. Pjesëmarrës ishin profesionistë të fushës së planifikimit dhe të ndërtimit, grupe të ndryshme interesi, qytetarë dhe përfaqësues të AKPT-së.

Takimi u hap me fjalën e kryetarit të Bashkisë Korçë, e cila u pasua nga prezantimi i analizës dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese nga ekspertët e studios konsulente. Prezantimi në përmbajtje të tij kishte:

Platformën e Planit të Përgjithshëm Vendor

Skemën e projektit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor

Profilin e Bashkisë së re

Parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar për rajonin e Korçës

Parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit të Korçës

Analizën e zhvillimit social, ekonomik dhe të dhënat mbi arsimin

Analizën mbi mobilitetin dhe transportin





Pas prezantimit, u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilave iu përgjigjën ekspertët e studios konsulente, specialistët e D.P.K.Zh.T dhe të AKPT.

- Një nga pyetjet e para ishte nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të jetë në të njëjtën linjë me Planin e Përgjithshëm Kombëtar, më konkretisht nëse do të parashikojë ndërtimin e aeroportit apo kalimin e linjës hekurudhore në qytetin e Korçës. Eksperti i transportit i studios konsulente sqaroi se edhe nëse këto parashikime konkrete nuk janë pjesë e PPK, gjithsesi ato parashikohen nga programe të tjera, si SEETO për vitin 2015 – 2016, në të cilin përcaktohet lidhja me rrjet hekurudhor e Shqipërisë me Greqinë nëpërmjet Kapshticës.
- Pyetjes nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të marrë në konsideratë Planin ekzistues të miratuar në vitin 2014 dhe Rregulloren e Qendrës Historike, iu përgjigj specialistja e AKPT, e cila sqaroi se Plani i Përgjithshëm Vendor, i miratuar në vitin 2014 është në fuqi, sikurse dhe Rregullorja e Qendrës, kurse Planet Rregulluese të ish komunave janë shfuqizuar.
- Nga pjesëmarrësit u bë një sugjerim për studion konsulente, në lidhje me kryerjen e analizave SWOT gjatë kronologjisë së punës. Ekspertët e studios siguruan se analizat SWOT do të jenë patjetër pjesë e punës në vazhdim
- Një problematikë e ngritur nga specialist i bujqësisë ishte sfida për urbanizimin e zonave rurale dhe fakti se prodhimi bujqësor është nën juridiksionin e Ministrisë përkatëse. Ky konstatim u shoqërua dhe me një sugjerim nga ana e tij për planifikimin e nj sinergjie të mirë midis zonës rurale dhe atë urbane brenda Bashkisë së re dhe industrializimin e zonës rurale. Ekspertët e studios konsulente janë përgjigjur se sfida më e madhe e Planit është pikërisht integrimi i zonave rurale, pasi dhe baza e të dhënave është shumë e varfër. Bashkia mund të jetë promovuese dhe mbështetëse e zhvillimit bujqësor, pavarësisht juridiksionit të Ministrive. Agropërpunimi i produkteve bujqësore dhe jo vetëm është një prioritet.
- Njëri prej qytetarëve ngriti shqetësimin për zhvillimin e zonës në rrugën “Ligor Rëmbeci”, i cili duhet parë me prioritet për shkak të vendndodhjes së kësaj zone shumë afër me qendrën e qytetit dhe gjendjes tepër kritike të ndërtesave në këtë rrugë. Gjithashtu ai kërkoi që kjo zonë të ketë një rritje të shfrytëzimit. Përgjigjja e ekspertëve të studios ishte se kjo kërkesë do të shqyrtohet.
- Së fundmi, janë ngritur pyetjet nëse Plani i Përgjithshëm Vendor do të mund të hartohet brenda periudhës 4 mujore dhe a do të ketë rregullore të re për ndërtimet në zonën ansambël të qytetit, e cila të mos jetë penalizuese për ndërtimet në këtë zonë por të mundësojë zhvillimin duke ruajtur karakteristikat e kësaj zone. Pjesës së parë të pyetjes i është përgjigjur eksperti i studios konsulente duke sqaruar se koha për hartimin e planit është e pamjaftueshme dhe se studioja ka kërkuar shtyrje të këtij afati. Ndërsa pjesës së dytë të pyetjes i është përgjigjur specialistja e AKPT-së, duke sqaruar se referim do të vazhdojë të jetë VKM 408, pasi të tjerat janë shfuqizuar. Aktet nënligjore mund të rishikohen pas funksionimit të regjistrimit elektronik të lejeve, nëse do të konstatohen probleme dhe ankesa dhe nga bashkitë e tjera.

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit

**Zhaneta Lubonja**

  
Drejtoreshë e D.P.K.ZH.T.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

FORUMI I BASHKËRENDIMIT

Datë 07.06.2016

Pas dëgjesave publike të organizuara më parë u mbledh forumi i bashkërendimit me bashkitë kufitare mbi hartimi e Planit të Përgjithshëm Vendor të zhvillimit të Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Pogradec.

Pas një prezantimi të bërë mbi strategjitë e zhvillimit të territorit të Bashkisë Korçë diskutimet e bëra nga përfaqësues të fushave të ndryshme të bashkive pjesëmarrëse në takim:

#### **Përfaqësuesi i Bashkisë Kolonjë – Paqësor Kajmaku**

Ju përgëzoj për punën e kryer, kjo është edhe një eksperiencë për ne si bashki më e vogël dhe kufitare me bashkinë e Korçës. Jemi këtu për të parë strategjitë kufitare por që nuk pashë ndonjë lidhje me korridoret natyrore që ekzistojnë apo edhe ndonjë lidhje të re tokësore apo natyrore me bashkinë tonë.

Kam një sugjerim gjithashtu, që të merren në studim zonat Vithkuq – Fshatrat e Vakëfeve - Kolonjë si një mundësi zhvillimi të përbashkët. Të krijohen lidhje me korridoret natyrore apo fetare me ato resurse që sot janë ekzistuese.



#### **Përfaqësuesi i studios fituese për hartimin e planit të Bashkisë Skrapar**

1. Bashkia Skrapar në strategjinë e saj ka përfshirë edhe krijimin e një rruge lidhëse midis dy qyteteve ndaj mendoj të kemi një bashkëpunim që dhe ju të bëni të njëjtën gjë në pjesën tuaj. Sot ekziston një rrugë Skrapar - Maliq, mund të bëhet një rrugë Maliq – Korçë. Po ashtu është dhe rruga që lidh pjesën Jugore të Skraparit me Korçën që do të bëhet nga TAP-i.



2. Të dy bashkitë duhet të japin shërbime në zonat e largëta rurale aty ku ka mangësi.

### **Përfaqësuesi i Bashkisë Kolonjë – Paqësor Kajmaku**

Lidhja mund të kryhet në mënyra të ndryshme, ndoshta një ide do të ishte edhe parashikimi i një itinerari të lëvizjes së biçikletave që lidh Moglicën me Voskopojën dhe Vithkuqin.



### **Drejtor i Zonave të Mbrojtura për Rajonin e Korçës – Mihallaq Qirjo**

1. Reforma territoriale ka sjellë edhe një ndarje arbitrare të zonave të mbrojtura. Sugjerimi im është krijimi i një rrjeti ekologjik që lëvizën në këto zona, ndërtimin e një rrugë kalimi nga një bioqëndër në një tjetër. Në pjesën jugore të bashkisë Korçë gjendet Ostrovica e cila për vlerat natyrore që ka duhet vlerësuar, sugjeroj krijimin e një zone të re të mbrojtur. Nga pikpamja e eko-turizmit ta kthejmë në një atraksion.
2. Ndotja e ajrit nga ngrohja e qytetit. Të rikthehet termoizolimi i të gjitha godinave ndërtimeve të reja, të vihet si detyrë konkrete nga bashkia në kërkesat e tyre.
3. Parashikimi i lanfilleve provizore në ato zona rurale të largëta ku dimri është i ashpër e ka vështirësi në kalim. Bashkia si pjesë e saj të ndërmarrë masa për krijimin e tyre në pika të ndryshme.

### **Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Monumenteve të Kulturës – Edvis Koki**

Po kryhet rishikimi i zonave të mbrojtura i zonave Buffer, në shumë objekte ne i kemi të dokumentuara dhe të hedhura në GIS. Ndaj nëse është e nevojshme secila bashki të kërkojë të dhënat që i nevojiten.

### **Drejtorja Rajonale e Bujqësisë Korçë – Vullnet Gjolla**

Mendoj prioritet në strategjitë e zhvillimit do të ishte ngritja e disa frigoriferëve në zonat e nevojshme. Ngritja e zonave grumbulluese është shumë e rëndësishme sepse nga 70.000 ton mollë në vit, vetëm 12.000 ton në vit mund të rezervohen.



Ngrita e tregjeve të shitjes po ashtu është primare sepse edhe ato të 3 tregje ekzistuese nuk janë funksionale.

Mungesa e sistemit të vaditjes. Bashkia Maliq ka filluar pastrimin e fushës së Korçës.

Duhet gjithashtu të bëhet ulja e shtratit të lumit Devoll, zgjidhje do të ishte edhe ngritja e pompave të ujit që të mos kemi përmbytje gjatë muajve me reshje.

Sektori i Kontrollit dhe Zhvillimit të Tokës

  
Edona VENXHA

Drejtoria D.P.K.ZH.T.

  
Zhaneta LUBONJA



# RAPORT

## Forumi Këshillimor i Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë

At, më datë 19.02.2016, u organizua takimi i Forumit Këshillimor të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, me pjesëmarrjen e administratorëve të njësive administrative të bashkisë Korçë, arkitektit Raqi Themeli dhe përfaqësuesit të forumit qytetar vendor Z. Vehbi Ibraxhi. Gjithashtu të pranishëm ishin përfaqësues të studios konsulente dhe pjesëtarë të grupit të punës për hartimin e PPV.



Agjendat e takimit ishte analiza dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese. Qëllimi kryesor i tij ishte marrja e informacionit për zhvillimet dhe prioritetet e zhvillimit të njësive administrative dhe të qytetit të Korçës. Diskutimet e pjesëmarrësve konsistojnë si më poshtë.  
Arkitekti Raqi Themeli u shpreh për disa çështje gjatë takimit duke nënvizuar nevojën që njësitet administrative të kryejnë diskutime dhe me aktorë të tjerë, në mënyrë që paraqitja e



problematikave dhe nevojave të jetë rezultat i një procesi sa më gjithpërfshirës. Është e rëndësishme që njësitë administrative të parashikojnë tendencat e zhvillimit dhe zonimin e territorit të tyre dhe më pas propozimet përkatëse do të shqyrtohen nga studioja konsulente bazuar në kriteret e planifikimit, e cila do të japë propozimin përfundimtar. Ai vlerësoi se informacioni për kategorinë e tokave është shumë i rëndësishëm për procesin e planifikimit dhe se për shkak të mungesës së pronës publike në disa fshatra, është shumë i rëndësishëm përcaktimi i instrumentave të zhvillimit. Studioja konsulente duhet të marrë në konsideratë parashikimet e Planit të Përgjithshëm Kombëtar në hartimin e Planit të përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë. Gjithashtu, Plani Vendor ekzistues i Bashkisë Korçë, ka nevojë për disa përmirësime dhe rregullim të disa problematikave që janë hasur tek ky plan.

Administratori i Njesisë Administrative Drenovë, u shpreh se është e nevojshme të kryhen disa konsultime me banorët dhe aktorët vendorë për të nxjerrë në pah problematikat kryesore në territorin e njesisë Drenovë.

Administratori i Njesisë Administrative Voskopojë, u shpreh se të dhënat për popullsinë nuk janë shumë të detajuara në zyrat e gjendjes civile.

Administratori i Njesisë Administrative Bulgarec, u shpreh se njësia nën administrimin e tij ka hartuar një listë prioritetesh, e cila duhet plotësuar dhe me vlerat përkatëse të investimeve.

Administratori i Njesisë Administrative Mollaj, u shpreh se do i verë në dispozicion studios konsulente Planin e vjetër rregullues dhe se ai vëren se në njësinë e tij administrative banorët po ndërgjegjësohen për nevojën e parashikimeve të zonave të ndryshme në territor, të cilat do të strehojnë aktivitete të ndryshme, të nevojshme për banorët.

Së fundmi, Z. Vehbi Furxhi nënvizoi nevojën për informimin e qytetarëve, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit publik.

Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit

**Zhaneta Lubonja**




Drejtoreshë e D.P.K.ZH.T.



# TAKIME INFORMUESE PËR PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR

Informimi mbi fillimin e procesit për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor ka qenë pjesë e programit të takimeve të Kryetarit të Bashkisë Korçë për buxhetimin me pjesëmarrje. Takimet janë zhvilluar në lagje të qytetit dhe në njësitë e reja administrative gjatë muajve tetor-dhjetor të vitit 2015

## TAKIME NË QYTETIN E KORÇËS



## NJËSIA ADMINISTRATIVE VOSKOP – Takim i datës 20.11.2015





**NJËSIA ADMINISTRATIVE DRENOVË – Takimi i datës 24.11.2015**



**NJËSIA ADMINISTRATIVE BULGAREC – Takimi i datës 27.11.2015**



**NJËSIA ADIMINISTRATIVE MOLLAJ – Takim i datës 15.12.2015**





**NJËSIA ADMINISTRATIVE VITHKUQ – Takim i datës 16.12.2015**



**Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit  
dhe Zhvillimit të Territorit**

**Zhaneta Lubonja**

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Zhaneta Lubonja', written over a horizontal line.

**Drejtoreshë**

**3. Lista e dokumenteve strategjike në nivel kombëtar**

Nr.	Akti miratues	Titulli i Strategjisë	Objekti/ qëllimi i strategjisë
	Ligjit nr.107, datë 31.07.2014	për “Planifikimin e dhe Zhvillimin e Territorit”	Rregullimi e kuadrit ligjor për planifikimin e territorit në Republikën e Shqipërisë
	VKM nr.671, dt.29.07.2015	për “Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”	Unifikimi i formatit dhe procedurave të dokumenteve dhe proceseve të planifikimit në Republikën e Shqipërisë
1	VKM nr. 405, datë 27.6.2012	Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020	Trajton zgjidhjen e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave; integrimin e zonave dhe ndërtimeve informale të legalizuara; përfundimi i regjistrimit fillestar të të gjitha pasurive; digjitalizimi i sistemeve.
2	VKM Nr.797, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut	Të mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe vetë konsumatorët për ushqimet, produkte joushqimore dhe farmaceutikën/medikamente.
3	VKM Nr.773, datë.14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal	Të sigurojë që të gjitha qarqet të jenë në gjendje të kontribuojnë në zhvillimin dhe konkurrencën e qëndrueshme – dhe në këtë mënyrë të reduktojnë pabarazitë sociale dhe ekonomike në të gjithë vendin.
4	VKM Nr.1561, datë 3.10.2008	Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013	Trajton reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimi i integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave në qeverisje
5	Ligji Nr.9322,	Strategjia e sigurisë	Trajton tërësinë e mjeteve dhe



	datë 25.11.2004	kombëtare të Republikës së Shqipërisë	instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme.
6	VKM Nr. 658 , date 17.10.2005	Strategjia e shërbimeve shoqërore	Trajton situatën e nevojave shoqërore, nxit mirëqenien shoqërore dhe synon/lehtëson integrimin e familjeve që jetojnë në kushte varfërie, të grupeve vulnerabël dhe personave me nevoja të veçanta.
7	VKM Nr.643, datë 14.09.2011	Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve	Trajton hartimin e politikave të përshtatshme dhe angazhimin e fondeve të mjaftueshme për të përmirësuar dhënien e shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve, dhe për të ecur në mënyrë të qëndrueshme drejt përputhjes me standardet e BE-së
8	VKM Nr.342, datë 12.3.2008	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013	Dokument i vetëm strategjik (axhenda) për zhvillim ekonomik e social të qëndrueshëm, të harmonizuar me axhendën e integritimit në BE dhe në strukturat e NATO-s, si dhe me atë të realizimit të Objektivave të Mijëvjeçarit.
9	VKM Nr.847, datë 29.11.2007	Strategjia ndërsektoriale e mjedisit	Trajtim modern dhe i integruar i sektorit mjedisor dhe i sektorëve të tjerë me ndikim të fortë në cilësinë e mjedisit si transporti, bujqësia, rregullimi i territorit etj.
10	VKM Nr. 751,	Strategjia sektoriale e	Vendos bazat për përmirësimin e

	datë 7.11.2007	punësimi	sistemit të shërbimeve të punësimi dhe formimit profesional, dhe zbatimit të programeve aktive dhe pasive të punësimi.
11	VKM Nr.924, datë 14.11.2007	Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit	Orienton dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe agropërpunimit
12	VKM Nr.774, datë 14.11.2007	Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural	Shërben si një bazë kombëtare, për zhvillim dhe më pas zbatimin e planeve për zhvillimin rural të rajoneve dhe nënrajoneve të Shqipërisë për të stimuluar qëndrimin dhe rikthimin e banorëve në zonat rurale.
13	VKM Nr.519, datë 20.7.2011	Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë	Trajton përsosjen e sistemit të drejtësisë në RSH, rritjen e aksesit në drejtësi, rritjen e besimit të publikut në drejtësinë shqiptare paralelisht me forcimin dhe rritjen e kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, si dhe nxitjen e përsheptimin e integritetit europian.
14	VKM Nr.80, datë 28.01.2008	Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale	Trajton orientimin e politikave horizontale për reduktimin e varfërisë dhe luftën kundër përjashtimit social.
15	VKM Nr.844, datë 11.06.2008	Strategjia sektoriale e turizmit 2007 - 2013	Merret me strukturimin dhe zhvillimin e turizmit dhe produkteve të tij si prioritete afatshkurtra dhe afatmesme.
16	VKM Nr.59,	Strategjia ndërsektoriale	Progresin e Shqipërisë drejt një

	datë 21.01.2009	e shoqërisë së informacionit	ekonomie të bazuar në njohuritë, përmes një zhvillimi të qëndrueshëm të shoqërisë së informacionit që do të çojë në një shoqëri ku të gjithë qytetarët përfitojnë nga teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit me qëllim shtimin e njohurive, rritjen e efektshmërisë dhe të transparencës në administratën publike.
17	VKM Nr.760, datë 01.09.2010	Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale	Garantimi dhe zhvillimi i një sistemi bashkëkohor të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale në Shqipëri, në funksion të konsolidimit të një sistemi social ekonomik konkurrues me të drejta dhe mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët shqiptarë, në përputhje me të gjitha kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritit të Shqipërisë në BE.
18	VKM Nr.863, datë 29.07.2009	Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009–2015	Përqendrimin e burimeve financiare në grupe kryesore kërkuesish të aftë, për të arritur një nivel ndërkombëtar njohjeje dhe ekselence.
19		Strategjia Kombëtare e Energjisë	Zhvillimi i një sektori energjetik efektiv që garanton sigurinë e furnizimit me burime energjetike në përgjithësi dhe energji elektrike ne veçanti, dhe nxit përdorimin eficient, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që

			sektori energjetik të jetë një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të të gjithë sektorëve ekonomik dhe shoqëror.
20	VKM Nr.175, datë 19.1.2011	Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet	Zhvillimin e qëndrueshëm të vendit duke mbrojtur sa më shumë të jetë e mundur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi dhe duke promovuar vlerat mjedisore
21	VKM Nr.479, datë 29.6.2011	Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025	Përcakton politikat dhe programet e veprimit të menaxhimit të burimeve minerare ekzistuese, si dhe zhvillimin e tyre në perspektivë në përputhje me zhvillimet e reja të ekonomisë shqiptare, prioritetet e zhvillimit të kësaj industrie, me objektivat afatgjatë, objektivat afatmesëm dhe imediatë, vlerësimin e potencialit minerar sipas grup-mineraleve, bazë për vendimmarrjen, planifikimin territorial, zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe infrastrukturës, luftës kundër varfërisë, sidomos në zonat rurale, punësimin në vijimësi, përmirësimin e bilancit valutor të vendit, transparencës dhe luftën ndaj korrupsionit, ka si vizion të saj një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke marrë parasysh impaktet ekonomike, mjedisore dhe sociale, bazuar mbi parimet e ndarjes së të



			ardhurave midis të gjitha niveleve të qeverisjes, kompanive dhe komuniteteve konkurruese për tërheqjen e investitorëve dhe balancuese midis së drejtës së licencës minerare dhe taksimit të industrive përgjatë zinxhirit të vlerës.
22	VKM Nr. 395, datë 21.6.2006	Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor	Perceptimin e Shqipërisë si destinacion i pasur kulturor dhe natyror (imazhi) dhe vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore shqiptare, kuptimi i vlerave nga industria turistike dhe komuniteti i gjerë
23	Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005	Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë	Vlerëson mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të sigurisë, përparimet e bëra në transformimin dhe ristrukturimin.
24	VKM Nr.1214, datë 3.9.2008	Strategjia sektoriale e transportit	Zhvillimin e transportit rrugor në Shqipëri
25	Vendim i KKT Nr. 1, datë 04.07.2013	Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)	Qëllimi i këtij dokumenti është të reflektojë çështjet strategjike, social-ekonomike, mjedisore dhe territoriale që shoqërojnë procesin e planifikimit territorial të projektit TAP në territorin Shqiptar. Planifikimi i territorit është një kërkesë ligjore dhe një domosdoshmëri për zhvillimin e projektit; shtrirja në hapësirë e projektit TAP do të integrohet

			<p>brenda planeve rajonale të zhvillimit dhe do të jetë pjesë e këtyre planifikimeve të territorit. Në datë 20 dhjetor 2012, Këshilli Kombëtar i Territorit, me iniciativën e AKPT dhe në përputhje me propozimin e METE-s, vendosi ta përcaktojë projektin TAP si një çështje me te rëndësisë kombëtare në planifikimin e territorit.</p>
--	--	--	--

#### 4. Vendime të KKT-së dhe KRRTRSh-së 1993-2015 për gjithë territorin e Bashkisë Korçë

Vendim KRRTRSH nr. 3, datë 04.02.1994 “Për planin rregullues dhe vijën kufizuese të qytetit të Korçës”. Sqarim: Në parim VI. Vija periferike të përfshijë fshatrat: Plasë, Malavec, Çiflik, Bulgarec, Fusha e Avionëve, Lumalas, Ravonik, Boboshticë, Drenovë, Mborje, Barç, Kreshpat e maleve, Moravë si dhe zona gjatë rrugës nacionale deri në Libonik.

Vendim KRRTRSH nr. 26, datë 01.12.1998 “Për shesh ndërtimi për vend depozitimi dhe trajtimi të mbeturinave të ngurta urbane për qytetin e Korçës”. Sqarim: Miraton sheshin e ndërtimit me sip. 5ha në Qafën e Qarrit

Vendim KRRTRSH nr. 1, datë 11.08.1999 “Për studimin urbanistik për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonës me përparësi zhvillimi të turizmit në Dardhë – rrethi Korçë”

Vendim KRRTRSH nr. 2, datë 11.08.1999 “Për studimin urbanistik për zhvillimin dhe mbrojtjen e Parkut Kombëtar “Bredhi i Drenovës”, rrethi Korçë”

Vendim KRRTRSH nr. 2, datë 26.01.2001 “Për studimin urbanistik dhe sheshin e ndërtimit për fshatin e ri në territorin midis fshatit Dishnicë dhe fshatit Barç në qarkun e Korçës, për spostimin e familjeve që rrezikohen nga rrëshqitjet e tokës në komunën Lekas të këtij qarku”. Sqarim: Miratohet sip. 8.36ha

Vendim KRRTRSH nr. 1, datë 19.02.2003 “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Korçës dhe vijës kufizuese të kësaj qendre”

Vendim KRRTRSH nr. 1 datë 17.04.2004 “Për miratimin e sheshit të ndërtimit për fushën e depozitimit të mbeturinave urbane të rajonit të Korçës”. Sqarim: Miratohet sheshi me sip. 22ha

Vendim KRRTRSH nr. 7, datë 18.12.2004 “Për pezullimin e vendimeve të KRRT të bashkisë Korçë në qendrën historike të qytetit të Korçës”. Sqarim: Vendos pezullimin e ekzekutimet të vendimeve të KRRT Korçë sipas Vendimit.

Vendim KRRTRSH nr. 13, datë 15.06.2005 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujrave të përdorura të qytetit të Korçës”. Sqarim: Miratohet sip. 13.5ha.

Vendim KRRTRSH nr. 14, datë 15.06.2005 “Për miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit për rrjetin e kanalizimeve në qytetin e Korçës”.

Vendim KRRTRSH nr. 3, datë 07.02.2006 “Për miratimin e studimit urbanistik pjesor, sheshit dhe lejes së ndërtimit për objektin “Burg në fshatin Drenovë – Korçë ””.

Vendim KRRTRSH nr. 7, datë 22.05.2007 “Për miratimin e ndryshimit të Planit Rregullues të qytetit të Korçës, në lidhje me ndryshimin në zonimin funksional për disa zona të qytetit”. Sqarim: Miratohet në 5 zona dhe nuk miratohet në zonën nr. 6, sipas vendimit.

Vendim KRRTRSH nr. 1/5, datë 18.04.2008 “Për miratimin e vijave kufizuese të zonave/vendbanimeve informale në Qarkun e Korçës”.

Vendim KKT nr. 13, datë 07.03.2014 “Për miratimin e Instrumentit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Korçë”.



## Shënime dhe referenca

- <sup>1</sup> Relacioni i të dhënave për Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Korçë, 2016
- <sup>2</sup> Ligj nr. 115-2014, dt.31.07.2014, për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
- <sup>3</sup> Ligj nr. 115-2014, dt.31.07.2014, për “Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”
- <sup>4</sup> Politika e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë, miratuar me vendim të KKT, Nr. 13 datë 07.03.2014, f. 16
- <sup>5</sup> Drejtoria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Rajoni i Korçës, referuar Politikat e Planifikimit të Territorit të Bashkisë Korçë, datë 07.03.2014, f. 18
- <sup>6</sup> Burimi: Dokumenti i Politikës së Planifikimit të Territorit
- <sup>7</sup> Shënim: Në lidhje me numrin e popullsisë në Bashkinë Korçë janë përdorur të dhënat që dalin nga CENSUSI 2011 pasi mbi atë bazë janë llogaritur edhe të dhënat në rang vendi (popullsia e Shqipërisë).
- <sup>8</sup> Shënim: Në numrin e bizneseve të raportuara nga INSTAT për vitin 2015 janë hequr bizneset e deklaruara si “Fermer” për arsye së konsumi I tyre i enërgjisë në mënyrë të përgjithshme është familjar dhe jo biznesor.
- <sup>9</sup> EU situation of Agriculture Data. Te dhenat jane per vitin 2008 dhe supozimi eshte qe konumi mesatar nuk ka ndryshuar shume keto vite.
- <sup>10</sup> Burimi: Bashkia Korçë
- <sup>12</sup> ligji nr. 115/2014, për "Ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë"
- <sup>13</sup> Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në janar të 2016, rezulton se popullsia në qytetin e Korçës është 129'805 banor.
- <sup>14</sup> ligji nr.8906, dt. 06.06.2002 për "Zonat e mbrojtura", i ndryshuar
- <sup>15</sup> ligji nr. 5/2016, për “Shpalljen e moratoriumit të pyjeve në Republikën e Shqipërisë”
- <sup>16</sup> 50'000 në fshatra dhe 80'000 në qytet, duke llogaritur 5m<sup>3</sup> dru zjarri nevoja mesatare vjetore për familje dhe 20'000 familje në qytet e 10'000 familje në fshat.
- <sup>17</sup> për më shumë, lexo në seksionin përkatës të bujqësisë
- <sup>18</sup> për më shumë rreth kësaj çështje, mund t'i referoheni analizës së aseteve vendore më poshtë.
- <sup>19</sup> Për të njohur më mirë problematikat specifike sipas zonave, mund t'i referoheni seksionit të “Profileve të Njësive Administrative”.
- <sup>20</sup> Për të njohur më mirë problematikat specifike sipas zonave, mund t'i referoheni seksionit të “Profileve të Njësive Administrative”.
- <sup>21</sup> Në Korçë dhe në Drenovë
- <sup>22</sup> Për më shumë rreth shpërndarjes së mënyrave të trajtimit të mbetjeve sipas zonave, mund t'i referoheni seksionit të “Profileve të Njësive Administrative”.

<sup>23</sup> Për të njohur më mirë problematikat specifike sipas zonave, mund t'i referoheni seksionit të “Profileve të Njësive Administrative”.

<sup>24</sup> Korça, për të gjithë qytetin ka aktualisht dy linja transporti publik me autobus urban, të cilat nuk mbulojnë të gjithë hapësirën dhe kërkesat për mobilitet për nevojat e qytetit.

<sup>25</sup> Planifikimi për transportin ajror do të trajtohen së bashku me mënyrat e tjera të transportit në Planin Territorial të PPV-së.

<sup>26</sup> Ligji nr. 107, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, Parimet

<sup>27</sup> Vendim nr. 460, datë 16.06.2010, për “Organizimin dhe Funksionimin e Regjistrimit të Planifikimit të Territorit”

## Dokumente strategjike

VKM nr. 405, datë 27.6.2012 “Strategjia ndërsektoriale reforma në fushën e të drejtave të pronësisë 2012-2020”

VKM Nr.797, datë 14.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorëve dhe mbikëqyrjen e tregut”

VKM Nr.773, datë 14.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rajonal”

VKM Nr.1561, datë 3.10.2008 “Strategjia ndërsektoriale e parandalimit, luftës kundër korrupsionit e qeverisjes transparente 2008-2013”

Ligji Nr.9322, datë 25.11.2004 “Strategjia e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”

VKM Nr. 658 , date 17.10.2005 “Strategjia e shërbimeve shoqërore”

VKM Nr.643, datë 14.09.2011 “Strategjia kombëtare sektoriale e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”

VKM Nr.342, datë 12.3.2008 “Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2007-2013”.

VKM Nr.847, datë 29.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale e mjedisit”.

VKM Nr. 751, datë 7.11.2007 “Strategjia sektoriale e punësimit”.

VKM Nr.924, datë 14.11.2007 “Strategjia sektoriale e bujqësisë dhe e ushqimit”.

VKM Nr.774, datë 14.11.2007 “Strategjia ndërsektoriale shqiptare e zhvillimit rural”

VKM Nr.519, datë 20.7.2011 “Strategjia ndërsektoriale e drejtësisë”

VKM Nr.80, datë 28.01.2008 “Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale”

VKM Nr.844, datë 11.06.2008 “Strategjia sektoriale e turizmit 2007 – 2013”

VKM Nr.59, datë 21.01.2009 “Strategjia ndërsektoriale e shoqërisë së informacionit”

VKM Nr.760, datë 01.09.2010 “Strategjia për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale”

---

VKM Nr.863, datë 29.07.2009 “Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009– 2015”

VKM Nr.175, datë 19.1.2011 “Strategjia kombëtare shqiptare mbi mbetjet”

VKM Nr.479, datë 29.6.2011 “Strategjia minerare e Republikës së Shqipërisë 2010- 2025”

VKM Nr. 395, datë 21.6.2006 “Strategjia dhe plani i veprimit për zhvillimin e turizmit kulturor dhe mjedisor”

Ligji Nr. 9419, datë 20.5.2005 “Strategjia ushtarake e Republikës së Shqipërisë”

VKM Nr.1214, datë 3.9.2008 “Strategjia sektoriale e transportit”

Vendim i KKT Nr. 1, datë 04.07.2013 “Planit Kombëtar Sektorial për Gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”

Dokumentet që përcaktojnë zonat e rëndësisë kombëtare, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 16, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, janë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 5 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 18.10.2013, “Për masat emergjente të ndërhyrjes mbrojtëse dhe rehabilituese mjedisore në zonat me rëndësi kombëtare të trashëgimisë kulturore dhe historike”
2. Vendimi nr. 1 i Këshillit Kombëtar të Territorit, datë 09.09.2015, “Përcaktimi si Zona të Rëndësisë Kombëtare në Planifikim, të 64 zonave të mbrojtura të monumenteve të kulturës, të shpallura me urdhër të Ministrit të Kulturës, pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve për periudhën 2014-2015”.
3. Ligj nr. 8906, datë 6.6.2002 “për zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin nr.9868, datë 4.2.2008 “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 “për zonat e mbrojtura”